



## KOHA PËR REFORMA DHE PËRMBYSJE

Prof. Dr. Ksenofon **KRISAFI**/ Prof. Asoc. Dr. Erjona **CANAJ**/ Dr. Afërdita **TEPSHI**/  
 Prof. Asoc. Hemion **BRAHO**/ Prof. Asoc. Dr. Edi **SPAHO**/ Prof. Asoc. Dr. Endirë **BUSHATI**/  
 Prof. Dr. Migena **LESKOVIKU**/ Dr. Evelina **ÇELA**/ Msc. Arjona **KOCIBELLINJ**/  
 Sokol **BANA** PhD/ Dokt. Andja **LEVANAKU**/ Dokt. Ardvin **KRAJA**/ Dokt. Valbona  
**SHUKARASI**/ Dr. Greta **BARDELI**/ Msc. Eglantina **GOLEMI**/ Shkëndi **ÇILI**/  
 Iri **MENGA**/ LL.M. Armer **JUKA**/ Msc. Arjan **KASTRATI**/ Msc. Brikena **MILE**/  
 Dokt. Artan **MANUSHAQE**/ Dnt. Enejda **SHYTI**/ Dokt. Marsidi **GUPI**

# JUS & JUSTICIA NR 13/2016

REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT JURIDIK

Kryeredaktor PROF. ASOC. DR. MIGENA LESKOVIKU ISSN 2223-8654

## *Bordi Editorial*

---

PROF. DR. KSENOFON KRISAFI

PROF. DR. FERIT DUKA

PROF. DR. ROMEO GURAKUQI

PROF. DR. SKËNDER KAÇUPI

PROF. DR. XHEZAIR ZAGANJORI

DR. ÇLIRIM GJATA

DR. SOKOL SADUSHI

DR. NEBI BARDHOSHI

---

## *Arti grafik*

BESNIK FRASHNI

*Jeni të mirëpritur të dërgoni shkrime, recensa librash, përmbledhje punimesh shkencore, monografi apo studime të ndryshme në redaksinë e revistës "Jus&Justicia".*

*Redaksia do t'i shqyrtojë me objektivitet, rigorozitet shkencor dhe konsideratë.*

*Materialet mund të dërgohen në formën Word, në adresën e mëposhtme:*

*migena.leskoviku@uet.edu.al*

© UET Press 2016

Të gjitha të drejtat për këtë botim janë të rezervuara.  
Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet  
përmes çdo mënyre ose mjete pa leje paraprake.

Punimet e paraqitura shprehin mendimet dhe qëndrimin personal të  
autorëve. Redaksia nuk mban përgjegjësi për sa autorët kanë shprehur në  
shkrimet e tyre.

Rruga: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.70, H.1, Tiranë, Albania  
Kodi Postal: 1023  
Tel: +355 4 2421 806  
Web: <http://www.uet.edu.al>

## ARTIKUJ

---

<i>Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale dhe Shqipëria</i> .....	7
<b>Prof. Dr. Ksenofon Krisafi</b>	
<i>E drejta e jetës versus Aborti. Disa reflektime mbi abortin dhe problematikat kryesore në Shqipëri</i> .....	27
<b>Prof. Asoc. Dr. Erjona Canaj &amp; Dr. Afërdita Tepshi</b>	
<i>Një opinion juridik mbi nenin 88 referuar rekomandimeve të komisionit të Venecias mbi reformën në drejtësi</i> .....	55
<b>Prof. Asoc. Hemion Braho</b>	
<i>Agjentët e bursës, aktorë kyç në blerjen dhe shitjen e titujve</i> .....	61
<b>Prof. Asoc. Dr. Edi Spaho</b>	
<i>Kufizimet e pronësisë në median audiovizive</i> .....	75
<b>Prof. Asoc. Dr. Endirë Bushati &amp; Prof. Dr. Migena Leskoviku</b>	
<i>Parimet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të gjykatave ndërkombëtare të arbitrazheve për investimet</i> .....	89
<b>Dr. Evelina Çela &amp; Msc. Arfjona Kocibellin</b>	
<i>Roli i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në interpretimin e rregullave të lëvizjes së lirë të personave</i> .....	101
<b>Sokol Bana PhD</b>	
<i>Risitë e Rregullores nr. 1215/2012 "Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare"</i> .....	115
<b>Dokt. Andja Levanaku</b>	
<i>Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, e ardhmja e shoqërive tregtare</i> .....	127
<b>Dokt. Ardvin Kraja</b>	
<i>Padia si akt procedural i mbrojtjes së të drejtës subjektive</i> .....	135
<b>Dokt. Valbona Shukarasi</b>	
<i>Bashkimi familjar si një e drejtë themelore në ditët e sotme</i> .....	141
<b>Dr. Greta Bardeli &amp; Prof. Asoc. Dr. Erjona Canaj</b>	

<i>Ndërmjetësimi i veprave penale të miturve në Shqipëri.</i> <i>Një disiplinë që duhet të zhvillohet .....</i>	157
<b>Msc. Eglantina Golemi</b>	
<i>Kontrata e porosisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.....</i>	169
<b>Shkëndi Çili</b>	
<i>Rregullimi i marrëdhënieve të punës në Shqipëri sipas ligjit</i> <i>“Për Nëpunësin Civil”, krhasimi me disa nga vendet e botës .....</i>	183
<b>Irisi Menga</b>	

## ARTIKUJ NË ANGLISHT DHE OPINIONE

---

<i>Risk attitudes and litigation: Kahneman and Tversky's fourfold pattern</i> <i>of risk attitudes and its implications on decision making involving</i> <i>litigation and settlement .....</i>	201
<b>LL.M. Armer Juka</b>	
<i>Parashikimi i veprave penale jashtë Kodit Penal dhe ndikimi</i> <i>i tyre në stabilitetin e sistemit juridik penal .....</i>	211
<b>Msc. Arjan Kastrati</b>	
<i>Pse i binden njerëzit ligjit? .....</i>	217
<b>Msc. Brikena Mile</b>	
<i>Legjitimimi i palëve në ngritjen e padisë për çështjet mjedisore.</i> <i>(Rasti i Parkut të Ligenit Artificial Tiranë).....</i>	221
<b>Dokt. Artan Manushaqe</b>	
<i>Vështrim i shkurtër krhasimor ndërmjet legjislacionit të BE-së</i> <i>dhe legjislacionit të SHBA-së në fushën e së drejtës së autorit .....</i>	227
<b>Dnt. Enejda Shyti</b>	

## RECENSË

---

<i>Recensë mbi librin “Pesë leksione mbi konstitucionalizmin”</i> <i>të autorit Spartak Ngjela.....</i>	245
<b>Dokt. Marsidi Gupi</b>	
<i>Abstract .....</i>	251

## ARTIKUJ

# Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale dhe Shqipëria

---

Prof. Dr. Ksenofon Krisafi

---

## Abstract

Nevoja për të garantuar mbrojtjen e pronësisë intelektuale në planin ndërkombëtar u shfaq formalisht për herë të parë në vitin 1873, kur pjesëmarrësit e thirrur për të ekspozuar krijimet e veta intelektuale në Sallonin Ndërkombëtar të Shpikjeve, në Vjenë, shfaqën frikën se punimet mund t'iu shfrytëzoheshin për qëllime tregtare nga vende të tjera. Ngjarja do t'i jepte shkas lindjes së idesë së nevojës për krijimin e një organizmi ndërkombëtar, misioni i të cilit duhet të ishte mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave intelektuale. Ajo u konkretizua dhjetë vjet më vonë, kur në 20 mars të vitit 1883, në kryeqytetin francez, u nënshkrua një marrëveshje, që njihet me emrin Konventa e Parisit Për mbrojtjen e pronësisë industriale. Më 20 shtator 1886, në Bernë nënshkruhet Konventa për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike, e cila krijoi Bashkimin Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale (BNMPI). Selia e tij u vendos në Bernë. Në vijim pati veprimtari dhe akte të tjera të cilat do të çonin në themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale në vitin 1970 dhe që e shndërroi atë në OBPI (WIPO, OMPI). Në vitin 1974, OBPI u bë përfshi në grupin e institucioneve të specializuara të sistemit të OKB. Progresi i veprimtarisë së bashkësisë botërore në fushën e mbrojtjes së pronësisë intelektuale dhe industriale ka qënë i gjithanshëm dhe i ndjeshëm. OBPI garanton të drejtat që lidhen me pronësinë industriale e cila përfshin, siç u tha, krijime që kanë të bëjnë me shpikjet, patentat, vizatime (dizajnet- dizenjot) industriale, veshjet tregtare, markat tregtare dhe të shërbimeve, emrat tregtarë, treguesit gjeografikë, varietetet e reja bimore, tipografite e qarqeve të integruara dhe mbrojtjen nga konkurrenca e padrejtë etj. Prona intelektuale është imateriale (jopasurore), por me karakteristika të ngjashme me pronën reale, sepse ajo mund të shitet, blihet, dhurohet, shkëmbehet, licensohet etj. Pronësia intelektuale është shndërruar prej kohësh në një nga zërat e rëndësishëm të tregtisë ndërkombëtare, sepse aktualisht përdorimi racional i dijeve dhe arritjeve intelektuale të shoqërisë njerëzore ndikon fuqimisht në përparimin

*ekonomik të popujve.* Anëtarë të Organizatës Botërore të Pronësisë Intellektuale janë 189 shtete. Selia e saj aktualisht gjendet në Gjenevë. Shqipëria është anëtare e OBPI prej vitit 1992.

**Fjalë kyçe:** Pronësia intelektuale, pronësia industriale, Organizatë, OBPI (WIPO), konventë, Shqipëri, legjislacion.

## 1. Hyrje

Institucionalizimi i mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të pronësisë intelektuale nisi aty nga çereku i fundit i shekullit të XIX, ndërsa vetë nocioni i pronësisë intelektuale është mjaft i hershëm. Si akti i parë i legjislacionit të brendshëm përmendet një dekret i Venedikut, i 19 marsit 1474, i cili përmban dispozita me karakter të përgjithshëm për sistemin e shpikjeve dhe patentave. Thelbi i tyre përmbledhet në të drejtën e autorit për të pasur autorësinë e veprës apo krijimit të tij, të drejtën për shpërblym dhe detyrimin e shtetit për t'ia mbrojtur atë.<sup>1</sup> Dekreti i Venedikut shërbeu si model dhe si nxitje për vende të tjera për të adoptuar akte për mbrojtjen e pronësisë intelektuale. Thomas Smith shkruante në vitin 1549 se në Venedik dhe në vende të tjera përballë detit e shpërblejnë dhe e inkurajojnë njeriun që sjell ose fut në përdorim çdolloj metode të re ose ndonjë sekret për fabrikim që krijon mundësi për njerëzit për të punuar.<sup>2</sup> Përpunuesit (fryrësit) e xhamit, në kërkim të punës, zhvendoseshin nga një vend në tjetrin duke marrë me vete edhe dokumentin e patentës së prodhimit të tyre, me pretendimin e ligjshëm që të mbanin monopolin e shpikjes që sillnin me vete,<sup>3</sup> e cila iu shërbente shpesh edhe si një lejë qëndrimi e rinovueshme, por me kushtin e transferimit të teknologjisë. Kjo bëhej shkak që ngandonjëherë t'i privonte nga mundësia e rikthimit në Venedik, sepse dhënia e teknologjisë ishte motiv për dënimin e tyre me vdekje. Në Francë patenta e parë për prodhimin e qelqit iu dha Theseus Mutio, nga Bolonja, në vitin 1551.<sup>4</sup> Sistemi i patentave u përhap më vonë edhe në vende të tjera në Europë.<sup>5</sup>

<sup>1</sup> Dekreti konsiderohet si akti që legjitimoi pronësinë intelektuale shumë kohë përpara kodifikimit klasik të Xhon Lokut në shek. XVII. Sipas May, C. (2000), *A Global Political Economy of Intellectual Property Rights. The New Enclosures?* Londres, Routledge, p. 24-26 dhe Phillips, J. (1982), *The English Patent as a Reward for Invention: the Importation of an Idea*, *Journal of Legal History*, n° 3 (1), p. 71-79. Sistemi venedikas i patentave mbron në mënyrë mjaft korrekte « pronarët intelektualë », çka krijoi siguri të ata për t'i importuar në vende të tjera.

<sup>2</sup> Cit. sipas MacLeod, C. (1988), *Inventing the Industrial Revolution. The English Patent System, 1660-1800*, Cambridge, Cambridge University Press., 1988, p. 11.

<sup>3</sup> Frumkin, M. (1945), *The Origin of Patents*, *Journal of the Patent Office Society* n° 27 (3), p. 144.

<sup>4</sup> Mandich, G. (1948), *Venetian Patents (1450-1550)*, *Journal of the Patent Office Society* n° 30 (3), p. 206.

<sup>5</sup> Prager (Prager, F. D. (1944), *A History of Intellectual Property from 1545 to 1787*, *Journal of the Patent Office Society* n° 26 (11), p. 720.

Dekreti i Venedikut ishte akti i parë juridik që legjitimoi pronësinë intelektuale shumë kohë përpara kodifikimit klasik të Xhon Lokut në shek. XVII.

Midis viteve 1750 dhe 1870, në kontinentin europian u vërtetuan ndryshime të rëndësishme që u shprehën në rritjen e qyteteve, ndërtimin e hekurudhave, investimin e kapitalit, rritjen e ekonomisë transoqeanike, zhvillime këto që favorizuan konsolidimin e disa prej elementëve kryesorë të pronësisë intelektuale. Në këtë kohë, në Angli, në vitin 1710, u miratua dhe hyri në fuqi një akt i posaçëm që njihet me emrin Statuti i Anës. Ai kishte si objekt rregullimi kufizimin në kohë të të drejtave të mëparshme të botuesve.<sup>6</sup> Statuti Anës konsiderohet si një ndër aktet e para të plota në rrugën e konsolidimit dhe modernizimit të legjislacionit për të drejtën e autorit në vendet ku zbotohet sistemi i *Common Law*. Ai pati ndikimet e veta edhe në legjislacionin dhe praktikën e vendeve të tjera, përfshirë edhe kontinentin amerikan. Disa prej kolonive amerikane, që prej gjysmës së dytë të shekullit të XVIII, kishin adoptuar akte të posaçme juridike që trajtonin dhënie të patentave. Kurse termi *pronësi intelektuale* shfaqet për herë të parë në ShBA, në tetorin e vitit 1845, në Massachusetts, gjatë shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore që kishte të bënte me një patentë. Në vendimin e gjyqtarit shkruhej ndër të tjera se “vetëm në këtë mënyrë ne mund të mbrojmë pronësinë intelektuale, punën e mendjes, prodhimtarinë dhe interesat që një njeri zotëron ..... sikurse gruri që ai kultivon, sikurse tufa që ai rrit”. Në Europë, ky term në formën *propriété intellectuelle* u përmend në botimin e francezit A. Nion në botimin e tij të vitit 1846, me titull *Droits civils des auteurs, artistes et inventeurs*.<sup>7</sup>

## 2. Historiku i themelimit të Organizatës Botërore të Pronësisë Intellektuale

Nevoja për të garantuar mbrojtjen e pronësisë intelektuale në planin ndërkombëtar u shfaq formalisht për herë të parë në vitin 1873, kur pjesëmarrësit e thirrur për të ekspozuar krijimet e veta intelektuale në *Sallonin Ndërkombëtar të Shpikjeve*, në Vjenë,<sup>8</sup> shfaqën frikën se punimet mund t'iu shfrytëzoheshin për qëllime

<sup>6</sup> Arthur R. Muller, Michael H. Davis, *Intellectual Property*, 1991, West Publishing Company, P.O.BOX 64526, faqe 280.

<sup>7</sup> Alfred Nion, - *Droits civils des auteurs, artistes et inventeurs, ou Applications des dispositions du Code civil, de commerce et de procédure aux droits attribués par les lois existantes aux auteurs et inventeurs en matière d'art, de science, de littérature et d'industrie: mémoire qui a remporté la première médaille d'or au concours ouvert en 1844, entre les docteurs, devant la Faculté de droit de Paris...* Publisher Joubert, 1846, Ghent University, Digitized 8 Jun 2010.

<sup>8</sup> Salloni ndërkombëtar i Vjenës, i quajtur ndryshe edhe Ekspozita universale e 1873 u zhvillua nga 1 maji deri më 31 tetor të vitit 1873, në rezervatin e vjetër të gjuetisë në Prater, afër Vjenës, me temën Arsimit dhe Kultura. Morrën pjesë 53 000 ekspozues. Nga 70 000 shpikje të ekspozuara u shpërblyen 26 002 prej tyre. Citohet nga - *Welt ausstellen. Schauplatz Wien 1873, Technisches Museum Wien* (ISBN 3-902183-10-1), « *Auf Spurensuche in der Landschaft des Wissens.* », p. 55 et suiv.

tregtare nga vende të tjera. Ngjarja do t'i jepte shkas lindjes së idesë së nevojës për krijimin e një organizmi ndërkombëtar, misioni i të cilit duhet të ishte mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave intelektuale. Ajo u konkretizua dhjetë vjet më vonë, kur në 20 mars të vitit 1883, në kryeqytetin francez, u nënshkrua një marrëveshje, që njihet me emrin Konventa e Parisit *Për mbrojtjen e pronësisë industriale*.<sup>9</sup> Ishin përfaqësuesit e 11 shteteve – Belgjikës, Brazilit, Francës, Guatemalës, Holandës, Italisë, Portugalisë, Salvadorit, Serbisë, Spanjës dhe Zvicrës, të cilëve shumë shpejt do t'ju shtoheshin edhe përfaqësuesit e Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Japonisë dhe ShBA, ata që hodhën firmën mbi tekstin e saj, duke i dhënë jetë krijimit të Bashkimit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, struktura institucionale e të cilit mbante emërtimin Zyrë ndërkombëtare.

Nënshkrimi i saj përkonte në kohë me krijimin e dy veprave të famshme me karakter të spikatur intelektual dhe industrial. Fjala është për përfundimin më 24 maj 1883, në Wiesbaden, të kompozimit nga Johan Brahms të Simfonisë së Tretë, një nga krijimet muzikore më të mira të kohës<sup>10</sup> dhe me mbarimin e ndërtimit dhe vënien në përdorim të Urës së varur të Bruklinit, në Nju Jork, pas 14 vjet punimesh, projektuar dhe ndërtuar nga John Roebling<sup>11</sup>, i biri i tij Washington Augustus dhe e shoqja Emily. Këto ishin vepra, krijime dhe prodhime intelektuale dhe industriale të atij lloji, mbrojtja e të drejtave të të cilave në të ardhmen do të bëhej objekt trajtimi dhe rregullimi nga Konventa e Parisit, ajo e Bernës dhe akte të tjera të kësaj natyre.

Konventa e Parisit konsiderohet si instrumenti i parë me karakter juridiko-ndërkombëtar, e cila synonte të mbronte të drejtën e krijuesve të veprave intelektuale nga abuzimet eventuale në vendet e tjera. Ajo mernte në mbrojtje posaçërisht shpikjet, vizatimet ose modelet industriale. Hyri në fuqi më 1884, kur 14 shtetet palë, krijuan Bashkimin Ndërkombëtar të Parisit, organ kryesor i të cilit ishte një Zyrë Ndërkombëtare, që do të kishte si detyrë të përmbushte angazhimet administrative, në mënyrë të veçantë të organizonte mbledhjet dhe

<sup>9</sup> Në vijim Konventa u rishikua disa herë, më 14 dhjetor 1900, në Bruksel, më 2 qershor 1911, në Uashington, më 6 nëntor 1925, në Hagë, më 2 qershor 1934, në Londër, më 31 tetor 1958, në Lisbonë, më 14 korrik 1967, në Stokholm dhe u ndryshua në Gjenevë, më 28 shtator 1979 dhe sërish në Gjenevë më 1 tetor 2003.

<sup>10</sup> Simfonia e tretë e Bramsit konsiderohet edhe si Heroika e Brahmsit ose si « kopshi i ti sekret » dhe një nga simfonitë më të mëha të të gjitha kohërave, një nga disqet më të bukur të të gjithë historisë, siç e ka cilësuar Wilhelm Furtwängler, kompozitor dhe një nga dirigjentët më të mëdhenj të orkestrës filarmonike të Berlinit. *Dictionnaire des disques Diapason: Guide critique de la musique classique enregistrée*, Robert Laffont, 1981 (ISBN 2-221-50233-7), p. 201

<sup>11</sup> Planin për ndërtimin e urës së Brooklyn-it mbi East River në Nju Jork, Roebling e nisi në vitin 1867. Ai mbikqyrte normalisht punimet për ndërtimin e saj, deri sa një ditë aksidentalisht një anije i theu këmbën, çka u bë shkak që 16 ditë më pas të ndrronte jetë. Vendin e tij e zuri i biri Washington Augustus Roebling, i cili i ndihmuar edhe nga bashkëshortja e John-it, Emilia, mori përsipër vazhdimin e punimeve, ndërtimin e projektit më të madh inxhinierik të kohës së vet, urës më të vjetër të varur, të Brooklyn-it, e cila lidhte Manhattan-in me Brooklyn-in. Ajo është e gjatë 1 825 metra dhe kushtoi 18 milionë dollarë të asaj kohe. U hap për qarkullim më 24 maj 1883, pas 14 vjet punimesh.

takimet e përfaqësuesve të shteteve anëtare dhe të përballonte funksionimin dhe përmbushjen e misionit nga ana e Bashkimit.

Më 20 shtator 1886 shënohet një hap tjetër më i rëndësishëm, në Bernë nënshkruhet Konventa për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike, e cila u konsiderua si akt themelor për garantimin ndërkombëtar të të drejtave të autorit. Sfera e veprimt të saj shtrihej në veprat letrare – romane, novela, poema, pjesë teatrale, këngë, opera, komedi muzikore, sonete, vizatime, piktura, skulptura, vepra arkitekture etj. Ajo synonte të siguronte të drejtat e krijuesve të shteteve palë nga abuzimet eventuale në shtetet e tjera si dhe t'i detyronte ata që në rast përkthimi, botimi, interpretimi, shfrytëzimi etj të këtyre veprave, të kryenin shpërblimin përkatës për autorët. Edhe Konventa e Bernës krijoi Bashkimin Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale, e cila gjithashtu, në fillimet e veta, kishte si strukturë institucionale një Zyrë Ndërkombëtare. Detyrat e saj konsistonin në përballimin e angazhimeve administrative që buronin nga përmbajtja e saj. Në vitin 1893 Bashkimet e Parisit dhe ai i Bernës u bashkuan dhe krijuan një organizatë ndërkombëtare që konvencionalisht mori emrin « Bashkimet », sikurse thuhet në nenin 2(iii) të Konventës për themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale. Bashkimet krijuan Zyrat e Bashkuara Ndërkombëtare për mbrojtjen e pronësisë intelektuale (*Bureaux internationaux réunis pour la protection de la propriété intellectuelle* - BIRPI).

Selia e organizatës u vendos në Bernë. Fillimisht veprimtaria e saj përballohej nga 7 punonjës e funksionarë. Ky institucion ndërkombëtar u bë zanafilla e krijimit të një organizate të rëndësishme ndërkombëtare, tepër dinamike, me karakter tekniko-administrativ, që quhet Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (World Intellectual Property Organization – WIPO, Organisation Mondiale de la Propriété Intellectuelle - OMPI). Ajo u themelua nëpërmjet Konventës, nënshkruar në Stokholm, më 14 korrik të vitit 1967 dhe amenduar më 28 shtator 1979.

Në vitin 1970, kur hyri në fuqi Konventa që themeloi Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale, BIRPI, u shndërrua në OMPI – OBPI, duke ndërmarrë njëkohësisht një varg reformash dhe duke u pajisur me një sekretariat solid, funksional, që do të forconte dhe konsolidonte marrëdhëniet me shtetet anëtare.

Në vitin 1974, OBPI u bë përfshi në grupin e institucioneve të specializuara të sistemit të OKB, me mandat administrim e çështjeve të pronësisë intelektuale të njohura nga shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara.

Në përmbushje të misionit të OBPI Sekretariati i tij nënshkroi, në vitin 1995, një marrëveshje bashkëpunimi me Organizatën Botërore të Tregtisë, e cila sapo ishte krijuar, marrëveshje që hyri në fuqi më 1 janar 1996. Qëllimi ishte që të forcohej roli i saj duke dëshmuar njëkohësisht edhe rëndësinë e veçantë që kishte ruajtja e të drejtave të pronësisë intelektuale gjatë shkëmbimeve tregtare.

Progresi i veprimtarisë së bashkësisë botërore në fushën e mbrojtjes së pronësisë intelektuale dhe industriale ka qënë i gjithanshëm dhe i ndjeshëm. Strukturat institucionale të ngritura për zbatimin e konventave përkatëse që prej vitit 1883 e në vijim, kanë zgjeruar vazhdimisht instrumentet institucionale e juridike. Për të krijuar një ide rreth ecurisë së realizuar le të përmendim se në vitin 1898, Zyrrat e Bashkuara Ndërkombëtare për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, administronin vetëm katër traktate ndërkombëtare, ndërkohë që pasardhësja aktuale, OBPI, administron shumë herë më tepër të tilla,<sup>12</sup> nga të cilat disa prej tyre në bashkëpunim me organizata të tjera ndërkombëtare. Mbështetur në marrëdhëniet me shtetet anëtarë dhe në veprimtarinë e Sekretariatit të vet, organizata ka zbatuar një program të pasur dhe të shumëllojshëm veprimtarish, që synon në harmonizimin e legjislacioneve dhe procedurave kombëtare në fushën e pronësisë intelektuale, në ofrimin e shërbimeve për kërkesat ndërkombëtare për titujt e pronësisë industriale, për shkëmbimet e informacioneve në fushën e pronësisë intelektuale, në furnizimin e një asistence juridike dhe teknike ndaj vendeve në zhvillim dhe vendeve të tjera, për rregullimin e mosmarrëveshjeve që lidhen me pronësinë intelektuale etj.

<sup>12</sup> Lista e traktateve të administruara nga OBPI, por edhe nga BNMVRB- Bashkimi Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Varieteteve të Bimëve (UPOV- International Union for the Protection of New Varieties of Plants), OBT dhe OKB, është si vijon: Traktati për të drejtën e patentave (17 maj 2010), Marrëveshja e Strasburgut në lidhje me klasifikimin ndërkombëtar të patentave (24 korrik 2007), Marrëveshja e Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të vizatimeve dhe modeleve industriale (19 mars 2007), Traktati i OBPI për të drejtën e autorit (6 gusht 2005), Marrëveshja e Nicës në lidhje me klasifikimin ndërkombëtar të produkteve dhe të shërbimeve për qëllimet e regjistrimit të markave (19 shtator 2003), Traktati i Budapestit për njohjen ndërkombëtare të depozitimeve të miko-organizmave për qëllimet e procedurës në fushën e patentave (19 shtator 2003), Protokollin për Marrëveshjen e Madridit në lidhje me regjistrimin ndërkombëtar të markave (30 korrik 2003), Traktati i OBPI për interpretimet dhe ekzekutimet dhe fonogramet (20 maj 2002), Konventa për mbrojtjen e prodhuesve të fonogrameve kundër riprodhimit dhe paautorizuar të fonogrameve të tyre (26 maj 2001), Konventa e Romës për mbrojtjen e artistëve interpretues ose ekzekutues, të prodhuesve të fonogrameve dhe të organizmave të radiodifuzionit (1 shtator 2000), Marrëveshja e Madridit në lidhje me regjistrimin ndërkombëtar të markave (4 tetor 1995), Konventa e Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale (4 tetor 1995), Traktati i bashkëpunimit në fushën e patentave (4 tetor 1995), Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike (6 mars 1994), Konventa që themeloi Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (30 qershor 1992). Krahas tyre janë edhe një numër jo i pakët traktatesh shumëpalësh që kanë të bëjnë me aspekte të veçanta të pronësisë intelektuale si p.sh. Protokollin i dytë lidhur me Konventën e Hagës të 1954 për mbrojtjen e pasurive kulturore në rastet e konflikteve të armatosura, Protokollin shtesë i Nagoya – Kuala Lumpur Për përgjegjësinë dhe riparimin lidhur me Protokollin e Kartagenës Për parandalimin i rreziqeve bioteknologjike, Protokollin i Nagoya për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë dhe të ndershme dhe avntazhet që rrjedhin nga përdorimi i tyre në lidhje me Konventën për diversitetin biologjik (12 tetor 2014), Konventa për mbrojtjen e pasurisë kulturore nënujore (19 qershor 2009), Konventa për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjeve kulturore 2005 (18 mars 2007), Konventa për ruajtjen e pasurisë kulturore jomateriale (4 korrik 2006), Konventa universale për të drejtën e autorit e 6 shtatorit 1952, e rishikuar në Paris më 24 korrik 1971 së bashku me protokollet, deklaratat dhe rezolutat përkatëse, Konventa për mbrojtjen e pasurisë botërore kulturore dhe natyrore (10 tetor 1989), Konventa për mbrojtjen e pasurive kulturore në rastet e konflikteve të armatosura (20 mars 1961), Konventa europiane për bashkëprodhimin kinematografik (1 tetor 2010), Konventa për patentën europiane (1 maj 2010) dhe shumë akte të tjerë të kësaj natyre.

### 3. Nocioni i të drejtave të pronësisë intelektuale

Për të kuptuar saktë objektin e OBPI do të ishte mirë të sqarohej shkurt nocioni « mbrojtje e pronësisë intelektuale », i cili ka të bëjë me shërbimin që iu ofrohet autorëve ose trashëgimtarëve të tyre për krijime mendore, intelektuale të tilla si shpikje, vepra letrare dhe artistike, simbole, emra, imazhe, dizajne të përdorura në afarizëm etj. OBPI garanton të drejtat që lidhen me pronësinë industriale e cila përfshin, siç u tha, krijime që lidhen me shpikjet, patentat,<sup>13</sup> vizatime (dizajnë-dizenjot) industriale,<sup>14</sup> veshjet tregtare,<sup>15</sup> markat tregtare dhe të shërbimeve,<sup>16</sup> emrat tregtarë, treguesit gjeografikë,<sup>17</sup> varietetet e reja bimore, tipografite e qarqeve të integruara dhe mbrojtjen nga konkurrenca e padrejtë etj.

Titullarët e të drejtave të pronësisë intelektuale kanë atributin që të lejojnë shfrytëzimin dhe përdorimin e krijimeve të tyre në shkëmbim të kompensimit material për përpjekjet dhe investimet që ata kanë kryer për to ose të ndalojnë të tjerët që t'i përdorin pa autorizim paraprak.

Pronësia intelektuale përfshin gjithashtu edhe të drejtën e autorit (copyright)<sup>18</sup>.

<sup>13</sup> *Patenta* vërteton posedimin e një tërësie të drejtash ekskluzive, të cilat i janë dhënë nga shteti për një periudhë të caktuar kohe, një individ, në shkëmbim të publikimit, sipas përcaktimeve juridike, të një a më shumë pajisjeve, substancave, metodave, proceseve të dobishme të zbatueshme në fusha të caktuara të veprimtarisë si në industri, shërbime etj dhe që sjellin risi. Patenta i jep titullarit një status të caktuar mbi objektin e saj, për një periudhë kohe nga 15 deri 20 vjet, në varësi të përcaktimeve legjislative të shtetit përkatës.

<sup>14</sup> *Të drejtat e dizajnëve (dizenjove) industriale* janë pjesë e rëndësishme e të drejtave të pronësisë intelektuale, që mbrojnë dizajnin vizual të objekteve, i cili nënkupton krijimin e një forme, konfiguracioni ose kompozimi të modeleve ose ngjyrave, ose kombinimin e modeleve dhe ngjyrave në formë tredimensionale dhe që përmbajnë vlera estetike. Dizajni industrial mund të ketë trajtën e një modeli dy ose tredimensional, që përdoret për të prodhuar një produkt, një të mirë industriale ose artizanale.

<sup>15</sup> *Veshjet tregtare* kanë të bëjnë me paraqitje vizuale të një produkti ose paketimi të tij, madje edhe me fasadën e një ndërtese që përdoret për qëllime tregtare ose shërbimi, e cila regjistrohet për t'u mbrojtur ashtu si edhe marka, nga përdorimi i paligjshëm dhe i paautorizuar nga të tjerë persona. Veshjet tregtare përfshijnë formën tredimensionale, dizajnin grafik, ngjyrën, aromën e një produkti dhe/ose paketimin e tij.

<sup>16</sup> Emërtimi *markë* përfshin markat tregtare dhe ato të shërbimit. Marka është shenjë dalluese e një lloji të veçantë që tregon burimin e mallit apo të shërbimit, që është përdorur nga një njësi prodhimi a shërbimi, për të identifikuar në mënyrë unike veten, produktet dhe shërbimet e saj tek konsumatorët dhe për t'i dalluar ato prej atyre të organizatave të tjera. Marka është një nga llojet e pronësisë industriale, e dallueshme prej formave të tjera të pronësisë intelektuale. Ajo mund të shfaqet në formën e një emri, fjale, shprehjeje, logoje, simboli, dizajni, imazhi, ose kombinimi të këtyre elementeve.

<sup>17</sup> Me termin *tregues gjeografik* kuptohet një emër ose shenjë e përdorur mbi produkte, ambalazhin ose paketimin e tyre, e cila i korrespondon një vendndodhjeje gjeografike ose origjine specifike, një qyteti, rajoni ose një vendi. Përdorimi i tij mund të vlerënohet në një çertifikate, që vërteton se produkti ka disa cilësi të veçanta ose një reputacion të caktuar për shkak të origjinës së tij gjeografike.

<sup>18</sup> *E drejta e autorit* i siguron titullarit të saj të drejtat ekskluzive për të riprodhuar dhe shpërndarë veprën, për ta përdorur ose shfaqur atë publikisht edhe pse mund të lejohet që një numër i kufizuar riprodhimesh të veprës së mbrojtur të bëhet prej të tjerëve për qëllime të ndryshme. Për të garantuar më mirë mbrojtjen e të drejtave të autorit veprat e tij mund të regjistrohen në zyrrat ose agjencitë e të drejtës së autorit. Në pjesën më të madhe të vendeve të botës, e drejta e autorit e shoqëron atë gjatë



OBPI ka marrë përsipër të garantojë të drejtat e autorëve për krijimet e tyre në fushat e letërsisë, shkencës dhe artit etj. Sipas nenit 2/viii, të Konventës për themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intellektuale, të Stokholmit, të vitit 1967, pronësia intelektuale përfshin « të drejtat në lidhje me veprat letrare, artistike dhe shkencore, shfaqjet artistike, fonogramet dhe transmetimet, shpikjet në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore, zbulimet shkencore, disenjot industriale, markat tregtare, markat e shërbimit, emrat tregtare dhe emërtimet e origjinës, mbrojtjen kundër konkurrencës së pandershme dhe të gjitha të drejtat e tjera që rezultojnë nga veprimtaria intelektuale, në fushat industriale, shkencore, letrare ose artistike. » Të tilla mund të jenë romane, poezi, krijime skenike teatrore, kinematografike, kompozime muzikore, skulptura, piktura, vizatime, fotografi, vepra arkitekture, koreografike, studime, artikuj dhe botime shkencore e publicistike sidhe krijime të tjera të ngjashme. Të drejtat e autorit përfshijnë gjithashtu të ashtuquajturat të drejta të përafërta me të si e drejta e artistëve interpretues, këngëtarëve, muzikantëve, valltarëve, aktorëve dhe të tjerëve të cilët interpretojnë veprat - produkte të veprimtarisë intelektuale, prodhuesit e fonogrameve, filmave, organizatave transmetuese etj.

Në vijim të trajtimit të kësaj çështjeje me termin « pronësia intelektuale » do të nënkuptohet pronësia industriale edhe të drejtat e autorit së bashku me të drejtat e përafërta.

Prona intelektuale është imateriale (jopasurore), por me karakteristika të ngjashme me pronën reale, sepse ajo mund të shitet, blihet, dhurohet, shkëmbehet, licensohet etj. Pronari i saj ka të drejtë të ndalojë veprimet dhe ndërhyrjet e paautorizuara në pronën e tij. Dallimi thelbësor me format e tjera të pronës është se pronat intelektuale, për shkak se nuk është materiale, nuk mund të përcaktohet nëpërmjet parametrave fizikë.

Aktet juridike për pronësinë intelektuale synojnë të mbrojnë krijuesit dhe prodhuesit e tjerë të pronës intelektuale, nëpërmjet dhënies së të drejtave të kufizuara në kohë për të kontrolluar përdorimin e pronës së tyre.

Prona intelektuale mbrohet si rregull nga legjislacioni i brendshëm i shteteve, por mundësitë e pakufizuara teknike e teknologjike për abuzime me të drejtën e saj si dhe liberalizimi i infrastrukturave dhe globalizimi i shërbimeve, kanë bërë që shtetet të priren drejt harmonizimit të legjislacioneve kombëtare dhe përfundimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, dy ose shumëpalëshe.

Pronësia intelektuale është shndërruar prej kohësh në një nga zërat e rëndësishëm të tregtisë ndërkombëtare, sepse aktualisht përdorimi racional i

dijeve dhe arritjeve intelektuale të shoqërisë njerëzore ndikon fuqimisht në përparimin ekonomik të popujve. Për këtë arsye mbrojtja dhe garantimi i të drejtave që lidhen me pronësinë intelektuale ka pasur dhe ka marrë prioritet të veçantë. Shtetet janë marrë vesh që dallimet eventuale në legjislacionet e tyre kombëtare për këto çështje t'i kapërcejnë nëpërmjet harmonizimit të qëndrimeve dhe zgjidhjeve me anë të traktateve ndërkombëtare, universale dhe rajonale.

#### 4. Objektivat e Organizatës Botërore të Pronësisë Intellektuale

Duke iu referuar Konventës së Stokholmit, 1967 për themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intellektuale, rezulton se objektivat kryesorë të saj janë të nxisë mbrojtjen e pronësisë intelektuale në të gjithë botën nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet shteteve dhe, kur është e përshtatshme, në bashkëpunim me çdo organizatë tjetër ndërkombëtare, si dhe të sigurojë bashkëpunimin administrativ ndërmjet shteteve.<sup>19</sup>

Për arritjen e objektivave të mësipërme organizata nëpërmjet organeve të saj, në përputhje me kompetencat e secilit prej Bashkimeve, ka marrë përsipër që:

- i) të nxitë zhvillimin e masave që synojnë të lehtësojnë mbrojtjen e pronësisë intelektuale në të gjithë botën dhe të harmonizojë legjislacionin kombëtar në këtë fushë;
- ii) të kryejë detyra administrative të Bashkimit të Parisit, Bashkimeve të veçanta të themeluara në lidhje me këtë Bashkim dhe Bashkimit të Bernës;
- iii) të marrë përsipër ose të marrë pjesë në administrimin e çdo marrëveshjeje tjetër ndërkombëtare, që synon të nxisë mbrojtjen e pronësisë intelektuale;
- iv) të inkurajojë përfundimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që synojnë të nxisin mbrojtjen e pronësisë intelektuale;
- v) t'u ofrojë bashkëpunim shteteve që kërkojnë asistencë tekniko-ligjore në fushën e pronësisë intelektuale;
- vi) të mbledhë dhe të përhapë informacione në lidhje me mbrojtjen e pronësisë intelektuale, të kryejë dhe të nxisë studime në këtë fushë dhe të publikojë rezultatet e këtyre studimeve;
- vii) të kryejë shërbimet që lehtësojnë mbrojtjen ndërkombëtare të pronësisë intelektuale dhe, kur është e përshtatshme, të sigurojë regjistrimin në këtë fushë dhe të publikojë të dhënat që kanë të bëjnë me regjistrimin;
- viii) të marrë të gjitha veprimet e tjera të përshtatshme etj.

<sup>19</sup> Neni 3 i Konventës.

## 5. Anëtarësimi

Anëtarë të Organizatës Botërore të Pronësisë Intellektuale janë 189 shtete. Anëtarësimi në Organizatë do të jetë i hapur për çdo shtet, i cili është anëtar i ndonjërit prej Bashkimeve, siç përcaktohet në nenin 2 (vii).

Anëtarësimi do të jetë i hapur edhe për çdo shtet joanëtar të secilit prej Bashkimeve, por vetëm në qoftë se është anëtar i Kombeve të Bashkuara, i agjencive të specializuara që ka lidhje me Kombet e Bashkuara ose Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike ose është Palë në statutin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Ata ftohen nga Asambleja e Përgjithshme për t'u bërë Palë në Konventë dhe në OBPI.

## 6. Struktura e Organizatës Botërore të Pronësisë Intellektuale

Në organet dhe zyrat e saj punojnë rreth 1000 funksionarë e punonjës nga 95 vende. Mandati, misioni, struktura dhe forma e saj zhvillohen dhe përparojnë në këtë sferë interesante të veprimtarisë së shoqërisë njerëzore, në dobi të bashkëpunimit ndërkombëtar të shteteve. Një ndër organet kryesore të saj është Asambleja e Përgjithshme. Neni 6 i aktit themeltar, lidhur me këtë çështje, thotë se ajo përbëhet nga përfaqësuesit e shteteve palë të Konventës, të cilët janë anëtarë të çdonjërit prej Bashkimeve të Parisit, Bernës dhe bashkimeve të tjerë. Qeveria e çdo shteti përfaqësohet nga një delegat, i cili mund të asistohet nga delegatë alternativë, këshilltarë dhe eksperte. Asambleja e Përgjithshme është kompetente të caktojë Drejtorin e Përgjithshëm, sipas rekomandimit të Komitetit të Koordinimit, të rishikojë dhe të miratojë raportet e Drejtorit të Përgjithshëm në lidhje me Organizatën duke i dhënë atij të gjitha udhëzimet e nevojshme, të rishikojë dhe të miratojë raportet dhe veprimtaritë e Komitetit të Koordinimit, që është një organ tjetër i rëndësishëm dhe t'i japë atij udhëzimet e nevojshme, të miratojë buxhetin 2-vjeçar të shpenzimeve të përbashkëta për Bashkimet, të miratojë masat e propozuara nga Drejtori i Përgjithshëm në lidhje me administrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të përmendura në nenin 4 (iii), të miratojë rregulloret financiare të Organizatës, të ftojë shtetet e përmendura në nenin 5 (2) (ii) për t'u bërë Palë të kësaj Konvente etj. Çdo shtet, anëtar i njërit ose i disa Bashkimeve, ka një votë në Asamblesë të Përgjithshme. Kuorumi i saj formohet nga gjysma e shteteve anëtarë. Por pavarësisht nga kjo, në qoftë se, në punimet e ndonjë sesioni, numri i shteteve të përfaqësuara është më pak se gjysma, por gjithësesi, i barabartë ose më shumë se një e treta e shteteve anëtarë të Asamblesë të Përgjithshme, ajo mund të marrë

vendime, por vendimet që kanë të bëjnë me çështje procedurale, merren duke plotësuar disa kushte që kanë të bëjnë edhe me marrjen e mendimit me shkrim dhe votimin e shteteve që nuk kanë marrë pjesë në votim. Ka edhe çështje, miratimi i të cilave merret me votimin e shumicës prej dy të tretave ose tre të katërtave të votave. Këto raste janë të përcaktuara shprehimisht në aktin themelues. Përgjithshëm bëhet për miratimin e një marrëveshjeje me Kombet e Bashkuara, sipas kërkesave të neneve 57 dhe 63 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, për të cilën kërkohet një shumicë prej nëntë të dhjetave të votave.

Asambleja e Përgjithshme mbledhet në sesion të zakonshëm një herë në çdo dy vjet, me iniciativën e Drejtorit të Përgjithshëm. Ajo mbledhet edhe në sesion të jashtëzakonshëm, veçse në këtë rast jo vetëm me nismën e Drejtorit të Përgjithshëm por edhe me kërkesën e Komitetit të Koordinimit, ose të një të katërtës së shteteve anëtarë të Asamblesë të Përgjithshme. Mbledhjet zhvillohen në selinë e Organizatës. Shtetet palë të Konventës, që nuk janë anëtarë të ndonjërit prej Bashkimeve, mund të pranohen në mbledhjet e Asamblesë me cilësinë e vëzhguesit.

Asambleja e Përgjithshme miraton Rregulloren e saj të brendshme.

## 7. Konferenca

Organ tjetër është Konferenca, e cila, sipas nenit 7, përbëhet nga shtetet palë të Konventës, qofshin anëtarë ose jo të ndonjërit prej Bashkimeve. Edhe në Konferencë, ashtu si në Asamble, qeveritë përfaqësohen nga një delegat, i cili mund të asistohet nga delegatë alternativë, këshilltarë dhe ekspertë.

Konferenca ka në kompetencën e saj të drejtën që të diskutojë çështje të interesit të përgjithshëm në fushën e pronësisë intelektuale, duke miratuar rekomandime për çështje që kanë të bëjnë me kompetencat dhe autonominë e Bashkimeve. Ajo miraton buxhetin e saj dy-vjeçar, përpunon dhe miraton programin dyvjeçar të asistencës juridiko - teknike, brenda hapësirave që lejon buxheti i Konferencës, në përputhje me nenin 17 të Konventës, adapton ndryshime në përmbajtjen e saj, përcakton shtetet joanëtare të Organizatës dhe organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare dhe joqeveritare që do të marrin pjesë si vëzhgues në forumet e ndryshme të saj etj.

Në Konferencë kanë të drejtën e votës vetëm shtetet anëtare. Kuorumi i marrjes së vendimeve formohet nga një e treta e shteteve anëtarë, kurse, sipas përcaktimit të nenit 17, ajo i merr vendimet me një shumicë prej dy të tretave të votave.

Konferenca mbledhet në sesione të zakonshme me iniciativën e Drejtorit të Përgjithshëm, në të njëjtën periudhë dhe në të njëjtin vend, kur dhe ku mbledhet Asambleja e Përgjithshme. Ajo zhvillon gjithashtu edhe sesione të jashtëzakonshme, kur thirrja e tyre kërkohet nga Drejtori i Përgjithshëm ose nga shumica e shteteve anëtarë.

## 8. Komiteti i Koordinimit

Neni 8 i Konventës parashikon edhe Komitetin e Koordinimit si një organ me kompetenca të gjera dhe me rëndësi të veçantë për mbarëvajtjen e punës së Organizatës. Ai përbëhet nga përfaqësuesit e atyre shteteve palë të Konventës, që janë anëtarë të komiteteve ekzekutive të Bashkimit të Parisit, të Bashkimit të Bernës ose të të dyve.

Komiteti i Koordinimit është kompetent që t'iu japë këshilla organeve të Bashkimeve, Asamblesë së Përgjithshme, Konferencës dhe Drejtorit të Përgjithshëm, për çështje me karakter administrativ; financiar dhe çështje të tjera me interes të përbashkët, në veçanti për buxhetin e shpenzimeve të përbashkëta për Bashkimet. Ai përgatit projektin e rendit të ditës së Asamblesë së Përgjithshme dhe Konferencës si dhe projekt-buxhetet e tyre.

Komiteti i Koordinimit i rekomandon Asamblesë së Përgjithshme kandidatin për postin e Drejtorit të Përgjithshëm etj. Me iniciativën e Drejtorit të Përgjithshëm mbledhet në sesionet e zakonshëm vjetorë, zakonisht në selinë e Organizatës. Ai mbledhet gjithashtu edhe në sesione të jashtëzakonshëm, me nismën e Drejtorit të Përgjithshëm, kryetarit të tij ose një të katërtës së anëtarëve të vet. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave.

**Zyra Ndërkombëtare** është një prej organeve të organizatës, e cila, sipas nenit 9 të Konventës, kryen funksionet e Sekretariatit. Ajo ndodhet nën autoritetin e Drejtorit të Përgjithshëm, i cili asistohet nga dy ose më shumë zëvendës drejtorë.

**Drejtori i Përgjithshëm**, që është një ndër funksionarët më të lartë të hierarkisë së OBPI, emërohet për një mandat gjashtëvjeçar, me të drejtën e riemërimit. Periudha e mandatit të parë, emërimet e tjera eventuale të mëtejshme dhe kushtet caktohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Drejtori i Përgjithshëm është shefi ekzekutiv i organizatës. Ai e përfaqëson atë në marrëdhëniet me të tretët, duke i raportuar Asamblesë së Përgjithshme për veprimtaritë e brendshme dhe të jashtme të saj. Ai përgatit programet, buxhetin dhe raportet periodike mbi veprimtaritë, të cilat ia transmeton qeverive të shteteve të interesuara, organeve kompetente të Bashkimeve si dhe vetë organizatës.

Drejtori i Përgjithshëm sidhe anëtarë të stafit të caktuar prej tij marrin pjesë pa të drejtë vote, në punimet e Asamblesë së Përgjithshme, Konferencës, Komitetit të Koordinimit dhe çdo komiteti tjetër ose grupi pune. Ata janë *ex officio* sekretarët e këtyre organizmave. Ai emëron stafin e nevojshëm për kryerjen e detyrave të Zyrës Ndërkombëtare, pas miratimit nga Komiteti i Koordinimit cakton Zëvendës drejtorin e Përgjithshëm. Konsideratat kryesore në rekrutimin e stafit kushtëzohen nga nevoja e sigurimit të standardeve sa më të larta të efikasitetit dhe ndershmërisë, duke mbajtur parasysh edhe përfaqësimin gjeografik.

Drejtori i Përgjithshëm dhe stafi në kryerjen e detyrave nuk kërkojnë dhe nuk marrin udhëzime nga asnjë qeveri, ose nga ndonjë autoritet jashtë organizatës. Ata nuk duhet të kryejnë veprime që mund të paragjykojnë pozicionin e tyre si zyrtarë ndërkombëtarë. Nga ana e vet shtetet anëtarë marrin përsipër të respektojnë karakterin ekskluzivisht ndërkombëtar të përgjegjësive të Drejtorit të Përgjithshëm dhe të stafit, pa ndërmarrë veprime apo formuluar kërkesa që mund të ndikojnë në kryerjen e detyrave të tyre.

OBPI ka edhe disa **komitete ad hoc**. Të tillë janë: Komiteti për të drejtën e patentave, Komiteti për të drejtën e markave, dizajneve industriale dhe treguesve gjeografikë (Standing Committee on the Law of Trademarks, Industrial Designs and Geographical Indications SCT), Komiteti për të drejtën e riprodhimit (copyright) dhe të drejtave të lidhura me të, Komiteti mbi standartet e OBPI. Ato formohen nga ekspertë që krijohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme për një qëllim të caktuar.

Në strukturën e OBPI bëjnë pjesë gjithashtu edhe disa **Komitete të përhershme**. Midis tyre përmenden sidomos Komiteti për programin dhe buxhetin, Komiteti i zhvillimit dhe pronësisë intelektuale, Komiteti ndërqeveritar mbi pronësinë intelektuale dhe burimet gjenetike, njohurinë tradicionale dhe folklorin, Komiteti Këshillues mbi zbatimin.

### Selia

Selia e organizatës, sikurse përcaktohet nga neni 10 i Konventës, ndodhet në Gjenevë. Më parë ajo ishte vendosur në Bernë, por në vitin 1960, me qëllim që t'i afrohej sa më shumë OKB dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, u zhvendos në Gjenevë, ku ndodhen selia e degës europiane të Kombeve të Bashkuara dhe e një numri organizatash të tjera.

### Financat

Organizata, sipas nenit 11, ka dy buxhete, ai i shpenzimeve të përbashkëta të Bashkimeve dhe ai i Konferencës. Ato janë të ndara nga njeri tjetri. *I pari* përfshin shpenzimet për mbajtjen e Bashkimeve dhe përballimin e veprimtarive të tyre. Krijohet kontributet e Bashkimeve, pagesat për shërbime të kryera nga Zyra Ndërkombëtare, shitja ose pagesat e publikimeve të Zyrës Ndërkombëtare, dhurata, sende të trashëguara dhe subvencione që mund t'i jenë kaluar organizatës, qira, interesa dhe çdo e ardhur tjetër e organizatës.

*I dyti*, buxheti i Konferencës, përdoret për përballimin e shpenzimeve të mbajtjes së sesioneve të Konferencës dhe për kostot e programit të asistencës juridiko-teknike. Ai financohet nga kontribute të shteteve anëtarë të Konventës, por edhe të shteteve që nuk janë anëtarë të ndonjërit prej Bashkimeve, shumave të të hollave

që Bashkimet i venë në dispozicion të këtij buxheti, të hollave që sigurohen nga shërbime të kryera nga Zyra Ndërkombëtare në fushën e asistencës legalo-teknike, dhurata, sende të trashëguara dhe subvencione që mund t'i jenë kaluar Organizatës nga individë ose donatorëm të ndryshëm etj.

Kontributet vjetore të shteteve ndaj buxhetit të Konferencës, caktohen mbi bazën e një numri njësisish të fiksuara në tre klasa, të ndara përkatësisht në klasën A, e cila përmban 10 njësi, në klasën B që përmban 3 njësi dhe në klasën C që ka 1 njësi. Zgjedhja e klasës, sipas nenit 14, bëhet nga shteti, i cili vendos vetë se cilës dëshiron t'i përkasë.

Vendimi për pranimin e dhuratave, sendeve të trashëguara dhe subvencioneve nga qeveritë, institucionet publike e private, shoqatat ose personat private merret me miratimin e Komitetit të Koordinimit.

## 9. Statusi juridik, privilegjet dhe imunitetet e organizatës

Neni 12 i Konventës përcakton se OBPI, për përmbushjen e objektivave dhe ushtrimin e funksioneve të saj, gëzon zotësi juridike dhe zotësi për të vepruar në territorin e çdo shteti anëtar, në përputhje me ligjet e atij shteti. Në këtë kuadër ajo mund të nënshkruajë marrëveshje për vendosjen e selisë së vet me Konfederatën Zvicerane dhe me çdo shtet tjetër në territorin e të cilit mund të vendosë në të ardhmen selinë e vet. Ajo mund të përfundojë marrëveshje dy ose shumëpalëshe me shtetet e tjera anëtarë, për t'iu garantuar organizatës, zyrtarëve të saj dhe përfaqësuesve të shteteve anëtarë, privilegje dhe imunitetet e nevojshme për përmbushjen e objektivave dhe ushtrimin e funksioneve të saj. Këto marrëveshje negociohet dhe nënshkruhen nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili duhet të ketë marrë paraprakisht miratimin e Komitetit të Koordinimit.

Me cilësinë e subjektit të së drejtës ndërkombëtare OBPI vendos marrëdhënie bashkëpunimi dhe lidh marrëveshje, kur e gjykon të arsyeshme, me organizata të tjera ndërkombëtare, me organizata joqeveritare dhe, me miratimin e qeverive përkatëse edhe me organizata kombëtare, qeveritare ose joqeveritare.

## 10. OBPI dhe Shqipëria

Shqipëria është anëtare e OBPI prej vitit 1992. Ajo ka bërë përpjekje për të përmbushur angazhimet juridiko – institucionale që burojnë nga akti themeltar i organizatës dhe për të siguruar sa më shumë përfitime nga anëtarësia. Çështjet që kanë të bëjnë me pronësinë intelektuale, në të gjitha aspektet e këtij termi, kanë qenë të njohura dhe relativisht të respektuara edhe përpara anëtarësimit të

Shqipërisë në OBPI. Madje edhe në periudhën e regjimit komunist, kur ideologjia e pronës kolektive ishte sunduese ndaj pronës dhe pronësisë private e individuale, Shqipëria kishte një legjislacion që përmbante disa të drejta dhe detyrime për pronësinë intelektuale.

Me përmbysjen e regjimit monist u bënë ndryshime të rëndësishme në konceptet, qëndrimet dhe raportet e Shqipërisë me çështjet e pronësisë intelektuale dhe me OBPI. Këto u pasqyruan në legjislacionin shqiptar të kohës, në pjesëmarrjen e vendit në aktet më të rëndësishme juridiko-ndërkombëtare të kësaj fushe si dhe në anëtarësimin e Shqipërisë në OBPI dhe organizata të tjera, veprimtaria e të cilave lidhej me to.

Marrëdhëniet e saj me OBPI janë mbështetur mbi përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga dispozitat themelore të akteve të Parisit dhe të Bernës si dhe aktet e tjera në zbatim të tyre. Një pjesë kanë gjetur pasqyrim edhe në legjislacionin shqiptar, duke filluar që nga *Kodi Civil i vitit 1929*. Ai shënon përpjekjet e para juridike të mbrojtjes të së drejtës së autorit në Shqipëri, e cila parashikohej si një nga objektet e asaj që quhej e drejta e zotërimit. Ajo sanksionohej si e drejtë e autorit dhe e shpikësve mbi veprat dhe shpikjet e tyre. Objekt i tyre konsideroheshin sendet e patrupëzuara.<sup>20</sup> Neni 794 parashikonte se "zotënimi asht e drejta me gëzue e me disponue sendet pa asnjë kufizim tjetër, jashtë atyne që caktohen me ligjë ose rregullore". Neni 795 thoshte se "produktet intelektuale zotnohen prej auktorëve të tyne simbas rregullave të caktueme në ligjat e posaçme".<sup>21</sup>

Pas Luftës së Dytë Botërore kjo çështje trajtohet për herë të parë në dekret-ligjin e Presidiumit të Kuvendit Popullor nr.538 datë 24.09.1947: *Mbi mbrojtjen e të drejtave të autorëve*.<sup>22</sup> Në vijim, ajo gjen rregullim në nenin 58 të Pjesës së Përgjithshme të Kodit Civil, miratuar me ligjin Nr.2022, datë 02.04.1955, i cili e sanksiononte mbrojtjen e të drejtës së autorit si një nga të drejtat personale jopasurore<sup>23</sup>. Në zbatim të rregullimit të përgjithshëm të saj u aprovuan edhe disa akte nënligjore<sup>24</sup>. Më 22.03.1960 doli dekreti nr 3077 *Mbi të drejtën e autorit, i*

<sup>20</sup> Për hollësi shih nenin 795 të këtij Kodi. Në këtë dispozitë është përcaktuar se cilat janë objektet e të drejtës së zotërimit, duke iu referuar kryesisht sendeve materiale, trupore. Krahas këtij koncepti dispozita jep edhe një mbrojtje të vecantë edhe për zotërimin letrar, artistik dhe industrial, duke iu referuar këtyre të drejtave dhe duke deklaruar se produktet intelektuale zotërohen nga autorët e tyre.

<sup>21</sup> Shih nenet përkatëse në Kodin Civil 1929, Tiranë 2010, botimet Papirus, fq 279.

<sup>22</sup> Gazeta zyrtare Tetor 1947 Dekret Ligja nr.538 datë 24.09.1947 *Mbi mbrojtjen e të drejtave të autorëve*.

<sup>23</sup> Më konkretisht ky nen sanksiononte mundësinë e autorit për mbrojtjen e të drejtave personale jopasurore dhe pasurore nëse atij i cënohej e drejta e emrit ose e pseudonimit, e drejta e autorit në përgjithësi e të tjera. Autori mund të kërkonte nga gjykata njohjen e së drejtës së tij, pushimin e cënimit nga personat e tjerë, apo rivendosjen e të drejtës së autorit në favor të tij. Në qoftë se atij i ishte shkaktuar edhe një dëm pasuror kishte të drejtë të kërkonte edhe shpërblimin nga shkaktimi i dëmit. Të drejtat personale jopasurore mbroheshin edhe pas vdekjes së autorit apo mbajtësit të tyre.

<sup>24</sup> Rregullorja e miratuar me VKM Nr.180, datë 09.06.1977, ndryshuar me Vendimin Nr.248, datë 30.08.1982 *Për shpërblimin e autorëve të veprave letrare, artistike, shkencore e publicistike* si dhe Udhëzimi i Këshillit të Ministrave Nr.1, datë 25.01.1982 *Për shpërblimin e autorëve veprat e të cilëve publikohen jashtë shtetit*.

miratuar me ligjin nr 3172 datë 26.10.1960, si dhe Rregullorja *Mbi shpërblimin e autorëve të veprave letrare, artistike dhe shkencore*.<sup>25</sup> Më pas u miratua Dekreti nr 4389 datë 7.05.1968 «Mbi të drejtën e autorit»<sup>26</sup> dhe në vijim Kodi Civil i vitit 1981, i cili shfuqizoi dekretin e vitit 1968 *Mbi të drejtën e autorit*. Në kreun VII të tij, nenet 315-335, parashikohen dispozitat mbi të drejtën e autorit ku ishte përfshirë edhe e drejta e shpikjes dhe e racionalizimit. Me miratimin e ligjit Nr. 7564, datë 19.05.1992 *Për të drejtën e autorit*, i ndryshuar dhe i plotësuar me akte të tjera ligjore e nënligjore, të drejtat pasurore të autorit u rregulluan në një mënyrë më të plotë. Çështja u bë objekt trajtimi edhe nga aktet bazë të legjislacionit penal dhe civil të vendit. Nenet 148 dhe 149 të *Kodit Penal* trajtonin posaçërisht mbrojtjen e të drejtës së autorit. Kurse në nenet 635 dhe 640 të *Kodit Civil* gjenden përcaktime që kanë të bëjë me shkakimin e dëmit jopasuror kundrejt emrit, personalitetit dhe veprës së një personi, apo me publikimet mashtruese të bëra nga subjekte që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e botimeve.

Përsa i përket pronësisë industriale, si pjesë e pronësisë intelektuale, hapi i parë drejt mbrojtjes së saj, në periudhën e pasluftës në Shqipëri, ishte dalja në vitin 1967 e një dekreti që fliste për markat tregtare. Ai përcaktonte se Dhoma e Tregtisë dhe e Industrisë luante rolin e përfaqësuesit të autorizuar të markave dhe patentave. Pranë saj depozitoheshin markat dhe patentat. Me daljen e ligjit *Për pronësinë intelektuale në Shqipëri*, më 27 prill 1994, dokumentacioni i Dhomës së Tregtisë për veprimtarinë e kryer për depozitim dhe regjistrimin e markave tregtare kaloi në administrimin e zyrës së patentave. Në vitin 1999 u miratuan ligji *Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për pronësinë industriale* dhe ligji *Për mbrojtjen e topografive dhe qarqeve të integruara*.

Në fundin e vitit 1998 u miratua Kushtetuta e Shqipërisë, neni 58 i së cilës kishte përcaktuar se liria e krijimit artistik dhe e kërkimit shkencor, vënia në përdorim, si dhe përfitimi prej arritjeve të tyre janë të garantuara për të gjithë dhe e drejta e autorit mbrohet me ligj. Në zbatim të tij, në vitin 2005 u miratua ligji Nr. 9380, datë 28.4.2005 *Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të*, i cili ka pasur disa ndryshime në vijim. Sipas nenit 1 mbrohen "veprat letrare, artistike e publicistike dhe vepra të tjera, ku futet çdo krijim origjinal e intelektual i kësaj natyre, pavarësisht nga forma e shprehjes si: a) vepra të shkruara, duke përfshirë edhe programe kompjuteri të shprehura në kod burimor ose në kod objekt; b) fjalime, predikime dhe vepra të tjera të shprehura gojarisht; c) vepra muzikore, me ose pa tekst shoqërues; d) vepra teatrale ose teatrale-muzikore; e) vepra koreografike dhe pantomima; f) vepra audiovizuale; g) vepra të arteve të bukura: vizatime, piktura, skulptura, gdhëndje e litografi; h) vepra arkitektonike; i) vepra fotografike; j) vepra të artit të aplikuar; k) ilustrime, harta, plane, skica

<sup>25</sup> Gazeta zyrtare nr. 6, 1960, Dekret nr. 3077 dt. 22.3.1960 *Mbi të drejtën e autorit*, si Rregullorja e aprovuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 155 dt. 22.3.1960.

<sup>26</sup> Gazeta zyrtare nr. 6, viti 1968, Dekreti nr. 4389 dt. 7.5.1968 "Mbi të drejtën e autorit".

dhe vepra tredimensionale në fushën e gjeografisë, të topografisë, arkitekturës dhe shkencës."

Ligji ka rregulluar me imtësi edhe shumë çështje të tjera që garantojnë gëzimin e plotë të të drejtave të autorit. Ai, fjala vjen ka përcaktuar se kush konsiderohet autor, duke stipuluar se i tillë është personi fizik apo grupi i personave që krijojnë një vepër, e cila del me emrin e tij ose të tyre. Sanksionon gjithashtu se autorësia është marrëdhënia juridike ndërmjet autorit dhe veprës, që përfshin elementët që lidhen me objektin, subjektin dhe përmbajtjen e të drejtës së autorit. Në vijim përcakton që titullarët e të drejtës së autorit dhe titullarët e të drejtave të afërta me to, i ushtrojnë ato në mënyrë individuale apo kolektive, me anë të agjensive të administrimit kolektiv. Parimi kryesor është se të drejtat e autorit dhe të drejtat e afërta me to mbrohen nga vet titullarët e tyre, nga një përfaqësues ose nga një agjensi e administrimit kolektiv, e zgjedhur prej tyre.

Në 7.7.2008 Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin Nr.9947, *Për pronësinë industriale*. Neni 1 përcakton se objekti i tij është rregullimi i sistemit të dhënies dhe të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale. Mbrojtja e saj ka si objekte të saj: a) patentat dhe modelet e përdorimit; b) disenjot industriale; c) markat tregtare dhe të shërbimit; ç) treguesit gjeografikë.

Sipas ligjit shpikjet mbrohen nëpërmjet patentave dhe modeleve të përdorimit, të cilat lëshohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM). Disenjot industriale, markat tregtare e të shërbimit dhe treguesit gjeografikë mbrohen nëpërmjet regjistrimit në DPPM. Mbrojtja e mësipërme për disenjot industriale nuk përjashton të drejtat e tjera, që parashikohen në ligj dhe, veçanërisht, të drejtat që bazohen në ligjin *Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera, të lidhura me të*.

Mbrojtja e të drejtave të autorit iu është besuar agjensive të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të afërta me to, të cilat janë në varësi të Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZSHDA), institucion qëndror që ka statusin e personit juridik publik.

Në raportet e Shqipërisë me institucionet ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave të autorit si dhe me anëtarësimin e saj në organizata të tjera ndërkombëtare, janë përcaktuar plotësimi prej saj i disa angazhimeve specifike. Për anëtarësimin në Bashkimin Europian Shqipërisë i është kërkuar përqsja e legjislacionit me direktivat dhe aktet e tjera të BE në këtë fushë, me qëllim që mbrojtja e të drejtave të autorit të realizohet sipas standardeve të vendosura nga aktet e OBPI dhe të Bashkimit Evropian. Është kjo arsyeja që përveç përpunimit dhe miratimit të akteve të legjislacionit të brendshëm në përputhje me përmbajtjen dhe frymën e përgjithshme të dokumenteve juridiko-ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së pronësisë intelektuale, institucionet kompetente shqiptare kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë për plotësimin e

kushteve për pjesëmarrjen e vendit në marrëveshjet ndërkombëtare të kësaj fushe si dhe veçanërisht për zbatimin e tyre.

Në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE, janë përcaktuar detyrime të posaçme që kanë të bëjnë me respektimin e kërkesave që burojnë nga standardet e BE në fushën e mbrojtjes së pronësisë intelektuale dhe asaj industriale. Ato përcaktohen shprehimisht nga nenet 70 dhe 73 të marrëveshjes. Të tilla janë miratimi e një ligji të ri për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të, fuqizimi dhe shtrirja e veprimtarisë së Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit në Zyrat Rajonale për të Drejtën e Autorit, forcimi i rolit të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave, ngritja e një infrastrukture të përshtatshme administrative, institucionalizimi i marrëdhënieve bashkëpunuese me institucionet shtetërore që ndikojnë në procesin e mbrojtjes dhe respektimit të së drejtës së autorit dhe pronësisë industriale, rritja e efikasitetit të luftës kundër piraterisë dhe mallrave të falsifikuara të pronësisë intelektuale nëpërmjet forcimit të mekanizmave ligjorë dhe institucionalë, ndërgjegjësimi i operatorëve ekonomikë që përdorin pronësinë intelektuale, ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e të drejtës së pronësisë industriale, sigurimi i një niveli të njëjtë mbrojtjeje të të drejtave të pronësisë industriale me atë të vendeve të Bashkimit Evropian brenda një periudhe katërvjeçare nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ndërgjegjësimi i institucioneve zbatuese të legjislationit të fushës, përfshirë sistemin gjyqësor, përafrimi i legjislationit kombëtar me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian në këtë fushë, anëtarësimi në traktate, konventa dhe marrëveshje ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale si *Konventa mbi Patentat Evropiane*, adoptuar në Munih, më 5 tetor 1973, e ndryshuar etj. dhe *Traktatit mbi Të drejtën e patentave*, miratuar në Gjenevë, më 2 qershor 2000 etj. Shqipëria duhet të plotësojë gjithashtu detyrimet që rrjedhin nga pjesëmarrja në Organizatën Botërore të Tregtisë, në TRIPS (Aspekte Tregtare të Drejtave të Pronësisë Intelektuale), në Zyrën Europiane të Patentave - EPO etj. Ajo duhet të përmbushë me korrektësi edhe angazhimet që burojnë nga Konventa e Parisit, Konventa e Bernës, Traktati i Budapestit, Marrëveshja e Madridit, Protokollit i Madridit, Konventa e Fonogrameve, Konventa e Romës dhe akte të tjera ku ajo është palë. Ato përcaktojnë parimet kryesore dhe kërkesat minimale për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, të cilat duhet të gjejnë garancitë e duhura juridiko-institucionale në legjislationet e palëve pjesëmarrëse.

Shqipëria, duke aspiruar t'i bashkohet tregut global në çdo drejtim, është përpjekur që, përmes vështirësish të shumta, të respektojë standardet për mbrojtjen dhe përdorimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Pjesë e tyre është zbatimi me rigorizitet i kërkesave që burojnë nga dokumenti strategjik për Pronësinë Intelektuale 2016-2020, për të cilin punojnë një varg strukturash dhe institucioneve kompetente në vend.

## Bibliografia

- Frumkin, M. (1945), *The Origin of Patents*, Journal of the Patent Office Society n° 27 (3).
- Laffont, Robert,- *Dictionnaire des disques Diapason: Guide critique de la musique classique enregistrée*, 1981.
- MacLeod, C. (1988), *Inventing the Industrial Revolution. The English Patent System, 1660-1800*, Cambridge, Cambridge University Press, 1988.
- Mandich, G. (1948), *Venetian Patents (1450-1550)*, Journal of the Patent Office Society n° 30 (3), p. 206.
- May, C. (2000), *A Global Political Economy of Intellectual Property Rights. The New Enclosures?* Londres, Routledge,
- Muller Arthur, R., Michael H. Davis, *Intellectual Property*, 1991, West Publishing Company, P.O.BOX 64526,
- Nion, Alfred - *Droits civils des auteurs, artistes et inventeurs, ou Applications des dispositions du Code civil, de commerce et de procédure aux droits attribués par les lois existantes aux auteurs et inventeurs en matière d'art, de science, de littérature et d'industrie: mémoire qui a remporté la première médaille d'or au concours ouvert en 1844, entre les docteurs, devant la Faculté de droit de Paris...* Publisher Joubert, 1846, Ghent University, Digitized 8 Jun 2010.
- Phillips, J. (1982), *The English Patent as a Reward for Invention: the Importation of an Idea*, *Journal of Legal History*, n° 3 (1).
- Prager, F. D. (1944), *A History of Intellectual Property from 1545 to 1787*, Journal of the Patent Office Society n° 26 (11).
- Welt ausstellen. Schauplatz Wien 1873, Technisches Museum Wien* (ISBN 3-902183-10-1), « *Auf Spurensuche in der Landschaft des Wissens* ».
- Gazeta zyrtare, Tetor 1947, Dekret Ligja nr.538 datë 24.09.1947 *Mbi mbrojtjen e të drejtave të autorëve*.
- Gazeta zyrtare nr. 6, 1960, Dekret nr. 3077 dt. 22.3.1960 *Mbi të drejtën e autorit*.
- Gazeta zyrtare nr. 6, viti 1968, Dekreti nr. 4389 dt. 7.5.1968 *"Mbi të drejtën e autorit"*.
- Kodi Civil 1929, Tiranë 2010, botimet Papyrus.
- Rregullorja e aprovuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 155 dt. 22.3.1960.
- Rregullorja e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.180, datë 09.06.1977, ndryshuar me Vendimin Nr.248, datë 30.08.1982 *Për shpërblimin e autorëve të veprave letrare, artistike, shkencore e publicistike*.
- Udhëzimi i Këshillit të Ministrave Nr.1, datë 25.01.1982 *Për shpërblimin e autorëve veprat e të cilëve publikohen jashtë shtetit*.

*E drejta e jetës versus Aborti.  
Disa reflektime mbi abortin dhe  
problematikat kryesore në Shqipëri \_\_\_\_\_*

\_\_\_\_\_ *Prof. Asoc. Dr. Erjona Canaj* \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ *Dr. Afërdita Tepshi* \_\_\_\_\_

**Abstrakt**

*E drejta për jetën është një e drejtë e paderogueshme, e pandashme dhe e patjetërsueshme e cila lidhet ngushtësisht me qenien njerëzore. E drejta për jetën për nga rëndësia renditet e para duke qenë një nga të drejtat themelore që lidhet me ekzistencën e njeriut. Për shkak të rëndësisë së padiskutueshme të saj, e drejta për jetën gëzon një mbrojtje të posaçme nga instrumentet kombëtare dhe ndërkombëtare. Ato ndalojnë heqjen në mënyrë arbitrare të jetës por në disa raste dhe në disa shtete e legjitimojnë atë, në raste specifike të përcaktuara nga vetë ligji i brendshëm sic është rasti i dënimit me vdekje ose eutanazisë, ndërsa sa i takon abortit, heqja e të drejtës së jetës diskutohet në lidhje me fetusin, si një qenie e palindur.*

*Aborti konsiderohet proces i rëndësishëm i jetës dhe ekzistencës së njeriut, dhe është në një konflikt të hapur dhe të vazhdueshëm në raport me jetën. Aborti është ndërprerja e zhvillimit të fetusit në mitër apo çfarëdo lindje para kohe me qëllim që të shkaktohet vdekja e fetusit. Qëllimi është që të përfundohet jeta e krijesës, që e bën abortin temë të diskutueshme edhe në ditët e sotme. Aborti në vetvete mbetet një çështje delikate. Ai prek nga ana tjetër edhe të drejtat e grave për të vendosur. Në të gjithë botën, aborti është një temë që ka provokuar shumë diskutime dhe debate të cilat vijojnë edhe sot.*

*E drejta e mbrojtjes së embrionit nuk garantohet plotësisht nga shumica e legjislacioneve ndërkombëtare, sepse abortin nuk e konsiderojnë akt penal, por si e drejtë e gruas që të vendosë për fatin e tij. Edhe në Shqipëri aborti rregullohet nga*

*ligji për ndërprerjen e shtatëzaniës dhe shëndetin riprodhues. Këto ligje respektojnë të drejtën e gruas që të marrë vendim të pavarur. Ligjet në fjalë kanë si qëllim të respektojnë në mënyrën e duhur jetën njerëzore. Gjithashtu të të garantojnë barazinë e plotë për gratë dhe t'iu përgjigjen kërkesave të arsyes publike duke mënjeluar në të njëjtën kohë efektet dhe doktrinën e tjera ideologjike apo teologjike që mund të ndikojnë mbi të me argumente të tjera.*

**Fjalët kyçe:** *e drejta e jetës, Neni 2 KEDNJ, mbrojtje substanciale, aborti, fetusit, ligji mbi ndërprerjen e shtatëzaniës dhe shëndetin riprodhues në Shqipëri, aborti selektiv, aborti në moshë të re.*

## 1. Hyrje. Mbrojtja e jetës dhe instrumentet më të njohura ndërkombëtare

Një shoqëri bashkëkohore përmban në vetvete si interes parësor të drejtat e individit<sup>1</sup>. Duke iu referuar zhvillimeve historike të shoqërive, preokupacioni kryesor i të drejtës ka qenë afirmimi i lirive kundrejt krijimit të legjislationit dhe strukturave juridike që nënkuptojnë në vetvete realizimin dhe garantimin e tyre. Në këtë drejtim e drejta e jetës dhe mbrojtja e saj në të gjitha drejtimet mbetet një prioritet. Po kështu, në kuadër të shoqërive bashkëkohore diskutime të shumta vijnë edhe në lidhje me mbrojtjen ose jo të fetusit dhe gjithë diskutimet lidhur me çështjet e abortit. Kuptimi që shkenca mjekësore ka për abortin është *“dhënia fund para kohe dhe shkatërrimi i fetusit të shtatëzaniës, i cili nuk është akoma i aftë për të jetuar jashtë trupit të nënës, gjatë 28 javëve të para. Dhënia fund e shtatëzaniës pas 28 javëve qubet lindje e parakohshme”*. Kuptimi mjekësor i abortit është ngritur mbi konceptet bazë mjekësore që lidhen me procesin e evoluimit të shtatëzaniës. Koncepti juridik i abortit është: *“ndërprerja e qëllimshme e procesit fiziologjik të shtatëzaniës me pasojë vdekjen e fetusit”*.

Shpesh herë termat ndërprerje e shtatëzaniës dhe abort përdoren si sinonim të njëra-tjetres; por diferenca qëndron pikërisht në faktin se koncepti i parë nënkupton vdekjen e fetusit, edhe pse kuptimi gramatikor i tij lejon një interpretim më të gjerë deri në rastin e shkakimit të lindjes së parakohshme. Aborti në legjislatione të ndryshme ka pasur rregullime të ndryshme ligjore, duke u nisur nga Kodi i Hamurabit i cili e konsideronte si faj kryerjen e abortit. Në Romë ku fenomeni i

<sup>1</sup> Një ndër aktet e para nëpërmjet të cilave u mundësua realizimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të drejtës së jetës ishte: Magna Carta (The Magna Carta) e hartuar në vitin 1215. Mbi këtë dokument u realizua hartimi i një sërë dokumentesh të tjera të rëndësishme si: Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit të Revolucionit Francez në vitin 1789 dhe më vonë Karta Amerikane e të Drejtave të Njeriut e vitit 1799. Me anë të këtyre dokumenteve u iniciua respektimi i jetës si ekzistencë dhe si proces duke mundësuar përmirësimin e jetesës dhe duke realizuar mbrojtjen e saj edhe pse e kufizuar. Ky shënoi një hap të rëndësishëm drejt sigurimit të ekzistencës dhe vazhdimësisë.

abortit ishte përhapur më shumë, fetusit nuk mbrohej nga e drejta romake sepse konsiderohej si pjesë e pandarë e trupit të nënës.

Më vonë në legjislationet që pasuan jeta e fetusit filloi të merrej në mbrojtje nga duke filluar nga Kodi i Justinianit i cili parashikonte dënime për abortin. Problemi i abortit në disa vende është lidhur dhe me pikëpamjen se fetusit do të konsiderohej një qenie e gjallë, vetëm kur ai do të kishte shpirt; kështu në Greqinë e vjetër, sipas Hipokratit, fetusit bëhej me shpirt në muajin e tretë të shtatëzaniës, ndërsa sipas Platonit dhe Aristotelit, vetëm pas lindjes.

Periodha e mesjetës ofroi një nivel më të lartë mbrojtjeje ndaj abortit, sepse në të drejtën kanonike, të drejtën franceze, të drejtën gjermane dhe angleze gjatë kësaj periudhe aborti barazohej me vrasjen dhe për këtë arsye këto të drejta parashikonin dënime të rënda deri në vdekje. Kjo tendencë pësoi një ulje nga fundi i shekullit të XVIII dhe në fillimet e shekullit të XIX, sepse u shoqërua me kundërshtime në radhët e dijetarëve dhe juristëve, duke sjellë një farë zbutjeje në dënimet. Konsiderata të tilla mund të thuhet edhe për vendin tonë duke iu referuar të drejtës zakonore<sup>2</sup>.

Koncepti i të drejtave universale të njeriut, u bë i pranueshëm për të gjithë njerëzit vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, kur nga 48 shtete u arrit marrëveshja për Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut. Që atëherë, ky koncept është bërë komponent i pandashëm i sistemit të Kombeve të Bashkuara.

E drejta e jetës është sanksionuar gjithashtu edhe në akte të tjera në nivel ndërkombëtar të tilla si: Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore; Konventa

<sup>2</sup> E drejta zakonore e mbron jetën e gruas shtatëzanë. Kështu, në Kanunin e Lek Dukagjinit vrasja e gruas shtatëzanë gjente rregullim juridik në seksionin e krimeve kundër jetës. (Elezi, 1983:14) Në lidhje me vrasjen e gruas shtatëzënë, normat e Kanunit të Lek Dukagjinit parashikojnë se ai që vret gruan shtatëzënë, qoftë edhe nga pakujdesia, është i detyruar të lajë çmimin e gjakut të gruas dhe të fëmijës. Çmimi i cili do të paguhet për jetën e gruas ishte 3 qese me florinj dhe çmimi për fetusin ishte i njëjlojtë, por nëse fetusit i vrasja ishte mashkull atëherë paguhej dyfishi. Kanuni i Labërisë nuk lejonte të vritej gruaja ose vajza shtatëzënë, nga marrëdhënie jashtëmartesore, pa lindur foshnjën dhe pas lindjes ajo vritej nga prindërit e saj. Në periudhën e Republikës dhe të Monarkisë normat e të drejtës penale përmbanin ndëshkime shumë të rrepta në lidhje me vrasjen e gruas shtatëzënë. E drejta penale socialiste, siguronte mbrojtjen e plotë juridike penale të jetës së personit nga krimet kundër jetës. Kodi Penal i vitit 1952 u kushtonte kreun e IV krimeve kundër personit duke parashikuar llojet e ndryshme të vrasjeve, midis të cilave edhe vrasjen në rrethana të cilësuar ku hynte edhe vrasja e gruas shtatëzënë. Ky qëndrim gjeti pasqyrim të plotë edhe në Kodin Penal të vitit 1977 sepse ky sistem ishte ndërtuar mbi bazën e rëndësisë së marrëdhënieve shoqërore që mbroheshin nga legjislationi penal. Në krimet kundër personit, vendin e parë dhe kryesor e zinin krimet kundër jetës dhe në nenin 84 të këtij Kodi parashikohej figura e veprës penale të vrasjes së gruas duke e ditur që është shtatëzënë. Shih Elezi I., (2002) *Mbrojtja e të drejtës për të jetuar- si e drejta më themelore e njeriut*, kumtesë në Konferencën Kombëtare “Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës”. Elezi, I. 2009, E Drejta Penale, pjesa e posacme, ERIK.Tirane.



Amerikane për të Drejtat e Njeriut; Konventa Afrikane; Konventa e New York-ut për mbrojtjen e fëmijëve e vitit 1989 etj<sup>3</sup>.

Përveç instrumenteve universale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, gjithashtu janë zhvilluar edhe disa sisteme rajonale të të drejtave të njeriut, të cilat zakonisht ofrojnë standarde më të larta për të drejtat dhe implementimin e tyre. Përparësia e sistemeve rajonale qëndron në mundësinë e tyre për adresim më efektiv të ankesave. Po ashtu, gjykatat nxjerrin vendime të karakterit të detyrueshëm për kompensim dhe, në përgjithësi, rekomandimet e Komisioneve për të Drejtat e Njeriut merren seriozisht nga ana e shteteve. Mund të ndodhë që shtetet jo vetëm të interpretojnë dhe sqarojnë dispozitat e instrumenteve për të drejtat e njeriut, por edhe të ndryshojnë legjislacionin e tyre të brendshëm, me qëllim të harmonizimit të tyre me detyrimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Për më tepër, sistemi rajonal ka tendencë të jetë më sensitiv ndaj problemeve kulturore dhe fetare, nëse ekzistojnë arsye të tilla. Sistemi evropian i të drejtave të njeriut ka tri nivele, sistemin e Këshillit të Evropës, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe Bashkimin Evropian. Duke përjashtuar OSBE-në, për shkak të natyrës së të drejtave që ajo mbron (në mënyrë të veçantë për minoritetet)<sup>4</sup>, përgjithësisht në fokusohemi tek sistemi evropian i të drejtave të njeriut i cili është sistemi më i përpunuar rajonal dhe përfshin Bashkimin Evropian dhe Këshillin e Evropës. Ai është zhvilluar si reagim ndaj shkeljeve masive të të drejtave të njeriut gjatë Luftës së Dytë Botërore. Thelbin e rendit ligjor evropian e përbëjnë të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit dhe demokracia pluraliste. Këshilli i Evropës<sup>5</sup>, ashtu dhe Bashkimi Evropian në sektorë më specifike, kanë arritur të krijojnë një legjislacion i cili siguron njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

KEDNJ – ja përfaqëson aktin e parë të Këshillit të Evropës që merret me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Që nga krijimi i saj Konventa i është nënshtuar disa ndryshimeve dhe amendimeve të cilat kanë shërbyer si baza e krijimit të shumë konventave të tjera nga ana e Këshillit të Evropës. Konventa është plotësuar

nga protokollet shtesë që kanë shërbyer për forcimin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut<sup>6</sup>.

Ndërsa Bashkimi Evropian ka në themel vlerat e respektimit të dinjitetit të njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut (neni 2 TBE)<sup>7</sup>. Megjithatë, siç u theksua edhe në paragrafin pararendës, traktatet kanë pasur mungesa në njohjen e të drejtave themelore të njeriut. Një rol shumë të rëndësishëm në njohjen dhe zhvillimin e këtyre të drejtave ka luajtur Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED). Prurjet e jurisprudencës u konfirmuan më pas edhe nga traktatet. Gjykatës së Drejtësisë i është dashur të mbushë këtë mangësi të traktateve<sup>8</sup>. Ajo ka elaboruar në mënyrë të vazhdueshme mbrojtjen e të drejtave të njeriut, derisa ato gradualisht u njohën në mënyrë të shprehur edhe nga traktatet<sup>9</sup>.

<sup>6</sup> Akandji-Kombe Jean-Francois, (2005), *Detyrimet pozitive sipas Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut. Udhërrefyes për përdorimin e Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut*, Këshilli i Europës, Manual i të drejtave të njeriut, fq. 20-35. Council of Europe (ed.) (2000) *Human Rights in International Law*, Basic texts. Strasbourg: Council of Europe Publishing. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut Dobjani E., (2002) Fjala e hapjes në Konferencën Kombëtare “Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës”, mbajtur në Konferencën Kombëtare, “Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës”, Tiranë, Luarasi.

<sup>7</sup> Shih Craig-De Burca, (2013), *E drejta e Bashkimit Evropian*, Oxford (perkt. AIIS). Buonnano, L., & Nugent, N., (2013). *Politikat dhe proceset e politikave të Bashkimit Evropian*, Kosovë: Universum Press; Canaj E.,- Bana S., (2014) *E drejta e Bashkimit Evropian*, Tiranë. *Version i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian dhe i Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian*, (2011), Ministria e Integritimit, Tiranë. Lazowski A., Bushati A., (2014) *Bazat e së drejtës evropiane*, Tiranë; Klaus-Dieter Borchardt, (2011) *ABC-ja e së drejtës së Bashkimit Evropian*. Ministria e Integritimit, Tiranë; Paskal Milo (2002), *Bashkimi Evropian, Ideja, Integrimi, Identiteti, E ardhmja*, Tiranë; *Fjalorth per integrimin evropian, institucionet dhe politikat e Bashkimit Evropian* (2010), Ministria e Integritimit, Tiranë, fq.3-173.

<sup>8</sup> *(Version i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian dhe i Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian*, (2011).

<sup>9</sup> Vetëm me Traktatin e Maastricht-it u aprovua neni “F” (aktualisht neni 6) që, në paragrafin 2, konfirmon se “Bashkimi Evropian respekton të drejtat themelore të cilat janë garantuar nga Traktati i Romës në vitin 1950 mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe të traditave kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare, si parime të përgjithshme të së drejtës komunitare”. Por, norma shtesë në Traktatin e Maastricht-it nuk ishte e mjaftueshme.” Kjo fushë u rishikua më vonë edhe me Traktatin e Amsterdimit. Rëndësia e të drejtave themelore në ndërtuesën evropiane është forcuar dhe respektimi i tyre garantohet në disa drejtime. Neni i ri “f” i Traktatit të BE-së përmban në paragrafin e parë referimin te “parimet e lirisë, të demokracisë, të respektit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, si dhe të shtetit të së drejtës, parime të përbashkëta për shtetet anëtare”, mbi të cilat është themeluar Bashkimi Evropian. Nga ana tjetër, neni “O” sanksionoi respektimin e parimit të sipërpërmendur si kusht për të aderuar në Bashkimin Evropian. Me kalimin e viteve dhe statusi i të drejtave të njeriut në sistemin ligjor të BE-së ka ndryshuar në mënyrë rrënjësore. Një përforcim i të drejtave themelore haset edhe me ndryshimet që i sjell së fundi Traktati i Lisbonës neni 6 TBE. Sipas këtij neni: “1. Bashkimi njëh të drejtat, liritë dhe parimet e sanksionuara në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, të 7 dhjetorit të vitit 2000, të miratuar më 12 dhjetor të vitit 2007, në Strasburg, e cila ka të njëjtën vlerë juridike si dhe traktatet. Dispozitat e Kartës nuk i zgjerojnë në asnjë mënyrë kompetencat e Bashkimit Evropian, të përcaktuara në traktate. Të drejtat, liritë dhe parimet e Kartës interpretohen konform dispozitave të përgjithshme të titullit VII të Kartës, të cilat rregullojnë interpretimin dhe aplikimin e saj, si dhe duke pasur parasysh shpjegimet, të cilave i referohet Karta, që tregojnë burimet e këtyre dispozitave.

<sup>2</sup> *Bashkimi Evropian anëtarësohet në Konventën Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Ky anëtarësim nuk ndryshon kompetencat e Bashkimit Evropian të përcaktuara në Traktate.*

<sup>3</sup> Weston, Burt H. - Stephen P. M., (1999) *The Future of International Human Rights*. New York: Transnational. Akandji-Kombe Jean-Francois, (2005), *Detyrimet pozitive sipas Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut. Udhërrefyes për përdorimin e Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut*, Këshilli i Europës, Manual i të drejtave të njeriut, fq. 20. Janis, M. (2000). *E drejta evropiane e të drejtave të njeriut*. Prishtine. Gruda, Z. (2000). *Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut*. (Volumi 1&2), Prishtinë: TIMEGATE.

<sup>4</sup> OSBE-ja është një organizatë e posaçme, e cila në vitin 1994 ka zëvendësuar Konferencën për Siguri dhe Bashkëpunim të Evropës. Ajo nuk ka ndonjë kartë ligjore ose akt ligjor ndërkombëtar të detyrueshëm, ndërsa deklaratat dhe rekomandimet e saj janë vetëm të natyrës politike dhe nuk janë të detyrueshme për shtetet.

<sup>5</sup> Këshilli i Evropës u themelua në vitin 1949, pas Luftës së Dytë Botërore dhe synimi i tij është të krijojë një hapësirë demokratike e juridike të përbashkët për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe për këtë arsye, në vitin 1950, në Romë, shtetet Palë të Larta Kontraktuese miratuan Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

## 2. Metodologjia e studimit

Objektivi i këtij punimi është që të japë një ide më të qartë të trajtimit të drejtës së jetës në rastet e fetusit dhe çështjet e abortit në nivel evropian dhe në Shqipëri. Aborti në moshë të vogël dhe aborti selektiv janë dy çështjet që prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë vendin tonë.

Ky studim është i bazuar në disa metoda të kërkimit shkencor. Një ndër metodat e përdorura është *metoda e analizës së legjislacionit*. Normat juridike në sistemin tonë ligjor janë të sanksionuara në kushtetutë, kode, ligje. Analizimi i normave juridike dhe e vendime të gjykatave na ka ardhur në ndihmë për trajtimin e këtij studimi. Gjithashtu në aka shërbyer edhe për të sqaruar dhe paqartësitë e normave, vendosjen e tyre në një rend koherent dhe analiza e ndërveprimit të normave të brendshme me ato ndërkombëtare. Pjesë e rëndësishme ka qenë dhe analiza e legjislacionit ndërkombëtar duke mundësuar një krahasim me sistemin e brendshëm në lidhje me të drejtën e jetës dhe çështjet e abortit. Gjatë hartimit të punimit kam përdorur metodat shkencore bashkëkohore. Kemi përdorur *metodën e kërkimit doktrinar* e cila konsiston në gjetjen e literaturës së përshtatshme për realizimin e punimit në përputhje me objektin e tij. Gjithashtu, ndër metodat e përdorura janë edhe metoda *empirike* dhe ajo *krahasimore*. Përmes metodave kërkimore dhe shkencore është tentuar nxjerrja në pah e karakteristikave dhe parimeve kryesore të së drejtës së jetës dhe abortit.

Një metodë tjetër po aq e rëndësishme është *metoda cilësore e intervistës* e realizuar kjo në funksion të problematikave kryesore që hasen në Shqipëri lidhur me trajtimin e fetusit dhe abortit. Intervista është zhvilluar në funksion të evidentimit në *praktikë* të problematikave që lidhen me abortin në vendin tonë. Metoda e *analizës së praktikës gjyqësore* është përdorur në punim me synimin për të parë mënyrën e interpretimit dhe zbatimit në praktikë të normave ligjore në lidhje me mbrojtjen e të drejtës së jetës dhe abortit<sup>10</sup>.

<sup>10</sup> *drejtat themelore të sanksionuara nga Konventa Evropiane për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe ato që rezultojnë nga praktikat kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare janë pjesë e së drejtës së Bashkimit Evropian si parime të përgjithshme*. Craig-De Burca, (2013), *E drejta e Bashkimit Evropian*, Oxford (perkth. AHS). Buonnano, L., & Nugent, N., (2013). *Politikat dhe proceset e politikave të Bashkimit Evropian*, Kosovë: Univerzum Press; Canaj E., - Bana S., (2014) *E drejta e Bashkimit Evropian*, Tiranë. *Version i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian dhe i Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian*, (2011), Ministria e Integritimit, Tiranë. Lazowski A., Bushati A., (2014) *Bazat e së drejtës evropiane*, Tiranë; Klaus-Dieter Borchardt, (2011) *ABC-ja e së drejtës së Bashkimit Evropian*. Ministria e Integritimit, Tiranë; Paskal Milo (2002), *Bashkimi Evropian, Ideja, Integritimi, Identiteti, E ardhmja*, Tiranë; *Fjalorth për integritimin evropian, institucionet dhe politikat e Bashkimit Evropian* (2010), Ministria e Integritimit, Tiranë, fq.3-173.

<sup>10</sup> Intervistat janë shtrirë në dy spitale shtetërore në rrethin e Tiranës dhe në disa klinika private në rrethin e Tiranës dhe të Durrësit. Të intervistuarit janë mjekë obstetër gjinekologë. Rezultatet e këtyre intervistave janë përpunuar për të nxjerrë të konkluzione dhe rekomandime.

## 3. Rishikimi i literaturës

Çështjet që lidhen me të drejtat që gëzon fetusit kanë bërë që të ngrihen debate dhe diskutime të shumtapër lejimin apo jo të abortit, pra, ndërprerjen e shtatëzanisë. Koncepti i “*të qenurit shtatzënë*” nuk është term shkencor, por është një term informal i cili i referohet procesit të fertilizimit. Studime të ndryshme me karakter mjekësor kanë vërtetuar se një numër i konsiderueshëm shtatëzanish përfundojnë në aborte të padëshirueshme. Ende sot komuniteti shkencor dhe ai mjekësor nuk kanë arritur të na ofrojnë një përcaktim të saktë në lidhje me momentin e fillimit të jetës. Konsensusi është gjetur vetëm në lidhje me fazat e progresit të shtatëzënisë së gruas.

Në këtë artikull kemi trajtuar të drejtën e jetës, legjislacionin ndërkombëtar dhe shqiptar edhe në rastin e fetusit. Analizën tonë e kemi filluar me një vështrim të përgjithshëm mbi të drejtën e abortit dhe kuptimit ligjor të së drejtës së fetusit për të jetuar, nga ku janë ngritur diskutime dhe polemika të ndryshme, siç është pyetja: “kur fillon jeta” dhe “kur mbaron ajo”. Duke u mbështetur në doktrinën dhe praktikën gjyqësore të huaj dhe të Gjykatës së Strasburgut, si dhe në legjislacionin shqiptar këto pyetje kanë marrë përgjigje të ndryshme.

Pasi kemi analizuar këto çështje, trajtesa ka kaluar në një tjetër këndvështrim, ku fokus të veçantë i kemi dhënë të drejtës së gruas për të ndërprerë shtatëzaninë dhe e drejta e fetusit për të jetuar. Të njëjtën trajtesë kemi bërë edhe në rastin e kundërt, ku kemi trajtuar aspektet penale të ndërprerjes së shtatëzënisë pa pëlqimin e gruas. Duke analizuar këtë të drejtë në vendin tonë, kemi konstatuar se problematikat në vendin tonë lidhen me abortin selektiv si dhe abortin në moshë të re, problematika të cilat trajtohen gjerësisht në këtë studim.

E drejta e jetës është parashikuar në nenin 2 të KEDNJ-së sipas të cilit:

“1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.

2. Marrja e jetës nuk konsiderohet të jetë shkaktuar në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ajo vjen si pasojë e përdorimit të forcës, që është jo më shumë se absolutisht e nevojshme:

a. në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme;

b. për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të cilit i është hequr liria ligjrisht;

c. për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.”

Neni 2 përmban dy elementë thelbësorë që pasqyrohen në dy paragrafët e tij: një detyrim të përgjithshëm për të mbrojtur të drejtën për jetën “me ligj” (paragrafi 1) dhe ndalimin e privimit të jetës në rastet përjashtuese (paragrafi 2)<sup>11</sup>.

Ajo që përbën një nga elementet më të rëndësishëm dhe më interesante të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, është se të gjitha të drejtat e përmendura më lart në strukturimin e saj janë të përfshira nën rolin themelor të dy dispozitave që garantojnë, të parashikuara nga neni 1 dhe neni 13 i Konventës. Konkretisht, me anë të Nenit 1 të gjitha shtetet anëtare marrin përsipër që t’u sigurojnë të gjithë individëve, pra jo vetëm shtetasve të tyre, që gjenden nën juridiksionin e tyre të drejtat e parashikuara nga Titulli I i Konventës, dhe me anë të Nenit 13 ato angazhohen t’u japin këtyre individëve mundësitë për ankim efektiv për vënien në vend të shkeljes eventuale të këtyre të drejtave<sup>12</sup>. Konventa nuk jep një përcaktim të qartë për jetën, gjithashtu ajo nuk përcakton kufijtë e fillimit dhe të përfundimit të mbrojtjes që kjo Konventë i bën të drejtës së jetës. Për këtë arsye por dhe për shkak të mungesës së një kompromisi ligjor në nivel europian dhe shkencor në lidhje me çështjen, tashmë i përket hapësirës së vlerësimit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Sipas Gjykatës shtetet duhet të shohin Konventën si një “*instrument jetik që duhet të interpretohet nën dritën e kushteve të ditëve të sotme*”. Të drejtat dhe liritë e sanksionuara në Konventën Europiane të të drejtave të Njeriut u bënë objekt i shqyrtimit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në raport me çdo të drejtë të cënuar në të. Gjykata Europiane e të drejtave themelore të Njeriut është kompetente që të kontrollojë dhe sigurojë respektimin e së drejtës në interpretimin dhe zbatimin e normave të përcaktuara në KEDNJ nga ana e institucioneve legjislativë dhe ekzekutive të Palëve të Larta Kontraktuese. Kjo Gjykatë, nëpërmjet numrit dhe gamës shumë të madhe të çështjeve, që ka trajtuar dhe që ka zgjidhur, i ka dhënë vetë Konventës një hapësirë dhe shtrirje, me të vërtetë të madhe për nga pikëpamja e zbatimit të neneve të saj. Jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut thekson se e drejta e individit për jetën mbrohet nga neni 2 i KEDNJ-së, por njëkohësisht, edhe nga neni 8 i kësaj Konvente nën i cili mbron dhe garanton dhe të drejtën e individit për “jetë private dhe familjare”. Ky nen ka për qëllim ndalimin e ndërhyrjes së shtetit në jetën private dhe familjare të individëve. Në vitin 1976 Komisioni për të drejtat e njeriut, ka konstatuar se neni 8 i KEDNJ-së është i zbatueshëm për çështjet e abortit pasi legjislati përmes të cilit rregullohet ndërprerja e shtatëzanisë prek

<sup>11</sup> Daci, J. (2011). *Të drejtat e njeriut*. botimi i III, Tiranë: Julvin 2. Ilir Panda, (2002) *E drejta e jetës sipas Konventës europiane për të drejtat e njeriut*, kumtese e mbajtur në Konferencën Kombëtare, *Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës*, Tiranë, Luarasi. Elezi I., (2002) *Mbrojtja e të drejtës për të jetuar- si e drejta më themelore e njeriut*, kumtesë në Konferencën Kombëtare “Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës”.

<sup>12</sup> Shih për një analizë të detajuar të nenit 13 KEDNJ Evis Alimehmeti; Ermir Dobjani; Oriona Muçollari *Neni i 13 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Lirive Themelore të Njeriut dhe kuadri ligjor shqiptar*. Tiranë.

sferën e jetës private, kjo sepse kur femra është shtatëzënë, jeta e saj ndërlihet ngushtë me fetusin në zhvillim.

Ky aspekt sqarohet edhe më tej pasi neni 8 të KEDNJ-së nuk mund të interpretohet se lejon të drejtën për abort, por vë theksin te e drejta e femrës për respektimin e integritetit të saj fizik dhe psikologjik, qartazi të paraparë në nocionin e “jetës private”. Në këtë aspekt, shtetet kanë detyrimin që të sigurojnë shërbimet e tyre në atë mënyrë që respekti për lirinë e profesionistëve mjekësorë në praktikë, të mos pengojë ushtrimin e të drejtës për ato shërbime për gratë shtatëzëna. Megjithatë, përfundimi i shtatëzanive përfshin jo vetëm të drejtat e nënave të ardhshme, por edhe të baballarëve. Nisur nga ky qëndrim gjyqtarë e Strasburgut arritën në përfundimin se të drejtat e mundshme të babait për respektimin e jetës së tij private dhe familjare nuk mund të interpretoheshin aq gjerë sa për të futur të drejtën e konsultimit apo të ngritjes së padisë në gjykatë lidhur me abortin e kërkuar nga bashkëshortja e tij, pasi respekti për jetën private të gruas shtatëzënë “personi kryesor lidhur me shtatëzaninë” interpretohet nga ana e Gjykatës si mbizotërues ndaj cilësdo të drejte të babait. Si përfundim, ankesa e babait në rastin *Boso* se vendimi i gruas për kryerjen e abortit nuk ishte diskutuar me të, është refuzuar si i pabazë. Praktika gjyqësore tregon se kur bëhet fjalë për interesat e dy prindërve të ardhshëm, vendimi i gruas për të mos u bërë prind mbizotëron ndaj atij të burrit për t’u bërë prind. Nëse rrezikohet integriteti trupor i nënës, mbizotërimi i të drejtave të saj për autonomi bëhet pothuajse automatik. Ndërkohë që në rastet e abortimit, Gjykata ka konstatuar se të drejtat e babait janë dytësore krahasuar me ato të nënës, pikëpamja ndryshon kur vendimi ka të bëjë me fillimin e shtatëzanisë. Në rastin *Evans*, Gjykatës i’u dha mundësia për të analizuar zbatimin e dispozitave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut lidhur me “teknologjitë e reja riprodhuese”, dhe me të drejtat e marrëdhëniet me riprodhimin. Rasti kishte të bënte me nxjerrjen e vezëve nga vezoret e paditëses për trajtimin *in vitro* (IVF). Paditësja është ankuar se ligjet vendore lejonin ish-partnerin e saj për të tërhequr kontratën e tij për ruajtjen dhe përdorimin e vazhdueshëm të embrionit, duke ia hequr mundësinë asaj që të ketë fëmijë, me të cilin ishte e lidhur gjenetikut. Fillimisht, Gjykata konstatoi se koncepti i “jetës private” përfshin të drejtën e respektimit të vendimit për t’u bërë prind gjithashtu nënvizoi se si mashkulli, ashtu edhe femra, që i hyjnë trajtimit *in vitro* (IVF-së) meritojnë trajtim të barabartë, përkundër përfshirjes së tyre të ndryshme në procedurë dhe rrjedhimisht, ruajta dhe implantimi i vezoreve të fertilizuara kërkon dakordësinë e vazhdueshme të të dyja palëve. Kohëve të fundit kjo dispozitë është interpretuar se gjithashtu përfshin zgjedhjen se si të bëhesh prind<sup>13</sup>.

<sup>13</sup> Tepshi A., (2016) *E drejta e jetës*. Mbrojtja e kësaj të drejte referuar nenit 2 KEDNJ. Çështjet e fetusit, abortit dhe eutanazisë. Punim doktorature on line <http://www.uet.edu.al/index.php/sq/publikimet>

Gjykata konstatoi se nocioni i autonomisë personale është parim themelor i interpretimit të garancive të parapara në nenin 8 të KEDNJ-së, prandaj, e drejta lidhur me vendimin për t'u bërë prind përfshin të drejtën e zgjedhjes së rrethanave të bërjes prind. Gjykata mendon se rrethanat e lindjes gjithsesi janë pjesë e pakontestueshme e jetës private të personit sipas kësaj dispozite.

Në Shqipëri aborti është i rregulluar sipas ligjit dhe urdhëresave të Ministrisë së Shëndetësisë për abortin. Ligji nr.8045, datë 07.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë” dhe Ligji nr.8876, datë 4.4.2002, “Për shëndetin riprodhues”, përfaqësojnë mjete të rëndësishme në kuadrin ligjor shqiptar, në lidhje me të drejtat riprodhuese. Ligji Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë” përkohet nga parimi se “Çdo grua ka të drejtën e informacionit të saktë dhe të këshillimit para ndërprerjes së shtatëzanisë”<sup>14</sup>. Në këtë kuadër, një rol të rëndësishëm ushtrojnë këshillimoret që ndodhen pranë çdo lagjeje. Mjekët dhe personeli i tyre, këshillojnë gratë me të gjithë informacionin e nevojshëm. Gjithashtu, ligji lejon ndërprerjen e shtatëzanisë vetëm me pëlqimin e gruas. Gjithsesi, parashikohet se, kur është e mundur, në këshillim dhe në marrjen e vendimit për ndërprerjen e shtatëzanisë, merr pjesë edhe bashkëshorti, ose prindi.

Ligji “Për shëndetin riprodhues” parashikon se, “Çdo grua, e lirë dhe e përjashtuar nga çdo formë diskriminimi, detyrimi dhe dhune, ka të drejtë për t'u kontrolluar e për të vendosur lirisht për të gjitha çështjet që lidhen me seksualitetin e saj dhe shëndetin seksual e riprodhues”<sup>15</sup>. Gjithashtu, sanksionohet e drejta e çdo individi për të zgjedhur marrëdhënien seksuale dhe për të kontrolluar jetën riprodhuese. Kjo zgjedhje nënkupton se asnjë grua nuk mund të detyrohet të jetë shtatëzënë dhe se, çdo ndërhyrje mjekësore e lidhur me shëndetin riprodhues dhe seksual duhet të kryhet me pëlqimin e saj<sup>16</sup>. Ligji Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë” parashikon në nenin 3 të tij se “*Ndërprerja e vullnetshme e shtatëzanisë bëhet vetëm nga mjeku specialist obstetërgjinekolog në institucione shëndetësore shtetërore e private që plotësojnë kushtet e përcaktuara në udhëzimin përkatës të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit*”. Pra, ligji parashikon se ndërprerja e shtatëzanisë realizohet vetëm nga mjeku duke ndaluar në këtë mënyrë ndërprerjen e shtatëzanisë nga persona të paautorizuar të cilët mund ti shkaktojnë dëme serioze shëndetit të nënës. Rastet kur konsiderohet shkak shëndetësor i justifikuar janë të parashikuara në Ligjin Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë” dhe vlerësohen me raport nga ekspertimi mjekoligjor kur:

- nga vazhdimi i shtatëzanisë dhe/ose lindja e fëmijës rrezikohet jeta ose shëndeti i gruas,<sup>17</sup>

<sup>14</sup> Ligj nr.8045, datë 07.12.1995, “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”, neni 2, pika 2.

<sup>15</sup> Ligj Nr. 8876, datë 4.4.2002, “Për shëndetin riprodhues”, neni 6, pika 1.

<sup>16</sup> Anastasi, 2013: 35.

<sup>17</sup> Shih nenin 9 paragrafi 1 Ligjit Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”

- fetusi ka keqformime të papajtueshme me jetën, apo sëmundje invaliduese me trajtim të pasigurtë,<sup>18</sup>
- shtatëzania i krijon probleme psikosociale gruas,<sup>19</sup>
- shtatëzania është rezultat i përdhunimit ose një krimi tjetër seksual,<sup>20</sup>
- vërtetohen arsye të tjera sociale.

Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit përcakton me udhëzim të veçantë përmbajtjen, mënyrën e hartimit dhe shpërndarjes së materialeve udhëzuese<sup>21</sup>. Mendojmë se e rëndësishme në këtë aspekt është vlerësimi nga ana e komisionit apo gjykatës, në bazë të kriterit të “cilësisë së jetës”, të vlerësuar edhe nga gjykata e Strasburgut, i cili gjen vend në ligjin tonë në trajtën e kriterit “të papajtueshme me jetën”. Kjo do të thotë që pasojat e keqformimit të jenë të tilla që denigrojnë të ardhmen e fëmijës dhe ulin rëndë dinjitetin e tij, si dhe i shkaktojnë vuajtje të rënda fizike dhe mendore, ankth e shqetësim. Në këtë aspekt, me keqformime të papajtueshme me jetën, apo sëmundje invaliduese me trajtim të pasigurt, të përfshihen keqformime apo sëmundje serioze dhe jo ato që janë vetëm të padëshirueshme për prindërit apo për shoqërinë.

Duke iu referuar nenit 1 të ligjit “Për ndërprerjen e shtatëzanisë” i cili parashikon se: “*Ligji garanton respektimin e çdo genieje njerëzore që në fillim të jetës*”, ky parim nuk shkelet, përveç rasteve kur është e domosdoshme dhe në kushtet e përcaktuara në këtë ligj.” Dispozitat e Kodit Penal, nga ana tjetër, nuk nxjerrin jashtë ligjit abortin në vetvete, por mbrojnë shëndetin e gruas nga praktikatat e jashtëligjshme të personelit mjekësor. Kjo edhe për arsye se në balancimin midis sakrificimit të të konceptuarit dhe të drejtës për mbrojtjen e shëndetit të gruas shtatëzënë, përparësi ka kjo e fundit. Për më tepër edhe në praktikën gjyqësore shqiptare, nuk njihet ndonjë rast ku të jetë dënues ndonjë person, kur ka shkaktuar një abort që vjen në kundërshtim me rastet dhe rregullat e parashikuara nga Ligji Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”. Gruaja është përjashtuar si subjekt i veprës penale, në ndryshim nga Kodi Penal i mëparshëm. Nuk ka përgjegjësi penale gruas shtatëzënë kur ndërprerja e shtatëzanisë kryhet prej saj ose nga persona të tjerë, me pëlqimin e saj, jashtë rasteve të përcaktuara në ligj.

Nga sa më lart mendojmë se as legjislacioni shqiptar nuk e mbron të drejtën e jetës që me konceptimin e tij, por kur në Kushtetutë parashikohet se jeta e personit mbrohet me ligj, me person do të kuptohet vetëm çdo njeri i cili ka lindur dhe jo fetusi i ngjizur.

<sup>18</sup> Shih nenin 9 të Ligjit Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”

<sup>19</sup> Shih nenin 10 i Ligjit Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”

<sup>20</sup> Neni 11 Ligjit Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”

<sup>21</sup> Neni 5 i Ligjit Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”

Të drejtat e fetusit kristalizohen dhe mund të ushtrohen vetëm pas lindjes<sup>22</sup>. Por, nëse fetusi lind gjallë, mund të kërkohet dëmi i shëndetit të fetusit shkaktuar nga veprimet e mjekut, para se të vinte në jetë. Në një vendim të Gjykatës së Lartë Spanjolle, mjeku u deklarua fajtor për mjekim të pakujdesshëm, pasi dështoi në dhënien e ndihmës mjekësore duke shkaktuar dëmtimin e fetusit gjatë lindjes<sup>23</sup>. E drejta e gruas për të ndërprerë shtatëzaninë, brenda kushteve të lejuara nga ligji nuk përbën një detyrim për mjekun, i cili nuk e praktikon abortin nëse kjo vjen ndesh me parimet e tij morale, dhe ndërgjegjen.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe ligjvënësi ynë, i cili pranon se e drejta e gruas për të ndërprerë shtatëzaninë nuk nënkupton detyrimin e mjekut për të kryer abortin<sup>24</sup>. Në praktikën e huaj, detyrimi në këtë rast qëndron në referimin e pacientes në një mjek tjetër i cili pranon të kryejë ndërprerjen e shtatëzanisë<sup>25</sup>. Neni 9 i Konventës Europiane së të Drejtave të Njeriut, përmban gjithashtu të drejtën e personit (mjekut) për të refuzuar, në përputhje me ndërgjegjen e tij, të kryejë abortin, ndërprerjen e trajtimit, dhënien e kontraktivëve, por duke e drejtuar pacientin në një mjek tjetër.

### *i) Debati bashkëkohor mbi momentin e fillimit të jetës*

Neni 2 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, përcakton detyrimin pozitiv të çdo shteti në respektimin e kërkesave për ruajtjen e jetës në sferën e shëndetit publik<sup>26</sup>. Gjykata e Strasburgut ka theksuar se: “*Edhe nëse prezumohet se fetusi gëzon mbrojtje, detyrimet pozitive të shtetit nuk shkojnë deri aty sa të ofrojnë instrumente ligjore me karakter penal në rastet e eliminimit të paqëllimshëm të fetusit*”.

Po ashtu lind pyetja nëse mund të kërkohet shpërblimi për dëmtimin e fetusit shkaktuar nga veprimet e mjekut, para lindjes? A do të mbajë përgjegjësi penale mjeku, në këtë rast? Dëmtimet e fetusit, nuk mund të përbëjnë shkak për dëmshpërblim, para lindjes, për arsye se fetusi nuk ka zotësi juridike. Si rrjedhim, shpërblimi i dëmtimit të fetusit nuk mund të kërkohet, në këtë moment, për arsye se fetusi nuk ka zotësi juridike të ndarë nga zotësia juridike e nënës.

<sup>22</sup> Vendim i datës 13.10.1992 i Gjykatës së Lartë spanjolle, Seksioni civil.

<sup>23</sup> Vendim i datës 19.01.1995 i Gjykatës së Lartë spanjolle, Seksioni penal.

<sup>24</sup> Ligji “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”, neni 16: “Asnjë mjek nuk mund të detyrohet të kryejë ndërprerje të shtatëzanisë kundër vullnetit të tij.”

<sup>25</sup> White & Baldwin, 2011:116.

<sup>26</sup> Çështja “Vo kundër Francës”, që kishte të bënte me vdekjen e fëmijës së palindur të kërkueses si pasojë e një neglizhence serioze mjekësore. Sipas Gjykatës së Strasburgut, çështja e të drejtës së jetës së fetusit. i takonte të drejtës së brendshme. Por edhe nëse prezumohej që fetusi gëzon mbrojtje, detyrimet pozitive të shtetit nuk shkojnë deri aty sa të ofrojnë instrumente me karakter penal në rastet e eliminimit të paqëllimshëm të fetusit. Ankimi civil ishte teorikisht i mjaftueshëm në këtë rast.

Kur flasim për të drejtën e jetës lindin pyetje si, a është koncepti i jetës absolut, që do të thotë se fillon jeta pas një momenti të caktuar, apo është një koncept gradual -ku fetusi konsiderohet gradualisht në jetë me zhvillimin e tij? A nënkuptohet edhe fetusi kur flitet për personin? Gjykata e Strasburgut ka vlerësuar se përgjigja e pyetjes se kur fillon jeta duhet të interpretohet dhe të gjejë rregullim në të drejtën e brendshme të shteteve për shkak se së pari, ky problem nuk ka gjetur ende një përgjigje në shumicën e shteteve që kanë ratifikuar Konventën, dhe së dyti, sepse nuk ka një konsensus në nivel evropian në lidhje me përkufizimin shkencor dhe ligjor të fillimit të jetës<sup>27</sup>.

Konventa nuk e qartëson se çfarë është “jeta”, ose kur dhe ku fillon apo mbaron mbrojtja e Neni 2 të Konventës. Në fakt, në mungesë të një kompromisi evropian (apo mbarë botëror) ligjor apo shkencor në lidhje me çështjen, Komisioni, gjatë kohës kur ende ekzistonte, dhe madje edhe Gjykata tani, nuk ka vullnetin për të vendosur standarde të sakta në këtë kuadër. Nga ana tjetër Gjykata e Strasburgut u shpreh se nuk ka një interpretim në lidhje me çështjen nëse një fëmije që nuk ka lindur ende mund të konsiderohet një person për qëllimet e neni 2 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata në çështjen e *Vo kundër Francës* përcaktoi se “.. çështja se kur fillon e drejta për jetën i përket hapësirës së vlerësimit që Gjykata zakonisht konsideron se, Shtetet duhet të gëzojnë në këtë sferë, pavarësisht nga interpretimi i Konventës, një “instrument jetik që duhet të interpretohet në dritën e kushteve të ditëve të sotme” (...).

Arsyet për këtë përfundim së pari, janë se çështja për një mbrojtje të tillë nuk është zgjidhur brenda shumicës së vetë Shteteve Kontraktuese, veçanërisht në Francë, e cila është bërë subjekt debati dhe së dyti, se nuk ka një kompromis evropian mbi përkufizimin shkencor dhe ligjor të fillimit të jetës. ... Pra, Gjykata është e bindur se asnjë nga këto nuk janë të pranueshme, dhe madje as nuk ka mundësi, përse i përket kësaj çështjeje, që të jepet një përgjigje në mënyrë abstrakte mbi pyetjen nëse fëmija i palindur është person për qëllime të Neni 2 të Konventës.

Shtrohet pyetja kur një fetus mund të “fitojë” të drejtën e jetës? Kjo pyetje i ndan juristët në dy grupe; ata që janë në favor të abortit të cilët e drejtojnë debatin mbi çështjen se fetusi merr jetë në momentin kur lind. Kundërshtarët e konsiderojnë fetusin njeri që nga ngjizja, dhe e drejta e jetës sipas tyre nis që nga ky moment. Momenti i fillimit të jetës është një pikë kyçe në debat për ata që janë përfshirë në hartimin e ligjeve që rregullojnë abortin. Ende nuk ka ndonjë marrëveshje në lidhje me momentin e fillimit të jetës në asnjë nga shkencat që studiojnë këtë fushë si: mjekësia, filozofia apo teologjia për të përcaktuar pikërisht fazën e zhvillimit të fetusit në të cilën ai do të mbrohet nga e drejta e jetës.

<sup>27</sup> Çështja *Vo kundër Francës*, aplikim nr.53924/00.

Duke iu referuar fazave të zhvillimit të fetusit për të dhënë një vështrim të konceptimit të jetës dallojmë: *Ngjizjen*<sup>28</sup>; *Zënia vend e vezës së fekunduar në miter*<sup>29</sup>; *Gjallërimi*<sup>30</sup> *Ndarja e indit*<sup>31</sup>; *Fillimi i Aktivitetit të trurit*<sup>32</sup> *Qëndrueshmëria e fetusit*<sup>33</sup> *Lindja*: kjo ne fakt, duket të jetë një datë e qartë dhe e kuptueshme, por edhe këtu ka mosmarrëveshje në pikën kur një fëmijë është i lindur. A është i tillë: kur një pjesë e foshnjës është jashtë trupit të nënës? Kur e tërë fëmija është jashtë trupit të nënës? Apo kur fetusit duhet të mbështetet në burimet e veta për t'u mbajtur gjallë?

Disa njerëz mendojnë se është absurde se e drejta e një qenie për jetën duhet të varet nga fakti nëse një qenie është e vendosur brenda ose jashtë mitrës.<sup>34</sup> Pra, siç e pamë, ka vështirësi në zgjedhjen e një pikë të saktë kur fetusit merr të drejtën për të jetuar për këtë arsye do të ishte më e drejtë të pranohet se fetusit e zhvillon apo e fiton të drejtën e jetës në mënyrë graduale. Në lidhje me këtë çështje, në kuadër të rendit juridik në shqyrtim, Komisioni dhe Gjykata në vend që të impononin një standard uniform, kanë vlerësuar dhe po vazhdojnë të vlerësojnë çështjet në lidhje me fillimin e jetës vetëm për ato dytësore, duke trajtuar çështjet një nga një, ndërsa u lënë liri të konsiderueshme Shteteve për të rregulluar vetë problemet në fjalë, përsa kohë që ata i trajtojnë ato në mënyrën e duhur, në veçanti duke i dhënë peshën e duhur interesave të ndryshme që janë në rrezik dhe duke i dhënë ekuilibrin e duhur atyre interesave. Kjo mund të vihet re nga jurisprudenca e organeve të Konventës në lidhje me ndërprerjen e shtatëzanisë. Nga pikëpamja sociale dhe morale sa më shumë i zhvilluar të jetë fetusit, aq më shumë i vështirë është aborti dhe më shumë

peshë i jepen të drejtave të fetusit në krahasim me të drejtat e nënës. Ashtu siç kemi theksuar, vende të ndryshme kanë mendime të ndryshme mbi momentin se kur fillon jeta e njeriut. Në ndryshim nga neni 4 i Konventës Amerikane mbi të Drejtat e Njeriut, e cila shprehet se “*jeta e njeriut duhet të mbrohet në përgjithësi, që nga momenti i mbetjes së gruas shtatëzënë*”, neni 2 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) hesht në lidhje me kufizimet kohore të së drejtës së jetës dhe nuk përcakton “çdonjëri” jetën e të cilit KEDNJ mbron.

Konventa nuk parashikon as momentin e fillimit të jetës së njeriut dhe nëse e drejta për jetën shtrin kufijtë e saj dhe mbi fëmijën e palindur<sup>35</sup>. Ky moment bëhet pre e polemikave në çështjet e abortit. Pyetjet që ngrihen në këto raste janë: A është i ligjshëm dëmtimi i fetusit? A ka të drejtë gruaja të bëjë abort? A do të konsiderohet fetusit si qenie e gjallë? Kur mund të konsiderohet si qenie njerëzore? Po në rastet e dëmtimit të tij pa dëshirën e gruas? Sigurisht që është e nevojshme njohja e natyrës sensitive dhe emocionale të çështjeve të abortit, kundërshtimet e forta lidhur me këtë çështje, madje edhe mes vetë mjekëve. Filozofia e njeriut, eksperiencat e tij, ekspozimi i individit ndaj limiteve të ekzistencës së tij si qenie njerëzore, edukimi fetar, kuptimi individual mbi jetën, familjen dhe vlerat e tjera, standardet morale që njeriu vendos dhe mundohet të ndjekë, që të gjitha këto influencojnë e ngjyrosin mendimet dhe përfundimet e secilit për jetën dhe abortin. Ashtu si legjislacionet e shteteve amerikane, edhe legjislacionet e vendeve anëtare të KEDNJ ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga njëri tjetri lidhur me përgjigjen e pyetjes se kur fillon jeta dhe përcaktimin e nocionit “njeri”. Në fushën shkencore ka dy qëndrime mbi statusin moral të embrionit e si rrjedhojë dhe të mbrojtjes ligjore që i ofrohet: - embrionet njerëzore nuk konsiderohen qenie njerëzore, e si rrjedhojë mbrojtja që u ofrohet është relative; dhe qëndrimi i dytë, se embrionet njerëzore kanë të njëjtin status moral si qeniet njerëzore e si rrjedhojë mbrojtja që i ofrohet të dyve është e njëjtë.<sup>36</sup>

## ii) *Debati në Francë dhe Itali mbi të drejtën për të mos lindur veçse i shëndetshëm*

Kohët e fundit lidhur me të drejtën e jetës është konfiguruar në disa shtete të Europës e drejta e fetusit për të lindur veçse i shëndetshëm. Në fakt, jo rrallë herë gjatë shtatëzanisë mjekët kanë konstatuar se embrioni është në pamundësi për të bërë një jetë të shëndetshme pas lindjes, kjo për faktin që mund të jetë i prekur nga sëmundje të pashërueshme. Këto sëmundje pasi konstatohen duhet t'i komunikohen nënës e cila ka të drejtën për të vendosur në lidhje me vijimësinë apo për ndërprerjen e shtatëzanisë. Mosrespektimi i detyrimit të mjekut për informim

<sup>28</sup> Disa studjues dhe, në veçanti, Kisha Katolike thekson se embrioni duhet të trajtohet si një person nga konceptimi dhe kështu kundërshton abortin. Momenti i ngjizjes është një pikë krejtësisht logjike për t'u zgjedhur si fillimi i jetës njerëzore. Në këtë pikë embrioni përmban kodin gjenetik të plotë dhe ka filluar të zhvillohet si një qenie njerëzore e veçantë dhe unike. Shih Barzelatto, 2005:15.

<sup>29</sup> Ky është momenti kur veza e fekunduar është futur në mitër. Kjo ndodh rreth një javë pas konceptimit. Kjo pikë është e lehtë për të identifikuar por kjo pikë është po aq arbitrare si çdo pikë tjetër.

<sup>30</sup> Kjo është kur fetusit lëviz për herë të parë në barkun e nënës. Kjo ndodh rreth 16-17 javë pas ngjizjes. Kjo ide rrjedh nga një teori e braktisur e krishterë se ky ishte momenti që fetusit merr shpirtin e tij. Për shembull, Shën Augustini bëri një dallim midis embrionit *inanimatus*, i papajisur ende me një shpirt, dhe embrionit *animatus*, i pajisur me një shpirt. Aristoteli nxori teorinë e tij me tre faza të jetës: bimore, shtazore, racionale. Faza e jetës bimore arrihet që në konceptim, kafsha në “*animacion*”, dhe qenia racionale pas lindjes gjallë.

<sup>31</sup> Kjo është koha kur indet e fetusit janë ndarë në lloje të ndryshme sipas funksionit të organeve dhe mbulon një periudhë të gjatë kohore. Kjo lloj teorie ind-ndarjeje nuk duket të ketë ndonjë status të qartë moral - kështu që zgjedhja e kësaj si datë kyçe është ndoshta për shkak se paraqitja gjithnjë e më njerëzore e fetusit shkakton ndjenjën gjithnjë e më të mbrojtjes të fetusit. Wesley, 1997:15.

<sup>32</sup> Disa besojnë se jeta fillon me shenjën e parë të aktivitetit të trurit. Kjo është një pikë logjike, pasi ajo shënon një nga kushtet e nevojshme për të qenë i gjallë. Por, aktiviteti i trurit në këtë fazë nuk është më shumë se një kusht - kjo nuk tregon se fetusit është në fakt i vetëdijshëm.

<sup>33</sup> Disa studiues janë të mendimit se jeta fillon në fazën kur fetusit mund të mbijetojë jashtë mitrës. Ky është kriteri më i zakonshëm i përdorur në hartimin e ligjeve që rregullojnë abortin. Nëse një fetus mund të mbijetojë jashtë mitrës varet nga: gjendja e shkencës mjekësore; objektet mjekësore në dispozicion në një vend të caktuar kompetenca apo gadishmëria e nënës. Shih Bamgbose, 2004:48.

<sup>34</sup> Shih Almagor, 2009:25.

<sup>35</sup> Shih *Vo v. Francës* e cit.

<sup>36</sup> Kane, 2011:39.

në një rast të tillë, pengon ushtrimin e të drejtës së gruas për të zgjedhur nëse do të vazhdojë shtatzëninë apo do ta ndërpresë sipas mënyrës së parashikuar në ligj. (Scott, 1997:827) Në rastin e një fëmije me talasemi, sëmundje kjo e diagnostikuar nga mjeku që ndjek shtatzëninë e gruas, gruaja duhet të informohet për ekzistencën e kësaj sëmundjeje që të mund të vendosë nëse do të vazhdojë shtatzëninë në këto kushte apo jo.

Gjykata e Lartë Franceze, në vendimin e famshëm *Perruche* të datës. 28.11.2001 vendosi se “*Përsa i përket gabimeve të kryera nga mjeku apo laboratorit mjekësor në ekzekutim të kontratës së kujdesit mjekësor me gruan shtatzënë, cënimi i të drejtës së saj për të zgjedhur ndërprerjen e shtatzënisë, me qëllim evitimin e lindjes së një fëmije me keqformime të rënda, e legjitimon për të kërkuar shpërblimin e dëmit të verifikuar në keqformimet e fëmijës.*” Ky vendim i Gjykatës së Lartë franceze së bashku me vendimin e Gjykatës së Lartë Italiane<sup>37</sup>, hapi debatin mbi të drejtën për të lindur veçse i shëndetshëm.

Ligjvënësi pas këtij qëndrimi të Gjykatës së Lartë ndërhyri duke parashikuar disa ndryshime esenciale në lidhje me këtë çështje. Kështu nuk mund të kërkohej shpërblimi i dëmit për fëmijën e lindur me keqformime nga mjeku pasi gjendja e tij nuk është provokuar apo rënduar nga gabimet e mjekut, por u legjitimua kërkesa e dëmshpërblimit nëse nëna nuk ishte informuar për shkaqet e keqformimit, me qëllim që të vendoste në lidhje me vijimësinë e shtatzënisë. Më vonë, praktika gjyqësore italiane bëri disa ndryshime duke mosnjohur të drejtën për të lindur veçse i shëndetshëm dhe mospranimin e kërkesës për dëmshpërblim<sup>38</sup>. Gjykata e Lartë italiane, vendosi rrezimin e kërkesës për dëmshpërblim për fetusin e lindur të keqformuar, kjo jo për shkak të veprimeve të mjekut. Mos informimi nga ana e mjekut nuk ka lidhje shkakësore të drejtpërdrejtë pra nuk është shkak i keqformimeve të fëmijës, pasi ka influencuar në të drejtën e gruas për të zgjedhur nëse do të vazhdonte shtatzëninë ose jo<sup>39</sup>. Ligji nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë” në legjislacionin shqiptar lejon kryerjen e abortit eugjenetik në raste të keqformimeve të rënda të fetusit të papajtueshme me jetën<sup>40</sup>.

<sup>37</sup> Vendim nr.6735 datë 10.05.2002 i Gjykatës së Lartë italiane, në të cilin njihej edhe e drejta e babait të fëmijës për tu dëmshpërblitur, si rezultat i mosinformimit nga ana e mjekut.

<sup>38</sup> Vendim nr.14488 datë 29.07.2004 i Gjykatës së Lartë Italiane, seksioni i tretë civil. “I konceptuari mund të gëzojë një të drejtë mbrojtjeje të një interesi të caktuar vetëm pas lindjes dhe të varur nga fakti i lindjes. Nëse nuk verifikohet ky fakt, mohohet edhe mbrojtja e të drejtës së garantuar. Prandaj, t’i njohësh të konceptuarit të drejtën për të mos lindur do të thote t’i njohësh një të drejtë, që në fakt nuk mund ta ushtrojë dhe që është konsumuar”.

<sup>39</sup> Vendim nr.16123 datë 14.07.2006 i Gjykatës së Lartë Italiane, seksioni i tretë civil: “Dëmi konsiderohet si humbje apo pakësim në lidhje me një gjendje të mëparshme, që shpërblimi synon të riintegrojë. Në këtë rast, nuk verifikohet dëmi, pasi e vetmja alternativë e lindjes jo i shëndetshëm, është mosardhja në jetë”.

<sup>40</sup> Ligj Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë”, neni 9: “Kur komisioni gjykon se fetusit ka keqformime të papajtueshme me jetën, apo sëmundje invaliduese me trajtim të pasigurtë, vendos për ndërprerjen e shtatzënisë në çdo kohë.”

Në legjislacionin tonë parashikohet e drejta e fetusit për të lindur i shëndetshëm, por jo “e drejta për të mos lindur veçse i shëndetshëm”. Ligji nr. 8876 date 04.04.2002 “Per shendetin riprodhues” i ndryshuar rregullon organizimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha veprimtarive që zhvillohen në fushën e shëndetit riprodhues, në institucionet shëndetësore private dhe publike, mbron të drejtat riprodhuese të individit e të çiftit dhe siguron që të drejtat riprodhuese të çdo individi të mbrohen në përputhje me ligjet dhe politikat kombëtare me principe të tjera të njohura ndërkombëtare. Ligji Nr.10 137, datë 11.5.2009 ka sjelle ndryshime në ligjin nr. 8876, datë 4.4.2002 “Për shendetin riprodhues” Në ligjin nr. 8876, datë 4.4.2002 “Për shendetin riprodhues”, jane bere disa ndryshime<sup>41</sup>. “Shëndeti Riprodhues” nënkupton mirëqenien e përgjithshme fizike, mendore, në tërësi, me mungesën e sëmundjeve e paaftësive problematike, si dhe çdo kushtëzim tjetër bazë që i nevojitet sistemit të riprodhimit për funksionet, proceset si dhe aftësinë e një jete seksuale të kënaqshme e të sigurt. Ai nënkupton aftësinë e njerëzve për t’u riprodhuar dhe lirinë e tyre për të vendosur për mënyrën dhe kohën e riprodhimit, si dhe të informohen se ku mund ta bëjnë këtë dhe ku mund të gjejnë të tilla shërbime.

## 4. Analiza e gjetjeve

### 4.1. Çështjet e abortit në Shqipëri

Kushtetuta Shqiptare sanksionon të drejtën e jetës por, nuk shprehet se në çfarë momenti fillon detyrimi i shtetit për mbrojtjen e të drejtës së jetës, nëse ky detyrim fillon që me konceptimin e fëmijës, me lindjen gjallë të tij apo në ndonjë moment tjetër. Duke iu referuar dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, dallojmë disa figura të veprave penale që lidhen me shkeljen e Ligjit Nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë”. Por duke parë se këto figura të veprave penale futen në grupin e veprave penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose mosdhënia e ndihmës, kuptohet se qëllimi i këtyre parashikimeve është mbrojtja e shëndetit të gruas shtatzënë dhe jo mbrojtja e së drejtës së fetusit për të jetuar. Ligji Nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë” u miratua më tepër si një nevojë për të shmangur abortet e pakontrollueshme dhe nga persona të pa specializuar të cilët vinin në rrezik jetën e grave shtatzëna, në kushtet kur aborti ishte i ndaluar me ligj. Me rendesi ne kete fushe paraqitet edhe Ligji nr. 8876 date 04.04.2002 “Per shendetin riprodhues” ndryshuar me ligjin nr. 11.05.2009, i cili rregullon organizimin dhe mbikëqyrjen e të

<sup>41</sup> Në nenin 14, pika 1 ndryshohet si më poshtë: “1. Veprimtaritë e përcaktuara në këtë ligj përfshihen në kategorinë II.6, të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen sipas ligjit për licencat.”. 2. Në nenin 23, në fund të pikës 1 fjalët “mbi bazën e udhëzimit të Ministrisë të Shëndetësisë” shfuqizohen.

gjitha veprimtarive që zhvillohen në fushën e shëndetit riprodhues, në institucionet shëndetësore private dhe publike, mbron të drejtat riprodhuese të individit dhe të çiftit dhe siguron që të drejtat riprodhuese të çdo individit të mbrohen në përputhje me ligjet dhe politikat kombëtare me parime të tjera të njohura ndërkombëtare.

Ligji shqiptar ashtu si ligjet e shumë vendeve të tjera, nuk parashikojnë të drejtën absolute të fetusit për të jetuar. Kjo e drejtë nëse do të njihet do të pengonte ushtrimin e të drejtës së grave për të vetëvendosur si pjesë e të drejtës për jetë private, dhe pikërisht të së drejtës së tyre për të ndërprerë shtatëzaninë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligj. Në keto kushte asnjë person, madje as bashkëshorti, nuk mund të kërkojë qoftë nga gjykata kufizimin e kësaj të drejte<sup>42</sup>. Këtë qëndrim ka mbajtur dhe jurisprudenca e Strasburgut, në një sërë çështjesh, duke përcaktuar se mosnjohja babait, e të drejtës për të kërkuar moskryerjen e ndërprerjes së shtatëzanisë, nuk çënon të drejtën e tij për jetë private dhe familjare, të garantuar edhe nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut<sup>43</sup>.

Ndërprerja e shtatëzanisë pa pëlqim të gruas në shumë vende parashikohet si figurë e veprës penale. Edhe në nenin 93<sup>44</sup> të Kodit tonë penal “*Ndërprerja e shtatëzanisë pa pëlqim të gruas*.” është figurë e veçantë e veprës penale. Objekti i kësaj vepre është mbrojtja e jetës dhe shëndetit të gruas shtatëzane. Objekti i veprës penale në fjalë është i dyfishtë pasi në aspekte të veçanta mbrohet edhe e drejta e fetusit për të jetuar.

Nga ana objektive, krimi kryhet me veprime që ndërpresin shtatëzaninë në mjedise spitalore publike apo klinika private të lejuara posaçërisht si dhe brenda kohës së lejueshme për ndërprerje, veç rastit kur ndërprerja diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar. Vepra penale mund të kryhet me anë të veprimeve aktive, kimike (ilaje apo substanca që kanë efekte abortive), fizike, si dhe nga emocionet apo frika. Lind pyetja: A përbën vepër penale ndërprerja e shtatëzanisë, dhënia e informacionit për një medikament i cili shkakton abortin, një gruaje shtatëzane? Në praktikën mjekësore shpesh, mjekët apo farmacistët informojnë pacientët dhe u japin medikamente të cilat shkaktojnë ndërprerjen e shtatëzanisë, duke qenë në dijeni të faktit se pacientja dëshiron të kryejë abortin, jashtë rasteve të përcaktuara në ligj. Legjislacioni ynë parashikon ndalimin e reklamimit të produkteve që shkaktojnë ndërprerjen e shtatëzanisë, ndërkohe që njihet detyrimi i mjekut për të informuar në lidhje me metodat kontraceptive të ofruara<sup>45</sup>. Në asnjë nga këto raste

<sup>42</sup> Ligj Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”, neni 6, “Kur është e mundur, në këshillimin dhe marrjen e vendimit për ndërprerjen e shtatëzanisë, merr pjesë edhe bashkëshorti ose prindi.”

<sup>43</sup> Çështja “*Paton kundër Mbretërisë së Bashkuar*”.

<sup>44</sup> Ndërprerja e shtatëzanisë pa pëlqim të gruas, veç rastit kur ndërprerja diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

<sup>45</sup> Ligj Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”, neni 14: “Në të gjitha rastet e ndërprerjes së shtatëzanisë, mjeku që i kryen ato është i detyruar të informojë gratë për shërbimet e planifikimit familjar dhe t’i këshillojë për metodat kontraceptive që ofron institucioni ku ai punon dhe/ose

nuk ka filluar ndjekja penale për veprën penale të ndërprerjes së shtatëzanisë.

Praktika gjyqësore e huaj ka mbajtur qëndrimin se mjeku i cili jep informacion për medikamente të cilat shkaktojnë ndërprerjen e shtatëzanisë, jashtë rasteve të parashikuara në ligj, mban përgjegjësi penale. Gjykata e Lartë spanjolle ka lënë në fuqi vendimin e një gjykate më të ulët e cila ka dënuar një mjek që i kishte përshkruar një gruaje shtatëzane –e cila donte të abortonte- për të marrë një ilaç që provokonte abort. Kërkuesi pretendoi se gjykata nuk duhet të vlerësonte këtë veprim të mjekut si ndërprerje të shtatëzanisë, strictu sensu, jashtë rasteve të parashikuara në ligj, por duhet ta vlerësonte si një informacion të përgjithshëm për efektet e një medikamenti të dhënë nga mjeku<sup>46</sup>.

Po ashtu shtrohet për diskutim çështja nëse mund të konsumohet kjo vepër penale me anë të mosveprimeve apo do të kemi përgjegjësi penale për mosdhënie ndihmë e cila ka shkakuar dëmtimin e rëndë të shëndetit duke ndërprerë shtatëzaninë. *A priori* nuk mund të përjashtohet mundësia e shkakimit të veprës penale me anë të mosveprimeve, edhe pse nga leximi literal i dispozitës, mund të mos nënkuptohet kjo formë e kryerjes së saj. P.sh. në rastin e mamisë, e cila ka detyrimin të asistojë gruan gjatë lindjes, në mënyrë të qëllimshme, kjo nuk i jep ndihmën e nevojshme dhe shkakton ndërprerjen e shtatëzanisë, plotësohen të gjithë elementët e veprës penale të ndërprerjes së shtatëzanisë, e cila duhet të aplikohet në këtë rast si dispozitë specifike.

Për marrjen në përgjegjësi penale, nuk kërkohet ardhja e ndonjë pasojë tjetër, veç ndërprerjes së shtatëzanisë. Por, e rëndësishme është të theksohet se ndërprerja e shtatëzanisë duhet të sjellë si pasojë vdekjen e fetusit, pasi në rast se fetusi nuk vdes, do të kemi të bëjmë me shkaktim të lindjes së parakohshme. Lindja e parakohshme, (përsheptimi i qëllimshëm i lindjes) i shkaktohet si pasojë e dëmtimeve të qëllimshme, nuk parashikohet në legjislacionin tonë penal, ndërkohe që ligji penal Italian e parashikon si figurë të posaçme të veprës penale. Në këtë rast nuk bëhet fjalë për vdekjen e fetusit, por vetëm për përsheptim të kohës që do të duhej normalisht për lindjen duke qenë se dëmtimi shkaktohet në kohën kur fetusi është në gjendje për të jetuar në mënyrë autonome.

Në rast se do të vërtetohej vdekja e fetusit, të maturuar, të aftë për të jetuar në mënyrë autonome, atëherë sipas ligjit Italian do të ketë vrasje me dashje, ndërsa sipas legjislacionit shqiptar, ndërprerja të shtatëzanisë pa pëlqim të gruas. P.sh. në rastin kur nga dëmtimet e shkaktoara gruas, është ndërprerë shtatëzania, si dhe fetusi pasi është shkëputur nga trupi i gruas gjallë, ka jetuar dhe disa orë dhe më pas ka vdekur, si dhe vërtetohet se ka patur mundësi të jetojë në mënyrë autonome por ka vdekur për shkak të dëmtimeve. Edhe në rastin kur fetusi, i shkëputur

institucione të tjera shtetërore e private.”, neni15: “Ndalohet çdo lloj propagande dhe reklamimi, direkt ose indirekt, me fjalë ose figurë, e institucioneve, metodave, medikamenteve e produkteve që shkaktojnë ndërprerje të shtatëzanisë, përveç se në botimet shkencore të destinuar për mjekë dhe farmacistë.”

<sup>46</sup> Gjykata e Lartë Spanjolle, seksioni penal, vendim datë 03.04.1997.



nga trupi i gruas i gjallë, vdes si pasojë e imaturimit dhe si pasojë e paaftësisë për të jetuar në mënyrë autonome, do të konsumohet vepra penale e ndërprerjes së shtatëzaniës pa pëlqim të gruas.

Nga ana subjektive vepra penale kryhet me dashje, kundër vullnetit të lirë të gruas, pa pëlqimin e saj, me përjashtim të rastit kur ndërprerja diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar me raport mjekësor dhe mjeku e gjykon të domosdoshme ndërprerjen e shtatëzaniës edhe pa pëlqimin e gruas shtatëzënë. Për efekt të përgjegjësisë penale, nuk ka rëndësi koha e shtatëzaniës, por kërkohet që subjekti ta dijë se gruaja është shtatëzënë dhe i shkaktohet ndërprerja me dashje<sup>47</sup>. Plagosja e rëndë e cila ka sjellë si pasojë ndërprerjen e shtatëzaniës parashikohet si figurë e veçantë e veprës penale në seksionin për veprat penale të kryera kundër shëndetit, dhe jo në seksionin e veprave penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e gruas nga ndërprerja e shtatëzaniës. Ndërsa, në rast se ndaj gruas përdoret dhunë fizike apo psikike personat do të përgjigjen për plagosje të rëndë kur si pasojë ka ardhur ndërprerja e shtatëzaniës. Ndërprerja e shtatëzaniës pa pëlqimin e gruas kryhet me veprime direkte për ndërprerjen e shtatëzaniës, kundër dëshirës. Dallimi në të dy dispozitat qëndron si në objekt ashtu dhe në anën objektive. Në vlerësimin e këtij kriteri mendojmë se duhet marrë parasysh si gjendja aktuale e gruas ashtu dhe e ardhmja e parashikueshme, duke mos u fokusuar vetëm në rreziqet në momentin e marrjes së vendimit. Nuk duhet të përfshihen rastet kur shtatëzania është thjesht e padëshirueshme apo e papërshtatshme për nënën dhe familjen e saj, por duhet të vlerësohet se sa arsye sociale ndikojnë në mirëqenien dhe shëndetin fizik e mendor të gruas. Proçesi fiziologjik ndërpritet për shkak të veprimeve të mjekut, personelit mjekësor, apo personave të tjerë, dhe jo për shkaq natyrale, si pasojë e një sëmundjeje, apo gjendjes shëndetësore të gruas.

#### 4.1. Problematikat e abortit në vendin tonë: aborti selektiv dhe ai i kryer nga vajzat në moshë të re (të mitur)

Në vijim të këtij studimi mendojmë se ka vlerë të trajtojmë cilat janë realisht problematikat që hasen në vendin tonë në kuadër të mbrojtjes së jetës, fetusit, dhe çështjeve të abortit.

Neni 4 i ligjit mbi abortin parashikon se, mjeku specialist prej të cilit kërkohet ndërprerja e vullnetshme e shtatëzaniës, është i detyruar të informojë gruan për të gjitha rreziqet dhe komplikimet që i sjell ndërprerja e shtatëzaniës, të drejtat që i garantohen me ligj për familjen, nënën dhe fëmijën, për institucionet dhe organizmat që mund të ofrojnë ndihmë morale dhe financiare dhe për klinikat që i kryejnë ndërprerjet e shtatëzaniës. Pasi gruaja të marrë të gjitha udhëzimet dhe informacionet përkatëse, mjeku kërkon konfirmimin me shkrim të kërkesës, 7 ditë

<sup>47</sup> Elezi, 2013:84.

pas kërkesës së parë<sup>48</sup>. Kur kërkesa bëhet nga një vajzë e mitur 16 vjeçare, përveç kërkesës së saj, kërkohet edhe miratimi i një personi i cili ushtron autoritetin prindëror ose të kujdestarit ligjor të saj<sup>49</sup>. Neni 9 i këtij ligji përcakton afatet brenda të cilave mund të lejohet ndërprerja e shtatëzaniës dhe në paragrafin e parë të këtij neni përcaktohet se “Ndërprerja e shtatëzaniës për arsye mjekësore mund të bëhet deri në javën e 22 të shtatëzaniës, në rast se një komision i përbërë nga 3 mjekë, pas ekzaminimit dhe konsultimit, gjykon se vazhdimi i shtatëzaniës dhe/ose lindja e fëmijës rrezikon jetën ose shëndetin e gruas.” Pra, ky paragraf përcakton afatin 22 javor vetëm nëse rrezikohet shëndeti i gruas sepse në rastet kur “komisioni gjykon se fetusit ka keqformime të papajtueshme me jetën, apo sëmundje invaliduese me trajtim të pasigurt, vendos për ndërprerjen e shtatëzaniës në çdo kohë”<sup>50</sup>. Kurse në rast se gruaja vlerëson se shtatëzania e saj krijon probleme psikosociale, ndërprerjen mund ta bëjë brenda javës së 12, por edhe deri në javën e 22<sup>51</sup>, nëse komisioni i përbërë nga 3 specialistë mjekë, punonjës socialë, juristë, pas ekzaminimit dhe konsultimit, gjykon se shtatëzania është rezultat i përdhunimit ose një krimi tjetër seksual, si dhe arsye të tjera të vërtetuara sociale. së shtatëzaniës janë të evidentuara keqformimet, deformimet, sëmundjet që janë të pashërueshme, si dhe nëse shtatëzania është rezultat i një përdhunimi apo

Ligji në nenin 15 të tij ndalon në mënyrë kategorike propagandën dhe reklamimin, direkt ose indirekt, nga ana e institucioneve të metodave, medikamenteve dhe produkteve që shkaktojnë ndërprerje të shtatëzaniës, përveç se kur këto informacione publikohen në botimet shkencore të destinuara për mjekë dhe farmacistë. Neni 16 i Ligjit Nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzaniës” përcakton se mjeku nuk është i detyruar të kryejë ndërprerje të shtatëzaniës kundër vullnetit të tij. Mund të konstatojmë se sipas të dhënave që i përmendëm ligji mbi abortin është liberal dhe kryerja e abortit bëhet pa frikë se do të jetë gruaja e përndjekur për akt penal.

Përndjekja penale, sipas këtij ligji dhe udhëzimeve, mund të aplikohet vetëm për mjekun specialist, nëse i shkel dispozitat e ligjit të miratuar nga Ministria<sup>52</sup>. Në Shqipëri, Kodi ynë Penal në seksionin V të tij ku parashikohen veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatëzaniës ose mosdhënia

<sup>48</sup> Shih nenin 6 të Ligjit Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzaniës” i cili përcakton se “Në rast se gruaja, pas marrjes së informacionit të përmendur në nenin 4, përsërit kërkesën e saj për ndërprerjen e shtatëzaniës, mjeku kërkon konfirmimin me shkrim të kërkesës. Ky konfirmim kërkohet pasi të kenë kaluar të paktën 7 ditë nga kërkesa e parë.”

<sup>49</sup> Shih nenin 8 të Ligjit Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzaniës”

<sup>50</sup> Shih nenin 9 paragrafi 2 të Ligjit Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzaniës”

<sup>51</sup> Shih nenin 10 dhe 11 të Ligjit Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzaniës”

<sup>52</sup> Këtu po japim vetëm një shifër të aborteve të kryera në Shqipëri, sipas B. Ç. Vetëm në Tiranë ka patur çdo vit rreth 10.000 aborte, kundrejt 7000 - 8000 lindjeve. Të gjitha këto aborte janë të regjistruara, por një numër i madh i aborteve bëhet në mënyrë të fshehur, ilegalisht. Prandaj numri i mesipërm mund të jetë edhe më i madh.

e ndihmës e trajton abortin apo ndërprerjen e shtatëzaniës është e paraqitur në nenet 93-95. Periudha brenda të cilës mund të lejohet aborti nuk është objekt i rregullimit të këtij Kodi pasi kjo përcaktohet sipas udhëzimeve dhe vendimeve të marra nga Ministra e Shëndetësisë. Neni 93 i Kodit penal parashikon dënime me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet për ndërprerje të shtatëzaniës pa pëlqim të gruas, veç rastit kur ndërprerja diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar.

Pra, gruaja e ka të drejtën e abortit vetëm nëse rrezikohet shëndeti i gruas apo jeta e saj, dhe atë nëse kanë kaluar 10 javë, 20 javë po edhe në çdo kohë të shtatëzaniës. Para 10 javëve të shtatëzaniës gruaja e ka të drejtën e abortit pa asnjë procedurë të veçantë, pavarësisht se për çfarë arsye. Nëse kanë kaluar 10 javë pas ngjizjes, gruaja mund të kërkojë ndërprerje të shtatëzaniës duke bërë kërkesën me shkrim që i dërgohet komisionit të posaçëm për këtë çështje, por paraprakisht duhet të jenë të evidentuara këto dukuri: në bazë të indikacioneve medicinale konstatohet se gjatë shtatëzaniës apo edhe pas lindjes, mund të vijë deri te keqësimi i rëndë i shëndetit të gruas apo edhe deri te vdekja e saj; kur mund të pritët se fëmija do të lindë me mungesa të rënda psikike dhe trupore, bazuar në indikacionet eugjenike; kur ngjizja ka qenë pasojë e dhunimit, marrëdhënies seksuale me personin e paaftë apo me personin e mitur.

Sjellim në këtë paragraf disa nga problematikat aktuale që po kalon shoqëria jonë lidhur me abortin që vitet e fundit po konsiderohen shqetësuese: aborti në moshë të re dhe aborti selektiv. Gjatë viteve të fundit është vënë re një rritje e tendencave për abortet në moshe të re dhe ato selektive. Ashtu si në shumë vende të Evropës Lindore dhe Shqipëria ka nivel shumë të lartë të abortit. Në Shqipëri përqindja e abortit është 230 aborte për 1.000 lindje të gjalla, ndërkohë që përqindja mesatare e Evropës është 28 për 1.000 lindje të gjalla. Statistikat në vendin tonë duket që janë vërtetë shqetësuese. Gjithsesi shifrat mbeten ende të diskutueshme pasi nuk ka të dhëna të sakta lidhur me këtë fenomen. Arsyeja kryesore lidhur me mungesa të tilla raportimi lidhet me abortet që bëhen në klinika private dhe ato që bëhen privatisht nga vetë femrat nëpërmjet marrjes së pilulave<sup>53</sup>. Grup-moshat më të prekura janë ato nga 13 deri në 18 vjeç<sup>54</sup>. Numri i aborteve nga adoleshentet sa vjen e rritet, pavarësisht se bëhet fjalë për një brez jo pak të informuar lidhur me metodat për t'u mbrojtur nga shtatëzanië. Shqetësuese mbetet sidomos kryeqyteti, ku, referuar të dhënave nga dy maternitetet në Tiranë, paraqiten për abort të paktën tri raste në javë.

Po në të njëjtat nivele mbetet edhe aborti selektiv: shumë prindër, pasi mësojnë se fëmija që do sjellin në jetë nuk është i seksit mashkull, preferojnë ta abortojnë.

<sup>53</sup> Pilula e abortit RU486 u aprovua nga FOOD & DRUG administration në vitin 2000 në SH.B.A. Ajo përdoret deri në 7 javë (49 ditë) shtatëzani e kombinuar dhe me një tablete tjetër për të shkaktuar kontraksionet uterine dhe më vonë abort të plotë.

<sup>54</sup> Sipas disa mjekeve të tjere në spitalet shtetërore dhe klinikat private grupmoshat janë 15 deri në 19 vjeç.

Ky fakt shqetësues është konfirmuar edhe nga studimi i kryer mbi balancat gjinore të lindjeve në vendin tonë. Studimi vë në dukje se popullsia shqiptare ka qenë e dominuar nga meshkujt për një kohë të gjatë, por vitet e fundit është vënë re një rritje e mëtejshme e këtij dominimi. Kjo pasi në vend po lindin më shumë meshkuj se femra, duke e çuar raportin e lindjeve femra-meshkuj në 100 femra të lindura kundrejt 111 meshkujve. Më i dukshëm ky fenomen i dëshirës për të sjellë në jetë vetëm meshkuj është në Dibër, Durrës, Lezhë dhe Fier, ndërsa më i zbutur në qytetet juglindore. (Gjoncaj: 2010).

Ligji Nr.8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatëzaniës” garanton respektimin e çdo qenie njerëzore që në fillim të jetës së tyre, pra që në fazën e konceptimit. Shtatëzania deri në 22 javë mund të ndërpritët për një sërë arsyesh shëndetësore, përfshirë edhe ato psikosociale të përcaktuara, në zbatim të këtij ligji nga Ministria e Shëndetësisë. Në to nuk përfshihet aborti për zgjedhjen e seksit. Një tjetër ligj që ndihmon në frenimin e këtij fenomeni është edhe ai me numër 10 339, datë 28.10.2010 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për të Drejtat e Njeriut dhe Biomjeksinë”. Një kapitull i veçantë i ligjit merr në mbrojtje personat që të mos diskriminohen, po ashtu parashikon zhvillimin e testeve gjenetike vetëm për shmangien e sëmundjeve gjenetike të trashëguara. Për herë të parë dy nene të veçanta të ligjit marrin në mbrojtje embrionet. Kështu, ndalohet përdorimi i teknikave që synojnë modifikimin e gjenomit njerëzor, si dhe zgjedhjes së gjinisë fëmijës së ardhshëm. Ky miratim i kësaj Konvente vjen duke vlerësuar se progresi në biologji dhe mjekësi duhet të përdoret për përfitimin e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm, të ndërgjegjshëm se keqpërdorimi i biologjisë dhe mjekësisë mund të çojë në akte që rrezikojnë dinjitetin njerëzor dhe duke theksuar nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar, në mënyrë që dhe gjithë popullata shqiptare të mund të gëzojë përfitimet e biologjisë dhe mjekësisë, është parë e arsyeshme që edhe vendi jonë të aderojë në këtë Konventë”. Ndërsa neni 14 i ligjit flet pikërisht për mospërzgjedhjen e gjinisë duke cituar se: “Përdorimi i teknikave të riprodhimit me ndihmën e elementeve mjekësore nuk lejohet për qëllim të zgjedhjes së gjinisë së fëmijës së ardhshëm, përveç rasteve kur duhet të shmangët një sëmundje e rëndë e trashëguar e lidhur me gjininë”. Për të gjitha sa më sipër, Ministria e Shëndetësisë e konsideron ndërprerjen e shtatëzaniës me qëllim përzgjedhjen e seksit fetal, si një veprim absurd, moralisht dhe ligjërish të dënueshëm.

## 5. Konkluzione dhe rekomandime

Shumë vende të Evropës, gjatë diskutimeve dhe nënshkrimit të Konventës së Këshillit të Europës mbi të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësinë, nuk arritën të kenë një konsensus lidhur me përcaktimin e embrionit, e si rrjedhojë, ishin në pamundësi për të përfshirë kërkimet mbi embrionin në Konventë. Konventa

Europiane për të Drejtat e Njeriut u lë vendeve anëtare një marzhë/hapësirë vlerësimi lidhur me çështjen e fillimit të jetës. Kjo në varësi të standardeve kombëtare, kulturës, drejtimit fetar të çdo vendi anëtar të saj. Kjo për shkak se edhe vetë Shtetet Anëtare kanë qenë në pamundësi për të zgjidhur konfliktet ndërmjet tyre për çështjen. Në ditët e sotme, statusi i embrionit dhe/ose fetusit ka filluar të ketë njëfarë mbrojtjeje si rrjedhojë e progresit shkencor dhe pasojave potenciale të kërkimeve në inxhinierinë gjenetike, rikrijimin mjekësor të vëzhguar (*in vitro*) ose eksperimente mbi embrionin. (Izumi, 2011:19)

Si në jurisprudencën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës<sup>55</sup>, ashtu dhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut<sup>56</sup> vihet re se e drejta e fetusit për jetën ka qenë gjithmonë e lidhur me të drejtën e gruas për të vendosur vetë për trupin e jetën e saj. Sipas jurisprudencës së SHBA-së, e drejta për privatësi mbrohet nga Amendamenti i 14 i Kushtetutës. E drejta për proces të rregullt, e parashikuar në këtë Amendament, mbron ndër të tjera dhe të drejtën për privatësi<sup>57</sup> në të cilën hyn dhe e drejta e gruas për të kryer abort.

Duke i rikthyer edhe njëherë konceptit të jetës, Konventa në fakt nuk jep një përcaktim të qartë për jetën, gjithashtu ajo nuk përcakton kufijtë e fillimit dhe të përfundimit të mbrojtjes që kjo Konventë i bënë të drejtës së jetës. Për këtë arsye por dhe për shkak të mungesës së kompromisit ligjor në nivel evropian dhe shkencor në lidhje me çështjen, tashmë i përket hapësirës së vlerësimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Sipas Gjykatës, shtetet duhet të gëzojnë në këtë sferë, pavarësisht nga interpretimi i Konventës, një “*instrument jetik që duhet të interpretohet në dritën e kushteve të ditëve të sotme*”. Një problem që lidhet me të drejtën e jetës pra ka të bëjë me fillimin dhe me mbarimin e jetës fizike të qenies njerëzore. Pra ndalim tek termi “çdo njeri”, i përdorur në nenin 2 të KEDNJ. Në kontekstin e nenit 2 të KEDNJ-së konceptit i “Jetës” nënkupton jetën njerëzore. A do të kuptohet edhe fetusit me këtë term apo jo? Në qoftë se po, kjo do të sillte që aborti, në parim, të ndalohej nga ligjvënësi dhe të kishte ndjekje penale nga organet përkatëse. Së pari, duhet thënë dhe për të gjithë është më se e qartë, se në këtë çështje ndërthuren pikëpamje sociale, morale, fetare, politike, juridike, shëndetësore etj. Së dyti, duhet thënë se si në rrafshin kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar, nuk ka një konsensus. Megjithatë, duke i referuar Komisionit Europian të të Drejtave të Njeriut, me termin “çdo njeri”, të përdorur në KEDNJ, nuk i është njohur fetusit e drejta absolute për jetë, por edhe në gjykatë, nuk është paraqitur për gjykim ndonjë çështje që të kërkojë një zgjidhje të qartë dhe të prerë lidhur me abortin. Çështja e lejimit të abortit ka qenë objekt diskutimesh kontradiktore që në fillimet e lindjes së konceptit të abortit. Në fakt, në mungesë të një kompromisi evropian

(apo mbarë botëror) ligjor apo shkencor në lidhje me çështjen, Komisioni, gjatë kohës kur ende ekzistonte, dhe madje edhe Gjykata tani, nuk ka vullnetin për të vendosur standarde të sakta në këtë kuadër. Nga ana tjetër Gjykata e Strasburgut u shpreh se nuk ka një interpretim në lidhje me çështjen nëse një fëmijë që nuk ka lindur ende mund të konsiderohet një person për qëllimet e nenit 2 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Siç e përcaktoi edhe Gjykata në çështjen e *Vo kundër Francës*: ... çështja se kur fillon e drejta për jetën i përket hapësirës së vlerësimit që Gjykata zakonisht konsideron se, Shtetet duhet të gëzojnë në këtë sferë, pavarësisht nga interpretimi i Konventës, një “instrument jetik që duhet të interpretohet në dritën e kushteve të ditëve të sotme” (...). Ashtu si legjislacionet e shteteve amerikane, edhe legjislacionet e vendeve anëtare të KEDNJ ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga njëri tjetri lidhur me përgjigjen e pyetjes se kur fillon jeta dhe përcaktimin e nocionit “njeri”. Në fushën shkencore ka dy qëndrime mbi statusin moral të embrionit e si rrjedhojë dhe të mbrojtjes ligjore që i ofrohet: - embrionet njerëzore nuk konsiderohen qenie njerëzore, e si rrjedhojë mbrojtja që u ofrohet është relative; dhe qëndrimi i dytë, se embrionet njerëzore kanë të njëjtin status moral si qeniet njerëzore e si rrjedhojë mbrojtja që i ofrohet të dyve është e njëjtë. Shumë vende të Evropës, gjatë diskutimeve dhe nënshkrimit të Konventës së Këshillit të Europës mbi të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësinë, nuk arritën të kenë një konsensus lidhur me përcaktimin e embrionit, e si rrjedhojë, ishin në pamundësi për të përfshirë kërkimet mbi embrionin në Konventë.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut u lë vendeve anëtare një marzh/hapësirë vlerësimi lidhur me çështjen e fillimit të jetës. Kjo në varësi të standardeve kombëtare, kulturës, drejtimit fetar të çdo vendi anëtar të saj. Kjo për shkak se edhe vetë Shtetet Anëtare kanë qenë në pamundësi për të zgjidhur konfliktet ndërmjet tyre për çështjen. Në ditët e sotme, statusi i embrionit dhe/ose fetusit ka filluar të ketë njëfarë mbrojtjeje si rrjedhojë e progresit shkencor dhe pasojave potenciale të kërkimeve në inxhinierinë gjenetike, rikrijimin mjekësor të vëzhguar (*in vitro*) ose eksperimente mbi embrionin.

Ligji shqiptar po ashtu si ligjet e shumë vendeve të tjera, nuk parashikojnë të drejtën absolute të fetusit për të jetuar. Kjo e drejtë nëse do të njihej do të pengonte ushtrimin e të drejtës së grave për të vetëvendosur si pjesë e të drejtës për jetë private, dhe pikërisht të së drejtës së tyre për të ndërprerë shtatzëninë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligj. Në këto kushte asnjë person, madje as bashkëshorti, nuk mund të kërkojë qoftë nga gjykata kufizimin e kësaj të drejte. Praktika gjyqësore e huaj ka mbajtur qëndrimin se mjeku i cili jep informacion për medikamente të cilat shkaktojnë ndërprerjen e shtatzënisë, jashtë rasteve të parashikuara në ligj, mban përgjegjësi penale. Mbrojtja dhe respektimi i të drejtës së jetës së individit, e konceptuar dhe e sanksionuar si një nga të drejtat më themelore të njeriut, qëndron në themel të legjislacionit tonë kushtetues dhe të atij penal e procedurial

<sup>55</sup> *Roe v. Wade*, 410 U.S. 113 (1973); *Doe v. Bolton*, 410 U.S. 179 (1973); *United States v. Vuitich*, 402 U.S. 62 (1971).

<sup>56</sup> *X v. the United Kingdom* (ECtHR).

<sup>57</sup> i.d. 7.

penal. Jeta e personit mbrohet me ligj. Në këtë mënyrë është sanksionuar koncepti juridik i mbrojtjes së jetës njerëzore në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ky formulim shpreh qartë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen e jetës së njeriut, e cila përbën një vlerë kushtetuese. Duke ardhur në legjislacionin shqiptar, kemi parasysh legjislacionin përkatës në këtë fushë, ku Ligji nr. 8045, datë 07.12.1995 Për ndërprerjen e shtatzanisë”, njuh të drejtën e ndërprerjes së vullnetshme të shtatzanisë, vetëm në disa kushte të caktuara.

Një specifikë lidhur me abortin në shoqërinë shqiptare e cila vitet e fundit po konsiderohet shqetësuese ka të bëjë me abortin selektiv. Gjatë viteve të fundit është vënë re një rritje e tendencave për abortet selektive, ku shumë prindër, pasi mësojnë se fëmija që do sjellin në jetë nuk është i seksit mashkull, preferojnë ta abortojnë. Ky fakt shqetësues është konfirmuar edhe nga studimi i kryer mbi balancat gjinore të lindjeve në vendin tonë. Studimi vë në dukje se popullsia shqiptare ka qenë e dominuar nga meshkujt për një kohë të gjatë, por vitet e fundit është vënë re një rritje e mëtejshme e këtij dominimi. Për të gjitha sa më sipër, Ministria e Shëndetësisë e konsideron ndërprerjen e shtatzënisë me qëllim përzgjedhjen e seksit fetal, si një veprim absurd, moralisht dhe ligjërish të dënueshëm.

Nga studimi në fjalë me shumë modesti po sjellim këtu disa rekomandime.

1. Autoritetet shtetërore duhet të marrin masa të përshtatshme, konkrete dhe efektive për mbrojtjen e jetës së shtetasve. Rekomandohet në këtë drejtim rritja e vazhdueshme e autoritetit të shtetit të të drejtës.
2. Për respektimin e të drejtës së jetës nevojiten reforma ligjore dhe mekanizma zbatues efektiv.
3. Sa i takon nenit 2 KEDNJ duhen ndjekur nga afër zhvillimet e fundit dhe të kemi një përqaasje të plotë me këto rende juridike mbikombëtare.
4. Shqipëria duhet të garantojë respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, mbi të drejtën për të jetuar dhe të drejtën e abortit në bazë të zhvillimeve të fundit dhe bashkëkohore lidhur me këto koncepte.
5. Shqipëria duhet të sigurojë të drejtën e jetës shtetasve të vet me të gjitha mënyrat përfshirë këtu edhe nga gjykatat, të cilat janë tepër të rëndësishme për zbatimin e kësaj të drejte themelore. Po ashtu gjykatat në mënyrë të veçantë duhet medoemos të mbajnë parasysh jurisprudencën e GJEDNJ-së lidhur me çështjet që implikon garantimi i të drejtës së jetës
6. Gjyqtarët duhet të trajtohen në vazhdimësi mbi këtë jurisprudencë dhe praktikë gjyqësore.
7. Sa i takon çështjeve të abortit, në vendin tonë duhen marrë masa urgjente për reduktimin në maksimum të abortit në moshë të vogël dhe abortit selektiv. Masat konkrete për eliminimin e fenomenit të abortit selektiv dhe atij në moshë të vogël, që prek në mënyrë të drejtpërdrejtë vendin tonë, duhet të

trajtohen jo nga pikëpamja modifikimeve ligjore por ato sociale. Një vlerë të vecantë këtu merr çështja e parandalimit dhe planifikimit familjar.

8. Edukimi i të rinjve (vajza dhe djem) dhe sidomos vajzave në moshë të re mbetet gjithsesi një çështje tepër e rëndësishme dhe prioritare.

## Bibliografia

1. Akandji-Kombe Jean-Francois, (2005), *Detyrimet pozitive sipas Konventës Europiane të Drejtave Të Njeriut. Udhërrefyes për përdorimin e Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut*, Këshilli i Europës, Manual i të drejtave të njeriut, fq. 20-35.
2. Alfredson, Gundumur et. Al. 1999. *The Universal Declaration of Human Rights*. Oslo: Scandinavian University Press.
3. Alston, Philip and James Crawford (eds.). 2000. *The Future of UN Human Rights Treaty Monitoring*. Cambridge: Cambridge University Press.
4. Anastasi A., (2010) *Të drejtat e gruas në legjislacionin shqiptar*, Tiranë.
5. Baxi, U., (2002). *The Future of Human Rights*. Oxford University Press.
6. Blaser. (2000) 'Eutanazia dhe të Drejtat e Njeriut
7. Buonnano, L., & Nugent, N., (2013). *Politikat dhe proceset e politikave të Bashkimit Europian, Kosovë*: Universum Press,
8. Canaj E., & Bana S., (2014). *E drejta e Bashkimit Europian*. Tiranë: Arbëria 07.
9. Council of Europe (ed.) (2000) *Human Rights in International Law*, Basic texts. Strasbourg: Council of Europe Publishing.
10. Daci, J. (2011). *Të drejtat e njeriut*. botimi i III, Tiranë: Julvin 2.
11. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
12. Dobjani E., (2002) Fjala e hapjes në Konferencën Kombëtare "Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës", mbajtur ne Konferencen Kombëtare, "Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës", Tirane, Luarasi.
13. ELEZI - S. Kaçupi - M. HAXHIA. (2001). "Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë", Tiranë.
14. Elezi I., (2002) *Mbrojtja e të drejtës për të jetuar- si e drejta më themelore e njeriut*, kumtesë në Konferencën Kombëtare "Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës".
15. Elezi, I. 2009, E Drejta Penale, pjesa e posacme, ERIK. Tirane.
16. Ermir Dobjani (2002) Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut Fjala e hapjes në Konferencën Kombëtare "Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës", mbajtur ne Konferencen Kombëtare, "Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës", Tirane, Luarasi.
17. Gjoncaj A. (2010) "Raport i pakuilibruar midis sekseve në lindje në Shqipëri".
18. Gomien, D. (2005). *Udhëzues i shkurtër për Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut*. Universiteti i Oslos.
19. Gruda, Z. (2000). *Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut*. (Volumi 1&2), Prishtinë: TIMEGATE.
20. Ilir Panda, (2002) *E drejta e jetës sipas Konventës europiane për të drejtat e njeriut*, kumtesë e mbajtur ne Konferencën Kombëtare, *Shteti dhe shoqëria civile ne mbrojtje te te drejtës se jetes*, Tirane, Luarasi.
21. Janis, M. (2000). *E drejta europiane e te drejtave te njeriut*. Prishtine.

22. Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1995.
23. Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
24. Konventa për “mbrojtjen e grave shtatëzana” Nr. 103 në vitin 1952
25. Kristo, V., (2007) *Kontrolli kushtetues i pajtueshmërisë së legjislacionit shqiptar me standardet e KEDNJ*, kumtesë në Konferencën Kombëtare, *Përmirësimi i cilësisë së zbatimit të KEDNJ nëpërmjet zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve vendase*, Tirane, 1.
26. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
27. Ligj nr. 10 339, datë 28.10.2010 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për të drejtat e njeriut dhe Biomjeksinë”.
28. Ligji nr. 10107 datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”
29. Ligji nr. 8045 datë 07.12.1995 “Për ndërprejten e shtatëzanisë”
30. Naço, N. (2002) *Roli i prokurorisë në parandalimin dhe luftën kundër krimeve të jetës*, kumtesë në Konferencën Kombëtare “Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës”,
31. Pakti Ndërkombëtar mbi të drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore
32. Pakti Ndërkombëtar mbi të drejtat Civile dhe Shoqërore
33. Tepshi A., (2016) E drejta e jetës. Mbrojtja e kësaj të drejte referuar nenit 2 KEDNJ. Çështjet e fetusit, abortit dhe eutanazisë. Punim doktore on line <http://www.uet.edu.al/index.php/sq/publikimet>
34. Toska Dobjani E., (2011) *Gjykata kushtetuese shqiptare si nje mjet ankimi efektiv në kuadër të Konventës Europiane të të drejtave të njeriut në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë*, Revista Shqiptare Ligjore, vol. 1, fq. 25-35.
35. Weston, Burt H. - Stephen P. M., (1999) *The Future of International Human Rights*. New York: Transnational.

## *Një opinion juridik mbi nenin 88 referuar rekomandimeve të komisionit të Venecias mbi reformën në drejtësi \_\_\_\_\_*

\_\_\_\_\_ **Prof. Asoc. Hemion Braho** \_\_\_\_\_

### **Abstrakt**

*Ky artikull shqyrton shkurtimisht situatën në lidhje me të ashtuquajturat “vendet e rezervuara” përsa I përket komisioneve parlamentare përzgjedhëse të Këshillit të Lartë të Gjyqësorit (KLGJ), Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe Kolegjit të Pavarur të Kualifikimit (KPK). Pavarësisht një lloj konsensusi të arritur mbi pika madhore, nga debatet e ndryshme, duket sikur ka mbetur pa zgjidhur ende interpretimi dhe zbatimi i nenit 88 të rekomandimeve të Komisionit të Venecias. Nga një anë opozita argumenton se formula e tanishme, pra votimi në Kuvend dhe kalimi i kësaj të drejte Këshillit të Emërimeve (organ kolegjal që do krijohet nga reforma) në rast të mos arritjes së shumicës, sjell si pasojë faktin që do të jetë K.L.E.-ja dhe jo Kuvendi institucioni që do i bëjë realisht emërimet. Forcat qeverisëse kanë bërë, në të kundërt, propozime që lidhen më mazhorancën përzgjedhëse. Fokusi këtij punimi është pikërisht tentative për të gjetur një të “vërtetë juridike” mbi këtë temë.*

**Fjalë kyçe:** *Neni 88, reforma në drejtësi, Komisioni Venecias, Këshilli Lartë i Gjyqësorit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji Pavarur i Kualifikimit.*

Politika shqiptare ka diskutuar dhe debatuar në mënyrë të ashpër reformën në drejtësi dhe këto debate janë bërë shkas për të mos votuar këtë reformë ligjore. Pavarësisht një lloj konsensusi të arritur mbi pika madhore, nga debatet e ndryshme, duket sikur ka mbetur pa zgjidhur ende interpretimi dhe zbatimi i nenit 88 të

rekomandimeve të Komisionit të Venecias. Ky nen ndër të tjerash sugjeron: “Nëse partitë politike të përfshira në proces nuk bien dakord për shumicën e cilësuar që duhet për zgjedhjen e anëtarëve, që do të vinë nga jashtë sistemit të drejtësisë, të Këshillit të Lartë të Gjyqësorit (KLGJ), Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe Kolegjit të Pavarur të Kualifikimit (KPK), ata mund të zgjedhin një sistem proporcional zgjedhjeje, i cili i garanton opozitës përfaqësimin në këto organe kolektive ose çdo lloj modeli tjetër të përshtatshëm, i cili do t’i siguronte opozitës një ndikim të caktuar në procesin e zgjedhjes së tyre.”

Pse diskutohet e debatohet kaq shumë ky nen, sidomos për pikën që i referohet të ashtuquajtura “vende të rezervuara”?

E gjithë lufta politike zhvillohet mbi formulimin dhe vendimmarrjen referuar organeve drejtuese të sipërpërmendura të pushtetit gjyqësor dhe veçanërisht Këshillit të Lartë të Gjyqësorit (KLGJ) (deri më sot Këshilli i Lartë i Drejtësisë KLD) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP). Nga formulimi aktual i draftit për këtë reformë rezultojnë këto ndryshime të nenit 147 të Kushtetutës që rregullon aktualisht KLD-në:

- “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.
2. Këshilli i Lartë Gjyqësor përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe pesë anëtarë zgjidhen nga Kuvendi nga radhët e juristëve jo gjyqtarë.
3. Kriteret dhe procedura transparente dhe publike e përzgjedhjes dhe e renditjes së kandidatëve gjyqtarë parashikohen me ligj. Anëtarët jo gjyqtarë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me moral dhe integritet të lartë profesional. Kandidatët nuk duhet të jenë dënuar më parë për kryerjen e një veprë penale. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike dhe pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.
4. Anëtarët jo gjyqtarë zgjidhen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit mbi bazën e propozimeve, nga radhët e avokatëve, 1 anëtar, nga radhët e noterëve, 1 anëtar, nga trupa e pedagogëve të drejtësisë, 1 anëtar, nga trupa e pedagogëve jo gjyqtarë ose prokurorë të Shkollës së Magjistraturës, 1 anëtar, dhe nga shoqëria civile, 1 anëtar. Për çdo vend vakant organizmat propozuese i paraqesin Këshillit të Emërimeve në Drejtësi tre kandidatë të përzgjedhur, sipas një procedure transparente dhe publike. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi bën renditjen e kandidatëve dhe ia dërgon Kuvendit.
5. Kuvendi voton veçmas për secilin grup kandidatësh. Kur në votimin e parë Kuvendi nuk arrin shumicën prej tri të pestave, organizmi propozues bën një propozim të ri brenda 15 ditëve. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson dhe rendit kandidatët brenda 7 ditëve nga dorëzimi i propozimeve të reja. Kuvendi

voton për kandidaturat e reja brenda 7 ditëve nga dorëzimi i vlerësimit dhe renditjes. Në rast se kjo shumicë nuk arrihet as në votimin e dytë, kandidatët nga të dyja raundet që renditen të parët për secilin grup konsiderohen të emëruar.”

Pikërisht pika 5 po bllokton miratimin e reformës sepse dy forcat kryesore në pushtet dhe opozita nuk po bien dakord, sepse për mënyrën e përzgjedhjes të 5 anëtarëve jo gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe atij të Prokurorisë po shkakton një betejë të madhe. Nga një anë opozita argumenton se formula e tanishme, pra votimi në Kuvend dhe kalimi i kësaj të drejte Këshillit të Emërimeve (organ kolegjal që do krijohet nga reforma) në rast të mos arritjes së shumicës, sjell si pasojë faktin që do të jetë K.L.E.-ja dhe jo Kuvendi institucioni që do i bëjë realisht emërimet. Shqetësimet e focës politike opozitare bazohen në faktin që Këshilli Emërimeve mund të kushtëzohet politikisht nga Kryeministri.

Po ti referohemi Këshillit të Lartë të Prokurorisë ndiqet e njëjta llogjikë dhe të njëjtat shqetësime<sup>1</sup>.

Nga ana tjetër forcat qeverisëse kanë ofruar një kompromis për të ndryshuar mazhorancën parlamentare që do të bëjë këto emërimet nga 3/5 (84 deputetë) në 2/3 (94 deputetë), në mënyrë që opozita të jetë gjithmonë e përfshirë në vendimmarrje.

<sup>1</sup> Neni 148/a i projektligjit “1.Këshilli i Lartë i Prokurorisë garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. 2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga prokurorët e të gjitha niveleve të prokurorisë dhe pesë anëtarë zgjidhen nga Kuvendi nga radhët e juristëve jo prokurorë. 3. Kriteret dhe procedura transparente dhe publike e përzgjedhjes dhe e renditjes së kandidatëve prokurorë parashikohen me ligj. Anëtarët jo prokurorë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Kandidatët nuk duhet të jenë dënuar më parë për kryerjen e një veprë penale. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike dhe pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. 4. Anëtarët jo prokurorë zgjidhen nga Kuvendi me tri të pestat e të gjithë anëtarëve mbi bazën e propozimeve nga radhët e avokatëve, 1 anëtar, nga radhët e noterëve, 1 anëtar, nga trupa e pedagogëve të drejtësisë, 1 anëtar, nga trupa e pedagogëve jo gjyqtarë ose prokurorë të Shkollës së Magjistraturës, 1 anëtar dhe nga shoqëria civile, 1 anëtar. Për çdo vend vakant organizmat propozuese i paraqesin Këshillit të Emërimeve në Drejtësi tre kandidatë të përzgjedhur, sipas një procedure transparente dhe publike. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi bën renditjen e kandidatëve dhe ia dërgon Kuvendit. 5. Kuvendi voton veçmas për secilin grup kandidatësh. Kur në votimin e parë Kuvendi nuk arrin shumicën prej tri të pestave, organizmi propozues bën një propozim të ri brenda 15 ditëve. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson dhe rendit kandidatët brenda 7 ditëve nga dorëzimi i propozimeve të reja. Kuvendi voton për kandidaturat e reja brenda 7 ditëve nga dorëzimi i vlerësimit dhe renditjes. Në rast se kjo shumicë nuk arrihet as në votimin e dytë, kandidatët nga të dyja raundet, të cilët renditen të parët për secilin grup konsiderohen të emëruar. 6. Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve jo prokurorë, me shumicën e të gjithë anëtarëve. Në rast se kryetari nuk zgjidhet në mbledhjen e parë, anëtar i më i vjetër në detyrë nga radhët e prokurorisë organizon zgjedhjen e kryetarit me short në mbledhjen e radhës, e cila zhvillohet e hapur. Kryetari qëndron në detyrë deri në përfundim të mandatit si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. 7. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Në përfundim të mandatit anëtarët prokurorë rrikthehen në vendet e mëparshme të punës. Anëtarët jo prokurorë që përpara emërimit punonin me kohë të plotë në sektorin publik, rrikthehen në vendet e mëparshme të punës ose në pamundësi, në detyra të barazvlefshme me to”.

As kjo formulë nuk pranohet nga opozita, sepse me bllokimin e Parlamentit, siç u shpjegua më sipër, emërimet i mbeten K.L.E.-së. Atëherë, sipas interpretimit të nenit 88 të rekomandimeve të Komisionit të Venecias (*nëse partitë politike të përfshira në proces nuk bien dakord për shumicën e cilësuar që duhet për zgjedhjen e anëtarëve, që do të vinë nga jashtë sistemit të drejtësisë, [...] ata mund të zgjedhin një sistem proporcional zgjedhjeje*), opozita kërkon ato që quhen “vende të rezervuara”, pra të ketë të drejtën ekskluzive të propozimit e 1 apo 2 grup-listave që lidhen me këto emërimet.

Mbi këtë pikë Pushteti Ekzekutiv aktual nuk pranon negociim me arsyen se ekziston rrisku i politizimit të këtyre organeve drejtuese (K.L.GJ. dhe K.L.P.) duke argumentuar se formula aktuale, pra fillimisht me votim 2/3 dhe pastaj përmes K.L.E.-së, është e panegociueshme.

Në mendimin tim për të dalë nga ky ngërç politiko-juridik, duhet kuptuar përse parashikohen në sistemin e ri 5 vende në KLGJ jashtë sistemit gjyqësor. Fryma e përgjithshme na çon drejt largimit nga ndikimet politike mbi këtë organ dhe kjo është arsyeja pse nuk do të jenë më anëtar të K.L.GJ.-së Presidenti i Republikës, por sidomos Ministri i Drejtësisë (Në Opinion Nr 10/2007, CCJE rekomandon, që «anëtarët e ardhshëm të Këshillit Gjyqësor, qofshin gjyqtarë ose jo – gjyqtarë, nuk duhet të jenë politikanët aktivë, anëtarë të Parlamentit, Ekzekutivit apo administratës. Kjo do të thotë se as Kreu i Shtetit, nëse ai / ajo është kreu i qeverisë, as ndonjë ministër nuk mund të jetë një anëtar i Këshillit të Gjyqësorit).

Nga ana tjetër, sipas Komisionit të Venecias jo vetëm gjyqtarët, por edhe «shfrytëzuesit e sistemit gjyqësor» të tillë si avokatë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe akademike duhet të kenë një vend në Këshillin e Lartë Gjyqësor; kjo pasi emërimet e bëra vetëm nga anëtarët e brendshëm mund të çojnë lehtë në mbylljen e sistemit, mungesën e përgjegjësisë publike dhe të të kuptuarit të nevojave dhe kërkesave të jashtme të sistemit. Sipas Komisionit të Venecias duhet siguruar që opozita gjithashtu të ketë një ndikim në përbërjen e Këshillit. Një mundësi do të ishte të kërkonte dy të tretat ose tri të katërtat për zgjedhjen e anëtarëve nga Parlament por, në të njëjtën kohë, duhen marrë masa mbrojtëse procedurale kundër rreziqeve të ngërçit.

Për të dalë nga kjo bllokadë do të sugjerohej të bëhej, nga një anë, një përmirësim me karakter procedural dhe, nga ana tjetër, një përmirësim substancial. Nga pikëpamja procedurale mendoj se janë me vend kritikata për fazën finale të procedurës përzgjedhimore ku mendohet se do të parashikohet një aprovim sipas renditjes apo propozimeve nga Këshilli i Lartë të Emërimeve. Kjo, jo sepse Këshilli i Emërimeve nuk do të jetë organ i besueshëm, meqë ndër anëtarët mendohet të jenë Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, i Gjykatës së Lartë, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese më i vjetër në moshë etj. (sipas nenit 149/ç të draftit<sup>2</sup>), por sepse kushtëzohet vullneti i

<sup>2</sup> Neni 149/ç: “1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore, profesionale dhe morale të kandidatëve jo gjyqtarë për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kandidatëve jo

organizmave propozues nga rradhët e avokatëve, noterëve, pedagogëve dhe shoqëria civile. Pra mund të parashikojmë një listë, me dy apo tre emra, që vijnë direkt nga këto organizma profesionale dhe shoqërorë, ku edhe renditja të bëhet nga vetë ata sipas sistemit të përzgjedhjes dhe votimit. Pra të favorizohet një lloj demokracie direkte duke eliminuar ndikimet e K.L.E.-së, ose duke i kufizuar rolin në një shprehje vetoje ndaj kandidatëve për arsye objektive të parashikuara me ligj.

Nga ana tjetër kërkesat për të ashtuquajturat “vende të rezervuara” nuk mund të pranohen nga pikëpamja juridike. Arsyeja e parë është fakti se ky parashikim nënkupton një interpretim të zgjeruar të nenit 88, ku në asnjë pikë nuk flitet për vende të rezervuara, por për parimin e proporcionalitetit. Arsyeja e dytë, që mbetet thelbësore, qëndron në faktin që ky parashikim do t'i jepte peshë të madhe politikës në këto emërimet, duke rënë ndesh me frymën e përgjithshme të reformës dhe me parimin juridik e ndarjes së pushteteve.

Mendoj se palët politike duhet të tregohen më mature dhe të gjejnë shpejt një zgjidhje, duke kërkuar që t'i japin përparësi kësaj reforme dhe parimeve të drejtësisë që ajo do të sjellë në vendin tonë, pa u kushtëzuar nga interesat e ngushtë partiakë.

## Bibliografia

- Analizë e sistemit të drejtësisë në shqipëri nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë - Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë.  
 Dokument Parlamentar – Projekt Ligj 2016 - Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë “për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.  
 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.  
 Material shoqëruar i projektamendamenteve kushtetuese (pas opinionit ad interim të Komisionit të Venecias, datë 21 dhjetor 2015).  
 Projekt Ligj 2016 “Për per Organet e Qeverisjes se Sistemit te Drejtësisë”.

*prokurorë për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese që emërohen nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët. 2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi mbledhet sa herë është e nevojshme. 3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi përbëhet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm, Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, gjyqtari më i vjetër në detyrë i Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtari më i vjetër në detyrë i Gjykatës së Lartë. 4. Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili krijon kushtet e punës për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. 5. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rregullohet me ligj”.*

# *Agjentët e bursës, aktorë kyç në blerjen dhe shitjen e titujve*

---

*Prof. Asoc. Dr. Edi Spaho*

---

## **Abstrakt**

*Në mënyrë për të pasur një avantazh mbi tendencat që do të ndikojnë në tregjet e ndryshme duhet të kuptohet mire procesi i blerjes dhe shitjes së titujve. Kjo përfshin tipet e ndryshme të urdhërave që mund të ekzekutohen në bursa, sesi tregtia elektronike funksionon, si të arrihen vetëm përfitime ose të minimizohen humbjet dhe kush përfshihet në urdhër në një transaksion të suksesshëm. Një investitor i cili po përgatitet për një transaksion të ri do të donte një investim profesional që të ishte i suksesshëm. Me fjalë të tjera, duhet të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme zhvillimin e një portofoli të ri dhe të sigurojë supervizionin në mënyrë për të siguruar që transaksionet do të kryhen në mënyrë korrekte. Kur përdor një agjent shitës nga një bursë e madhe ose një tregti online, investitori i zgjuar do të ishte i suksesshëm vetëm nëse ai është përfshirë direkt në të gjithë procesin.*

*Pikësnyimi përfundimtar i investitorit është të zgjedhë titujt që të krijojë një portofol me një cilësi të lartë. Në varësi të synimeve të tij dhe tolerancës ndaj riskut, kuptohet që investitorë të ndryshëm kanë objektiva personale të ndryshme. Për shembull, një investitor i ri mund të jetë duke grumbulluar para për të blerë një shtëpi ose për të filluar një fond shkollimi për fëmijën. Një investitor më i vjetër dhe më me shumë eksperiencë mund të jetë duke ngritur kapital për t'u përgatitur për një pleqëri të mundshme ose t'u lërë para anëtarëve të familjes si trashëgimi. Cilado të jetë arsyeja, rëndësia e të kuptuarit sesi titujt individual tregëtohen është kritike për një menaxhim të mirë të parave.*

*Agjentët e bursës dëshirojnë të blejnë dhe shesin aksione në çdo ditë të dhënë gjatë orarit zyrtar të tregut. Ata monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme aktivitetin e tregut dhe janë gati të bëjnë një lëvizje për çdo lajm çasti. Kështu pra, synimi i tyre është të bëjnë para sa më shpejt që të mundin dhe ata marrin përsipër një sasi të madhe risku në aktivitetin e tyre të tregëtisë. Por edhe njëherë, tundimi për t'u bërë një agjent burse është më i hasur sot me mundësinë e lehtë për të ngritur një llogari tregtie online.*



*Fjalë Kyçe: Agjentët e Bursës, investitor, menaxherë të portofolit, bursa e letrave me vlerë, shoqëri aksionare.*

## 1. Tregtia: Blerja dhe Shitja e Titujve

### 1.1 Agjentët e Bursës dhe Tregtarët

Në ditët e sotme më shumë investitorë individualë do të duan të mbajnë përgjegjësi për portofolet e tyre. Ata do të tundohen të bëhen menaxherët e parave të tyre dhe që do të thotë që e marrin gjithçka më seriozisht. Ata do të duan të vendosin lidhje me një agjent burse apo menaxher portofoli për një menaxhim më të mirë të parave të tyre.<sup>1</sup>

Menaxherët e portofolit blejnë dhe shesin tituj me qëllim mbajtjen e tyre për një periudhë më të gjatë (zakonisht 3-mujore, 6-mujore apo 1-vjeçare). Pikësynimet e tyre janë të kenë fitime duke përdorur një analize rrënjësore të fortë. Vetëm nëse ata marrin një vendim për të blerë një titull, ata monitorojnë kushtet bazë të kompanisë në shqyrtim për të vendosur kur të shesin pozicionin e tyre në një datë më të largët. Ata munden gjithashtu të blejnë dhe të mbajnë titujt e tyre për më shumë se një vit në mënyrë për të marrë një përfitim nga taksat e ulëta që janë vendosur për fitimet kapitale afat-gjata.

Nëse investitorët duan të tregtojnë tituj duke kërkuar një fitim të shpejtë ose duan të ndërtojnë një portofol mbi një afat të gjatë, duhet të shqyrtojnë mekanizmat e tregtisë. Tregtia e aksioneve të zakonshme ndodh në një numër sistemesh tregjesh të mëdha, duke përfshirë bursat kombëtare, bursat rajonale dhe Tregun Mbi Banak, OTC. Sistemet e tregëtisë elektronike të zotëruara në mënyrë të pavarur dhe operative janë të disponueshme për tregëtinë e aksioneve të zakonshme.

Suksesi përfundimtar i tregut të bursës lidhet me agjentët e bursës dhe tregtarët. Një agjent burse, zakonisht i referohemi një përfaqësuesi të rregjistruar ose një financieri ekzekutiv dhe është një person i cili është i liçencuar për titujt dhe është i autorizuar të veprojë si një agjent për një investitor i cili dëshiron të ekzekutojë një urdhër. Ky person është përgjegjës për veprimet që bën në emër të klientit bazuar në standartet më të larta etike. Me fjalë të tjera, agjenti i bursës nuk mund të mbajë një pozicion mbi një titull, gjë e cila mund të çojë në një konflikt interesi ose rekomandim jo të denjë. Agjenti i bursës duhet gjithashtu të ketë kujdes që të mos t'i tregëtojë tituj klientit pa qenë nevoja, në mënyrë që ai të mos përfitojë komisione të pamërituara. Kur një investitor përdor një agjent burse për të

<sup>1</sup> Alan Northcott, "The Complete Guide to Investing in Short Term Trading: How to Earn High Rates of Returns Safely", Atlantic Publishing Group, 2007, fq.73.

ekzekutuar urdhërat e tij, ai ose ajo pret standartet më të larta të profesionalizmit të pasuara nga një diplomë e garantuar besimi që përforcon marrëdhënien.<sup>2</sup>

Në të kundërt, një tregtar është një entitet ose një kompani që shpreson të blejë ose shesë një titull për llogari të tij. Shumë firma të mëdha agjentësh burse kanë përfaqësuesit e tyre në dyshemetë e bursës të cilët njihen edhe si "specialistë". Ata qëndrojnë gati për të blerë tituj për inventarin e tyre ose të shesin tituj për t'a zvogëluar këtë inventar. Në çdo moment kohe, tregëtarët deklarojnë dëshirën e tyre për të blerë një titull me një çmim specifik (çmimi bid) që është më i ulët se çmimi për të cilin ata shpresojnë të shesin për të njëjtin titull (çmimi ask ose çmimi i ofruar).

Ky proces ka një rëndësi kritike, sepse një mosbalancë në urdhëra mund ta godasë tregun në çdo moment të kohës. Për shembull, të rejtat negative mbi një kompani mund t'i bëjnë tregtarët të nxjerrin një sasi të madhe urdhërash shitjeje. Kjo pabarazi e përkohshme do të tentojë të shtyjë çmimin e titullit më ngadalë pa një balancë mes dëshirave të blerësve për të blerë titullin nga ana tjetër.

Tregtarët ndihmojnë për të stabilizuar tregun duke vepruar si një amortizator midis anës së blerjes dhe shitjes së tregtarëve. Ata punojnë me njëri-tjetri në dyshemenë e bursës për të siguruar likuiditet dhe stabilitet çmimi. Tregëtarët të cilët kanë një ofertë titujsh në inventarin e tyre janë duke shpresuar për t'ia shitur atë atyre tregëtarëve të cilët duan të blejnë titujt për klientët e tyre. Ne mund të shikojmë shpërndarjen bid-ask si çmimin e vendosur nga tregëtarët për të kërkuar likuiditet dhe stabilitet që rezultojnë nga urdhërat afat-shkurtër.<sup>3</sup>

Tipi i dytë i riskut është i lidhur me sasinë e kohës që atij do t'i duhet të ndryshojë drejtimin e një pozicioni dhe pasigurinë për të bërë këtë. Kjo situatë fillimisht varet nga shpeshësia e transaksioneve që ndodhin për një titull të veçantë. Sa më i madh numri i blerjeve dhe shitjeve për një titull, aq më e vogël koha që një tregtari i duhet për të mbajtur këtë pozicion. Një titull që tregtohet në mënyrë jofrekuente, megjithatë, mban mbi vete më shumë risk, sepse çmimi i tij mund të bjerë gjatë një periudhe të gjatë mbajtjeje.

### 1.2 Agjentët e Bursës së Dyshemesë dhe Specialistët

Tipe të ndryshme punonjësish punojnë në tregun e dyshemesë së bursave më të mëdha dhe secili luan një rol të veçantë në gjithë procesin.

Një tregtar dyshemeje vepron si agjent, duke përfaqësuar urdhërat e klientëve për të blerë dhe shitur tituj. Janë dy tipe kryesore të agjentëve të dyshemesë: ata me komisione dhe ata të pavarur. Zyrat e komisionerëve që janë anëtarë të Bursës së New York-ut (NYSE) punësojnë agjentët me komision. Një agjent me komision

<sup>2</sup> Id.fq.79.

<sup>3</sup> Jason Kelly, "Neatest Little Guide to Stock Market Investing", Publishing by Penguin Group, 2013, fq.152.

ekzekuton urdhërat e firmave të klientëve. Agjentët e pavarur punojnë për veten e tyre. Megjithatë nuk janë të lidhur me asnjë zyrë komisionerësh, ata marrin urdhëra nga këto zyra komisionerësh të cilat nuk kanë agjentë me kohë të plotë, agjentët e të cilave gjenden poshtë në dysheme, ose agjentët e të cilave janë shumë të zënë për të mbajtur një urdhër specifik. Paguesa e tyre negociohet plotësisht në varësi të madhësisë dhe vështirësisë të atij urdhëri që ata janë duke tregëtuar.

Siç e përmenda dhe më lart, agjentët e bursave kanë përfaqësuesit e tyre në dyshemetë e bursës, të cilët njihen dhe me emrin “specialist”. Funkcionet kryesore të një specialist janë:

- Menaxhon procesin e tregtisë – Për të mbajtur një treg të drejtë dhe të rregullt për një titull të veçantë, specialisti përcakton çmimin hapës për atë titull çdo ditë. Më pas, gjatë ditës, ai kuoton në mënyrë të vazhdueshme çmimet korrentë bid dhe ask për agjentët.<sup>4</sup>
- Ekzekuton urdhërat për agjentët e dyshemesë – Specialisti mund të ekzekutojë një urdhër menjëherë ose t’u mbajë urdhërin dhe t’u ekzekutojë atë kur titulli arrin çmimin specifik të kërkuar nga klienti. Si një tregtar, specialisti do të blejë ose shesë tituj nga inventari i tij në mënyrë që të mbajë tregun likuid ose të sjellë ndryshime të shpejta të çmimit.
- Shërben si një katalizator – Specialistët janë pika e kontaktit midis agjentëve të cilët duhet të blejnë ose shesin urdhëra. Specialisti vepron si një katalizator, duke sjellë blerës dhe shitës sëbashku dhe mundëson një transaksion që do të ndodhë aty.

### 1.3 Rregjistrimi i llogarive

Përpara se specialisti të ekzekutojë një urdhër për një klient të tij, ai duhet të dijë të hapë dhe të rregjistrojë një llogari. Ka shumë situata të ndryshme me të cilat ai duhet të jetë i informuar, si p.sh, se çfarë llogari duhet të krijojë dhe çfarë tipi partneriteti është më i mirë për çdo klient. Tipet më të zakonshme të regjistrimit të llogarive janë:

- Llogaritë individuale – Për persona të veçantë të cilët dëshirojnë një partnership të vetëm dhe kontroll të aktiveve.
- Bashkëpronësitë – Përfshijnë bashkëpronësinë 50-50%, bashkëpronësitë me të drejtën e supervizimit (në qoftë se një pronar vdes, trashëgimtari përfiton të gjithë bashkëpronësinë e të gjitha aktiveve të marra në llogari), bashkëpronësitë e zakonshme (në qoftë se një pronar vdes, llogaria ndahet

<sup>4</sup> Tim Ord, “The Secret Science of Price and Volume: Techniques for spotting Market Trends, Hot Sectors, and the Best Stocks”, Wiley Trading, 2008, fq.48.

në varësi të përqindjes së rënë dakord në marrëveshjen e bashkëpronësisë), gjithëpronësi (çdo pronar ka një interes të plotë në tituj, dhe në rast të vdekjes së një prej pronarëve, i gjithë kapitali u dorëzohet trashëgimtarëve) dhe bashkëpronësia në komunitet (për burrin dhe gruan vetëm; në rast të vdekjes së njërit bashkëshort, tjetri mban gjysmën dhe gjysma tjetër është e taksueshme).

- Llogaritë e mbikqyrura – Vendosen nën mbikqyrjen e UGMA (The Uniformed Gifts to Minors Act) në çdo shtet, në mbështetje të ligjeve specifike. UGMA lejon transferimin ligjor të pasurisë një të mituri pa patur shpenzime për krijimin e një trusti ose koston e një bonoje. Pasuria që mund të jepet zakonisht limitohet në para, tituj, fonde të përbashkëta dhe kontrata jete apo fonde pensionesh. Të ardhurat nga investimet në llogaritë (dividentët dhe interesat) janë në pronësi të të miturit duke përdorur numrin e tij ose të saj të sigurimit dhe duhet të riinvestohet nga mbikqyrësi në mbështetje të Rregullit të Kujdestarit në interesin më të mirë të të miturit.<sup>5</sup>
- Llogaritë mbikqyrëse konservatore – Kjo llogari është përcaktuar për një të mitur i cili nuk ka mbikqyrës njërin nga prindërit. Një gjykatë do të vendosë një tutor deri në kohën që i mituri arrin moshën madhore. Në shtesë të kësaj, mund të jetë vetëm një fëmijë, numri i Sigurimeve Shoqërore të të cilit përdoret për llogarinë.

## 2. Tipat e Urdhërave

Tani le të përpiqemi të ekzaminojmë tipat e urdhërave që specialisti zbaton për të blerë dhe shitur në dyshemenë e një burse, siç është NYSE. Ai duhet të dijë cilin tip urdhëri të zbatojë në lidhje me dëshirën e klientit për të blerë ose shitur tituj. Ka urdhëra për çdo tip investitori, nga të cilat disa duan ekzekutim të menjëhershëm, ndërsa disa te tjera duan te pritjet për të arritur një çmim specifik.

Tashmë çmimet e titujve kutohen me presje dhjetore, ku çdo cent ka rëndësi. Para kësaj, çmimet kuotoheshin me një të gjashtëmbëdhjetat. Me fjalë të tjera, çmimet për titujt janë në 6.25 cent shtesë. Për shembull, nëse PFE kuotohet me 34 1/16 në NYSE, kjo vlerë e konvertuar në dollarë të vërtetë është e barabartë me 34.0625\$ për aksion. Një çmim titulli prej 48 13/16 konvertohet në 48\$ plus 13 herë 0.0625\$, ose 48.8125\$.

Në përgjithësi, shumica e investitorëve i vendosin urdhërat në raunde nga më i larti tek më i ulëti. Çdo raund përfaqëson 100 aksione të titullit. Nëse urdhëri është për 500 aksione për titujt e General Motors (GM) në NYSE ose 800 aksione të Microsoft (MSFT) në tregun OTC, urdhëri konsiderohet si një raund i plotë. Në

<sup>5</sup> [http://en.wikipedia.org/wiki/Uniform\\_Gifts\\_to\\_Minors\\_Act](http://en.wikipedia.org/wiki/Uniform_Gifts_to_Minors_Act).

qoftë se një investitor nuk ka mjaftueshëm para për të blerë në këto raunde, atëherë ai mund të blejë në raundet më të ulëta.

Një raund më i ulët tregton urdhëra për më pak se 100 aksione dhe mund të jetë në çfarëdo shume. Sa më i lartë çmimi i titujve, si ato të kompanive të internetit, do të krijojnë shpesh urdhëra më të ulëta. Investitorët zakonisht paguajnë një të gjashtëmbëdhjetën për çdo shtesë të tregtisë. Kjo pagesë shtesë bëhet për mbajtjen shtesë të ndodhur gjatë tregëtisë së vogël. Për shembull, nëse çmimi i një titulli është 150\$ për aksion, një shtesë e tillë do të kushtojë 150.0625\$ për një aksion.<sup>6</sup>

### 2.1 Urdhërat e Tregut

Ky urdhër është më i thjeshti sepse ekzekutohet me çmimin e disponueshëm në momentin që ai është dhënë. Një urdhër tregu thjesht nënkupton që mund të blesh ose të shesësh me çmimin aktual të tregut. Investitori ka dëshirë të pranojë çmimin e tregut kur është i leverdisshëm. Urdhërat e tregut kanë prioritet në tregun e dyshemesë, sepse ato mund të ekzekutohen me shpejtësi kur urdhërat e blerjes dhe shitjes arrijnë tregun në të njëjtën kohë. Si rrjedhim, urdhëri që ka çmimin më të mirë ka prioritet më të lartë. Për shembull, kur një shitës dëshiron të paguajë një çmim më të lartë për një titull, urdhëri i tij plotësohet më shpejt, gjithashtu kur një shitës dëshiron të marrë më pak për titullin e tij, gjithashtu urdhëri plotësohet më shpejt. Për shkak të fluksit të madh të urdhërave të marrë në dyshemenë e një burse të organizuar, duhet të ketë një prioritet për ato urdhëra që vijnë në të njëjtën kohë. Përgjithësisht, specialisti duhet të mendojë për urdhërin e parë si të parin që duhet të ekzekutohet, por nga ana tjetër prioritet më të madh mund t'ju jepet disa përfaqësuesve të veçantë të tregut. Për shembull, ndryshimi i rregullave kërkon që urdhërat e marra nga publiku t'u jepet një prioritet më i fortë mbi ato të marra nga anëtarët e firmave që janë duke tregtuar për llogari të tyre.

### 2.2 Urdhërat e Kufizuar

Për investitorët që duan të paguajnë një çmim të caktuar për titujt e tyre, një urdhër i kufizuar është tipi më i dëshiruar i urdhërit për t'u vendosur. Për ta specifikuar më mirë, urdhërat e kufizuar tregojnë çmimin që duhet të paguhet ose të merret për blerjen ose shitjen e aksioneve.<sup>7</sup> Tregtia nuk do të ndodhë deri sa çmimi i kufizuar të jetë arritur. Me këtë tip urdhëri, nuk ka vend për negociim për një çmim më të lartë apo më të ulët.

Për shembull, një investitor mund të dëshirojë të blejë aksione nga Boeing (BA) me 45\$ për aksion. Megjithatë titujt po tregtohen aktualisht me 48\$, ai po

<sup>6</sup> John J Murphy, "Technical Analysis of the Financial Markets: A Comprehensive Guide to Trading Methods and Applications, New York Institute of Finance, 1999, fq.32.

<sup>7</sup> Id. fq.71.

shpreson të paguajë jo më shumë se 45\$ për aksion. Nëse titulli e ul çmimin, urdhëri mund të ekzekutohet në 45\$ dhe ai do t'a kishte blerë titullin me një çmim më të arsyeshëm. Megjithatë, nëse çmimi i titullit vazhdon të rritet dhe nuk ulet më kurrë në nivelin e 45\$, investitori nuk do të ketë mundësi të blejë vetëm nëse ai e anulon urdhërin e kufizimit dhe vendos një urdhër tregu në vend të tij.

Urdhëri i kufizuar gjithashtu konsiderohet i kushtëzuar sepse ai ekzekutohet vetëm nëse çmimi i limituar ose një çmim më i mirë mund të arrihet. Një urdhër i kufizuar për blerje tregon se një titull mund të blihet me një çmim të caktuar ose më të ulët.

Një urdhër i kufizuar për shitje të autorizon që titullin mund ta shesësh me një çmim të caktuar ose më të lartë. Për shembull, supozojmë se gruaja e këtij investitori është gjithashtu një investitore për llogari të saj. Ajo zotëron aksione të Lands End (LE) që aktualisht po shiten me 34.75\$ dhe ajo ka nevojë të shesë në mënyrë që të bëjë një udhëtim turistik. Ajo vendos një urdhër të kufizuar për të shitur 100 aksione me 38\$. Nëse çmimi rritet në këtë nivel ose më lartë, urdhëri do të ekzekutohet. Nëse çmimi bie që nga ky kuotim i fundit, asaj do t'i duhet të presë ose të ndryshojë urdhërin e saj nëse ajo dëshiron të shesë titullin e saj.<sup>8</sup>

### 2.3 Urdhërat e Ndalimit

Një urdhër ndalimi konsiderohet i kushtëzuar sepse ai specifikon një tregti që nuk do të ekzekutohet deri sa tregu të arrijë në një çmim të përcaktuar. Në atë kohë urdhëri bëhet një urdhër tregu. Për shembull, një urdhër ndalimi për të blerë nënkupton se një urdhër nuk mund të ekzekutohet deri sa çmimi i tregut të një titulli të rritet në një çmim specifik. Gjithashtu, një urdhër ndalimi për të shitur tregon se një urdhër nuk mund të ekzekutohet deri sa çmimi i tregut të një titulli të bjerë në një çmim të caktuar. Vetëm kur çmimi i synuar arrihet, ai bëhet një urdhër tregu dhe ekzekutohet menjëherë.

### 2.4 Urdhërat Specialë

Një urdhër i cili në mënyrë automatike shndërrohet në një urdhër tregu kur një çmim i specifikuar arrihet është quajtur një urdhër tregu nëse preket. Ky tip urdhëri është i kundërti i urdhërit të ndalimit, sepse tregu duhet të bjerë në një çmim të dhënë në mënyrë që urdhëri të ekzekutohet si një urdhër blerjeje. Në mënyrë të ngjashme, një urdhër shitje bëhet një urdhër tregu kur tregu bie në një çmim të dhënë. Për të bërë dallimin midis një urdhëri ndalimi dhe një urdhëri tregu, i pari është krijuar për të nxjerrë një pozicion ekzistues në një çmim të pranueshëm, ndërkohë që i dyti është krijuar për të futur në një pozicion një çmim të kërkuar.

<sup>8</sup> Id. fq.76.

Një tip tjetër urdhëri mund të klasifikohet si specifik kohor. Për shembull, një urdhër për të blerë ose shitur me hapjen e tregut është quajtur një urdhër hapje. Një urdhër mbyllje tregon se një tregëti do të ekzekutohet vetëm brenda në periudhën e mbylljes së ditës së punës. Një urdhër vepro-ose-ndërprit është një urdhër që duhet të ekzekutohet në momentin e arritjes së një çmimi dysHEME ose ai do të anulohet menjëherë. Urdhëra të tjerë mund të përshkruajnë një periudhë kohe të caktuar në të cilën ata janë të efektshëm, një ditë, një javë, një muaj, ose madje një orë të dhënë gjatë një dite të rregullt tregtie.

## 2.5 Blerja me Marzh

Kur një investitor nuk ka mjaftueshëm para për të paguar cash për blerjen totale të një urdhëri i jepet mundësia të kreditohet duke blerë me marzhe. Përpara se një transaksion marzhi të mund të ndodhë, duhet hapur një llogari speciale në shtëpinë e brokerimit ose zyrat e tregtarëve. Si rrjedhim, kjo llogari i lejon investitorit të aplikojë për një linjë kredie, vetëm se paratë përdoren vetëm për të blerë tituj.

Qeveria amerikane dhe NASDAQ kanë vendosur rregulla speciale në lidhje me marzhin e tregtisë. Tani, kërkohet një 50% marzh mbi një llogari që kjo lloj tregtie të kryhet. Me fjalë të tjera, kur titujt blihen me marzhe, një sasi cash prej 50% të çmimit total të blerjes duhet të jetë kredituar që më parë në llogarinë e agjentëve të bursës.

Për shembull, supozojmë sikur duam të blejmë 100 aksione të Xerox, të cilat aktualisht po ofrohen me 45\$ për aksion. Çmimi i rregullt i plotë për këtë tregti do të ishte 4.500\$ duke përjashtuar komisionet. Nëse i blejmë këto aksione me marzh, do të përfitohet 2.250\$ ose gjysmën e kostos totale. Kjo shumë duhet të jetë e depozituar në llogari të agjentit të bursës si një kolateral. Njerëzit blejnë tituj me marzh për të patur një sasi të vogël parash për qëllimin e lëvrimit. Si rrjedhojë, një sasi e vogël parash përdoret për të kontrolluar një sasi të madhe të vlerës së titullit. Kur një investitor ble tituj me marzh, kthimi potencial është më i madh nëse çmimi i titullit rritet, sepse agjenti i bursës u pagua vetëm për gjysmën e çmimit fillestar të blerjes. Ndërkohë që ky koncept duket si një ide e mirë, duhet patur parasysh që titujt mund të bien gjithashtu në çmim, gjë e cila shkakton efektin e kundërt. Nëse kjo ndodh, agjenti i bursës mund t'i kërkojë investitorit të shtojë disa cash në mënyrë që të mbahet një marzh minimum i kërkuar. Kjo situatë klasifikohet si një thirrje marzhi. Kredia e agjentit të bursës në llogarinë e investitorit nuk zvogëlohet me çmimin e titullit; por në vend të kësaj, vetëm sasia e investimit humbet vlerë.

## 2.6 Shitja Shkurt

Kur mendohet për tregëtinë në një drejtim të rregullt, investitori do të blejë një titull në fillim dhe do t'a shesë atë më vonë, duke shpresuar për një fitim. Me një

shitje shkurt, bëhet thjesht e kundërta, ku shitet titulli në fillim dhe më pas blihet mbrapsht në mënyrë që të mbulohet titulli që u shit në fillim. Para së gjithash, duhet të dihet se shitjet tentojnë të jenë pesimiste dhe presin që çmimi i titullit të bjerë. Kjo situatë mund të rezultojë nga rëniet e fitimeve për aksion të kompanisë, një zvogëlim në përqindjen e dividendit, ose një ndryshim në menaxhim që është përshpejtuar në një efekt negativ të kompanisë si një e tërë. Në këtë situatë nuk ka shumë rëndësi arsyeja, por investitorët do të jenë të lëkundur mbi atë titull të veçantë.

Duke vepruar thjesht në të kundërt të blerësve me marzh, të cilët presin që një çmim të rritet në vlerë, shitësi shkurt shpreson që të fitojë nga rënia e çmimit të titullit. Së pari, një llogari marzhi duhet vendosur me agjentin e bursës. Më pas, në vend që të marrë para borxh me marzh, shitësi shkurt merr hua tituj nga agjenti. Kështu që titulli mund të shitet me një çmim më të lartë që në fillim, gjë e cila do të çojë në një rënie në vlerë dhe mund të blihet prapë mbrapsht me një çmim më të ulët.

Le të supozojmë se shtëpia e brokerimit mund të japë hua aksione të cilat kërkon investitori që bën një shitje shkurt. Aksionet vendosen në llogari dhe i dërgohen blerësit kur ato shiten. Investitori ka bërë tani një shitje shkurt të titullit dhe do t'i duhet të blejë aksionet përsëri më vonë për t'ia kthyer ato agjentit të bursës. Qëllimi është që t'i riblejë këto aksione me një çmim më të ulët, t'ia kthejë ato agjentit dhe të mbajë diferencën e çmimit si përfitim. Nëse çmimi i aksioneve rritet, investitorit do t'i duhet të blejë mbrapsht aksionet me një çmim më të lartë dhe kështu pra të rezultojë me humbje.

Këtu po japim një shembull hipotetik sesi funksionon shitja shkurt. Supozojmë se investitori ka marrë vesh se Boeing ka humbur një kontratë të fuqishme me Qeverinë për të ndërtuar avionë ushtarakë në kompaninë e tij të vjetër McDonnell-Douglas në St. Louis. Ai parashikon se të ardhurat e tij për vitin në vazhdim do të bien, gjë që do të ndikojë negativisht në çmimin e titujve të tij. Për të përfituar nga kjo situatë, ai merr hua 100 aksione Boeing nga agjenti i tij i bursës dhe i shet 48\$ për aksion. Kjo shitje i jep atij një të ardhur neto prej 4.800\$ duke përjashtuar komisionet. Dy muaj më vonë çmimi i këtyre aksioneve bie në 40\$ për aksion dhe investitori vendos të riblejë 100 aksione nga Boeing me një vlerë prej 4.000\$ në mënyrë për të shlyer huanë e marrë nga agjenti në fillim. Si rrjedhim, agjenti i merr këto aksione mbrapsht dhe investitori largohet me një fitim prej 800\$ duke hequr komisionet. Sikurse në tregtinë me marzh, një investitor që bën një shitje shkurt gjithashtu rrezikon. Le të supozojmë se dy muaj më vonë, qeveria e Arabisë Saudite nënshkruan me Boeing një kontratë për të ndërtuar avionë lufte për shtetin e tyre. Duke parashikuar fitimet e mëdha të vitit në vazhdim, tregu detyron që çmimi i aksioneve të Boeing të rritet në vend që të ulet. Tani aksionet tregëtohen më 62\$ për aksion, kështu që investitori vendos që të riblejë aksionet dhe të mbyllë

llogarinë me agjentin. Si rrjedhim, ai do të humbasë 1.400\$ plus komisionet – sepse blerja mbrapsh e aksioneve ka kushtuar 6.200\$.

Për të mbrojtur veten nga kjo situatë e padëshirueshme, investitori mund të kishte vendosur një urdhër ndalim-humbje mbi aksionet e Boeing dhe kështu nëse titujt që ai shiti me 48\$ do të rriteshin në 54\$, do të fillonte një riblerje automatike për 100 aksionet e Boeing. Ndërkohë që ai është i sigurt nga humbja, kjo situatë nuk është aq e keqe sa të lerë që aksionet t'i dalin nga duart dhe të arrijnë çmime akoma më të mëdha, që si rrjedhojë do të çojnë në humbje më të mëdha.

## 2.7 Transaksionet në Tregun Mbi Banak (OTC)

Titujt e emtuar në publik të cilat nuk tregëtohen në bursë, tregëtohen në OTC. Ky treg i referohet gjithashtu sistemit NASDAQ. Siç e përshkruam më lart, tregu OTC nuk ka një treg dyshemeje, që do të thotë se tregtia ndodh nëpërmjet një sistemi të kompjuterizuar kuotimi në banakët e agjensive të brokerimit. Ky treg dytësor zotëron ato që quhen aksione të dorës së dyte, të cilat përfshijnë kompani solide dhe me reputacion. Megjithatë, ato zakonisht kanë një kapitalizim më të ulët, (aksione të dala nga qarkullimi) dhe tregtojnë me çmime më të ulëta se ato të bursave të mëdha. Për shembull, një klasifikim njihet si emetimi i titujve në rritje dhe këto tituj përfaqësojnë kompani të reja që kanë një potencial rritjeje të jashtëzakonshëm por kanë siguri më të ulët në tregun afat-gjatë.

Ndërkohë që tregtia ndodh, agjentët dhe tregëtarët e bursës veprojnë si aktorë tregu për tituj të ndryshëm. Sistemi i kompjuterizuar i tregtisë iu lejon atyre të ndërveprojnë menjëherë kur ekzekutohen urdhërat, duke siguruar një likuiditet të shpejtë për funksionimin e tregut. Për shembull, titulli mund të ketë një çmim bid prej 15\$ dhe një çmim ask prej 15.75\$. Një investitor i cili dëshiron të blejë aksione do të paguante 15.75\$ për aksion dhe një investitor i cili do të shesë do të merrte 15\$.

Zakonisht, investitorët institucionalë punojnë nëpërmjet një agjencie të madhe komisionerësh në mënyrë që të kompletojnë transaksionin. Ata munden gjithashtu të punojnë në mënyrë të pavarur, megjithëse, në një treg të katërt me një sistem tregëtimi të kompjuterizuar të quajtur Instinet. Sistemi është i kufizuar vetëm për nënshkruarit dhe siguron kuotime bid dhe ask, plus urdhërat e ekzekutimit. Ky aktivitet raportohet në shtypin financiar si transaksione të përziera, sikurse raportohen edhe tregtitë në bursat e ndryshme.

## 2.8 Hyrja e Numrave Dhjetorë në Tregje

Pas vitesh pengesash, Komisioni i Sigurisë dhe Bursës (SEC) ju ka dhënë bursave më të mëdha lejen për të konvertuar çmimet e titujve dhe opsioneve në presje

dhjetore nga thyesa që ishin më parë. Kuotimet e reja do të zëvendësojnë tregtinë 200 vjeçare të përdorimit të fraksioneve të dollarit, si 1/8 u zëvendësua me 12.5 cent. Avokatët mendojnë se numrat dhjetorë do të zvogëlojnë shpërndarjen e çmimeve bid-ask dhe do ju kursejnë investitorëve mbi 3 milion \$ çdo ditë në komisione.<sup>9</sup>

Nuk zgjati shumë që investitorët të rregullonin këto çmime me presje. Qindra gazeta që publikojnë çmimet e titujve janë kthyer në formatin e numrave dhjetorë. Faqet e internetit dhe deklarata mujore të agjensive të komisionerëve gjithashtu shfaqin në mënyrë të vazhdueshme çmimet me presje dhjetore. Bursat në Amerikë janë duke përdorur gjithashtu praktikën ndërkombëtare të këtyre çmimeve në mënyrë që të vazhdojnë të jenë në garë dhe ky është një hap kritik në drejtimin e duhur.

Mbështetësit thonë se përdorimi i sistemit të presjeve dhjetore do të ndihmojë investitorët e rregullt duke ngushtuar diferencën ndërmjet çmimeve më të mira bid dhe ask, të njohura edhe si shpërndarja. Shpërndarjet zakonisht variojnë nga 125 në 50 cent, një shumë që rrit masën e fitimit të agjentëve të bursës, të cilët marrin një përqindje në bazë të madhësisë së shpërndarjes. Kjo situatë do të jetë në mënyrë të padiskutueshme e favorshme për investitorët dhe do t'i bëjë tregjet më atraktive për investitorët e huaj në të ardhmen.

## 2.9 Zhdukja e Shpërndarjes

Kërkesa dhe oferta përcaktojnë çmimet e titujve dhe diferenca ndërmjet asaj që çfarë një shitës kërkon dhe çfarë një blerës jep (shpërndarja) është pjesa ku specialistët bëjnë një pjesë të përfitimeve të tyre. Pjesa më e madhe e të ardhurave vjetore vjen nga kompania që specialisti përfaqëson dhe është disi e lidhur me volumin e tregtisë, kështu pra është në të mirën e specialistit për të lehtësuar procesin e tregtisë. Megjithatë, shpërndarja është duke u zhdukur nga pjesa më e madhe e tregtimeve në NYSE. Me përdorjen e shumicës së urdhërave direkt dhe në mënyrë elektronike, shpërndarja pothuajse po bëhet zero.

Në të kundërt, të 500 aktorët e tregut të NASDAQ, në vend që të kenë tituj specifik të caktuar secilit prej tyre, mund të konkurojnë për çdo transaksion titulli. Rrjetet e Komunikimit Elektronik (ECN) janë bërë të famshme falë internetit. Duke përdorur ECN-në, agjentët e bursës munden menjëherë të bashkojnë urdhërat e blerjes dhe të shitjes dhe të eliminojnë shpërndarjen kur bëjnë një tregti. Nëse nuk ndodh një përputhje mes tyre, urdhëri vendoset në një libër elektronik tregtimi që liston ata që do të bëhen blerës dhe shitës, numrin e aksioneve që do të hyjnë në transaksion dhe çmimin. Aktorët e tregut të NASDAQ nëpërmjet librit

<sup>9</sup> Guy Cohen, "Options Made Easy: Your Guide to Profitable Trading", Published by Pearson Education, 2013, fq.57.

përpiqen të plotësojnë urdhërat.<sup>10</sup> Ky është një avantazh i sistemit të specializuar dhe çdo urdhër që hyn në këtë sistem përshkron këtë rrugë për t'u plotësuar. Rregullat e NYSE-s kërkojnë specialistë për të ndihmuar të mbajnë një treg të rregullt. Për shembull, nëse asnjë blerës nuk afrohet për të blerë aksione që dikush do t'i shesë, specialisti do t'i blejë ato për t'i shitur më vonë. Siç e përmendëm edhe më parë, ky proces quhet bërja e tregut brenda një titulli.

### 3. Tregëtia Elektronike: Tendanca e së Ardhmes

Interneti po bën një revolucion në investimet personale sidomos në vitet e fundit. Asnjë gjë nuk është më e paprekshme dhe madje edhe agjentët e bursës me shërbim të plotë janë duke iu bashkuar bumit të tregtisë elektronike në mënyrë që të mbajnë klientët dhe të vazhdojnë kështu me konkurrencën. Ndërkohë që investitorët bëhen më të pavarur dhe duan të marrin vendimet e tyre në lidhje me investimet, aq më e natyrshme do të bëhet hyrja në internet për të blerë dhe shitur tituj në përpjekjen për kosto më të ulëta tregtimi.

Megjithëse tregtia online është bërë shumë interesante për klientët individualë, ata mundet gjithashtu të jenë më të hutuarit e kohës. Tregu i kohëve të fundit ka pasur një popullaritet të madh në tregëtinë elektronike dhe ka vendosur investimin me gjetje më afër çdokujt. Nuk janë vetëm investitorët ata që mund të blejnë dhe shesin tituj me një kosto minimale, por titujt e disponueshëm mund të gjenden në internet dhe mund të presin këdo që dëshiron të bëhet një blerës i shpejtë.<sup>11</sup> Investimi online bazë përfshin një mënyrë më të lirë ose më të lehtë veprimi në një kompani komisionerësh. Këto metoda janë për njerëzit që dëshirojnë t'i zgjedhin investimet vetë. Në vend që të telefonojë një agjent burse për një urdhër të zakonshëm blerje apo shitjeje, investitori ia dërgon agjentit urdhërin online. Këto llogari zakonisht janë me zbritje nga agjentët e bursës të cilët nuk japin asnjë këshillë investimi.

#### 3.1 Rreziku i Tundimit

Për vite me rradhë, ekspertët, planifikuesit dhe rregullatorët kanë diskutuar mbi kohën minimale të përshtatshme që një titull duhet të mbahet përpara se ai të shitet. Sa kohë duhet të kalojë që një investitor të blejë tituj, dhe pastaj planifikuesi i tij të mund t'i sugjerojë të shesë në mënyrë që të mund të blejë një titull të ri? Ka një mundësi të madhe për abuzim këtu, sepse planifikuesit e bazuar në komisione ose agjentët e bursës mund të bëjnë më shumë para vetëm duke bërë rekomandime.

<sup>10</sup> Id.fq.96.

<sup>11</sup> Mark R. Conway and Aaron N. Behle, "Professional Stock Trading: System Design and Automation", Published by Acme Trader LLC, 2003, fq.29.

Ka pasur shumë rastesh ku profesionistët e licencuar të titujve janë akuzuar për vjedhje në llogaritë e klientëve. Në të vërtetë, ata rekomandojnë një blerje dhe shitje të të njëjtit titull brenda një periudhe shumë të shkurtër kohe në mënyrë që të realizojnë më shumë të ardhura nga komisionet. Megjithëse me një strukturë me komisionet më të ulëta të shumicës së agjentëve-tregëtarëve të sotëm, kjo çështje është e vështirë për t'u provuar. SEC-i është si një roje e industrisë dhe përpiqet të ndëshkojë abuzimet në këtë fushë. Sa më të larta të jenë komisionet për investitorët e zakonshëm aq më shumë shkelje do të ndodhin në fondet e përbashkëta të industrisë. Mund të ndodhë që agjenti të gjejë një investitor i cili ka vuajtur nga një tip i tillë abuzimi. Më e rëndësishmja është se agjentët duhet të kenë një arsye të fortë për të rekomanduar një person të besuar për fondet në një portofol.

Si profesionistë financiarë, agjentët duhet të praktikohen t'u japin siguri klientëve se kjo tip situatë nuk do të ndodhë. Rishikimet e shpeshta nuk nënkuptojnë se portofolit do t'i bëhen ndryshime drastike. Më saktë, disa ripozicionime minimale mund të ndodhin vetëm nëse situata e justifikon. Për shembull, një titull që nuk e përmbush më kriterin e arritjes së një qëllimi të caktuar mund të ripozicionohet në një investim më të mirë që ka më shumë shanse për t'iu përmbushur ky qëllim. Vetëm kur klientët janë të sigurt për qëllimet e agjentëve, ata nuk do të shqetësohen në lidhje me abuzimet dhe tregëtimin e shpeshtë të investimeve të tyre.

#### 3.2 E Ardhmja e Tregjeve Financiare

Bursa është e pasuruar me traditë dhe teknologjia po bëhet më shumë se një faktor në ndryshimin e mënyrës si një biznes duhet të drejtohet në të ardhmen. Për shembull, vetëm në dekadën e kaluar, teknologjia dhe teoritë financiare u bashkuan për të shënuar një revolucion të produkteve të reja. Çdo gjë në të ardhmen do të ketë si qëllim uljen e kostove dhe rishpërndarjen e riskut kështu që investitori mund të marrë vendime më të mira.

Agjentët e bursave duhet të jenë të përgatitur si financierë profesionistë, për të patur maksimizimin e vlerës së të ardhurave të klientëve të tyre, duke patur parasysh:

- Së pari, shumë e më shumë të mira do të shiten nëpërmjet tregjeve. Vlerësimi i transaksioneve të internetit i bën ato me kosto më efçente në blerje si të mirat ashtu dhe shërbimet e prekshme dhe të paprekshme. Vlerësimi me efektshmëri eliminon personin e ndërmjetëm, kështu që çmimi mund të bëhet më konkurrues. Sa më shumë shkrirje dhe blerje të ndodhin në shërbimet financiare, bursat do të bëhen tundimi i së ardhmes.
- Bashkimi i blerësve dhe shitësve potencialë do të zmadhohet shumë. Kjo situatë do të favorizojë ofertuesin më të lirë dhe blerësin më të etur dhe kështu pra do të ulët kostoja e punës dhe do të rritet produktiviteti. Jo vetëm që kjo

situatë ka një impakt të jashtëzakonshëm mbi tregjet e të mirave afat-gjata të konsumatorit, por kjo do të ndikojë gjithashtu në kërkesën për produkte të paprekshme. Për shembull, ndërkohë që rritet numri i investitorëve të rinj që përdorin internetin për tregëtinë online, kjo do të çojë në një inkurajim të një tregu më eficient me ekzekutime të shpejta dhe më shumë besueshmëri në çmimet e titujve.<sup>12</sup>

- Një fond i përzier është përcaktuar nga një kompani e vetme trustesh për përdorimin e klientëve të bankës dhe nuk mund të përdoret në mënyrë ligjore nga njerëz jashtë marrëdhënies së përcaktuar të trustit. Për këtë arsye këto llogari ndryshojnë nga fondet e përbashkëta, të cilat janë krijuar për investitorët që duan të bashkohen të ardhurat e tyre. Ndërkohë që bankat punësojnë përfaqësues të regjistruar për të shitur jashtë fonde të përbashkëta publikut investues, fondet e përziera janë mjete të veçanta që zakonisht ofrohen sëbashku me shërbimet e departamentit të trusteve të bankës.<sup>13</sup> Teknika e njohur si përzierje përfshin bashkimin e titujve për të krijuar një fond të një tipi të caktuar të klasifikimit të një titulli. Teknika e përzierjes aplikohet në të dyja sëbashku, fondet e përziera dhe fondet e zakonshme të trusteve. Në një kuptim më të jashtëm, ideja e përzierjes ose e bashkimit të titujve mund të krahasohet me konceptin e fondit të përbashkët. Në secilën prej tyre, pjesëmarrësit ndajnë në kthimin total të titujve që paguajnë dividend dhe që vlerësojnë në vlerë.

## Bibliografia

- Alan Northcott, "The Complete Guide to Investing in Short Term Trading: How to Earn High Rates of Returns Safely", Atlantic Publishing Group, 2007.
- Guy Cohen, "Options Made Easy: Your Guide to Profitable Trading", Published by Pearson Education, 2013.
- Jason Kelly, "Neatest Little Guide to Stock Market Investing", Publishing by Penguin Group, 2013.
- John J Murphy, "Technical Analysis of the Financial Markets: A Comprehensive Guide to Trading Methods and Applications, New York Institute of Finance, 1999.
- Mark Douglas, "Trading in the Zone: Master the Market with Confidence, Discipline and a Winning Attitude Mark Douglas", 2001.
- Mark R. Conway and Aaron N. Behle, "Professional Stock Trading: System Design and Automation", Published by Acme Trader LLC, 2003.
- Tim Ord, "The Secret Science of Price and Volume: Techniques for spotting Market Trends, Hot Sectors, and the Best Stocks", Wiley Trading, 2008.
- [http://en.wikipedia.org/wiki/Uniform\\_Gifts\\_to\\_Minors\\_Act](http://en.wikipedia.org/wiki/Uniform_Gifts_to_Minors_Act)

<sup>12</sup> Id.fq.68.

<sup>13</sup> Mark Douglas, "Trading in the Zone: Master the Market with Confidence, Discipline and a Winning Attitude Mark Douglas", 2001, fq.15.

## Kufizimet e pronësisë në median audiovizive

Prof.Asoc.Dr. Endirë Bushati

Prof.Dr. Migena Leskoviku

### Abstrakti

*Ka një lidhje të qartë mes konceptit të pluralizmit në media dhe konkurrencës. Kjo lidhje ngjall debate dhe keqkuptime të mëdha. Keqkuptimi kryesor qëndron në kundërshtinë mes ndërhyrjes ex ante dhe ndërhyrjes ex post, mes rregullimit dhe konkurrencës. Ndërhyrjet rregullatore shpesh mbrojnë konkurrencën dhe nga mbrojtja e konkurrencës, rregullohet tregu. Përmes kësaj mbrojtjeje të konkurrencës, pra, ekzistencës së shumë operatorëve, synohet shmangia e përqendrimit në sektorin audioviziv.*

*Kufizimet e pronësisë në median audiovizive, gjithmonë janë shoqëruar me debate të ashpra edhe në Shqipëri. Ligji 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i miratuar me konsensusin e të gjitha palëve të politikës përse i përket përmbajtjes, ka rregulla të thjeshta e të qarta në këtë drejtim. Ky ligj, në raport me rregullimet ligjore të mëparshme, paraqet risi përse i përket kufizimit të pronësisë, duke rregulluar dhe të metat e vërejtura nga zbatimi në praktikë i ligjeve të mëparshme.*

*Fjalët kyçe: pluralizëm, media, kufizim, pronësi, licencë*

### Hyrje

Në Kushtetutën tonë e drejta e informimit është e garantuar<sup>1</sup>. Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i kushtohet lirisë së shprehjes, duke garantuar lirinë e shtypit, radios dhe televizionit. Në pikën 4 të këtij neni, parashikohet që, ligji

<sup>1</sup> Neni 23/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit. Edhe neni 10 i Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, parashikon që, liria e shprehjes e garantuar nga neni, nuk ndalon Shtetet që të kërkojnë licencim për televizion.

Liria e shprehjes dhe e drejta e informimit, të parashikuara nga nenet 22 dhe 23 të Kushtetutës, përveç garancisë subjektive si të drejta kushtetuese themelore, janë të lidhura objektivisht edhe me parimin e ndërtimit të një shteti demokratik, e deklaruar kjo në preambulën e Kushtetutës sonë. Zbatimi i këtij parimi të rëndësishëm nënkupton edhe garantimin e lirisë së shprehjes, të lirisë së shtypit dhe së drejtës së informimit, si të domosdoshme për një rend të lirë e kushtetues.

Parë në këndvështrimin e mësipërm, Gjykata jonë Kushtetuese i ka kushtuar vëmendje të posaçme lirisë së shprehjes, duke theksuar se: *“Në dallim nga KEDNJ-ja, Kushtetuta jonë garanton lirinë e shprehjes në kuptim të ngushtë dhe të drejtën e informimit në dy dispozita të veçanta, respektivisht në nenet 22 dhe 23 të saj. [...] Liria e shprehjes përbën një nga gurët themelore të shtetit demokratik. Pa garantimin e kësaj të drejte nuk mund të bëhet fjalë për pluralizëm, tolerancë dhe krijim të vullnetit të lirë politik, aq të domosdoshëm për shoqërinë demokratike. Shkëmbimi i ideve dhe informimi i lirë janë ndër mjetet më të rëndësishme dhe më efkase për të kontrolluar demokracinë si formë e qeverisjes. Nëpërmjet tyre pushteti shtetëror bëhet më transparent, më efkas dhe më afër qytetarit. Liria e shprehjes është gjithashtu bazë dhe kusht i domosdoshëm paraprak për garantimin e një sërë të drejtave dhe lirive të tjera themelore.”*<sup>2</sup>

Pas disa përpjekjesh ligjore e institucionale, 18 vjet pas daljes së ligjit të parë që synonte rregullimin e tregut mediatic audioviziv, ky treg në vendin tonë vazhdon të mbizotërohet nga informaliteti, moszbatimi i ligjit dhe situata monopol. Faktorët e një gjendjeje të tillë janë të shumtë, por lulëzimi i televizioneve private në kushtet e vakuimit ligjor, lidhja e mëpasshme klienteliste e televizioneve me partitë politike, një autoritet rregullator i dobët dhe shpesh nën presione të forta politike dhe nga operatorët, janë disa nga shkaqet kryesore të këtij informaliteti.

Garantimi i lirisë së medias, ndër të tjera, zvogëlon mundësinë e manipulimeve me pushtetin publik, si dhe nxit identifikimin e rasteve korruptive. Arma e saj më e fuqishme është kritika e vazhdueshme ndaj dukurive negative që rrezikojnë demokracinë, si formë e qeverisjes.

Pluralizmi në media është një koncept i gjerë. Vetë jurisprudenca e GJEDNJ është e qartë kur pohon “neni 10 i Konventës nuk i referohet vetëm të drejtës individuale të lirisë së medias, por imponon edhe detyrimin për të garantuar pluralizmin e opinionëve dhe diversitetin kulturor në interes të mirëfunksionimit të sistemit demokratik e lirisë për informim për të gjithë,... dhe për më tepër, pluralizmi është një rregull i përgjithshëm i politikës evropiane për median”<sup>3</sup>

<sup>2</sup> Vendimi Nr.56, datë 27.07.2016 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

<sup>3</sup> Vendimi *Informationsverein Lentia vs. Austri*, 14 Nëntor 1993.

Po ashtu, GJEDNJ-ja në lidhje me lirinë e shprehjes ka theksuar: “Ushtrimi i vërtetë dhe efektiv i lirisë së shprehjes nuk varet thjesht nga detyrimi i shtetit për të mos ndërhyrë, por mund të kërkojë të merren masa pozitive të mbrojtjes nëpërmjet ligjeve dhe praktikave të tij. Duke marrë parasysh rëndësinë e asaj çfarë garanton neni 10 i Konventës, shtetet duhet të jenë garantuesit e fundit të pluralizmit. [...] Gjykata konsideron se në fushën e transmetimeve audiovizuale, parimet e parashtruara .....i vendosin shtetit detyrimin për të garantuar, së pari, që publiku të ketë akses nëpërmjet TV-së dhe radio-s për një informacion të drejtë dhe të paanshëm dhe për një gamë opinionesh dhe komentesh, të cilat reflektojnë përmbajtjet e shumëllojshme politike brenda vendit dhe, së dyti, që gazetarët dhe profesionistët që punojnë në mediat audiovizuale të mos ndalohen për dhënien, shpërndarjen dhe përmbajtjen e këtij informacioni. Gjykata vëren se në një sektor të tillë sensitiv si ai i mediave audiovizuale, përveç detyrimit negativ për të mos ndërhyrë, shteti ka detyrimin pozitiv për të krijuar një kuadër legjislativ dhe administrativ për të garantuar pluralizmin efektiv.”<sup>4</sup>

Rekomandimi i Këshillit të Evropës i vitit 1999 mbi masat për të promovuar pluralizmin në media<sup>5</sup> jep ca elementë të dobishëm për ta përkufizuar konceptin. Në mënyrë të veçantë, në Memorandumin sqarues, sqarohet që “Pluralizmi në media” kuptohet si ekzistenca e shumë mjeteve të komunikimit, e kuptuar si pluralitet media autonome dhe të pavarura (pluralizmi strukturor), si pluralitet llojesh komunikimi e përmbajtjes (mendime, opinione) që i bëhen të njohura publikut. Në aspektin politik, pluralizmi në media përfshin, nevojën e një numri të gjerë opinionesh politike që duhet të përfaqësohen në media për të garantuar demokracinë dhe për të shmangur krijimin e një mendimi dominues.

Po ashtu, standardet e Këshillit të Evropës në lidhje me pronësinë në media i njohin “hapësirën e vlerësimit” shtetit përkatës, si në instrumentet me të cilat operojnë, ashtu edhe për mënyrën se si mund të arrijnë qëllimet dhe pikësynimet e interesit të përgjithshëm në nivel kombëtar. Rekomandimi i Këshillit të Ministrave CM/Rec (2007) 2 “Mbi pluralizmin e mediave dhe shumëllojshmërinë e përmbajtjes mediatike” thekson se *“në mënyrë që të mbrohen dhe promovohen aktivisht opinionet, shprehjet dhe idetë pluraliste, si dhe shumëllojshmëria kulturore, shtetet anëtare duhet të adoptojnë një kuadër ekzistues rregullator, veçanërisht në lidhje me pronësinë e mediave dhe të adaptojnë çdo masë financiare dhe rregullatore me qëllim që të garantojnë transparencën e medias dhe një pluralizëm struktural, si dhe një shumëllojshmëri të përmbajtjeve të përcjella publikut”*.

Në Bashkimin Europian, nocioni i pluralizmit, si parim bazë parashikohet në Traktatin e Lisbonës, si një nga vlerat bazë të BE. Por, mungon si përkufizim

<sup>4</sup> Vendimi *Europa Qendrore 7.S.R.L dhe Di Stefano kundër Italisë*, vendim i datës 7 qershor 2012, referuar edhe në Vendimin Nr.56, datë 27.07.2016 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

<sup>5</sup> Këshilli i Evropës, Rekomandim n.R (99) 1 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare për masat për të promovuar pluralizmin në media, 19 janar 1999.



në zbatimin specifik në sektorin e komunikimit. Pluralizmi në media i “besohet” rregullimit të Shteteve anëtare. Gjithsesi, në thelb, përfshihet në konceptin e pluralizmit të pranuar nga Komisioni Evropian gjithçka që i garanton qytetarit aksesin në shumë burime informimi dhe që i mundësojnë krijimin e lirë të opinioneve. Garanci e pluralizmit, mbetet transmetuesi publik.

Ka një lidhje të qartë mes konceptit të pluralizmit në media dhe konkurrencës. Kjo lidhje ngjall debate dhe keqkuptime të mëdha. Keqkuptimi kryesor qëndron në kundërshtinë mes ndërhyrjes ex ante dhe ndërhyrjes ex post, mes rregullimit dhe konkurrencës. Ndërhyrjet rregullatore shpesh mbrojnë konkurrencën dhe nga mbrojtja e konkurrencës, rregullohet tregu.<sup>6</sup> Përmes kësaj mbrojtjeje të konkurrencës, pra, ekzistencës së shumë operatorëve, synohet shmangia e përqendrimit në sektorin audioviziv.

Kufizimet e pronësisë në median audiovizive, gjithmonë janë shoqëruar me debate të ashpra edhe në Shqipëri. Ligji 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i miratuar me konsensusin e të gjitha palëve të politikës përsa i përket përmbajtjes, ka rregulla të thjeshta e të qarta në këtë drejtim. Ky ligj, unikal në historinë e parlamentarizmit shqiptar (përgatitja e tij zgjati 6 vjet), i asistuar me ekspertizën e KiE, OSBE, Komision Evropian, në raport me rregullimet ligjore të mëparshme, paraqet disa risi përsa i përket kufizimit të pronësisë, duke rregulluar dhe të metat e vërejtura nga zbatimi në praktikë i ligjeve të mëparshme.

## 1. Rregullimi ligjor i pronësisë mbi median audiovizive gjatë viteve 1997-2013

### 1.1 Ligji nr. 8221, datë 14.5.1997 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”

Ligji i parë i miratuar për rregullimin e tregut të medias audiovizive ishte ligji nr. 8221, datë 14.5.1997 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”. Lindja dhe veprimtaria e televizioneve dhe radiove të para private, e një tregu pa rregulla, solli domosdoshmërinë e një ligji të tillë edhe në kushtet e krijuara në vitin 1997.

Ligji 8221 e rregullon çështjen e pronësisë së radiove dhe televizioneve në nenin 19 të tij, kur trajton procesin e dhënies së licencës. Kufizimet e pronësisë shfaqen në 3 drejtime:

i. Kufizime në përqindjen e aksioneve në kapitalin e shoqërisë aksionare mbajtëse të licencës radiotelevizive dhe në një licencë të dytë radiotelevizive; ii. Kufizime specifike për personat me shtetësi të huaj; iii. Kufizime specifike në raport me subjektet që zotërojnë ndërmarrjet botuese të gazetave.

<sup>6</sup> V. Franceschelli, E. Tosi, Diritto degli audiovisivi, Giuffrè Editore, Milano, 2012.

Sipas këtij rregullimi, licenca për radio dhe televizion u jepej vetëm shoqërive aksionare të krijuara në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto shoqëri aksionare duhet të kishin synim ekskluziv veprimtarinë radiotelevizive. Asnjë person fizik ose juridik nuk mund të kishte më shumë se 25% të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë.

Personat me shtetësi të huaj nuk mund të ishin përfaqësues apo drejtues të shoqërisë që zotëron licencën radiotelevizive, as të kishin direkt apo indirekt më shumë se 20% të kapitalit apo të të drejtave të votës në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.

Përsa i përket mundësisë për një licencë të dytë radiotelevizive nga një shoqëri që zotëron një licencë radiotelevizive, neni 19 përcaktonte: “...Një person fizik apo juridik që ka mbi 15% të kapitalit të një shoqërie radiotelevizive, nuk mund të ketë, direkt apo indirekt, më shumë se 15% të kapitalit në një shoqëri të dytë radiotelevizive. Pra, asnjë person fizik e juridik që mund të kishte deri në 25% të aksioneve në një shoqëri aksionare mbajtëse të një licence, nuk mund të kishte, direkt ose indirekt më shumë se 15% të kapitalit në një shoqëri të dytë radiotelevizive. Bie në sy paqartësia me të cilën është formuluar neni. Se cilat do të ishin rastet e zotërimit “indirekt” mbetet çështje interpretimi. Ndërkohë që neni nuk bën dallim të qartë mes radios dhe televizionit, duke u paraqitur mjaft kufizues në zotërimin e një licence radioje apo televizioni.

Ky nen paraqet një kufizim interesant përsa i përket shtypit të shkruar. Ndalohej dhënia e licencës radiotelevizive personave juridikë e fizikë që zotërojnë kontrollin e ndërmarrjeve botuese të gazetave me tirazh që kalon 10% të tirazhit të përgjithshëm të gazetave në Shqipëri. Qëllimi i ligjvënësit në këtë drejtim ishte i qartë: synonte shmangien e përqendrimit në një numër të vogël “pronarësh” të medias, qoftë audiovizive, qoftë të shkruar.

Në dispozitat kalimtare të ligjit parashikohej që rregullimet për dhënien e licencave do të zbatoheshin 12 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Ndërkohë, radiot dhe televizionet private që deri në datën 14 maj 1997 ushtronin veprimtari të palicensuar sipas kërkesave të ligjit, mund të mos e ndërprisnin atë deri në datën 14 maj 1998. Përmes kësaj dispozite, ligjvënësi u dha kohë 1 vit subjekteve të palicensuara që ushtronin veprimtari radiotelevizive në atë kohë, që të licencoheshin dhe të rregullonin veprimtarinë e tyre sipas kërkesave të ligjit. Askush nuk e mendonte që informaliteti i tregut audioviziv do të vazhdonte deri në vitin 2015.

### 1.2 Ligji nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”

Ligji nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar disa herë, shfaqet si ligji më jetëgjatë për

rregullimin e tregut të medias. Shumë shpejt, ligji nr. 8221, datë 14.5.1997 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, u shfaq i pazbatueshëm në praktikë, kjo edhe për shkak të fuqizimit e rritjes së presionit që pronarë të ndryshëm të televizioneve private ushtronin mbi pushtetin politik. Nevoja për t’iu përshtatur kushteve të reja të tregut dhe për korrigjuar e plotësuar mangësitë e ligjit të vitit 1997, solli domosdoshmërinë e miratimit të një ligji të ri. Ky ligj rregullonte veprimtarinë radiotelevizive që zhvillohej përmes transmetimeve analoge tokësore, kablllove, përsëritëve apo rrjeteve satelitore.

Ligji 8410/1998 parashikonte kufizimin e pronësisë në nenin 20, nen që përmbante dispozitat e përgjithshme për licencimin.

Sipas këtij neni, licencat ishin dy llojesh: kombëtare dhe vendore. Në varësi të licencës, neni jepte dhe kufizimet përkatëse. Përvec kufizimeve të parashikuara për rastet e licencave, ky nen parashikonte dhe ndalimin për personat me aksione në media, për të marrë pjesë në prokurimet me fondet publike të shtetit si dhe në proceset e privatizimit të pronës shtetërore.

Licencat për transmetim televiziv ose radioje në shkallë kombëtare u jepeshin shoqërive anonime që themeloheshin me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë me objekt ekskluziv veprimtarinë radiotelevizive. Asnjë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, nuk duhet të kishte më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë. Mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të asamblesë së shoqërisë anonime, me objekt të vetëm veprimtarinë për transmetime televizive ose radio, ishin të vlefshme kur në to merrnin pjesë jo më pak se dy të tretat e mbajtësve të aksioneve. Një person fizik ose juridik, që kishte aksione në një shoqëri televizive ose radioje kombëtare, nuk lejohet të ishte, drejtpërdrejt ose tërthorazi, pjesëmarrës në një shoqëri të dytë televizive ose radioje kombëtare, si dhe nuk i lejohet të marrë licencë për transmetim televiziv ose radioje vendore.

Licencat për transmetim televiziv ose radioje vendore u jepeshin personave juridikë e fizikë të regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë me objekt ekskluziv veprimtarinë radiotelevizive. Të njëjtit subjekt nuk i jepej licencë për më shumë se dy zona transmetimi vendor. Licenca për transmetim vendor në zonat urbane me mbi 200 000 banorë nuk u jepej personave fizikë. I njëjti subjekt që zotëron një licencë për transmetim televiziv vendor mund të merrte vetëm një licencë të dytë për transmetim radioje vendor. I njëjti subjekt që zotëron një licencë për radioje vendore mund të marrë vetëm një licencë të dytë për transmetim televiziv vendor.

Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri radio ose televizive, nuk lejohet që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të marrë pjesë në prokurimet me fondet publike të shtetit, njësisive të pushtetit vendor ose shoqërive me kapital shtetëror, si dhe në procesin e privatizimit të pronës publike.

Për shkak të mosrregullimit të saktë ligjor, shumë shpejt në tregun mediatik audioviziv u shfaq fenomeni i aksioneve në emër të bashkëshortëve apo familjarë të afërt, duke shmangur në këtë mënyrë kufizimet në përqindje apo për licenca të dyta që parashikonte neni 20.

Licenca e transmetimit ishte e patjetërsueshme dhe vllente vetëm për subjektin të cilit i ishte dhënë. Në rast se mbajtësi i licencës hynte në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave ishte edhe veprimtaria radiotelevizive e licencuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që buronin nga licenca kërkohej miratimi i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Subjektit që kishte fituar këto të drejta, miratimi i jepej në formën e një licence të re me të njëjtën përmbajtje. Kur Këshilli nuk e miratonte kalimin për shkaqe të parashikuara në këtë ligj, i ofronte frekuencat që i përkisnin kësaj licence për një konkurrim të ri kandidaturash.<sup>7</sup>

### *1.3 Ligji nr.9742, datë 28.5. 2007 “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë”*

Ky ligj synonte rregullimin e transmetimeve numerike (digjitale), si në respekt të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, si për “legalizimin” e operatorëve numerikë që lindën në Shqipëri që në vitin 2004 dhe po zhvilloheshin me shpejtësi. Dy procedura licencimi të shpallura nga autoriteti rregullator dështuan dhe operatorët ekzistues paraqitën pretendimin e tarifave të larta për licencim. Ky ligj u shndërrua shumë shpejt në një ligj të paaplikueshëm dhe lindi nevoja e një ligji të ri që do të integronte në një tekst të vetëm ligjin 8410/1998 dhe ligjin për transmetimet numerike.

Gjithsesi, ligji i vitit 2007 kishte një nen për kufizimet e pronësisë në media, neni 13 i ligjit, i cili kishte dhe titullin “Pluralizmi në median audiovizuale”.

Në bazë të këtij neni, një person juridik nuk mund të kishte më shumë se një licencë për një rrjet numerik tokësor. Një person fizik, që ka interesa ekonomikë ose është në pozitë vendimmarrëse në një person juridik që ka licencë për transmetim numerik tokësor, nuk mund të ketë interesa ekonomikë ose të jetë në pozitë vendimmarrëse në një person tjetër juridik që ka një licencë tjetër numerike tokësore. Një operator rrjeti kishte të drejtë të pajisej me licencë për transmetimin e një programi radioteleviziv dhe anasjellas. U jepej mundësia që, deri në vitin 2012 (afati maksimal i përcaktuar për kalimin në transmetimet numerike), operatorët analogë të mund të licencoheshin si operator rrjeti ose operator programesh. Për herë të parë u vendos kufizimi që asnjë operator i licencuar nuk mund të zotëronte më shumë se 30% të tregut të reklamave në tregun audiovizual. Ndërkohë, pronësia në personat juridikë që gëzojnë një licencë për operator rrjeti ose programi duhet të respektohte kriteret e përcaktuara në nenin 20 të ligjit 8410/1998.

<sup>7</sup> Neni 22 i Ligjit

Për marrjen e vendimeve përkatëse për kufizimet e mësipërme, parashikohet që KKRT merrte mendimin paraprak të Autoritetit të Konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës, në cdo rast që verifikonte lindjen e një situatë të tillë, do të njoftonte KKRT, e cila do të vendoste pezullimin ose heqjen e licencës. Ky nen parashikonte që vendimi i Autoritetit të Konkurrencës ishte i detyrueshëm për KKRT-në.

Sic del qartë, pavarësisht qëllimit të ligjvënës, ky nen lë vend për interpretime e keqkuptime. Është i paqartë formulimi “person fizik që ka interesa ekonomike...” duke lënë vend për interpretime të shumta dhe duke moszgjdhur çështjen e familjarëve të përfshirë, si një situatë që verifikohet në praktikën shqiptare. Ndërkohë, raporti KKRT/Autoriteti i Konkurrencës është i paqartë. Nga njëra anë parashikohet marrja e mendimit të Autoritetit të konkurrencës nga KKRT, nga ana tjetër, parashikohet që vendimi i Autoritetit të Konkurrencës është i detyrueshëm për KKRT.

Gjithsesi, nuk ka pasur asnjë zbatim në praktikë të këtij neni, sepse vetë ligji mbeti i pazbatueshëm në praktikë.

## 2. Ligji 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

A. Ligji 97/2013 “Për mediat audiovizive në RSH”, i miratuar me konsensus për përmbajtjen e tij në mars 2013, ka rregullim të qartë e të thjeshtë ligjor për çështjen e pronësisë në median audiovizive, në ndryshim nga rregullimet ligjore të mëparshme. Ky rregullim parashikohet në nenin 62 të ligjit.

Konkretisht ai parashikon se:

1. Licenca kombëtare e transmetimit audio (radio) dhe audioviziv (televiziv) u jep vetëm shoqërive aksionare të regjistruara në RSH, të cilat kanë si objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.
2. Asnjë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, nuk mund të ketë më shumë se 40% të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë aksionare, që zotëron një licencë kombëtare.
3. Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë kombëtare, nuk mund të ketë më shumë se 20 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare. Për transmetimet analoge audio lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10% në një shoqëri të tretë kombëtare.
4. Një person i tillë nuk lejohet të marrë licencë transmetimi audio, lokale apo rajonale ose licencë transmetimi audioviziv, lokale apo rajonale. Kushteve të mësipërme u nënshtrohen edhe licencat kombëtare për shërbimin e programit audio dhe/ose audioviziv. Përsa i përket transmetimeve audiovizive, ligji bën

dallimin mes dy llojeve të licencave: licenca transmetimi që përshin licencë për rrjetin dhe si operator programi dhe licencë për shërbimin e programit audioviziv.

Përsa u përket licencave lokale apo rajonale të transmetimit audio dhe audioviziv, këto licenca u jepen personave juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, me objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.

1. Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë të dytë për transmetim audio lokale apo rajonale. Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë transmetimi audiovizive lokale apo rajonale.
2. Një person fizik ose juridik që ka aksione në një subjekt që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale.
3. Një person fizik ose juridik që ka aksione në një subjekt që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale.
4. Kushteve të mësipërme u nënshtrohen edhe subjektet juridike të autorizuara për ofrimin e shërbimeve të programit audio dhe autorizimet e shërbimit të programit audioviziv të mbështetura në rrjete satelitore.

Pika 10 e nenit 62 rregullon “fiktivitetin” e hasur në praktikë nga rregullimet ligjore të mëparshme. Në kuptim të këtij neni, aksionar konsiderohet mbajtësi i aksioneve dhe personat e lidhur me të deri në shkallën e dytë. Për të mos lënë vend për interpretime të shumta, gjykoj se formulimi më i saktë do të ishte “..... dhe bashkëshorti, bashkëjetuesi dhe personat në lidhje gjinie apo krushqie me të deri në shkallë të dytë”. Gjithsesi, ky formulim shpreh qartë qëllimin e ligjvënës: aksionar do të konsiderohet mbajtësi i aksioneve dhe personat familjarë të afërt me të deri në shkallë të dytë dhe kufizimi prek gjithë rrethin e këtyre personave të marrë së bashku.

Në këndvështrim të ekuilibrit të interesave, tri parametrat e mekanizmit ligjvënës ndërhyrës: (i) nevoja; (ii) domosdoshmëria, (iii) përshtatshmëria, i imponojnë ligjvënës të evidentojë nevojën reale të ndërhyrjes në kufizimin e aksioneve në kapitalin e përgjithshëm për personat fizikë ose juridikë, aksionarë në shoqëri mbajtëse të licencave kombëtare të transmetimeve audiovizuale, si

ndërhyrje në lirinë ekonomike. Domosdoshmëria e detyron ligjvënësin të vërtetojë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera dhe se ka përdorur mjetin më pak të dëmshëm për subjektet që u kufizohet liria ekonomike. Ndërsa, përshtatshmëria e detyron ligjvënësin të argumentojë se mjeti i ndërhyrjes është efikas dhe ka sjellë efektet e pritshme dhe të dëshiruara në praktikë.

Pika 12 e nenit përmban dhe një kufizim tjetër të rëndësishëm: Asnjë zotërues i licencave kombëtare të transmetimeve përfshirë operatorët e shërbimit mediatik audioviziv, të licencuar për shërbimin e programit audioviziv dhe/ose të autorizuar për shërbimin e programeve të mbështetura në rrjete satelitore, nuk mund të transmetojë më shumë se 30 për qind të reklamave në tregun e transmetimeve audiovizive. Për këtë kontroll, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) duhet të miratojë aktet përkatëse nënligjore.

Një tjetër aspekt që garanton pluralizmin dhe konkurrencën e ndershme, është dhe përcaktimi ligjor mbi shfrytëzimin e multipleksit, parashikuar nga neni 63 i ligjit.

Mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv janë të detyruar t'u japin akses në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, në jo më pak se 40 për qind të kapacitetit të multipleksit të tyre, ofruesve të shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA) që zotërojnë liçencë shërbimi programi audio dhe/ose liçencë shërbimi programi audioviziv.

Në cdo rast, një subjekt i licencuar për transmetime numerike ose për ofrimin e shërbimit të programit audio ose audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se një të tretën e sasisë së përgjithshme të programeve përkatëse lokale, rajonale dhe kombëtare.

Mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv ofrojnë aksesin për transmetim në rrjetin numerik, mbi bazën e marrëveshjeve tregtare me OSHMA-të. Tarifat për dhënien e aksesit për transmetim në rrjetin numerik duhet të orientohen në kosto. AMA siguron që të gjitha shërbimet që u ofrohen OSHMA-ve, që zotërojnë liçencë shërbimi programi audio dhe ose liçencë shërbimi programi audioviziv, nga mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv, bazohen në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, dhe në rast mosmarrëveshjes midis OSHMA-ve dhe mbajtësve të licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv, palët i drejtohen AMA-s. AMA, duke mbajtur parasysh garantimin e aksesit të barabartë dhe jodiskriminues për OSHMA-të, garantimin e konkurrencës së ndershme dhe shumëllojshmërisë së shërbimeve, pasi dëgjon pretendimet e palëve, vendos për

zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Kundër vendimit të AMA-s, palët mund të bëjnë ankim në gjykatë.

Neni 62 dhe 63 i ligjit rregullojnë në mënyrë të qartë e të thjeshtë çështjen e kufizimit të pronësisë në median audiovizive dhe çështje që lidhen drejtpërdrejt me konceptin e gjerë të pluralizmit në media.

**B. AMA**, më datë 16 prill 2015 ka shpallur vendimin “Për çeljen e procedurës së dhënies së 5 (pesë) licencave private kombëtare transmetimi audioviziv numerik sipas “Beauty Contest”. Në procedurën “beauty contest” janë ftuar të marrin pjesë, në kuptim të ligjit, operatorët analogë historikë kombëtarë dhe operatorët ekzistues me eksperiencë në transmetimet numerike. “Privilegji” i këtyre operatorëve për të mos iu nënshtruar një konkurrimit të hapur parashikohet në dispozitat kalimtare të ligjit<sup>8</sup> për gjithë periudhën e tranzicionit të kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike deri në datën 17 qershor 2015. Vendimi i AMAs ka disa shkelje ligjore, por përse i përket kufizimeve të pronësisë 4 nga 5 subjektet e ftuara për marrjen e një licence kombëtare transmetimi janë në shkelje të parashikimeve ligjore të nenit 62 të ligjit. Nëse një licencim i tillë do të vendosej nga AMA, do të ishim përballë një shkelje flagrante të ligjit dhe krijimit të një monopoli të pastër, në kundërshtim të plotë me parimin e pluralizmit në media<sup>9</sup>.

## Konkluzione

Këshilli i Europës, në Rekomandim n.R (99) 1 të Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare për masat për të promovuar pluralizmin në media, 19 janar 1999, ka dhënë disa alternative për rregullimin e pronësisë në media. Kështu, Shtetet anëtare duhet të marrin në konsideratë hartimin e legjislacionit për të parandaluar ose luftuar përqendrimet që mund të rrezikojnë pluralizmin e medias në nivel kombëtar, rajonal ose nivelet lokale, apo të shqyrtojnë mundësinë e përcaktimit të pragut ligjor në procedurat e licencimit apo autorizimeve, për të kufizuar ndikim që një kompani e vetme apo grup personash të zotërojnë një ose më shumë sektorë të medias, apo mund të parashikojnë kufizime përse i përket përqindjes së aksioneve në kompanitë mediatike. Gjithashtu, Shtetet Anëtare duhet të marrin në konsideratë adoptimin e masave specifike ku, ajo që quhet integrimi vertikal, që është kontrolli i elementeve si prodhimi, transmetimi, shpërndarja nga një kompani e vetme apo grup, të mos kthehet në rrezik për pluralizmin.

<sup>8</sup> Nenet 138, 139 të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>9</sup> Pikërisht në këtë periudhë, një deputet i mazhorancës parlamentare depozitoi një projektligj për shfuqizimin e neni 62 të ligjit 97/2013, me argumentimin se ky nen pengon konkurrencën në treg. Ky propozim u prit me kritika të ashpra nga përfaqësuesit e OSBE dhe KiE dhe aktualisht pritet një ekspertizë për çështjen nga këto institucione.

Në përgjithësi, që nga ligji i parë i vitit 1997 e deri me ligjin e fundit, ligjvënësi shqiptar është kujdesur që të respektojë këto rekomandime, duke adoptuar formën e kufizimit të aksioneve brenda shoqërisë që mban një licencë audiovizive apo kufizime të tjera për licenca të dyta audio ose audiovizive. Pranohet gjerësisht që për vende me demokraci të brishtë si Shqipëria, pasja e rregullave të thjeshta e të qarta, që nuk lënë shumë vend për interpretim e për pasojë abuzim, është rruga më e mirë për të garantuar konkurrencën në tregun mediatik audioviziv. Deri në vitin 2013, rregullimi ligjor i çështjes ka ndjekur këtë rrugë, edhe pse me mangësi e të meta. Vështirë të mendohej në vitin 1997 që tregu audioviziv do të sundohej nga paligjshmëria për rreth 18 vjet.

Pas një pune rreth 6 vjeçare për ligjin e ri të medias, çështja më në fund gjeti rregullim të plotë në nenin 62 të Ligjit 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Dhe pikërisht kur mendohej që ky ligj, i përafuar tërësisht me direktivat dhe standardet evropiane, tashmë do të vendoste rregullat në një treg krejtësisht informal, propozimi (i një deputeti) për të shfuqizuar nenin 62, rrezikonte që jo vetëm ta kthente këtë ligj në të pazbatueshëm, të krijojë monopol në tregun mediatik, por edhe të rrezikojë vetë standardet demokratike.

Në vendimin e saj nr.56, datë 27.07.2016, Gjykata jonë Kushtetuese çmoi se pavarësisht rëndësisë së objektivit të ligjvënësit dhe pranisë së interesit publik për një sistem mediatik mbështetur thelbësisht në shumëllojshmërinë e informacionit, bazuar në kërkesën kushtetuese për ndërhyrje legislative proporcionale, masa kufizuese e parashikuar në nenin 62/3 të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, nuk i shërben ligjvënësit për të përmbushur efektivisht objektivin e përcaktuar dhe në këtë kuptim është mjet i papërshtatshëm dhe i panevojshëm. Si përfundim, Gjykata Kushtetuese çmoi se mjeti i përzgjedhur nga ligjvënësi për kufizimin e aksioneve të pronësisë së shoqërive që veprojnë në fushën e medias, nuk ka një lidhje të arsyeshme dhe proporcionale me qëllimin e ligjshëm të ligjvënësit për shumëllojshmëri informacioni. Për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se ndërhyrja e ligjvënësit nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, prandaj paragrafi 3 i nenit 62 të ligjit për median u shfuqizua. Ajo që lind si nevojë tashmë pas këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese është detyrimi i ligjvënësit për të bërë amendimet e nevojshme në këtë ligj.

## Bibliografi

- Ligji nr. 8221, datë 14.5.1997 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”  
 Ligji nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”.  
 Ligji nr.9742, datë 28.5. 2007 “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë”

- Ligji 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.  
 Vendimi Nr.56, datë 27.07.2016 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.  
 Vendimi nr.16, datë 11.11.2004 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.  
 Vendimi *Europa Qendrore 7.S.R.L dhe Di Stefano kundër Italisë*, vendim i datës 7 qershor 2012.  
 Vendimi *Informationsverein Lentia vs. Austri*, 14 Nëntor 1993.  
 Këshilli i Europës, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave Nr.(2007) 2 “Mbi pluralizmin e mediave dhe shumëllojshmërinë e përmbajtjes mediatike”.  
 Këshilli i Europës, Rekomandim i Komitetit të Ministrave Nr (1999) 1 “Për masat për të promovuar pluralizmin në media”, 19 janar 1999.  
 V. Franceschelli, E. Tosi, “Diritto degli audiovisivi”, Giuffrè Editore, Milano, 2012.

# *Parimet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të gjykatave ndërkombëtare të arbitrazheve për investimet \_\_\_\_\_*

\_\_\_\_\_ *Dr. Evelina Çela* \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ *Msc. Arfjona Kocibellinj* \_\_\_\_\_

## **Abstrakt**

*Ky artikull ka të bëjë me parimet kryesore të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në fushën e investimeve nga gjykatat e arbitrazhit ndërkombëtar të përzier si dhe me veprimtarinë e procedurave të këtyre gjykatave, problematikat e tyre, duke analizuar: zhvillimin, statusin aktual dhe mundësitë e rritjes së efektivitetit të secilit prej tyre.*

*Parimet e procedurave të arbitrazhit ndërkombëtar përfaqësojnë norma, të cilat janë një sistem rregullator bazë, të njohura tashmë dhe pranuar botërisht për sa i përket procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në nivel ndërkombëtar. Në këtë këndvështrim kërkohet një diskutim dhe analizë e detajuar duke filluar nga momenti i rritjes së numrit të investimeve (të pambrojtura) deri tek arritjet e ditëve të sotme dhe rritja e numrit të marrëveshjeve bilaterale të këtyre arbitrazheve për mbrojtjen dhe promovimin e mëtejshëm të investimeve të huaja.*

***Fjalët kyçe:*** *mosmarrëveshje të investimeve, arbitrazhe të përzier, parimet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.*

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në arbitrazhet ndërkombëtare, ku personat privat kanë të drejtën e aksesit (arbitrazhet ndërkombëtare të përzier), bazohet në parime të ngjashme me parimet e arbitrazhit ndërkombëtar publik. Parimet e procedurave të arbitrazhit ndërkombëtar përfaqësojnë në vetvete normat e mbarënjohura të së drejtës publike ndërkombëtare të një rëndësie themelore për funksionimin e arbitrazhit ndërkombëtar të përzier.

Pavarësisht faktit, se në të drejtën ndërkombëtare nuk egziston ndonjë marrëveshje uniform ndërqeveritare, që të përmbante një listë të parimeve bazë të procedurës ndërkombëtare të arbitrazhit, nëpërmjet praktikës gradualisht janë zhvilluar rregulla themelore procedurale të përbashkëta për të gjitha arbitrazhet e përziera, duke përfshirë procedurën për rekurs në arbitrazh, organizimin e seancave dëgjimore, si dhe rregullat e zbatimit të vendimeve të marra nga gjykatat ndërkombëtare të arbitrazhit të përzier. Duke filluar nga shekulli XX, praktika e arbitrazhit ka zhvilluar parime të qëndrueshme të procedurave të arbitrazhit ndërkombëtar të përzier.

Në parimet e procedurave të arbitrazhit ndërkombëtar të përzier hyjnë: Parimi i aksesit të lirë në një gjykatë arbitrazhi, parimi i mirëbesimit, parimi i barazisë procedurale të palëve, parimi i kundërshtimit, parimi i optimalitetit, parimi i kolegialitetit, parimi i sigurisë ligjore, parimi i konfidencialitetit. Nga fundi shekullit XX veprimtaria e investimeve bëhet pjesë përbërëse e ekonomisë së secilit shtet ku fillon të rritet numri i marrëveshjeve bilaterale (BIT, bilateral investment treaty) për mbrojtjen dhe promovimin e investimeve të huaja, të cilat ofrojnë mundësinë e aksesit të konflikteve ndërmjet investitorëve dhe shtetit në arbitrazhe ndërkombëtare të përziera. E gjithë kjo çoi në një rritje të konsiderueshme të numrit të mosmarrëveshjeve në fushën e investimeve, të shqyrtuara nga arbitrazhi ndërkombëtar i përzier. Dhe disa nga parimet themelore të veprimtarisë së arbitrazhit ndërkombëtar të përzier filluan të pengojnë zhvillimin e një praktike koherente dhe konsistente të mosmarrëveshjeve në fushën e investimeve.

## 1. Parimi i aksesit të lirë arbitrazh

Procedura e arbitrazhit ndërkombëtar mund të kryhet vetëm mbi baza reciproke. Parimi mbi bazën e të cilit arbitrazhi është vullnetar, do të thotë se mosmarrëveshjet, ku njëra nga palët është një shtet ose një organizatë ndërkombëtare, dhe pala tjetër - është një person privat nuk mund të paraqiten në arbitrazh pa pëlqimin e palëve në konflikt. Në vendimin *Larsen v. Hawaiian Kingdom* arbitrat e Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit<sup>1</sup> kanë konstatuar se arbitrazhi i përzier ndërkombëtar nuk mund të ushtroj juridiksion mbi palën, e cila nuk është palë në procedurë<sup>2</sup>. Praktika e arbitrazhit ndërkombëtar të përzier njihet dy mënyra në të cilat palët mund të shprehin pëlqimin e tyre për mosmarrëveshjen.

**Së pari**, ajo është rezultat/prodhim i një marrëveshje apo kompromisi<sup>3</sup> të veçantë (*compromis d'arbitrage*), sidomos kur kemi të bëjmë me një mosmarrëveshje, që

<sup>1</sup> [www.icj-cij.org/docket/files/19/4761.pdf](http://www.icj-cij.org/docket/files/19/4761.pdf)

<sup>2</sup> Merrills J. G. The Contribution of the Permanent Court of Arbitration to international law 1999-2009. Summaries of Awards 1999-2009. F.10. The Hague: T. M. C. Asser Press 2010. F. 53.

<sup>3</sup> Malcolm N. Shaw. International Law. 6th Edition. Cambridge. 2008. F.1051.

është *post facto*, dhe e cila përfundon me marrjen e vendimit të arbitrazhit. **Së dyti**, një kompromis i tillë mund të shprehet në një kontratë mes individit dhe shtetit, për shembull, në kontratën e investimeve apo marrëveshjen e konçesionit. Zhvillimi i të drejtës moderne ndërkombëtare të investimeve do të thotë se çdo marrëveshje bilaterale, domosdoshmërisht fikson mundësinë për çdo investitor të një shteti anëtar në këtë marrëveshje, në rast të një konflikti, të ketë të drejtën e zgjidhjes në arbitrazhin ndërkombëtar me padinë kundër një shteti tjetër. Me fjalë të tjera, çdo shtet-palë në BIT parapakisht bie dakord për zgjidhje në arbitrazh për çdo lloj konflikti me këdo investitor të një shteti tjetër palë të marrëveshjes. Nga pikëpamja e arbitrazheve ndërkombëtare të investimeve (ky pozicion është sanksionuar në vendime të shumta), dispozitat e BIT përfaqësojnë një propozim (ofertë), e cila mund të merret (pranohet) nga çdo investitor në rast të një mosmarrëveshjeje në të ardhmen. Investitori, në rast domosdoshmërie të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në arbitrazhin ndërkombëtar të investimeve, e merr këtë propozimin për procedurë arbitrazhi, thjesht duke aplikuar në këtë gjykatë me një kërkesë për fillimin e procedurës, por duke cituar dispozitat e BIT<sup>4</sup>.

## 2. Parimi i besimit të mirë

Parimi i besimit të mirë siguron në nivel të duhur procedura të tilla si: aksesit në arbitrazh, një proces të drejtë si dhe ekzekutimin e vendimit të marrë<sup>5</sup>. Bin Cheng konsideron parimin e besimit të mirë si «parimin themelor të çdo sistemi ligjor»<sup>6</sup>. Në vendimin e vet në rastin e *Metzger & Co. Case* të vitit 1900, arbitri vendosi: «ndershmëria është një parim jo më pak i rëndësishëm për një shtet drejt përmbushjes së detyrimeve të veta kundrejt individëve dhe subjekteve juridik sesa kundrejt shteteve»<sup>7</sup>.

Baza e kësaj force tërheqëse të arbitrazheve ndërkombëtare të investimeve përbëhet nga dy faktorë: mundësia e investitorëve të huaj për tu drejtuar direkt në arbitrazh ndërkombëtar, (një rregull i tillë u konfirmua në vendimin e arbitrave të ICSID-it në rastin e *Siemens v. Argentina*<sup>8</sup>, dhe prania e garancive për zbatimin e vendimeve të marra prej arbitrazhit). Në pajtim me nenin 54 të Konventës «Për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të

<sup>4</sup> Eureko B.V. v. The Slovak Republic <http://www.pca-cpa.org>

<sup>5</sup> A.H.A. Soons, International Arbitration: Past and Prospects, Kluwer Academic Publishers, The Netherlands. 1990. F. 160. Shiko gjithashtu: Malcolm N. Shaw. International Law. 7th Edition. Cambridge. 2014.

<sup>6</sup> Bin Cheng, General principles of law as applied by international courts and tribunals. 2006. F. 105.

<sup>7</sup> United States, Dept. of State Charles Irving Bevans. Treaties and other International Agreements of the United States of America 1776-1949. 1971. F. 649

<sup>8</sup> [http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC1171\\_En&caseId=C5](http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC1171_En&caseId=C5)

shteteve të tjera» e vitit 1965, një shtet kontraktues duhet të njohë një vendim të dhënë nga arbitrat e ICSID-it, dhe ta zbatoj atë sikur të ishte një vendim i formës së prerë të një gjykate kombëtare të atij Shteti.

### 3. Parimi i barazisë procedurale të palëve

Ky parim është themelor për sa i përket organizimit të një procesi arbitrazhi ndërkombëtar, i cili shprehet në barazinë themelore të palëve në konflikt dhe «rrjedh nga vetë natyra e së drejtës ndërkombëtare»<sup>9</sup>. Në veprimtarinë e gjykatave të arbitrazheve ndërkombëtare, ky parim realizohet nëpërmjet sigurimit të të drejtave të barabarta të palëve në zgjedhjen e arbitrave për shqyrtimin e mosmarrëveshjes<sup>10</sup> si dhe nëpërmjet përcaktimit në rregulloren e procedurës të të drejtave të barabarta të palëve përpara gjykatës në mbrojtjen e interesave të tyre dhe të masave mbrojtëse procedurale të barabarta<sup>11</sup>.

Neni 52 i Konventës “Për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera” e vitit 1965, parashikon anulimin e vendimit të arbitrazhit, në mënyrë të veçantë, për arsyet e mëposhtme: përbërja e Tribunalit nuk është caktuar në mënyrën e duhur në pajtim me ligjin, kur ka tejkuluar qartësisht kompetencat e veta, kur ka pasur korrupsion nga ana e një anëtari të Tribunalit, kur ka patur një largim serioz nga rregullat themelore të procedurës dhe kur vendimi nuk ka arritur të tregoj arsyet mbi të cilat është bazuar<sup>12</sup>. Sipas përcaktimit të Ch. Schreuer: kur Tribunali nuk i jep mundësinë njëjës prej palëve për të shprehur pozicionin e saj, atëherë kjo përbën një largim serioz nga rregullat themelore të procedurës së ICSID-it<sup>13</sup>.

Në rrjedhën e procedurës në rastin e *Giovanna A Beccara and Others v. The Argentine Republic* arbitrat në mënyrë të përsëritur ndërmorën rregulla procedurale në lidhje me procesin dhe pranueshmërinë e dokumentave (pranueshmërinë e dokumentave të reja), organizimin e seancave dëgjimore dhe pjesëmarrjen në to, marrjen në pyetje të dëshmitarëve si dhe zbulimin e informacioneve nga aplikantët. Gjatë procedurës i pandehuri është paraqitur me një propozim për përjashtimin e dy arbitrave dhe procedura e kësaj çështje u pezullua (më vonë Tribunali u rivendos)<sup>14</sup>. Ky parim është në lidhje të ngushtë me parimin e kundërshtimit, realizimi i të cilit është i mundur vetëm kur kemi barazi ligjore të palëve në proces.

<sup>9</sup> Shinkareckaya G.G. International court procedures. M. 1992. F. 154.

<sup>10</sup> Nemirovskij. About International Court. «The Journal of jurisprudence communication» Nr.4. 1898. F. 85.

<sup>11</sup> ICSID Reports: James Crawford, Karen Lee, Elihu Lauterpacht 2005. F. 231.

<sup>12</sup> [https://icsid.worldbank.org/ICSID/StaticFiles/basicdoc/CRR\\_English-final.pdf](https://icsid.worldbank.org/ICSID/StaticFiles/basicdoc/CRR_English-final.pdf)

<sup>13</sup> Ch. Schreuer, The ICSID Convention: A Comentary, Cambridge University Press. 2001. F. 765.

<sup>14</sup> <http://www.investmenttreatynews.org/cms/news/archive/2010/03/10/icsid-tribunal-applies-ad-hoc-approach-to-confidentiality-in-arbitral-proceeding.aspx>

### 4. Parimi i kundërshtimit

Parimi i kundërshtimit përcakton aftësinë e palëve për të mbrojtur pozicionin e tyre ligjor. Që do të thotë, secila palë duhet të vërtetoj ato fakte mbi të cilat ka mbështetur kërkesat e parashtruara. Parimi i kundërshtimit përcakton gjithashtu rolin e gjykatës së arbitrazhit në përcaktimin e dispozitave relevante për shqyrtimin e çështjeve. Arbitrat kanë autoritetin i cili rrjedh nga vet funksionet gjyqësore, që vendosjen e drejtësisë ta kërkojnë me të gjitha mundësitë e mundshme. Arbitri gjithmonë mund tu kërkoj palëve paraqitjen e të gjitha akteve, dokumentave dhe shpjegimet e nevojshme si dhe të thërrasë dëshmitarë, të kryej ekzaminime apo hetime. Arbitri nuk mund ta bëj këtë vetëm nëse shprehimisht ndalohe nga palët e mosmarrëveshjes<sup>15</sup>.

Arbitrat e ICSID-it në vendimin e çështjes *AAP v. Sri Lanka* deklaror: “Pala duhet që, jo vetëm të japë dëshmi në mbështetje të kërkesave të saj, por edhe për të provuar vërtetësinë e tyre, në të kundërt këto dëshmi mund të mbeten jashtë vëmendjes»<sup>16</sup>. Në një vendim të dhënë në rastin e *Tradex v. Albania*, kundërshtimi pranohet si “parim i përgjithshëm i procedurës ndërkombëtare»<sup>17</sup>. Zbatimi i parimit të kundërshtimit është i lidhur gjithashtu me parimin e optimalitetit.

### 5. Parimi i optimalitetit

Në përputhje me parimin e optimalitetit, palët në çdo fazë të procesit munden lirisht të disponojnë të drejtat e tyre subjektive procedurale, të cilat janë: të njihen me materialet e çështjes, të marrin kopje të dokumenteve që disponohen për çështjen, të marrin pjesë në procedurat gjyqësore apo të paraqesin kundërshtime. Palët mund ti japin fund zgjidhjes së çështjes me një marrëveshje paqësore në çdo fazë të procesit<sup>18</sup>. Praktika e ICSID-it njeh disa raste, të përfundimit të çështjeve me anë të marrëveshjeve paqësore ndërmjet palëve. Në pajtim të nenit 43 të Rregullores së ICSID-it, palët mund të bien dakord për të ndërprerë mosmarrëveshjen përpara se arbitrazhi të marrë vendimin. Marrëveshje të tilla paqësore janë nënshkruar

<sup>15</sup> Jean-François Poudret, Sébastien Besson. Comparative law of international arbitration. 2007, F. 338-339

<sup>16</sup> [http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC677\\_En&caseId=C140](http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC677_En&caseId=C140)

<sup>17</sup> <http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC533&caseId=C148>

<sup>18</sup> Alan Redfern, Law and practice of international commercial arbitration. 2004., Malcolm N. Shaw. International Law. 7th Edition. Cambridge. 2014.



nga palët në konflikt në këto raste: *GGPC v. Nigeria* në vitin 1980<sup>19</sup>, *I Goetz v. Burundi* në vitin 1999<sup>20</sup>, *WRB v. Grenada* në vitin 1998<sup>21</sup>, *Compagnie Francaise pour le Developpement des Fibres Textiles v. Cote d'Ivoire* në vitin 2000<sup>22</sup>, *Lemire v. Ukraine* në vitin 2000<sup>23</sup>, *Astaldi v. Honduras* 2000<sup>24</sup>.

## 6. Parimi i kolegjalitetit

Parimi i kolegjalitetit do të thotë se të gjithë anëtarët e komisionit të arbitrazhit kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në vendimmarrje, pavarësisht nëse është arbitër i zgjedhur nga pala apo në rastin kur është një arbitër i përgjithshëm (kryearbitër)<sup>25</sup>. Parimi i kolegjalitetit u formua menjëherë pas fillimit të veprimtarisë së arbitrazheve ndërkombëtare të përziera<sup>26</sup>. Vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë arbitrat, dhe në rast të mospajimit të njërit prej tyre me vendimin e përgjithshëm, ai mund të parashtroj mendimin e tij të veçantë<sup>27</sup>. Kështu, mendimi kundërshtues i arbitrit, u sygjerua nga Profesor Georges Abi-Saab në çështjen e përmendur më lart *Giovanna A Beccara and Others v. The Argentine Republic*<sup>28</sup>. Që prej vitit 1996, arbitrat e ICSID-it kanë shprehur mendime të veçanta në më shumë se njëzet herë<sup>29</sup>.

Një nga shembujt më të njohur të arbitrazheve kolegjiale të përziera mund të përmendim Tribunalin për pretendimet mes Iranit dhe Shteteve të Bashkuara<sup>30</sup>, i cili ishte krijuar me marrëveshjen e Algjerisë për zgjidhjen e konfliktit në vitin 1981<sup>31</sup>.

<sup>19</sup> *Guadalupe Gas Products Corporation v. Nigeria* (ICSID Case No. ARB/78/1).

<sup>20</sup> Taida Begic. *Applicable law in international investment disputes*. 2005. F. 32, ICSID Rep. Vol 6.

<sup>21</sup> <http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC536&caseId=C15>

<sup>22</sup> Antonio R. Parra, *The History of ICSID*. Oxford University Press, 2012. F.209. <http://www.worldbank.org/afr/wps/wp62.pdf>

<sup>23</sup> [http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC569\\_En&caseId=C165](http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC569_En&caseId=C165)

<sup>24</sup> Antonio R. Parra, *The History of ICSID*. Oxford University Press, 2012. F. 264.

<sup>25</sup> Michael W. Bühler, Thomas H. Webster, *Handbook of ICC arbitration: commentary, precedents, materials.*, 2005. F. 309; Jackson H. Ralston. *International Arbitration from Athens to Locarno*. 2004. F. 178.

<sup>26</sup> Michael W. Bühler, Thomas H. Webster, *Handbook of ICC arbitration: commentary, precedents, materials.*, 2005. P. 309; Jackson H. Ralston. *International Arbitration from Athens to Locarno*. 2004. F. 178.

<sup>27</sup> Elizabeth Whitsitt. *An ICSID Tribunal splits over whether to hear ancillary claims in dispute over unpaid gas deliveries 2010*.

<sup>28</sup> Erik de Brabandere, *Investment treaty arbitration as Public International Law 2014*. F. 156.

<sup>29</sup> <http://icsid.worldbank.org>

<sup>30</sup> Collier John, Vaughan Lowe. *The settlement of disputes in international law: institutions and procedures*. 2000. F. 73, Julian D.M. Lew Loukas A. Mistelis, Stefan Kröll. *Comparative international commercial arbitration 2003*. F. 42.

<sup>31</sup> «Marrëveshja e Algjerisë» përbëhet nga dy Deklarata: Deklarata e qeverive demokratike dhe ajo e Republikës popullore të Algjerisë (deklarata e Përgjithshme) dhe Deklarata e qeverive demokratike dhe

Sipas nenit 37 të Konventës «Për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera», arbitrazhi duhet të përbëhet ose nga një arbitër i vetëm ose nga një numër tek arbitrash të caktuar prej palëve. Në mungesë të marrëveshjes ndërmjet palëve për numrin e arbitrave, atëhere gjykata do të përbëhet prej tre vetash (dy arbitra do të zgjidhen prej palëve, kurse i treti do të zgjidhet nga Presidentit të gjykatës, kandidaturë për të cilën palët duhet të shprehin dakortësinë e tyre).

## 7. Parimi i sigurisë juridike

Format dhe metodat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të investimeve në përputhje me të drejtën ndërkombëtare zakonore, marrin një përfundim të veçantë ligjor në marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale të investimeve. Kontratat/marrëveshjet e investimeve janë të projektuara për të siguruar mbrojtje ligjore sipas së drejtës ndërkombëtare, si dhe të kenë qasje në mënyrat ndërkombëtare të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në rast se ato do të lindin.

Marrëveshjet bilaterale për investimet (BIT) rregullojnë ato çështje të cilat investitorët e huaj i konsiderojnë të rëndësishme për veten e tyre, duke synuar krijimin e një regjimi ligjor më të besueshëm dhe për këtë arsye të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm. Numri i BIT filloi dukshëm të rritet që në fillim të viteve 90 të shekullit XX, po ashtu edhe numri i shteteve palë në BIT (në fund të shekullit XX, numri i BIT arriti në 1100, kurse deri në vitin 2014 kishte më shumë se disa herë). Në vitet e fundit, numri i rasteve të dërguara në arbitrazh është rritur ndjeshëm<sup>32</sup>.

Rritja e numrit të mosmarrëveshjeve të dërguara për shqyrtim në arbitrazh çoi gjithashtu në një rritje të numrit të arbitrave të përfshir për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve. Arbitrat në këtë situatë, duke interpretuar dhe zbatuar normat e të drejtës ndërkombëtare publike, shpesh vinin në përfundime kundërshtuese, duke formuar kështu një praktikë të diskutueshme. Kështu, në vend që të ofronin siguri ligjore dhe qëndrueshmëri, të cilat në vetvete japin rritje të parashikueshmërisë dhe besueshmërisë për investitorët e huaj dhe shtetet, arbitrat krijuan (një interpretim dhe aplikim jo-uniform) në lidhje me kuptimin e normave të së drejtës ndërkombëtare, e cila ka çuar në një mungesë të një praktike gjyqësore logjike. Në këtë drejtim, Sekretari i Përgjithshëm i ICSID-it vuri në dukje se «mundësia për vendime të papajtueshme në thelb për të njëjtat çështje është e dukshme»

ajo e Republikës popullore të Algjerisë për zgjidhjen e pretendimeve ndërmjet Qeverisë së Shteteve të Bashkuara dhe Qeverisë së Republikës Islamike të Iranit (Deklaratës për zgjidhjen e humbjeve, (Declaration on the settlement of losses)), në bazë të së cilës u themelua Tribunali për pretendimet mes Iranit dhe Shteteve të Bashkuara për zgjidhjen e konflikteve si dhe të pesë Marrëveshjeve teknike. [www.iusct.org/general-declaration.pdf](http://www.iusct.org/general-declaration.pdf)

<sup>32</sup> Deri në ditët e sotme nën shqyrtimin e gjykatës së ICSID-it janë depozituar 549 çështje arbitrazhi. [www.icsid.worldbank.org](http://www.icsid.worldbank.org)

dhe se vendimet e arbitrazheve të investimeve demonstrojnë një valë vendimesh kontradiktore. Në të ardhmen, këto vendime mund jo thjesht të kundërshtojnë njëra-tjetrën (papajtueshmëri e dyfishtë), por shtrirja e gjykimeve të papajtueshme mund të jetë e trefishtë dhe katërfishtë<sup>33</sup>.

Si shembull mund të sjellim vendimin e marrë nga arbitrat e arbitrazheve të Londrës dhe Stokholmit në çështjen e *Lauder/CME*<sup>34</sup>. Në vitin 1990, z. Lauder (biznesmen Amerikan) dhe partneri i tij (bashkë-investitor), së bashku me z. Iron (shtetas Çek) themeluan një sipërmarrje të përbashkët në Republikën Çeke (stacion televiziv privat) duke ushtruar aktivitetin e vet në bazë të licencës së marrë në përputhje me legjislacionin kombëtar të Republikës Çeke<sup>35</sup>. Në vitin 1995 Republika Çeke miratoi një ligj, dispozitat e të cilit ndryshojnë procedurën për licencimin e veprimtarisë së ndërmarrjeve në fushën e transmetimeve. Në vitin 1999, z. Lauder inicioi procedurën e arbitrazhit mbi bazën e marrëveshjes BIT SHBA-Çeki në arbitrazhin e Londrës, kurse partneri i tij (bashkë-investitor) në arbitrazhin e Stokholmit në bazë të marrëveshjes BIT Hollandë-Çeki. Arbitrat në Londër pranuan se dispozitat e ligjit të ri çek nuk ishin diskriminuese në lidhje me investitorët e huaj, kurse arbitrat në Stokholm, vendosën të kundërtën, i njohën dispozitat e ligjit çek si diskriminuese ndaj investitorëve të huaj dhe i konsideruan veprimet e qeverisë çeke si një privatizim të fshehur.

Rritja e shpejtë e numrit të vendimeve të arbitrave për çështjet e aplikimit të BIT çoi qartësisht në atë, që në vitet e fundit u shfaqën të meta të cilat lejuan disa autorë për ta përshkruar gjëndjen si një «krizë legjitimiteti» ose «privatizim të së drejtës ndërkombëtare» prej arbitrave privat<sup>36</sup>. Me fjalë të tjera, nuk u krijua një praktikë e qëndrueshme e interpretimit të normave të së drejtës ndërkombëtare publike, e cila sot është një mangësi thelbësore e arbitrazhit ndërkombëtar të përzier. Përveç kësaj, gjithashtu duhet ti kushtojmë vëmendje edhe kostos së lartë të shqyrtimit të çështjes (rreth 1-2 milionë dollarë vetëm për vitin e parë), si dhe afateve të kohëzgjatjes së shqyrtimit të çështjeve (rreth 3-5 vjet). Me fjalë të tjera, mungesa e qartësisë së kuptimit të normave ligjore dhe praktikës së zbatimit të tyre, mund të bëhet një kërcënim konkret për marrëdhëniet ndërkombëtare të fushës së investimeve.

Në këtë drejtim, praktika ka treguar se «në çdo sistem ligjor në të cilin vendime diametralisht të kundërta që janë ligjërish të pranuar, nuk mund të ekzistojnë për një kohë të gjatë». Kjo minon ndjenjën e drejtësisë dhe paanësisë. Duke patur

parasysh se çështjet ligjore janë baza e procedurës së arbitrazhit, shkencëtarët duhet të zgjidhin problemet themelore të cilat qëndrojnë në krizën e legjitimitetit<sup>37</sup>.

Arbitrazhi për investimet duhet ti drejtoj përpjekjet drejt një kuptimi uniform, të interpretimit dhe zbatimit të normave të së drejtës ndërkombëtare publike. Për këtë, mund të duhet të ngrihet një organ arbitrazhi apeli, i cili mund të shqyrtonte mosmarrëveshjet në thelb. Kështu, vendimi i tij do të kishte vlefshmëri më të madhe ligjore (argumentuese), nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, vendimeve të tij do të detyroheshin t'i kushtoin vëmendje të gjitha arbitrazhet e tjera të investimeve, në marrjen e një vendimi konkret. Finalizimi i vendimit në ditët e sotme nuk është më një cilësi tërheqëse e arbitrazhit ndërkombëtar të përzier, por përkundrazi është një mungesë e saj. Përpara organit të Apelit qëndrojnë dy detyra: identifikimi i gabimeve të dukshme në interpretimin dhe zbatimin e të drejtës ndërkombëtare dhe krijimi i një jurisprudence (gjithëpërfshirëse) të konsoliduar.

Një rast shembull të suksesshëm të një organi apeli mund të sjellim Organin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të OBT-së (World Trade Organisation), sipas të cilit «pranimi i raporteve të panelit të arbitrazhit është një pjesë e rëndësishme e jurisprudence së GATT (General Agreement on Tariffs and Trade) dhe shpesh merren në konsideratë nga grupet e paneleve të arbitrazhit. Anëtarët e OBT-së presin që paneli do të veprojë në të ardhmen në të njëjtën frymë, prandaj dhe raportet duhet të merren parasysh atje ku është e përshtatshme»<sup>38</sup>.

Deri më sot, asnjë arbitrazh i përzier nuk ka potencialin për të eliminuar mospërputhjet në vendimet e arbitrazheve për investimet. Por, në perspektivë, organ apeli mund të ishte ICSID-i.

## 8. Parimi i konfidencialitetit

Në shumicën e rasteve, vendimet e marra nga arbitrazhet e përziere janë konfidenciale dhe nuk janë në dispozicion për studim, si nga shkencëtarët e jurisprudence ashtu edhe nga arbitrat e tjerë. Rëndësia themelore e publikimit të vendimeve të arbitrazheve vjen nga fakti se akumulimi i zgjidhjeve identike ose të ngjashme, aftëson për të gjeneruar një fenomen të imitimit, që do të punojë vetëm në rast të përsëritjeve të vendimeve të njëjta për çështje të ndryshme. Në qoftë se arbitrazhi është një mundësi efektive për të zgjidhur, në veçanti, mosmarrëveshjet e investimeve, atëherë është e nevojshme tu ofrojmë individëve dhe shteteve një mundësi të një parashikueshmërie të madhe të rezultatit të çështjeve. Nga ana tjetër, një njohuri e mirë e praktikës së arbitrazhit do të lejojë që të kemi një kuptim

<sup>33</sup> Susan D. Franck // The Legitimacy Crisis in Investment Treaty Arbitration: Privatizing Public International Law through Inconsistent Decisions. Vol. 73., FORDHAM L. REV. 2005. F. 1582.

<sup>34</sup> Po aty. F. 1558-1559. Shiko dhe: Waibel M. The backlash against investment arbitration: perceptions and reality 2010. F. 118.

<sup>35</sup> Lauder me partnerin e tij ushtuan investime jo direkte në ekonominë e Republikës Çeke.

<sup>36</sup> Susan D. Franck // The Legitimacy Crisis in Investment Treaty Arbitration: Privatizing Public International Law through Inconsistent Decisions. Vol. 73., FORDHAM L. REV. 2005. F. 1521.

<sup>37</sup> Vandeveldt J. Kenneth, The growth of bilateral investment treaties and their impact on foreign investment in developing countries // Int'l Law. 1990.

<sup>38</sup> WTO Appellate Body Report on United States - Import prohibition of certain shrimp products, WT/DS58/AB/RW (Oct. 22, 2001) F. 108. www.wto.org

të qartë të realitetit dhe të përparësive të arbitrazhit. Kjo, natyrisht, nuk do të thotë se arbitrat duhet të privohen nga liria në mënyrën e zgjidhjes së çdo rasti konkret.

Si një sygjërim për të zgjidhur problemin e legjitimitetit të vendimeve të arbitrazheve, mund të supozojmë se zgjidhja e mosmarrëveshjeve në arbitrazhet ndërkombëtare, (ku kanë të drejtën e aksesit personat privat), të ndërtohet në përputhje me parimin e transparencës. Transparenca ka një rëndësi të madhe në se rregullat e rëndësishme për ekonominë dhe zbatimin e tyre në praktikë është në dispozicion për të gjithë, dhe kur nuk krijohen pengesa për pjesëmarrësit e marrëdhënieve në fushën e investimeve për marrjen e informacioneve<sup>39</sup>.

Në veçanti, institucionet e arbitrazheve mund të marrin në konsideratë çështjen për sa i përket miratimit të një protokollit që do të ofronte mundësinë për të botuar vendimin e marrë. Ose, ndoshta, krijimi i grupeve të punës, anëtarët e të cilëve mund të jenë si arbitra nga praktika ashtu edhe zyrtarëve qeverie. Rekomandimet e këtyre grupeve të punës gjithashtu mund të formojnë një bazë për rregullat e arbitrazhit.

Për shembull, ICSID-i mund të ndryshonte rregullat e veta shtesë neni 53 (3) për të treguar se në rastin e një marrëveshje arbitrazhi për investim, palët bien dakord për publikimin e vendimit. Megjithatë, në praktikë mund të ndeshim në një sërë vështirësish. Në veçanti, rishikimi i rregullave shtesë të ICSID-it do të jetë i kufizuar nga kërkesat e Konventës «Për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera». Kurse Rregullorja e UNCITRAL-it nuk ka ndryshuar që prej vitit 1978, ku në nenin 32§5 parashikohet se vendimet e arbitrazheve nuk duhet të publikohen pa pëlqimin e palëve, dhe kjo mund të përbëjë një problem, duke qënë se rishikimi apo ndryshimi i Rregullores kërkon pëlqimin e shteteve<sup>40</sup>.

## Bibliografia

1. Antonio R. Parra, *The History of ICSID*. Oxford University Press, 2012.
2. Alexis Mourre, Castaldi Mourre & Partners // *Arbitral Jurisprudence in International Commercial Arbitration: The Case For A Systematic Publication Of Arbitral Awards In 10 Questions...*2009.
3. A.H.A. Soons (ed.) *International Arbitration: Past and Prospects*, Kluwer Academic Publishers, The Netherlands. 1990.
4. Alfred Redfern, *Law and practice of International commercial arbitration*. 2004.
5. Alexis Mourre, Castaldi Mourre & Partners // *Arbitral Jurisprudence in International Commercial Arbitration: The Case For A Systematic Publication Of Arbitral Awards In 10 Questions...*2009.
6. Bin Cheng, *General principles of law as applied by international courts and tribunals*. 2006.

<sup>39</sup> Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, 8th Ed. 2012.

<sup>40</sup> Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, 6th Ed. 2003.

7. Collier John, Vaughan Lowe. *The settlement of disputes in international law: institutions and procedures*. 2000.
8. Ch. Schreuer, *The ICSID Convention: A Comentary*, Cambridge University Press. 2001.
9. Charles Irving Bevans, United States Dept. of State, *Treaties and other International Agreements of the United States of America 1776-1949*. 1971.
10. Erik de Brabandere, *Investment treaty arbitration as Public International Law* 2014.
11. Elizabeth Whitsitt. *An ICSID Tribunal splits over whether to hear ancillary claims in dispute over unpaid gas deliveries*, 2010.
12. Fahrutdinov I. Z. *International investment law: theory and practice issues*. . 2005.
13. Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, 6th Ed. 2003.
14. Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, 8th Ed. 2012.
15. Jean-François Poudret, Sébastien Besson. *Comparative law of international arbitration*. 2007.
16. Ileana M. Smeureanu, *Confidentiality in international arbitration*, Kluwer Law International, The Netherlands. 2011.
17. James Crawford, Karen Lee, Elihu Lauterpacht, *ICSID Reports: 2005*.
18. Julian D. M., Lew Loukas A. Mistelis, Stefan Kröll. *Comparative international commercial arbitration* 2003.
19. John O'Brien. *International Law*. 2002.
20. Malcolm N. Shaw. *International Law*. 6th Edition. Cambridge. 2008.
21. Malcolm N. Shaw. *International Law*. 7th Edition. Cambridge. 2014.
22. Nemirovskij. *About International Court*. «The Journal of jurisprudence communication» Nr.4.1898.
23. Susan D. Franck // *The Legitimacy Crisis in Investment Treaty Arbitration: Privatizing Public International Law through Inconsistent Decisions*. Vol. 73., *FORDHAM L. REV.* 2005.
24. Shinkareckaya G.G. *International court procedures*. . 1992.
25. Thomas H. Webster, *Handbook of ICC arbitration: commentary, precedents, materials*., Michael W. Bühler, 2005.
26. Taida Begic. *Applicable law in international investment disputes*. 2005. *ICSID Vol. 6*.
27. Vandeveld J. Kenneth, *The growth of bilateral investment treaties and their impact on foreign investment in developing countries // Int'l Law*. 1990.
28. Waibel M. *The backlash against investment arbitration: perceptions and reality*, 2010.
29. WTO Appellate Body Report on United States - Import prohibition of certain shrimp products, WT/DS58/AB/RW (Oct. 22, 2001).

## Burime nga interneti:

1. <http://www.pca-cpa.org>
2. [www.wto.org](http://www.wto.org)
3. <http://icsid.worldbank.org>
4. [www.icj-cij.org/docket/files/19/4761.pdf](http://www.icj-cij.org/docket/files/19/4761.pdf)
5. [http://icsid.worldbank.org/ICSID/Servlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC1171\\_En&caseId=C5](http://icsid.worldbank.org/ICSID/Servlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC1171_En&caseId=C5)
6. [https://icsid.worldbank.org/ICSID/StaticFiles/basicdoc/CRR\\_English-final.pdf](https://icsid.worldbank.org/ICSID/StaticFiles/basicdoc/CRR_English-final.pdf)
7. <http://www.investmenttreatynews.org/cms/news/archive/2010/03/10/icsid-tribunal-applies-ad-hoc-approach-to-confidentiality-in-arbitral-proceeding.aspx>
8. <http://icsid.worldbank.org/ICSID/Servlet?requestType=CasesRH&actionVal=show>

- Doc&docId=DC677\_En&caseId=C140
9. <http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC533&caseId=C148>
  10. <http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC536&caseId=C15>
  11. <http://www.worldbank.org/afr/wps/wp62.pdf>
  12. [http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC569\\_En&caseId=C165](http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC569_En&caseId=C165)
  13. [www.iusct.org/general-declaration.pdf](http://www.iusct.org/general-declaration.pdf)

## *Roli i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë ne interpretimin e rregullave të lëvizjes së lirë të personave*

*Sokol Bana PhD*

### **Abstrakt**

*Lëvizja e lirë është një e drejtë themelore në Bashkimin Europian. E drejta e Bashkimit Europian dhe në këtë kuadër edhe lëvizja e lirë e shtetasve evropianë udhëhiqet nga disa parime shumë të rëndësishme që përbëjnë bazën e zhvillimit dhe funksionimit të Tregut të Përbashkët Evropian. Lëvizja e lirë si një nga katër liritë themelore që siguron tregu i përbashkët udhëhiqet nga parimi i respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ashtu siç do të trajtohet në këte artikull, lëvizja e lirë është një ndër të drejtat e patjetërsueshme të njeriut, e cila në legjislacionin e BE-së ka marrë një dimension shumë më të gjerë e të avancuar. Gjykata e Drejtësisë ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për afirmimin progresiv të lëvizjes së lirë të personave. Nëpërmjet një interpretimi gjithnjë në rritje të legjislacionit komunitar, Gjykata i ka dhënë një zgjerim fushës së aplikimit të dispozitave të Traktatit për lëvizjen e lirë të personave, duke hequr pothuajse plotësisht kufirin e parë që ia njihje këtë të drejtë vetëm një kategorie të ngushtë operatorësh ekonomikë.*

***Fjalet Kyçe:** lëvizja e lirë, Bashkimin Europian, shtetas komunitarë, shtetas jo komunitarë, jurisprudenca e GEJD-së etj.*

### **1. Hyrje**

Lëvizja e lirë është një e drejtë parashikon që çdo individ i një shteti, në cilin ky është rezident, mund të largohet nga shteti i tij, me dokumentacionin përkatës të udhëtojë sa herë që ai dëshiron dhe të mund të kthehet tek shteti i origjinës në çdo

kohë. Ajo lidhet me te drejtat qe garantohen në kuadër të tregut të përbashkët. Këto të drejta parashikohen dhe garantohen në legjislacionet e shumë shteteve. Kjo e drejtë parashikon që çdo individ i një shteti, në cilin ky është rezident, mund të largohet nga shteti i tij, me dokumentacionin përkatës të udhëtoje sa herë që ai dëshiron dhe të mund të kthehet tek shteti i origjinës në çdo kohë; kjo e drejte parashikon gjithashtu, të drejtën e inividit të udhëtoje, të banojë dhe/ose të punojë në çdo pjesë të vendit ku qytetari dëshiron, pa ndërhyrje nga shteti.

E drejta e lëvizjes së lirë ndryshon në lidhje me kontekstin në të cilin ajo analizohet. Ajo analizohet në kontekstin ndërkombëtar, në atë europian ose në kontekstin e legjislacionit të brendshëm. N.q.s. do i referohemi këtij të fundit (legjislacionit shqiptar) neni 38 i Kushtetutës së Shqipërisë thotë shprehimisht: “Kushdo ka të drejtë të zgjedhë vendbanimin si dhe të lëvizë lirisht në cdo pjesë të territorit të shtetit. Askush nuk mund të pengohet të dalë lirisht jashtë shtetit.” Në këtë drejtim lëvizja e lirë i referohet lirisë për të lëvizur lirisht në cdo pjesë të vendit, territorit të shtetit shqiptar si dhe në gëzimin e kësaj të drejte shteti nuk mund të ndërhyjë. Paragrafi i dytë i nenit në fjalë sanksionon lirinë për të dalë nga shteti. Po kështu, edhe në përputhje me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (1948) të gjithë personat gëzojnë një sërë të drejtash të patjetërsueshme të cilat janë “bazat e lirisë dhe të drejtësisë në botë”. Neni 13 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut sanksionon shprehimisht: “Çdo person ka të drejtë të qarkullojë lirisht dhe të zgjedhë vendbanimin e tij brenda një shteti. Çdo person ka të drejtë të largohet nga cdo vend, përfshirë edhe vendin e vet, si dhe të kthehet në vendin e tij.”. Ndonëse mund të duket se kjo e drejtë aplikohet më shumë për emigrantët, ajo ka shtrirje të gjerë edhe tek persona të tjerë po në kuadër të emigracionit si per shembull per azil-kërkuesit, refugjatët, studentet apo për familjarët në përgjithësi. Kjo e drejtë e patjetërsueshme e lirisë shtrihet, ne thelb, tek të gjithë personat.

Një kuptim shumë më të gjerë dhe me karakteristika më të veçanta merr liria e lëvizjes në legjislacionin europian (*acquis communautaire*). Në Bashkimin Europian garantohen katër liri/të drejta themelore: liria e qarkullimit të mallrave, personave, shërbimeve dhe kapitaleve. Tregu i përbashkët në BE përfshin pikerisht lëvizjen e lirë të mallrave, të personave, të shërbimeve dhe të kapitaleve. Realizimi i këtij tregu, ashtu siç parashikohet në nenin 2 TBE, parashikon eliminimin mes Shteteve anëtare të pengesave për shkëmbimet e mallrave, për qarkullimin e lirë të personave, shërbimeve dhe kapitaleve. Tregu i brendshëm, i sanksionuar në nenin 14 TBE përfshin “një hapësirë pa kufij të brendshëm ku lëvizja e lirë e mallrave, e personave, e shërbimeve dhe e kapitaleve është e garantuar në përputhje me dispozitat e këtij Traktati”. Dy parime të tjera mjaft të rëndësishme, që qëndrojnë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën në BE, janë ndalimi i diskriminimit dhe trajtimi i barabartë, të cilët sanksionohen në nenin 12, të TBE-së. Parimi i parë

nënkupton që asnjë shtetas i cili lëviz nga shteti i origjinës në një shtet tjetër të Bashkimit nuk mund të diskriminohet për shkak të kombësisë, gjinisë, përkatësisë fetare, etnike, shoqërore etj.

Lëvizja e lirë e këtyre personave në BE nuk mund të kuptohet vetëm në kuptimin e ngushtë të fjalës, si lëvizje e thjeshtë, tranzitore, por edhe si e drejta e këtyre personave për t’u vendosur në një nga shtetet anëtare, për të studiuar, për të punuar, për të marrë me vete familjarët dhe për të pasur një trajtim të barabartë me shtetasit e atij shteti. Kjo e drejtë themelore e shtetasve evropianë fillimisht ka pasur një konotacion ekskluzivisht ekonomik dhe gjente aplikim vetëm për lëvizjen e lirë të punëtorëve të punësuar apo të vetëpunësuar, në të drejtën e qëndrimit dhe ofrimit të shërbimeve. Personat, të cilët konsideroheshin si forcë punëtore, përbënin faktorin e tretë të prodhimit të mallrave dhe kapitaleve në atë kohë dhe për këtë arsye lëvizja e tyre është parë gjithmonë si një hallkë e nevojshme për qarkullimin e lirë të dy faktorëve të tjerë. Liria e qarkullimit të personave, në veçanti, është objekt i një parimi themelor i destinuar për të kënaqur nevojat të gjithë shtetasve komunitarë duke u mundësuar dhe lehtësuar atyre ushtrimin e një aktiviteti përtej kufijve shtetërorë. Për sa i përket konceptit të lëvizjes së lirë, ai shtrihet edhe tek shtetasit jo komunitarë. Hyrja dhe qëndrimi i shtetasve jo komunitarë ka qenë prerogativë e sovranitetit të Shteteve anëtare të cilat i vendosnin vetë kushtet dhe kriteret për ushtrimin e kësaj të drejte.

## 2. Baza ligjore

Pavarësisht se dispozitat origjinale të Traktateve i referohen vetëm ndryshimeve të rëndësishme ekonomike, e drejta komunitare ka zgjeruar në mënyrë progresive konceptin e lirisë së qarkullimit, duke e shtrirë këtë liri tek të gjithë personat që kanë shtetësinë e një Shteti anëtar të BE-së dhe që transferohen nga një vend anëtar në tjetrin<sup>1</sup>. Gjykata Europiane e Drejtësisë, në fakt, e ka zgjeruar shumë sferën e subjekteve që mund të përfitojnë nga kjo liri, duke kaluar përtej rasteve tipike të lidhura me punën, me qëndrimin dhe dhënien e shërbimeve. Është arritur në një rezultat të tillë qoftë duke interpretuar në mënyrë të gjerë kategorinë e personave të përcaktuara në traktat, qoftë duke zgjeruar kategorite e aktiviteteve të punës, po ashtu duke futur kategori të reja personash që mund të përfitojnë këtë liri edhe duke mos qenë të përcaktuar në mënyrë të qartë në traktat. Një zgjerim/shtrirje të tillë e gjejmë në legjislacionin komunitar edhe për familjarët e punëtorëve, për kategorinë e shtetasve që nuk janë punëtorë, punëtorëve që nuk mund të punojnë me për arsye moshe, invaliditeti etj. dhe per studentët me kushtin që të disponojnë të ardhurat e duhura për të jetuar. Një rol të veçantë në këtë

<sup>1</sup> Shih direktivën 2004/38/KE të 28 prillit të vitit 2004.

drejtim ka luajtur edhe normativa dytësore (rregulloret dhe direktivat), duke bërë që t'u njihet e drejta e lëvizjes së lirë pothuajse të gjithë shtetasve të Bashkimit European, duke përfshirë këtu edhe ata individë të cilët qarkullojnë edhe pa u punësuar. Me tre direktivat e vitit 1990, që kanë të bëjnë me shtrirjen e të drejtës së lëvizjes së lirë dhe qëndrimit, iu njoh e drejta e qëndrimit të gjithë punonjësve të cilët i kanë përfunduar marrëdhëniet e punës, studentëve dhe të gjithë personave të cilët disponojnë të ardhura ekonomike të mjaftueshme për të jetuar<sup>2</sup>.

E drejta për të qarkulluar dhe qëndruar lirisht mbi të gjithë territorin komunitar është përforcuar në vazhdim me dispozitat e reja lidhur me shtetësinë europiane të futura në traktatin e Maastricht-it. Paragrafi 1 i nenit 21 (ish neni 18) TBE tregon, në fakt, se çdo shtetas i Bashkimit European ka të drejtën e qarkullimit dhe të qëndrimit lirisht në territoret e vendeve anëtare, duke e shtrirë këtë të drejtë për të gjithë shtetasit e Bashkimit European, nisur nga fakti se mund të kryejnë një aktivitet në një vend tjetër anëtar. Sipas nenit në fjalë “Çdo shtetas i Bashkimit gëzon të drejtën e lëvizjes dhe të qëndrimit në mënyrë të lirë brenda territoreve të Shteteve anëtare, e drejtë kjo që është subjekt i kufizimeve dhe i kushteve të përcaktuara në këtë Traktat dhe i masave që merren për ta vënë këtë në zbatim”. Kjo dispozitë përbën tani bazën juridike mbi të cilën bazohet e gjithë disiplina komunitare në fushën e qarkullimit dhe të qëndrimit të lirë të qytetarëve komunitarë.

Një rëndësi të veçantë në këtë fushë ka Direktiva 2004/38/KE e cila ka riorganizuar dhe modifikuar aktet ligjore të mëparshme të BE-së që disiplinonin në mënyrë jo unike qarkullimin e lirë të punëtorëve vartës, punëtorëve autonome, studentëve, personave jo aktivë ekonomikisht<sup>3</sup>. Ajo rregullon në një tekst të vetëm legjislativ të drejtën për të qarkulluar lirshëm të shtetasve komunitarë dhe familjarëve të tyre në Bashkimin European.

Neni 21 TBE, së bashku me jurisprudencën e GJED-së dhe direktiva 2004/38/KE, kanë shënuar në mënyrë definitive kapërcimin e konceptit merkantilist të së drejtës së lëvizjes së lirë: pra, jo më lëvizje e lirë në funksion të ushtrimit të një aktiviteti ekonomik por qarkullim i lirë dhe qëndrim si shtetas të Bashkimit European. Në lidhje me këtë shtohet edhe një koncept ose fenomen i ri përveç tregut të përbashkët që është “hapësira e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë”, nëpërmjet të cilës realizohet edhe qarkullimi i lirë i personave. Pra, qarkullimi i lirë i personave në Bashkimin European nënkupton lëvizjen e lirë të shtetasve të vendeve anëtare të

<sup>2</sup> Bëhet fjalë për direktivat e Këshillit, n. 90/364/KEE, 90/365/KEE, 90/366/KEE të 28 qershor të vitit 1990, të publikuara në Fletoren Zyrtare të BE-së, L 180, e datës 13 korrik të vitit 1990. Direktiva 90/366 që parashikonte të drejtën e qarkullimit të lirë të studentëve u anulua nga Gjykata e Drejtësisë (çështja *Parlamenti k. Këshillit*, C-295/90 e datës 7 korrik të vitit 1992, por ajo “rigjenerohet” në direktivën 93/96/KEE (botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së, L 137, e datës 18 dhjetor të vitit 1993).

<sup>3</sup> Ky term i referohet të gjithë personave-shtetas komunitarë që janë transferuar në një shtet tjetër anëtar të BE-së për arsyeve të punësuar (pra, jo për t'u punësuar) pasi ata disponojnë të ardhura të mjaftueshme për të bërë një jetë normale në atë shtet ku janë transferuar.

“hapësirës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë”, brenda hapësirës së këtyre shteteve pa asnjë pengesë administrative.

Lëvizja e lirë e këtyre personave në BE nuk mund të kuptohet vetëm në kuptimin e ngushtë të fjalës, si lëvizje e thjeshtë, tranzitore, por edhe si e drejta e këtyre personave për tu vendosur në një nga shtetet anëtare, për të studiuar, për të punuar, për të marrë me vete familjarët dhe për të pasur një trajtim të barabartë me shtetasit e atij shteti<sup>4</sup>.

Sot, përfitojnë nga regjimi i lëvizjes së lirë të gjithë personat që janë shtetas të një shteti anëtar të Bashkimit European. Nga kjo e drejtë përfitojnë edhe personat të cilat kanë dy shtetësi, një të një Shteti anëtar të BE-së dhe shtetësinë e një shteti jo anëtar.

Ajo realizohet nëpërmjet hapësirës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, një hapësirë kjo, e fundit pa kufij të brendshëm. Eliminimi i kufijve të brendshëm kërkon rritjen e menaxhimit të kufijve të jashtëm dhe një hyrje e rregulluar; si dhe të qëndrimit të qytetarëve të huaj, duke përfshirë edhe përmes një politike të përbashkët mbi azilin dhe emigracionin. Për sa i përket konceptit të lëvizjes së lirë, ai shtrihet edhe tek shtetasit jo komunitarë. Hyrja dhe qëndrimi i shtetasve jo komunitarë ka qenë prerogative e sovranitetit të Shteteve anëtare të cilat i vendosnin vetë kushtet dhe kriteret për ushtrimin e kësaj të drejte. Koncepti i lëvizjes së lirë të personave, lindur me nënshkrimin e Marrëveshjes së Shengenit në vitin 1985 dhe pasuesen e Shengen në 1990, Konventa, e cila hoqi kontrollin e kufijve midis vendeve pjesëmarrëse. Bashkëpunimi Shengen, si pjesë e kuadrit ligjor dhe institucional të BE-së, është zgjeruar gradualisht në shumicën e shteteve anëtare të BE-së dhe disa vende jashtë BE-së.

Sot, regjimi i lëvizjes së lirë të shtetasve jo komunitarë në Bashkimin European është një ndërthurje e rregullave të vendosura në kuadër të Marrëveshjeve Shengen dhe rregullave të vendosura nga secili Shtet Anëtar, në varësi të arsyeve dhe kohës së qëndrimit.

### 3. Jurisprudenca e Gjykatës europiane të Drejtësisë

Gjykata e Drejtësisë ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për afirmimin progresiv të lëvizjes së lirë të personave. Nëpërmjet një interpretimi gjithnjë në rritje të legjislacionit komunitar, Gjykata i ka dhënë një zgjerim fushës së aplikimit të dispozitave të Traktatit për lëvizjen e lirë të personave, duke hequr pothuajse plotësisht kufirin e parë që ia njihnte këtë të drejtë vetëm një kategorie të ngushtë

<sup>4</sup> Cassese S., “La cittadinanza europea e le prospettive di sviluppo dell'Europa”, në Rivista italiana di diritto pubblico comunitario, 1996, fq. 869; Daniele L., “Diritto del mercato unico europeo”, Milano, 2006.

operatorësh ekonomikë<sup>5</sup>, me anën e një procesi të quajtur “përngadalësim të funksionimit ekonomik të lëvizjes së lirë”.

Ky rezultat është arritur falë interpretimit zgjerues të kategorive të personave që përfitojnë nga lëvizja e lirë të përcaktuar në Traktat, të konceptit të aktivitetit ekonomik, (GJED, Vendimi 3 korrik 1986 *Lawrie- Blum* çështja 66/55), si dhe duke shtuar kategori të tjera të personave jo të përfshirë.

Në këtë mënyrë janë futur në kategorinë e përfituesve të lëvizjes së lirë, jo vetëm ofruesit por dhe përfituesit e shërbimit, duke përfshirë dhe turistët, duke krijuar në këtë mënyrë të drejtën për të hyrë në territoret e Shteteve anëtare për të gjithë shtetasit komunitarë.

Vlen të përmendet këtu vendimi i çështjes *Luisi e Carbone* (Vendimi 31 janar 1984, çështjet e bashkuara 286/82 dhe 26/83, *Luisi e Carbone*, pika 16, GJED) në të cilën Gjykata theksoi se në bazë të nenit 49 të Traktatit (aktualisht neni 40), për të bërë të mundur lëvizjen e shërbimeve është e lejuar jo vetëm zhvendosja e ofruesit të shërbimeve në Shtetin anëtar ku është përfituesi i shërbimeve, por dhe zhvendosjen e këtij të fundit në Shtetin ku ofruesi i shërbimeve ka vendqëndrimin, kështu është saktësuar e drejta e përfituesit të shërbimeve për të lëvizur lirisht në një Shtet anëtar me qëllim përfitimin nga një shërbim (GJED, Vendimi 7 korrik 1976, çështja 118/75 *Watson dhe Belman*). Kjo e drejtë nuk duhet të jetë e ndaluar nga asnjë kushtëzim. Kështu zgjerohet lëvizja e lirë e kapitaleve, “*ratione personae*” dhe e turistëve, pacientëve që përdorin shërbimet mjekësore, studentëve për udhëtimet e studimit, meqë konsiderohen si përfitues të shërbimeve.

Në çështjen *Cowan* (Vendimi 2 shkurt 1989, *Cowan*, çështja 186/87, pika 15, GJED), Gjykata Evropiane e Drejtësisë merr një nga vendimet më të përparuar në fushën e lëvizjes së lirë të personave. Në këtë çështje diskutohet nëse i duhet njohur apo jo e drejta e dëmshpërblimit për vuajtje dhune një turisti anglez i cili kishte pësuar një akt dhune në Francë. Shteti francez i njej të drejtën e këtij dëmshpërblimi çdo shtetasi të vet që pëson dhunime. Shteti francez nuk pranonte aplikimin e ligjit të brendshëm në këtë rast pasi theksonte që kjo fushë nuk hyn në fushën e aplikimit të Traktatit. Gjykata vendosi se dhe pse në parim kjo kompetence i përkiste shtetit anëtar, gjithsesi legjislacioni komunitar i vendoste disa limite kësaj kompetence.

Ndërsa Rasti *Gzerlczyk* ka të bëjë me çështjen e përfitimit të sigurimeve shoqërore nga shtetasit e BE-së që ndjekin studimet në një Shtet tjetër Anëtar dhe GJED-ja në paragrafin 39 të atij vendimi (më lart) tërhoqi vëmendjen ndaj faktit që Direktiva e Qëndrimit për studentët nuk vendoste ndonjë të drejtë për të paguar një bursë shteti. Gjithsesi, në çështjen *Bidar*, GJED-ja u konfrontua pikërisht me këtë situatën e fundit—d.m.th një student me shtetësi franceze që

<sup>5</sup> Vendimi i 13 korrik 1986, *Lawrie – Blum*, çështja 66/85, Racc. p. 1 – 2121, ne të cilin Gjykata nxjerr përkufizimin e punëtorit për të cilin zbatohet legjislacioni kombëtar, duke e ngushtuar konceptin me lidhjen e saj të zbatimit të ligjit.

aplikoi në Britaninë e Madhe për një kredi studimi ose bursë për të financuar koston e studimeve të tij atje.<sup>6</sup> Çështja ishte nëse kjo asistencë jetese, pavarësisht kushteve kufizuese në Direktivën e Qëndrimit dhe në praktikën e mëparshme gjyqësore në rastin *Brown* dhe *Lair*, përfshihej në fushën e Traktatit në lidhje me diskriminimin sipas nenit 12 KE. Gjykata, duke ndjekur një linjë mjaft të ngjashme arsyetimi me atë të rastit *Grezlczyk*, u mbështet në futjen e shtetësisë së BE-së dhe në ndryshimet e kompetencave arsimore dhe të trajnimit profesional sipas së drejtës së Traktatit të KE-së, për t’u larguar nga konkluzionet e saj të mëparshme në rastet *Brown* dhe *Lair* dhe për të vendosur se bursat shtetërore për studentët tani përfshiheshin vërtet në fushën e nenit 12.<sup>7</sup>

Gjykata duke lidhur lëvizjen e lirë të marrësve të shërbimeve me parimin e mos diskriminimit me bazë kombësinë, u përgjigj pozitivisht, duke theksuar “që mbrojtja e integritetit fizik të një personi, e liria e lëvizjes është e garantuar nga legjislacioni komunitar, ai vendos në lidhje me këtë liri”. Nga leximi i këtyre vendimeve del qartë se çdo shtetas që shkon në një Shtet anëtar për motive jo pune është përfitues, në territorin e këtij Shteti, të një sërë shërbimesh (shpenzime akomodimi, të transportit, të ngrënies).

Gjithmonë e lidhur me fushën e aplikimit të *ratione personae*, në normat mbi lëvizjen e lirë të punëtorëve, në nenin 45 (ish neni 39 TBE-së), futet dhe lëvizja e studenteve për një formim profesional<sup>8</sup>, gjithashtu dhe lëvizja për kërkimin e një vendi pune në një Shtet tjetër. Me shumë rëndësi është edhe vendimi i çështjes *Antonissen* (Vendimi 26 shkurt 1961, *Antonissen*, çështja C-292/89, GJED), në të cilën Gjykata bën një interpretim të ngushtë të nenit 45 paragrafi 3 (ish neni 48), i cili përfshin mundësinë efektive të një shtetasi të një Shteti anëtar që është në kërkim të një punësimi, të gjejë një vend pune në Shtetet e tjera anëtare.

Gjykata theksoi që autoritet kombëtare janë të detyruara t’u japin shtetasve komunitarë një periudhë kohe të mjaftueshme në mënyrë që t’i lejojë kërkimin e një vendi pune të përshtatshëm për kualifikimet e parashikuara në dispozita. Pasi kundërshtoi legjislacionin britanik që jepte një periudhë prej 6 muajsh, duke e konsideruar këtë periudhë të pamjaftueshme, Gjykata, theksoi se autoritet kombëtare nuk mund të detyrojnë një person që kërkon një vend pune të largohet nga vendi pritës, në përfundim të kohës, nëse ky ka mundësi konkrete për t’u punësuar. Nga ky vendim kuptohet se liria dhe lëvizja e lirë e nenit 45 nuk i përket

<sup>6</sup> Çështja C-209/03 *Bidar v. London Borough of Ealing* [2005] I-2119.

<sup>7</sup> Çështja C-209/03 *Bidar*, nr. 51 më lart, paragrafët 31-42.

<sup>8</sup> Lidhja midis formimit profesional dhe kualitetit të punëtorit në legjislacionin komunitar, shfaqet në vendimin e çështjes *Lair*, të 21 qeshorit 1988, çështja 39/86. Gjykata theksoi se kualifikimi i punëtorit në baze të nenit 48 duhet të mbahet nga një person i cili ka lënë punën e tij dhe është regjistruar në një kurs të formimit profesional, dhe është e nevojshme një lidhje midis studimeve të ndërrmarra dhe punës të mëparshme, kjo mund të mungojë kur personi gjendet i papunë jo vullnetarisht, në këtë rast frekuentimi i studimeve jo të lidhura me punësimin e mëparshëm nuk lejon humbjen e kualifikimit. Me të njëjtën frymë vendimi *Bernini*, me 26 shkurt 1992, çështja C-3/90, Racc. p. I-1071

vetëm atyre që kanë një punësim por dhe atyre personave që janë në kërkim të një pune në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Europian.

Gjykata Europiane e Drejtësisë ka dhënë kontributin e saj për të bërë me të qartë dhe të sigurt përmbajtjen e direktivës 2004/38/KE-së mbi lëvizjen e lirë të personave.

Gjykata në radhë të parë ka treguar se cilët janë parimet e përgjithshme të legjislacionit komunitar të cilat duhet të respektohen me patjetër nga ana e Shteteve anëtare, dhe ka theksuar pamundësinë e Shteteve për të kufizuar liritë themelore të Traktatit, sepse përjashtimet nga normat e Traktatit mund të interpretohen në mënyrë të ngushtë dhe të marra nën dritën e parimit të proporcionalitetit. Nga kjo del një sovranitet shtetëror i kufizuar, që nuk mund të konsiderohet absolut, e cila mund të shmangë kontrollin e institucioneve komunitare. Shumë rendësi merr rasti i masave që kufizojnë lirinë e lëvizjes në brendësi të Shtetit anëtar, të cilat mund të merren ndaj një shtetasi të huaj vetëm nëse mund t'i aplikohen dhe shtetasve kombëtar; ky parim parashikohet nga neni 22 i direktivës dhe që e ka rikthësuar disa herë Gjykata.

Në veçanti Gjykata, në vendimin e 7 qeshorit 2007, *Komisioni kundër Vendeve të Ulta*, që kishte si objekt një masë të një shkeljeje deklaroi Holandën si mos përmbushëse të detyrimeve komunitare sepse normativa në fuqi e këtij Shteti bënte të mundur “një lidhje sistematike dhe të drejtpërdrejte midis një dënimi penal dhe një mase dëbimi”<sup>9</sup> (Vendimi 7 korrik 2007, *Commisioni vs. Holanda*, çështja C-50/06, GJED). Gjykata vendosi se disa kufizime “aplikohen njëllor edhe për qytetarët e Bashkimit që nuk jetojnë rregullisht në territorin e Shtetit anëtar pritës” dhe se “këto mund të dëbohen për arsye të rendit ose sigurisë publike brenda kufizimeve të vendosura”.

Një situatë e ngjashme ju paraqit Gjykatës me vendimin Jipa<sup>10</sup> (Vendimi 10 korrik 2008, *Jipa*, çështja C-33/07, GJED) të 10 korrikut 2008. Në këtë rast Gjykata u thirr të interpretojë nenet 21 TKE –së dhe 27 të direktivës 2004/38 për të vlerësuar nëse ato ndalojnë një normativë kombëtare që lejon kufizimin e të drejtës së një shtetasi të një Shteti anëtar të shkojë në territorin e një Shteti tjetër

<sup>9</sup> Vendimi i 7 qeshor 2007, *Komisioni k. Holandës*, çështja C-50/06, në këtë rast Gjykata dënoi Mbretërinë e Holandës për mos aplikimin shtetasve të Bashkimit europian direktiven 64/221/KE-se, sot e zëvendësuar nga direktiva 2004/28/KE-së, për koordinimin e masave speciale për transferimin dhe qëndrimin e të huajve, të justifikuar nga arsye të rendit publik, sigurisë publike dhe të shëndetit publik, dhe të një normative të përgjithshme mbi të huajt që mundeson “një lidhje sistematike dhe të drejtpërdrejtë midis një dënimi penal dhe një mase dëbimi”.

<sup>10</sup> Vendimi i 10 korrik 2008, *Jipa*, çështja C-33/07. Çështja trajtonte situatën e një shtetas rumun që në 2006 ishte debuar nga Belgjika, legjislacioni i të cilës parashikon një kufizim të të drejtës të rihyerjes. Sipas Gjykatës një normative e këtij rangi nuk është e përjashtuar si e tillë nga legjislacioni komunitar “me kusht që nga një anë sjellja personale e këtij shtetasi përbën një rrezik të vërtetë e aktual e mjaftueshmërisht serioz për të ndikuar në interesin themeltar të shoqërisë, dhe nga ana tjetër masa shtrënguese që do të merrte është aftë të garantojë realizimin e objektivit që ndjek e mos të tejkalojë cka është e nevojshme për arritjen e objektivit. I takon gjykatësit të vërtetojë nëse në çështjen përpara tij ekzistojnë këtë elemente”.

anëtar, në veçanti nëse më parë kishte qenë i dëbuar nga ky Shtet sepse ndodhej në një situatë jo ligjore. Sipas Gjykatës nuk mjafton për të justifikuar dëbimin, “trazimi i rendit shoqëror i pandarë nga çdo shkelje e ligjit”, por nevojitet që sjellja e të huajt të perbeje “një rrezik të vërtetë dhe mjaftueshmërisht serioz ndaj një interesi themelor të shoqërisë”.

Në një mori vendimesh Gjykata e Drejtësisë ka rikthësuar që neni 21 i Traktatit KE-së, së bashku me direktivën e përmendur i jep çdo shtetasi të Bashkimit të drejtën e qëndrimit në territorin e një Shteti anëtar, dhe ka nënvizuar nevojën për një interpretim të të drejtës të lëvizjes së lirë duke e parë me të drejtat themeltare, në veçanti me të drejtën e mbrojtjes së jetës familjare, të parimit të proporcionalitetit dhe ndalimit të diskriminimit.

Në vendimin *Metock*<sup>11</sup> (Vendimi 25 korrik 2008, *Metock*, çështja C-127-08, GJED) në 25 korrik 2008, Gjykata shikon në dispozitat e Qeverisë irlandeze një mos respektim të direktivës 2004/38/KE-së, e cila duke vendosur mënyrat e hyrjes, lëvizjes dhe qëndrimit për të afërmit e shtetasit të Bashkimit, i garanton qytetarëve të Bashkimit Europian të drejtën për të qëndruar në një Shtet anëtar. Në këto rrethana, vendosja e një kufizimi, familjarëve jo-komunitarëve të shtetasve, për të qëndruar në mënyrë të rregullt në një nga shtetet anëtare, siç deklarohet nga Qeveria irlandeze, përbente për Gjykatën një shkelje të direktivës.

Për këtë arsye Gjykata vendosi që “e drejta e një shtetasi jo-komunitar, bashkëshort i një shtetasi të BE-së, të shoqërojë apo të shkojë tek ai shtetas nuk mund të jetë i kushtëzuar nga një rezidence ligjore e mëparshme në një Shtet anëtar” dhe ka nënvizuar “që bashkëshorti jo – komunitar mund të përfitojë kushte të qëndrimit e të lëvizjes pavarësisht nga kur apo ku është lidhur martesë ose se si ka hyrë në Shtetin pritës”. Kështu “shtetasit e shteteve të treta”, familjarë të një shtetasi të Bashkimit, marrin nga direktiva 2004/38 të drejtën për të shkuar tek ky shtetas i Bashkimit në Shtetin anëtar pritës, pavarësisht nëse ky është vendosur aty para apo pas krijimit të familjes”.

Gjykata parashikon që asgjë nuk ndalon Shtetin të aplikojë ndaj një shtetasi të parregullt një dënim – si një gjobë proporcionale – pa ndërmarrë dëbimin.

Në të njëjtin vendim Gjykata vendosi dhe që direktiva 2004/38 të jetë e aplikuar ndaj çdo shtetasi të një shteti të tretë, familjari të një shteti të Bashkimit, i cili shoqëron apo arrin shtetasin e Bashkimit në një nga Shtet anëtare të ndryshëm nga ai që ka shtetësinë, dhe i jep të drejtën e hyrjes e të qëndrimit në këtë Shtet anëtar, pa bërë dallime nëse ky shtetas i një shteti të tretë ka qëndruar rregullisht në një Shtet tjetër anëtar.

<sup>11</sup> Vendimi i 25 korrik 2008, *Metock*, çështja C-127/08, Katër qytetar afrikanë kanë paraqitur apel pranë Gjykatës të Drejtësisë mbasi i është mohuar e drejta e qëndrimit edhe pse ishin martuar me shtetas europianë që qëndronin në Irlandë. Për Qeverinë irlandeze martesë me një qytetar të BE-së të një shtetasi jo të rregullt në territorin e 27 Shteteve anëtare, nuk i lejon rregullimin e qëndrimit të tij. Ai duhet të ketë të paktën një rezidence të rregullt në një Shtet anëtar.



Në çështjen *Foster*<sup>12</sup> (Vendimi 18 nëntor 2008, *Förster*, çështja C-158/07, GJED) më 18 nëntor 2008, Gjykata e Drejtësisë vendosi deri në ç'pikë mund të kushtëzohet e drejta e ndihmës për studime e parashikuar nga një normativë kombëtare, për studentët shtetas të një Shteti anëtar tjetër, që trajtimi i diferencuar të mos konsiderohet diskriminues.

Gjykata kujton që është e ligjshme për një Shtet anëtar të japi një ndihmë e një shumë të shpenzimeve për jetesë vetëm atyre studentëve të cilët kanë dhënë prova për një shkallë të caktuar të integritimit në shoqërinë e një Shteti. Ekzistenca e një shkalle integritimi mund të konsiderohet e provuar nëpërmjet vërtetimit se studenti ka jetuar për një periudhë të caktuar në Shtetin pritës.

Qëndrimi i pandërprerë për pesë vjet është në gjendje që të tregojë që ai i cili kërkon ndihmën është i integruar në Shtetin anëtar pritës. Kjo nuk mund të konsiderohet e tepërt.

Duke parathënë që normativa i mundëson të interesuarve njohjen e sigurt të të drejtave e detyrimeve të tyre, dhe që kushti i rezidencës për faktin e vetëm që ekziston është i tillë që të garantojë një nivel të sigurisë së ligjit dhe transparencë në fushën e dhënies së financimeve të studimeve të studentëve, Gjykata pohon që “e drejta komunitare nuk përjashton aplikimin ndaj shtetasve të Shteteve anëtare, me një situatë të mëparshme qëndrimi prej pesë vitesh”. Ajo që ka rëndësi sipas Gjykatës është fakti që studenti, i cili qëndron ligjërisht në një Shtet anëtar, mund të përfitojë nga ndalimi i çdo diskriminimi nga kombësia për marrjen e një burse studimi.

Në lidhje me martesën, kohët e fundit shtrohet dhe problemi i martesave të personave të të njëjtit seks. Këto martesa njihen më së shumti në disa shtete të BE-së, si në Holandë, Spanjë, Portugali dhe Belgjikë<sup>13</sup>. Ç'ndodh me këto çifte të cilat duan të transferohen për arsye punësimi në një Shtet tjetër Anëtar i BE-së? Rastet me të cilat mund të përballen çifte të tilla, në linja të përgjithshme, janë dy. Nëse bashkeshortët transferohen në një shtet i cili i njeh martesat ndërmjet

<sup>12</sup> Vendimi i 18 nëntor 2008, *Foster*, çështja C.158/07, mbi mosmarrëveshjen midis zonjës Forter, shtetase gjermane dhe Hoofddirectie Informatie Beheer Groep, mbi anulimin e pjesës së një burse studimi që ajo kishte përfituar nga një ligj i 2000 mbi financimin e studimeve në Holandë.

<sup>13</sup> CALVO CARAVACA A.- CARRASCOSA GONZÁLES J., *I matrimoni tra persone dello stesso sesso*, në *La famiglia senzafrontiere*. Atti del Convegno tenuto presso la Facoltà di Giurisprudenza dell'Università degli studi di Milano il 25.05.2007, a cura di S.Bariatti – A.Galizia Danovi, fq. 81; N.Boschiero, *Lesunions homosexuelles à l'épreuve du droit international privé italien*, në *Rivista di diritto internazionale*, n. 1/2007, fq. 50; M.CARRILLO, *La legge spagnola sul matrimonio tra omosessuali ed i principi costituzionali*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 264; DE SCHUTTER O., *Homophobia and Discrimination on Grounds of Sexual Orientation*, (a cura di) European Union Agency for Fundamental Rights, 2008, fq. 67; R.ROMBOLI, *La legge spagnola sul matrimonio tra persone dello stesso sesso e la tutela delle coppie omosessuali in Italia. Note introduttive*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 256; N.PIGNATELLI, *Nozione di matrimonio e disciplina delle coppie omosessuali in Europa*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 260; E.E.GÓMEZ, *La legge spagnola sul matrimonio tra omosessuali e la Costituzione spagnola*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 267; E.LAUROBA, *La legge spagnola sul matrimonio tra omosessuali ed i principi del diritto civile spagnolo*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 272.

homoseksualëve (p.sh. një çift spanjoll që transferohet në Belgjikë) rregullimi ligjor i tyre do të jetë i njëjtë dhe do të vazhdojnë të konsiderohen të tillë edhe nga legjislacioni komunitar, në kuadër të bashkimit familjar. Nëse bashkeshortët transferohen në një vend i cili nuk parashikon në legjislacionin e tij martesat e tilla, atëherë bashkeshortët nuk mund të quhen me “bashkeshortë” dhe situatën e tyre mund ta rregullojnë, nëse është e mundur, vetëm nëpërmjet legjislacionit që rregullon bashkëjetesën në të gjitha format e saj<sup>14</sup>.

#### 4. Konkluzione

Në Bashkimin Europian, subjektet që përfitojnë nga lëvizja e lirë ndahen në dy kategori: shtetasit komunitarë dhe shtetasit jo komunitarë. Shtetasit e Bashkimit Europian janë të gjithë personat, që kanë shtetësinë e një shteti anëtar të Bashkimit Europian. Personat që kanë dy shtetësi janë qytetarë të Bashkimit, nëse posedojnë shtetësinë, e të paktën një shteti të Bashkimit Europian. Në këtë këndvështrim, të gjithë shtetasit evropianë përfitojnë potencialisht nga kjo e drejtë. Shtetasit komunitarë i nënshtrohen rregullave të Bashkimit Europian vetëm në momentin që ata e ushtrojnë efektivisht këtë të drejtë. Për shembull, nëse një rregullore në Bashkimin Europian lidhur me lëvizjen e lirë i jep qytetarit të një shteti disa të drejta, me shumë se ato që u jep shteti shtetasve të vet, këta shtetas nuk mund t'i ushtrojnë këto të drejta nëse nuk dalin asnjëherë nga vendi i vet, pra nëse efektivisht nuk e ushtrojnë këtë të drejtë.

Më konkretisht, personat të cilët përfitojnë nga kjo e drejtë janë: të punësuarit – personat e punësuar dhe të varur nga drejtimi i një punëdhënësi “punëtorë me kontratë pune”; të vetëpunësuarit – personat të cilët ushtrojnë një punë (sipërmarrje) të lirë dhe të drejtën e qëndrimit; ofruesit e shërbimeve që ofrojnë një aktivitet ekonomik jo të rastësishëm në një Shtet anëtar të ndryshëm nga ai ku është qëndrimi; pensionistët; personat e punësuar, por që janë me *handicap* për shkak aksidenti në punë, familjarët e individëve të sapo përmendur dhe në mënyrë potenciale, të gjithë shtetasit që janë shtetas të një shteti anëtar, në Bashkimin Europian. Nga ana tjetër, shtetasit jo komunitarë që përfitojnë nga lëvizja e lirë janë të gjithë shtetasit, shtetas të një shteti, i cili nuk është anëtar i BE-së, që përfitojnë nga regjimi i lëvizjes së lirë nëpërmjet rregullave Shengen. Gjykata i ka zgjeruar keto kategori me interpretimet e saj nder vite, sidomos që nga viti 2008. Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka dhënë kontributin e saj për të bërë me të qartë dhe të sigurt përmbajtjen e direktivës 2004/38/KE-së mbi lëvizjen e lirë të personave.

<sup>14</sup> Këto martesa hyjnë në kategorinë e martesave që “nuk e kalojnë dot kufirin”, pra nuk janë të vlefshme në një shtet tjetër por vetëm në atë shtet në të cilin janë celebruar, ose në atë shtet ku e parashikojnë në të njëjtën mënyrë. CALVO CARAVACA A.- CARRASCOSA GONZÁLES J., *I matrimoni tra persone dello stesso sesso*, vep. e cit., fq. 85.

Gjykata në radhë të parë ka treguar se cilët janë parimet e përgjithshme të legjislacionit komunitar të cilat duhet të respektohen me patjetër nga ana e Shteteve anëtare, dhe ka theksuar pamundësinë e Shteteve për të kufizuar liritë themelore të Traktatit, sepse përjashtimet nga normat e Traktatit mund të interpretohen në mënyre të ngushtë dhe të marra nën dritën e parimit të proporcionalitetit. Nga kjo del një sovranitet shtetëror i kufizuar, që nuk mund të konsiderohet absolut, e cila mund të shmangë kontrollin e institucioneve komunitare.

Shumë rendësi merr rasti i masave që kufizojnë lirinë e lëvizjes në brendësi të Shtetit anëtar, të cilat mund të merren ndaj një shtetasi të huaj vetëm nëse mund t'i aplikohen dhe shtetasve kombëtar; ky parim parashikohet nga neni 22 i direktivës dhe që e ka rikthësuar disa herë Gjykata.

Në veçanti Gjykata, në vendimin e 7 qeshorit 2007, Komisioni kundër Vendeve të Ulta, që kishte si objekt një masë të një shkeljeje deklaroi Holandën si mos përmbushëse të detyrimeve komunitare sepse normativa në fuqi e këtij Shteti bënte të mundur “një lidhje sistematike dhe të drejtpërdrejte midis një dënimi penal dhe një mase dëbimi”<sup>15</sup>

## Bibliografia

- ADOBATI E., (1995) *La libera circolazione delle persone*, Elementi di diritto comunitario, U.Draetta, Milano.
- ADOBATI E.- CIMOLINO G.P.- POLO M.- SANDRINI A., (1999) *La libera circolazione delle persone che esercitano un'attività economica*, Elementi di diritto dell'Unione Europea, U.Draetta e N.Parisi, Milano, p. 35.
- ALEXANDER ALENIKOFF T., – CHETAİL V., (2003) *Migration and International Legal Norms*, The Hague.
- ALGOSTINO A., (4/2003) *La condizione degli stranieri in Italia fra diritto universali e difesa della forza*, Diritto Pubblico comparato europeo, p. 622.
- AMBROSINI M., (2005) *Accoglienza degli immigrati e terzo settore*, Decimo Rapporto sulle migrazioni 2004, Milano.
- APAPJ., (2006) *Justice and Home Affaire in the EU*, Liberty and security issues after enlargement, Bruxelles.
- AVETA R., (2007) *Famiglie migranti e rischi di degradazione del legame parentale nella disciplina comunitaria sul ricongiungimento*, Diritti dell'uomo, p. 21.
- BALLARINO T., (2004) *Manuale breve di diritto dell'Unione europea*, Padova.
- BARATTA R., (2004) *La Convenzione sui diritti dei migranti e la normativa italiana sull'immigrazione*, Studi emigrazione, n. 153.

<sup>15</sup> Vendimi i 7 qeshor 2007, Komisioni k. Holandës çështja C-50/06, në këtë rast Gjykata dënoi Mbretërinë e Holandës për mos aplikimin shtetasve të Bashkimit evropian direktiven 64/221/KE-se, sot e zvendësuar nga direktiva 2004/28/KE-se, për koordinimin e masave speciale për transferimin dhe qëndrimin e të huajve, të justifikuar nga arsye të rendit publik, sigurisë publike dhe të shëndetit publik, dhe të një normative të përgjithshme mbi të huajt që mundeson “një lidhje sistematike dhe të drejtpërdrejte midis një dënimi penal dhe një mase dëbimi”.

- BARATTA R., (2003) *La Convenzione delle Nazioni Unite sulla protezione dei lavoratori migranti: quali ostacoli all'adesione dei paesi di ricezione dei flussi migratori?* Rivista di diritto internazionale.
- BORGMANN Y. – PREBIL., (2008) *The rule of reason in European Citizenship*, European Law Journal, fq. 328.
- BRINKMANN G., (2002) *Family reunification of third-country nationals: access of family members to social protection benefits*, European Journal of migration and law.
- BROUWER E., (3/2005) *Effective Remedies in EU Immigration and Asylum Law: Justice Accessible to All?*, European Journal of Migration and Law, fq. 223.
- CANAJ E., (2014) *Lëvizja e lirë e personave në Bashkimin Evropian*, UETPRESS.
- CHALMAS D.- HADJIEMMANUIL C.- MONTI G.- TOMKINS A., (2006) *European Union Law*, Cambridge.
- CHALMERS D.- SZYSZCZAK E., (1998) *European Union Law. Volume two: Towards a European Polity*, Great Britain.
- CHOLEWINSKI R., (1997) *Migrant workers in International Human Rights*, Oxford.
- CHOLEWINSKI R. - PERUCHOUD R.- MACDONALD E., (2007) *International migration law. Developing paradigms and key challenges*, The Hague.
- DI PASCALE A., (2002) *The new regulations on immigration and the status of foreigners in Italy*, European Journal of Migration and Law.
- D'ORIANO F., (2003) *Ingresso e soggiorno nell'Unione europea del coniuge non comunitario del lavoratore migrante*, Diritto pubblico comparato ed europeo.
- DOUGAN M., (2006) *The constitutional dimension to the case law on Union citizenship*, European Law Review.
- DURANTE F. - GENNARELLI M.F., (1998) *I diritti dell'uomo in Italia. L'applicazione della Dichiarazione universale nell'ordinamento italiano*, Milano.
- GIUBBONI S., (3/2007) *Free movement of Persons and European Solidarity*, European Law Journal, fq. 360.
- GIUZZI V., (2000) *Manuale di diritto e politica dell'Unione Europea*, 2° ed., Editoriale, Scientifica.
- GUILD E.- NIESSEN J., (1996) *The developing immigration and asylum policies of the European Union*, Kluwer Law International.
- GUILD E., (2004) *The legal elements of European Identity – EU citizenship and Migration Law*, Kluwer Law International.
- GUILD E., (4/2004) *The variable subject of the EU Constitution, Civil Liberties and human rights*, European Journal of Migration and Law.
- GUILD E.- HARLOW C., (2001), *Implementing Amsterdam. Immigration and Asylum Rights in EC law*, Oxford.
- GUILD E., (2005) *What is a Neighbour? Examining the EU Neighbourhood Policy from the Perspective of Movement of Persons*, Paper.
- GROENENDIJK K.- FERNHOUT R.- VAN DAM D.- VAN OERS R.- Strik T., (2007) *The family Reunification Directive in EU Member States*, Nijmegen.
- GROENENDIJK K.- GUILD E.- BARZILAY R., (2000) *The Legal Status of Third Country Nationals who are Long-Term Residents in a Member State of the European Union*, Nijmegen.
- GROENENDIJK K., (2/2006) *Family reunification as a right under Community law*, European Journal of Migration and Law.
- GROENENDIJK K., (2/2004) *Legal concepts of integration in EU migration law*, European Journal of Migration and Law.

- GROUSSOT X., "Principled citizenship" and the process of european constitutionalization-From a pie in the sky to a sky with diamonds, U.Bernitz-Nergelius J.-Cardner, *General Principles of EC Law in a Process of Development*, cit., fq. 315
- HAILBRONNER K., (2000) *Immigration and Asylum Law and Policy of the European Union*, LAia.
- HAILBRONNER K., (1998) *European immigration and asylum law under the Amsterdam Treaty*, Common Market Law Review, fq. 1047.
- HANLON J., (2000) *European Community Law*, 2° ed., London.
- HANNUM H., (1987) *The right to leave and return in international law practice*, Martinus Nijhoff Publishers.
- HARTLEY T., (1976), *Public policy and internal free movement: a critical comment on Rutili Decision*, European Law Review, fq. 242.
- NASCIMBENE B., (2004), *Diritto degli stranieri*, Padova.
- NASCIMBENE B. (2002) *La libera circolazione dei lavoratori*, Milano.
- NASCIMBENE B., (1998) *Da Schengen a Maastricht. Apertura delle frontiere, cooperazione giudiziaria e di polizia*, Milano.
- NASCIMBENE B., E.M. MAFROLLA, (2002), *Recenti sviluppi della politica comunitaria in materia di immigrazione e asilo in Diritto, immigrazione e cittadinanza*, fq. 13.
- NASCIMBENE B., *La convenzione, la condizione dello straniero e la giurisprudenza*, in
- NASCIMBENE B. (2002) *La Convenzione europea dei diritti dell'uomo. Profili ed effetti nell'ordinamento italiano*, Milano .
- NASCIMBENE B., (2/2008) *L'approccio globale nella gestione dell'immigrazione: la politica della UE alla luce dell'attuazione del Programma dell'Aja*, Il Diritto dell'Unione europea
- NASCIMBENE B., (1993) *Le norme sul diritto d'asilo. Il caso italiano*, Diritti dell'uomo
- NASCIMBENE B., (1997) *La condizione giuridica dello straniero- Diritto vigente e prospettive di riforma*, Cedam.
- NASCIMBENE B., (1997) *Il matrimonio del cittadino italiano all'estero e dello straniero in Italia alla luce della riforma del sistema di diritto internazionale privato*, Collisio Legum-Studi di diritto internazionale per Gerardo Brogini, Milano.
- VILLANI U., (1997) *La politica dell'Unione europea in materia di immigrazione*, Il fenomeno dell'immigrazione clandestina: aspetti penali e di prevenzione criminale. Atti del Convegno di Studi di Diritto Penale, Bari,
- VILLANI V., (1998) *La cittadinanza dell'Unione europea*, Studi in ricordo di A.F.Panzerà, vol. II, Diritto internazionale, Bari
- VILLANI U., (2008) *Istituzioni di diritto dell'Unione europea*, Bari.
- ZANELLI A.- ROMEO G., (2002) *Profili di diritto dell'Unione europea. Storia, istituzioni, aspetti giuridici dell'integrazione europea*, Milano.
- ZANETTI L., *I cambiamenti nella legislazione sui ricongiungimenti in alcuni paesi europei*, Ricongiungere la famiglia altrove Torino.
- ZANFRINI L., (2007) *Cittadinanze. Appartenenza e diritti nella società dell'immigrazione*, Bari.
- ZANGHÌ C., (2005) *Istituzioni di diritto dell'Unione Europea* Torino.

## Risitë e Rregullores nr. 1215/2012 "Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare"

**Dok. Andja Levanaku**

### Abstrakt

Rregullorja 1215/2012 "Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare" ka hyrë në fuqi në 10 janar 2015 në Bashkimin Europian. Kjo rregullore konsiderohet si një nga aktet më të rëndësishme dhe më me ndikim në të drejtën ndërkombëtare private, për shkak të fushës së gjerë të veprimit, në përcaktimin e çështjeve të rëndësishme: juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare. Çështjet e juridiksionit dhe ekzekutimit të vendimeve në Bashkimin Europian janë rregulluar nga Konventa e Brukselit e miratuar në vitin 1968, fillimisht nga njëmbëdhjetë shtetet e para të Komunitet Europian, e me pas u miratua dhe nga shtetet e tjera që u bënë pjesë e Bashkimit Europian. Kjo konsiderohet si faza e parë në të cilën shtetet anëtare rregullonin marrëdhëniet juridike në këtë fushë. Konventa e Brukselit përfaqëson aktin e parë juridik që rregulloi marrëdhëniet mbi çështjet e juridiksionit. Qëllimi primar ishte parashikimi i rregullave dhe parimeve të përgjithshme që përcaktonin juridiksionin dhe njohjen e vendimeve të gjykatave në shtetet anëtare. Më pas, Bashkimi Europian miratoi në vitin 1988 Konventën e Luganos, "Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare", e cila kishte të njëjtin qëllim si Konventa e Brukselit, e u shfuqizua nga rregullorja e Brukselit nr.44/2001, "Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare. Rregullorja 1bis e Brukselit solli një sërë ndryshimesh ligjore në përcaktimin e juridiksionit, çështjes së gjyqëvarësisë, duke e zgjeruar rrethin e subjekteve që mund të jenë paditës dhe të padiur përpara gjykatave europiane, si dhe ndryshimi më i rëndësishëm, heqja e procedurës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, e njohur

si procedura “*exequatur*”, duke sjellë ndryshime për procedurën e njohjes së vendimeve gjyqësore të shteteve anëtare në shtetet e tjera. Njohja e kësaj rregulloreje merr një rëndësi të veçantë duke marrë parasysh që Shqipëria ka marrë statusin e vendit kandidat në B.E dhe është në pritje të hapjes së negociatave. Pavarësisht se Rregullorja e Brukselit ende nuk ka fuqi detyruese për Shqipërinë, studimi dhe njohja e saj na shërben si studiues të së drejtës për përafrimin e legjislacionit shqiptar me aktet ndërkombëtare, duke synuar krijimin e një kornize ligjore sa më bashkëkohore dhe të përshtatur me ekonominë dhe lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, sigurimit të investimeve të huaja, në mënyrë të tillë që ti paraprijë integritetit të Shqipërisë në B.E.

**Fjalë kyçe:** rregullore, juridiksion, procedura “*exequatur*”, njohja e vendimeve,

## I. Hyrje

Juridiksioni, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve ndërmjet gjykatave të shteteve anëtare ka filluar të rregullohet që në vitin 1968 në Europë. Vlejnë të përmenden si aktet më themelore: Konventa e Brukselit, Konventa e Luganos, Rregullorja e Këshillit Europian e vitit 44\2001 dhe së fundmi rregullorja nr. 1215/2012 “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”, e cila hyri në fuqi në 10 Janar 2015, duke shfuqizuar të gjithë bazën ligjore të mëparshme, duke riformatuar kështu koncepte themelore dhe sjellë ndryshime përsa i përket çështjes së juridiksionit dhe njohjes së vendimeve në fushën civile dhe tregtare. Rregullorja e Brukselit njihet si “*Konventa 1bis e Brukselit*”<sup>1</sup> dhe është rregullorja më e rëndësishme që rregullon marrëdhëniet në këtë fushë. Rregullorja ka si bazë ligjore Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian, dhe veçanërisht nenin 67(4), pika (a), (c), dhe (e), nenin 81 (2), u propozua nga Komisioni Europian, pas miratimit të draftit legjislativ në parlament, duke marrë parasysh opinionin e Komitetit Europian Ekonomik e Social, në përputhje me procedurën e zakonshme legjislative të miratimit të akteve. Pas raportit të 21 Prill 2009 të Komisionit Europian mbi aplikimin e rregullores nr.44/2001, të 22 Dhjetorit 2000, “Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare”, u konkludua se duheshin një sërë amendimesh mbi rregulloren 44\2001, me qëllim qartësinë e normave të saj për të përmirësuar qarkullimin e lirë të gjykimeve në çështjet civile dhe tregtare.<sup>2</sup> Rol kryesor në hartimin e rregullores 1215/2012 luajti programi me titull “Programi i Stokholmit”, i cili u krijua në mbledhjen e Brukselit më datë 10 dhe 11 Dhjetor 2009. Ky program vë theksin te

<sup>1</sup> Rregullorja nr.1215/2012 “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare” ose “Konventa I bis Brukselit”.

<sup>2</sup> Raporti I Komisionit Europian I dt.29.04.2009 mbi aplikimin e rregullores 44/2001 për Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare.

një Europë e hapur dhe e sigurtë. Në programin e Stokholmit Këshilli Europian konsideron që heqja e procedurës së njohjes së vendimeve të gjykatave të huaja duhet të shoqërohet nga një sërë masash mbrojtëse.

## II. Debati bashkëkohorë në çështjet e juridiksionit

Bashkimi Europian me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e fushës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, për lehtësimin e aksesit në drejtësi, veçanërisht përmes parimit të njohjes reciproke të vendimeve në çështjet civile, për vendosjen graduale të kësaj zone, miratoi Rregulloren 1bis të Brukselit, për adoptimin e masave që lidhen me bashkëpunimin gjyqësor në çështjet civile, në bashkëpunim me shtetet ndërkufitare, sidomos me qëllimin funksionimin sa më të mirë të tregut të përbashkët europian. Në mënyrë që të arrihen objektivat e qarkullimit të lirë të gjykimeve në fushën civile dhe tregtare u krijuan rregulla që normohen nga një instrument ligjor i Bashkimit Europian, i cili është i detyrueshëm dhe i aplikueshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë. Diferencat mes rregullave të brendshme që rregullojnë juridiksionin dhe njohjen e vendimeve u panë si faktorë që dëmtojnë veprimin e tregut të brendshëm. Gjithashtu, u pa e nevojshme parashikimi i normave që unifikojnë rregullat e konflikteve juridiksionale në çështjet civile dhe tregtare, dhe që sigurojnë njohjen dhe zbatimin e vendimeve në mënyrë të shpejtë të vendimeve që jepen në vendet anëtare. Këto parashikime përfshinë fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile në kuptim të nenit 81 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, e cila shërbeu si bazë ligjore në miratimin e Rregullores 1bis të Brukselit nr.1215\2012. Rregullorja 1bis e Brukselit bën pjesë në aktet e detyrueshme të Bashkimit Europian, është e detyrueshme në të gjitha elementët e saj dhe zbatohet drejtpërdrejtë në të gjitha vendet e B.E. Ka rolin e ligjit në të drejtën shtetërore, pra është akt i përtshëm juridik. Normat e saj kanë për qëllim disiplinimin e të gjithë lëndës dhe duhet zbatuar në tërësi nga destinatarët e saj, në fushën e zbatimit. Asnjë prej vendeve anëtare nuk mund të zbatoj në mënyrë selektive Rregulloren e Brukselit, ashtu si asnjë rregullore tjetër. Shtetet anëtare janë të detyruara ta zbatojnë në tërësi dhe jo në mënyrë selektive me qëllim paralizimin e atyre pjesëve të rregullores që konsiderohet si në kundërshtim me aktet kombëtare. Çdo marrëveshje apo akt ligjor në kundërshtim me këtë është i pavlefshëm. Rregullorja mund të plotësohen me masa ekzekutimi, që mund të nxirren si nga vet institucioni që e ka nxjerr rregulloren pra nga Këshilli Europian, ashtu dhe nga një institucion tjetër komunitar p.sh Komisioni, ashtu edhe nga autoritetet kombëtare. Rregullorja e Brukselit ka zbatueshmëri të drejtpërdrejtë në vendet anëtare, që do të thotë që kjo rregullore prodhon efekte juridike në shtetet anëtare pa qënë nevoja që vendi që i drejtohet apo shteti anëtarë të nxjerr një akt

pranimi ose përshtatje me rendin e tij, prandaj dhe normat e Rregullores janë të vet zbatueshme. Veçoria e zbatueshmërisë së drejtpërdrejtë të rregullores së Brukselit sjell një sërë detyrimesh që vendet anëtare duhet t'i ndjekin në mënyrë të përpiktë dhe me hyrjen në fuqi të rregullores pas botimit në fletoren zyrtare të Bashkimit Europian, çdo akt apo masë legislative edhe e mëparshme që nuk përputhet me rregulloren nuk mund të zbatohen. Një tjetër karakteristikë e rregullores është që ka fuqi veprimi të përgjithshme, nuk u drejtohet subjekteve të paracaktuara dhe as të indentifikueshme, por u drejtohet kategorive të konsideruara në mënyrë abstrakte, të përgjithshme në tërësinë e tyre. Në mënyrë të përmbledhur karakteristikat e Rregullores së Brukselit janë: fuqia e përgjithshme e veprimit; karakteri detyrues; zbatueshmëria e drejtpërdrejtë e saj. Fuqia e përgjithshme nënkupton që i drejtohet një numëri të papërcaktuar subjektësh dhe është abstrakte, qëndron mbi faktin konkret dhe mund të zbatohet për cdo rast që hyn në parashikimin e vet. Rregullorja e Brukselit ka karakter detyrues në të gjitha elementët e saj dhe ka zbatim të drejtpërdrejtë në të gjitha shtetet anëtare, në mënyrë automatike, pa qënë nevoja ndërhyrja normative e pushtetit të shteteve përmes akteve ligjore. Rregullorja jep të drejta dhe imponon detyrime për shtetet anëtare, për organet e tyre dhe për të gjitha subjektet që veprojnë në shtetet anëtare, subjekte fizike apo juridike publike e private. Rregullorja e re e Brukselit u prit mjaft mirë nga operatorët e ndryshëm të drejtësisë dhe biznesit, duke parë lehtësimin që i jep qarkullimit të vendimeve gjyqësore, aksesit në gjykim, dhe si rrjedhojë shërben për lehtësimin e qarkullimit të mallarave dhe shërbimeve në B.E dhe jashtë.<sup>3</sup>

Në lidhje me miratimin e Konventës 1bis të Brukselit, Vëra Jourová Komisionerja e Bashkimit Europian për Drejtësi, Tregëti dhe Barazi Gjinore, deklaroi: është një lajmë i mirë për qytetarët e B.E dhe Ndërmarrjet e Vogla dhe të mesme miratimi i kësaj rregulloreje. Këto rregulla të reja kursejnë një shumë prej 2000 deri 12000 Euro për çështje individuale. Është një ogur i mirë për tregun e përbashkët Europian. Ky veprim do të sjellë një ndryshim rrënjësor sidomos në ndërmarrjen e vogla dhe të mesme dhe do të sjellë më shumë mundësi për biznesin në Europë.<sup>4</sup>

Rregullorja e Brukselit e ndryshuar prezanton përmirësime të ndryshme në këtë instrument të rëndësishëm të B.E. Veçanërisht, ndryshimet për gjyqëvarësinë do të kenë impakt në sjelljen e palëve në çështjet tregtare<sup>5</sup> Risia që sjell Konventa 1bis e Brukselit për sa i përket juridiksionit të përgjithshëm ka të bëjë me aplikimin e saj dhe ndaj personave që nuk janë rezidentë në Bashkimin Europian. Rregullorja 1215/2012 ka si qëllim lehtësimin e qarkullimit të lirë të vendimeve gjyqësore në Bashkimin Europian dhe aksesin në gjykim, si pjesë e rëndësishme e procesit

të rregullt ligjor, si garanci për mbrojtjen e të dretjave dhe interesave legjitim të subjekteve të interesuar. Kjo rregullore zgjeroi qëllimin e juridiksionit dhe u bë e aplikueshme për të paditurit që nuk janë rezident në një nga vendet anëtare. Kështu, duke filluar nga Janari 2015 të gjitha marrëdhëniet që rregullon kjo rregullore do të shtrihen dhe ndaj personave që nuk janë rezidentë në B.E. ky është një ndryshim themelor që bën Konventa 1bis e Brukselit në ndryshim nga i gjithë kuadri ligjor që ka qënë në fuqi deri në vitin 2015. Ky ndryshim u bë për shkak të zhvillimeve dinamike që ka aktualisht Bashkimi Europian, për t'i shërbyer qarkullimit të lirë të vendimeve dhe për t'i dhënë mundësi palës së paditur, si palë që ka nevojë më tepër për mbrojtje reale, për tu dëgjuar e për të realizuar mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre, duke i shërbyer aksesit në drejtësi. Kështu, përveç heqjes së procedurës së njohjes së vendimeve gjyqësor, ka zgjeruar qëllimin e juridiksionit edhe mbi të paditurit që nuk janë rezidentë në vendet e B.E.

### III. Marrëveshja e juridiksionit

Rregullorja 1215/2015 përmirëson efektivitetin e marrëveshjes së zgjedhjes së gjykatës të njohur ndryshe si Marrëveshja e juridiksionit. Rregullat e parashikuara në të lehtësojnë qarkullimin e lire të vendimeve të gjykatës dhe përmirësojnë aksesin në drejtësi. Në këtë mënyrë lejon paditësin të identifikojë më lehtë gjykatën që do të zgjedhi për të paditur dhe për palën e paditur i jep mundësi të parashikojë ku mund të paditet.<sup>6</sup> Rregullorja 1215/2012 i jep përparësi gjykatës së zgjedhur nga palët me anë të marrëveshjes së juridiksionit në krahasim me gjykatën ku është paraqitur së pari çështja. Mekanizmi i Rregullores 44/2001 çoi në krijimin e një klauzole juridiksionale të papërcaktuar, ku palët vraponin për të dërguar çështjen e tyre në gjykatën e preferuar, në mënyrë që të kishin përfitime. Ky lloj abuzimi me procedurat njihet ndryshe si italian torpedo.<sup>7</sup> Rregullorja 1215/2015 wshtw strukturuar mbi të njohurit parime si rregullorja 44/2001. Kjo nuk do të thotë që nuk ka ndryshime, përkundrazi e kundërta do të ishte e pavërtetë. Madje këto ndryshime janë konsideruar evolucion në aspektin e juridiksionit. (Dickinson.A, Lein.E,2015:18)

### IV. Heqja e procedurës së ekzekutimit të vendimeve, si risi e Rregullores 1 bis të Brukselit.

Risia më e rëndësishme që ka sjellë Rregullorja 1215/2012 në qarkullimin e lirë të vendimeve është heqja e procedurës "exequatur", "ekzekutimi i vendimit".

<sup>3</sup> Jurisdiction in civil and commercial matters under the Regulation 1215/2012 between common ground of jurisdiction and divergent national rules. Lukasz Dyrda, University of Krakow, Poland.

<sup>4</sup> [https://Europe.eu/rapid-release\\_IP15-3080-en.htm](https://Europe.eu/rapid-release_IP15-3080-en.htm)

<sup>5</sup> [http://www.allenoverly.com/publications/en-gb/Pages/BRUSSELS-REGULATION-\(RECAST\)-ARE-YOU-READY.aspx](http://www.allenoverly.com/publications/en-gb/Pages/BRUSSELS-REGULATION-(RECAST)-ARE-YOU-READY.aspx)

<sup>6</sup> Case C-125/92 [1993] ECR I-4075, Muloxvs.Geels

<sup>7</sup> <http://www.lexology.com/library/detail,Gomez-Acebo & Pombo Abogados - Miguel Troncoso Ferrer>

Procedura exequatur, është një procedurë për deklarimin e ekzekutimit të vendimeve të dhëna nga një shtet anëtar, në shtetet e tjera anëtare. Sipas Rregullores Bruksel 1, duhet një deklaratë ekzekutimi për një vendim të dhënë nga një gjykatë e shtetit anëtar në mënyrë që ky vendim të zbatohet në një tjetër shtet anëtar. Rregullorja 44/2001 kërkonte që një vendim gjykate e dhënë nga një shtet anëtar i B.E të ishte i ekzekutueshëm në shtetet e tjera anëtare duhet të plotesohej një deklaratë ekzekutueshmërie, e cila kërkohej nga personi i interesuar në gjykatën e ekzekutimit, bazuar në nenin 38(1): “*një vendim gjykate i dhënë në një shtet anëtar dhe i ekzekutueshëm në atë shtet, do të jetë i ekzekutueshëm në një tjetër shtet anëtar, n.q.s me aplikimin e palës së interesuar, është bërë i ekzekutueshëm dhe atje*”. Komisioni Europian pasi vëzhgoi në praktikë zbatimin e rregullores 44/2001, konstatoi që kjo procedurë zgjaste procesin e ekzekutimit dhe kishte kosto të lartë për palët. Komisioni rekomandoi heqjen e kësaj procedure për lehtësimin e qarkullimit të lirë të vendimeve.<sup>8</sup> Sipas Komisionit Europian procedura e ekzekutimit zakonisht kushtonte nga 2.000 deri në 3.000 euro në varësi të shtetit anëtar ku bëhej aplikimi për të, ndërsa duke përfshirë dhe kostot e avokatit, përkthimin e dokumentit dhe shpenzimet gjyqësore kjo kosto varionte deri në 12.700 euro. Në pothuajse 95% të rasteve kjo procedurë ishte thjeshtë një formalitet.<sup>9</sup> Rregullorja 1215/2012 bën të mundur që një vendim i dhënë në një shtet anëtar, i cili është në fuqi dhe i ekzekutueshëm në atë shtet anëtar, të jetë i ekzekutueshëm në të gjitha shtetet anëtare, pa qënë nevoja për nxjerrjen e një deklaratë ekzekutueshmërie. Neni 39 i Rregullores 1215/2012 parashikon: “*një vendim i dhënë në një gjykatë të një shteti anëtar, i cili është i ekzekutueshëm në atë shtet, do të jetë i ekzekutueshëm dhe në shtetet e tjera anëtare pa qënë nevoja e nxjerrjes së ndonjë deklaratë ekzekutueshmërie*”.<sup>10</sup> Deklarata e ekzekutueshmërisë nuk është më e nevojshme. Kjo për faktin se një vendim gjykate i dhënë në një shtet anëtar dhe i zbatueshëm në atë shtet anëtar duhet të jetë i ekzekutueshëm dhe në shtetet e tjera anëtare pa tërhequr deklaratën e zbatueshmërisë. Kjo do të thotë që çdo vendim i dhënë nga një gjykatë e një shteti anëtar të Bashkimit Europian do të njihet dhe zbatohet automatikisht në çdo shtet anëtar. Vendimi i gjykatës do të trajtohet njësoj sikur të jetë dhënë nga gjykata e shtetit anëtar ku kërkohet të ekzekutohet. Nga 10 janari 2015, dita kur ka hyrë në fuqi Rregullorja 1 bis e Brukselit, në mënyrë që një vendim të bëhet i ekzekutueshëm në shtetet e tjera anëtare duhet që pala të cilës i drejtohet vendimi të paraqesi përpara gjykatës ku do të ekzekutohet vendimi, një kopje të vendimit dhe një certifikatë standarte të

<sup>8</sup> Raporti i Komisionit Europian i dt.29.04.2009 mbi aplikimin e rregullores 44/2001 për Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare.

<sup>9</sup> [http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-15-3080\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-3080_en.htm).

<sup>10</sup> Rregullorja e Këshillit Europian nr.1215/2012, mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare, neni 39

nxjerrë nga gjykata që ka dhënë vendimin, parashikuar në nenin 42 (1) dhe 53 të Rregullores. Kështu, pala që dëshiron të ekzekutohet vendimi në një tjetër shtet anëtar, duhet të pajisë autoritetin kompetent të ekzekutimit me një kopje të vendimit duke siguruar autenticitetin e tij, dhe një certifikatë e siguruar nga gjykata e origjinës, pra gjykata që ka dhënë vendimin. Modifikimet e Rregullores 1bis të Brukselit nuk preken mekanizmin e refuzimit të njohjes dhe zbatimit të vendimeve, të parashikuara në nenin 45 të saj, i cili korrespondon me nenin 34 dhe 35 Rregullores 1 të Brukselit. Refuzimi i njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve bëhet në raste të limituara dhe specifike. Arsytet ligjore për refuzimin e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në shtetet anëtare janë të njëjta si me rregulloren e parë. Refuzohet njohja e vendimit n.q.s vendimi është haptazi në kundërshtim me rendin publik të shtetit ku kërkohet të njihet apo ekzekutohet. Gjithashtu, do të refuzohet njohja e vendimit nëse vendimi është dhënë në mungesë të palës së paditur duke mos e njoftuar rregullisht, duke mos i vendosur në dispozicion dokumentat gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, duke bërë kështu që i padituri mos të ketë mundësi të realizojë mbrojtjen ligjore para gjykatës për çështjen në fjalë. Nëse vendimi është në kundërshtim me një vendim të mëparshëm mes të njëjtave palë, dhënë në shtetin anëtar ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi i tij, si dhe n.q.s vendimi është në kundërshtim me rregullat e juridiksionit të veçantë për çështjeve që kanë si palë të paditur të siguruarit, konsumatorët dhe punëmarrësit, bazuar në nenin 10-16, neni 17-19, neni 22-23 si dhe bazuar në rregullat e juridiksionit ekskluziv të parashikuara në nenin 24. Sipas Komisionit Europian rregullorja e re që heq procedurën e mëparshme dhe të gjatë të ekzekutimit, e cila përdorej 10,000 herë në vit, për rrjedhojë çështjet ndër-kufitare do të zgjidhen më shpejt.<sup>11</sup> Në rastet kur vendoset refuzimi i njohjes dhe i ekzekutimit të vendimit, në asnjë lloj rrethane, gjyqtari nuk mund të riekzaminojë apo të modifikojë vendimin original të gjykatës. Kështu, edhe nëse ndodhemi përpara rrethanave të përmendura në nenin 45 të Rregullores, për refuzimin e njohjes apo ekzekutimit të vendimit, nuk është në diskrecionin e gjyqtarit që e vlerëson ekzistencën apo jo të rrethanës, të ndryshojë vendimin, të rihapë çështjen apo të bëjë modifike të ndryshme në vendimin original. Ky parashikim i Rregullores 1bis të Brukselit është në përputhje me rregulloren EC nr.805/2004, Për krijimin e një urdhëri europian për ekzekutimin e vendimeve të çështjeve të pakontestuar, që ka hyrë në fuqi në 21 Tetor 2005, e cila për herë të parë hoqi kërkesën për ekzekutim ndaj vendimeve të pakundërshtuara dhe që i është parashkruar afati i apelimit të vendimit. Për të tilla pretendime, duhet të paraqitet vetëm një certifikatë ekzekutimi, e njohur ndyshe si “Urdhëri Europian i Ekzekutimit”. Kjo certifikatë nxirret nga gjykata që ka dhënë vendimin.

<sup>11</sup> [http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-15-3080\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-3080_en.htm)

## V. Zgjerimi i rregullave të juridiksionit edhe për personat që nuk banojnë në vendet anëtare të Bashkimit Europian

I gjithë kuadri ligjor që ka rregulluar marrëdhëniet juridike në fushën civile dhe tregtare, duke filluar nga Konventa e parë e Brukselit, Konventa e Luganos, Rregullorja nr.44/2001 e Këshillit Europian mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare, aplikoheshin vetëm mbi shtetasit që kishin vendbanim ose vendqëndrim në shtetet e Bashkimit Europian. Fusha e zbatimit të rregullores ishte përcaktimi i Juridiksionit të shteteve anëtare të Bashkimit Europian, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve në fushën civile dhe tregtare. Përsa i përket juridiksionit, si rregull i përgjithshëm ai përcaktohej nga vendbanimi i personit në një shtet anëtarë, cilado qofte shtetësia e tij. Personat që nuk janë shtetas të shtetit anëtarë, por që banojnë në këtë shtet janë nën juridiksionin që zbatohet për shtetasit e këtij shteti. Këta shtetas mund të paditen në gjykatat e shteteve anëtare, përsa kohë kanë vendbanimin në një nga vendet anëtare dhe do të zbatohen të njëjtat rregulla të juridiksionit si për vendasit. Rregullorja nuk zbatohet për personat që nuk ishin resident në një nga shtetet e Bashkimit Europian. Nga analiza e neneve të Rregullores 44/2001 vihet re që ka si parim kryesor aplikimin e saj vetëm mbi shtetasit që kanë vendbanim ose vendqëndrim në një nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian, në ndryshim nga rregullorja e Brukselit nr. 1215/2012 e cila ka shtrirje më të gjerë, duke u aplikuar edhe mbi personat fizik apo juridik që nuk janë rezidentë në një nga vendet e B.E. Rregullorja 1 e Brukselit aplikohet vetëm në mosmarrëveshje ku pala e paditur ishte resident në B.E, pa qënë e rëndësishme vendbanimi i palës paditëse, bazuar nënenet 2, 3, 4 të Rregullores 1 të Brukselit. Ajo që është e dallueshme ishte ndryshimi në trajtimin përpara gjykatave europian të personave që janë rezidentë në një nga shtetet anëtare me të huajt. (Mandro.Walker,Kadia,2005:96) Në sesionin 6 neni 22 rregullorja parashikonte juridiksionin ekskluziv. Ky lloj juridiksioni bënte një rezervim, në kuptimin që ishte i detyrueshëm në nivel komunitar dhe kishte aplikim të drejtpërdrejtë. Në raste të tilla juridiksioni nuk mund të përzgjidhej me marrëveshje të palëve, sepse në të kundërt kjo klauzolë juridiksionale do të ishte absolutisht e pavlefshme. Ky ishte një juridiksion nga i cili nuk mund të hiqje dorë kollaj dhe nuk e merrte parasysh rregullin e përgjithshëm, atë të rezidencës së palës së paditur. Në çdo rast, nëse palët njëra ose më shumë janë rezidentë në një nga shtetet anëtare, bien dakort që një gjykatë do të ketë juridiksion, është pikërisht kjo gjykatë që do të gjykojë çështjen. Ky juridiksion në këtë rast është ekskluziv në rast se palët nuk kanë vendosur ndryshe. Risia që sjell Konventa 1bis e Brukselit, ka të bëjë me aplikimin e saj dhe ndaj personave që nuk janë rezidentë në Bashkimin Europian. Rregullorja

1215/2012 ka si qëllim lehtësimin e qarkullimit të lirë të vendimeve gjyqësore në Bashkimin Europian dhe aksesin në gjykim, si pjesë e rëndësishme e procesit të rregullt ligjor, si garanci për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitim të subjekteve të interesuar. Kjo rregullore zgjeroi qëllimin e juridiksionit dhe u bë e aplikueshme për të paditurit që nuk janë rezident në një nga vendet anëtare. Kështu, duke filluar nga Janari 2015 të gjitha marrëdhëniet që rregullon kjo rregullore do të shtrihen dhe ndaj personave që nuk janë rezidentë në B.E. Ky është një ndryshim themelor që bën Konventa 1bis e Brukselit në ndryshim nga i gjithë kuadri ligjor që ka qënë në fuqi deri në vitin 2015. Ky ndryshim u bë për shkak të zhvillimeve dinamike që ka aktualisht Bashkimi Europian, për t'i shërbyer qarkullimit të lirë të vendimeve dhe për t'i dhënë mundësi palës së paditur, si palë që ka nevojë më tepër për mbrojtje reale, për tu dëgjuar e për të realizuar mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre, duke i shërbyer aksesit në drejtësi. Kështu, përveç heqjes së procedurës së njohjes së vendimeve gjyqësor, ka zgjeruar juridiksionin edhe mbi të paditurit që nuk janë rezidentë në vendet e B.E. Rregullorja e re përcakton se rregullat e juridiksionit do të bazohen në vendbanimin e të paditurit, përveç në disa raste të caktuara në të cilat për shkak të subjektit ose autonomisë së palëve justifikon përdorimin e kriterëve të ndryshme. Kjo bëhet që të parandalojë që një person të marrë një kërkesë padi nga një gjykatë e një shteti anëtar që nuk ka mundur ta parashikojë. Siç e theksova dhe më lart, kjo rregullore shtrihet vetëm mbi shtetasit që ishin resident në B.E. në rast se marrëveshja lidhet nga palë që nuk ishin resident në B.E gjykatat e atij shteti anëtar nuk do të kishin juridiksion mbi mosmarrëveshjen e palëve. Çdo marrëveshje që lidhet në kundërshtim me nenet 13, 17 ose 21 të Rregullores Bruksel 1 ishte e pavlefshme. Në nenin 25 të Rregullores së Brukselit nr.44/2001 i njihet mundësia palëve që nëpërmjet një marrëveshje të përbashkët të zgjedhin njërin juridiksion të një shteti anëtar për mosmarrëveshjen e tyre, me kushtin sinequanon që palët të kishin vendbanimin në Bashkimin Europian. Tashmë me Rregulloren 1bis të Brukselit nr.1215/2012 është modifikuar ky nen dhe korrespondon me nenin 27 të saj i cili i jep mundësi për përzgjedhjen e juridiksionit me marrëveshje edhe palëve që nuk janë rezident në B.E. Neni 27 i rregullores 1bis të Brukselit, sipas të cilës i njihet mundësia palëve që nëpërmjet një marrëveshjeje të përbashkët, të zgjedhin njërin juridiksion të një shteti anëtar, që u duket më i përshtatshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre, që ka lindur ose që mund të lindi në të ardhme. Kushti që paditësi të kishte vendbanimin ose vendqëndrimin në një nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian është shfuqizuar, aktualisht nga Janari i vitit 2015 këtë marrëveshje ka të drejtë ta lidhi kushdo pavarësisht vendbanimit. Gjithashtu, rregullorja parashikoi rregulla specifike për disa kategori që tashmë gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga normat e saj. Këto kategori janë konsumatorët, punëmarrësit dhe të siguruarit. Bazuar në rregulloren 44/2001 konsumatorët shpesh nuk kishin mundësi të ushtronin të drejtat e tyre, në rastet kur blinin mallra nga kompani me seli në një shtet jo anëtar

i B.E, por që shisnin mallra në B.E. rregullat e reja të juridiksionit në lidhje me punëmarrësit, konsumatorët dhe të sigurarit do të aplikohen pavarësisht vendbanimit të punëdhënësit, kompanisë tregtare, apo kompanisë së sigurimeve. Përveç rregullit të përgjithshëm për përcaktimin e juridiksionit, rregullorja njih edhe përjashtime, të cilat i konsideron juridiksione të veçanta. (Brati,2008:73) Rregullat e juridiksionit të veçantë mbrojnë këto kategori të veçanta, respektivisht në nenet 10, 17, 18, 20, 21 të rregullores së re. kështu, një punëdhënësi i cili nuk ka vendbanimin në një shtet anëtar, mund të paditet në një gjykatë të B.E ku punëmarrësi kryen zakonisht punën e tij, ose në gjykatën e shtetit ku ka kryer së fundmi punën e tij, edhe pse punëdhënësi nuk ka seli në B.E, por në shtetet e treta.

## VI. Përfundime

Rregullorja nr. 1215/2012 e njohur ndryshe si Konventa 1bis e Brukselit solli një sërë ndryshimesh e risish në fushën civile dhe tregtare në Bashkimin Europian. Përmirësimi efektivitetin e marrëveshjes së zgjedhjes së gjykatës apo e quajtur ndryshe Marrëveshja e Juridiksionit, duke parashikuar që në rast konflikti mes marrëveshjes së juridiksionit për përzgjedhjen e gjykatës dhe gjykatës ku është filluar së pari çështja, të prevalojë marrëveshja e juridiksionit, duke i dhënë fund kështu, abuzimit me procedurat nga palët e interesuara. Heqja e procedurës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në shtetet anëtare, procedura exequator, ishte një tjetër risi e vlerësuar gjerësisht, që solli rregullorja. Kjo risi solli lehtësimin e qarkullimit të vendimeve gjyqësore mes shteteve të B.E. dhe shkurtimeve të shpenzimeve gjyqësore. Rregullorja zgjeroi rregullat e juridiksionit edhe për personat që nuk banojnë në vendet anëtare të Bashkimit Europian. Kjo rregullore zgjeroi qëllimin e juridiksionit dhe u bë e aplikueshme për të paditurit që nuk janë rezident në një nga vendet anëtare. Kështu, duke filluar nga Janari 2015 të gjitha marrëdhëniet që rregullon kjo rregullore do të shtrihen dhe ndaj personave që nuk janë rezidentë në B.E. Rregullorja parashikoi rregulla specifike për disa kategori që tashmë gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga normat e saj. Këto kategori janë konsumatorët, punëmarrësit dhe të siguruarit, të cilët tashmë kanë mundësi të padisin kompanitë edhe nëse këto të fundit nuk kanë seli në B.E.

## Bibliografia

- Konventa e Brukselit për juridiksionin dhe zbatimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare 1968.  
Konventa për juridiksionin dhe zbatimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare, 88/592/EEC, lidhur në Lugano, më 16 shtator 1988.

- Rregullorja nr.44/2001 e Këshillit Europian mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare  
Rregullorja nr.1215/2012 “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”  
Brati A.,Procedura Civile e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2008.  
Canaj E., Bana S., “E drejta e Bashkimit Evropian”, Inf-botues, Tiranë, Shqipëri, 2014.  
Dickinson.A, Lein.E, The Brussels 1 Regulation Recast, Oxford 2015.  
Mandro A, Walker G, Kalia A, “Private International Law”. Tirana 2005.  
Case C-125/92 [1993] ECR I-4075, Muloxvs.Geels  
Jurisdiction in civil and commercial matters under the Regulation 1215/2012 between common ground of jurisdiction and divergent national rules. Lukasz Dyrda,University of Krakow,Poland.  
Raporti i Komisionit Europian i dt.29.04.2009 mbi aplikimin e rregullores 44/2001 për Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare.  
www.hcch.net/ hudoc.echr.coe.int  
Opinion 1/03 of the European Court of Justice. [http://eur-lex.europa.eu/legal\\_content/EN/TXT/?uri=CELEX:32001R0](http://eur-lex.europa.eu/legal_content/EN/TXT/?uri=CELEX:32001R0)  
Raportit i Komisionit Europian mbi zbatimin e rregullores, parë në [http://eur-lex.europa.eu/legal\\_content](http://eur-lex.europa.eu/legal_content)  
<https://www.unidroit.org/english/principles/contracts/principles2004/blackletter.pdf>  
[https://Europe.eu/rapid-release\\_IP15-3080-en.htm](https://Europe.eu/rapid-release_IP15-3080-en.htm)  
[http://www.allenoverly.com/publications/en-gb/Pages/BRUSSELS-REGULATION-\(RECAST\)-ARE-YOU-READY.aspx](http://www.allenoverly.com/publications/en-gb/Pages/BRUSSELS-REGULATION-(RECAST)-ARE-YOU-READY.aspx)  
Case C-125/92 [1993] ECR I-4075, Muloxvs.Geels  
<http://www.lexology.com/library/detail,Gómez-Acebo & Pombo Abogados - Miguel Troncoso Ferrer>  
[http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-15-3080\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-3080_en.htm)



# *Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, e ardhmja e shoqërive tregtare \_\_\_\_\_*

\_\_\_\_\_ **Dokt. Ardvin Kraja** \_\_\_\_\_

## **Abstrakt**

*Legjislacioni shqiptar i të drejtës së biznesit parashikon në dispozitat e tij katër lloje organizimesh monetare në formën e shoqërive tregtare. Shoqëritë e parashikuara ndahen në shoqëri kapitali dhe shoqëri personash. Në realitetin e sotëm, shoqëritë që fitojnë terren në aplikimin e tyre janë ato të kapitalit. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar po dominojnë tregun nga viti në vit. Këto lloj organizimesh monetare po bëjnë të mundur hapjen e sektorëve të ndryshëm të biznesit pa ndonjë kosto shumë të madhe për personat që i disponojnë këto shoqëri. Me anë të lehtësirave ligjore shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar bëjnë të mundur që çdo individ pavarësisht kapitalit që disponon, të bëjë një hap përpara në biznesin e tij. Legjislacioni i të drejtës tregtare parashikon përparësi të kësaj shoqërie në raport me të tjerat.*

*Ligji shqiptar i shoqërive tregtare parashikon me hollësi krijimin e shoqërive të tilla si dhe mënyrën e funksionimit të tyre, duke krijuar një kuadër ligjor të plotë në kuadër të biznesit dhe të mirëfunksionimit të tregut. Me anë të vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe rregulloreve në funksion të rregullimit tregut të lirë është bërë e mundur që këto lloj shoqëri të jenë më të aksesueshme nga personat e interesuar në hapjen e bizneseve të reja, duke i ofruar një garanci dhe thjeshtësi më tepër në organizimin e administrimit të shoqërive respektive. Ekzistojnë shumë diferenca të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar në dallim nga kompanitë aksionere, diferenca këto që e bëjnë shpk-në më të aplikueshme në tregun modern.*

**Fjalë kyçe:** *shoqëri tregtare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, kapital, marrëveshje, ortakë aksionarë.*

## I. Hyrje

Aktiviteti ekonomik në Europë që në mesjetë *de facto* është shoqëruar me parimin e përgjegjësive së kufizuar. Më shumë ky parim u bë mbizotërues në praktikën tregtare si mjet i sigurtë për tregëtinë. Ndërvarësia dhe veprimtaria ekonomike kanë angazhuar përgjegjësinë e plotë të individit madje edhe të afërmeve të tij, duke qenë se të gjitha asetet personale dhe pasuria mund të jenë potencialisht në rrezik si pasojë e veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjeve.

Ndërmarrjet me përgjegjësi të kufizuar janë ato shoqëri të cilat themelohen nga një ose më shumë persona, që kanë për qëllim arritjen e disa objektivave ekonomike, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve të statutit të saj.

Që në fillimet e shtetit Shqiptar dhe sidomos gjatë periudhës së Mbretërisë së Zogut ka qenë i pranishëm rregullimi juridik i biznesit dhe në veçanti i tregtarëve dhe shoqërive tregtare. Legjislacioni i trashëguar nga e kaluara, i cili ishte ende në fuqi për të drejtën zakonore shqiptare dhe për kodet juridike të perandorisë Osmane, pësoi ndryshim duke vijuar me një legjislacion të ri të standarteve evropiane. Pas mbretërisë së Zogut, në periudhën e regjimit komunist u ndalua plotësisht veprimtaria private dhe në përgjithësi e gjithë veprimtaria dhe e drejta tregtare u kufizua duke u centralizuar nën pushtetin shtetëror. Me kalimin e regjimit komunist, shoqëritë tregtare në shtetin shqiptar rregullohen me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i cili u krijua si pasojë e përafrimit të legjislacionit me *Acquis Communautaire* brenda një periudhe 10-vjeçare. Direktivat evropiane, përqëndrohen më shumë tek shoqëritë aksionare dhe më pak tek shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar. Nga kjo dhe ligjet për shoqëritë tregtare në vendet e BE-së ndryshojnë nga një vend në tjetrin, meqenëse nuk ka konventa të cilat të jenë bërë pjesë përbërëse e legjislacionit të vendeve të BE-së dhe për rrjedhojë, nuk ka një korpus të përbashkët normash në lidhje me shoqëritë tregtare. Legjislacioni shqiptar në fakt është bazuar shumë tek ligjet për shoqëritë tregtare të Italisë dhe Gjermanisë. Procesi i përafrimit të ligjeve duhet të ndjekë një qasje strategjike duke marrë parasysh zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik të vendit, kapacitetet e kërkuara administrative dhe burimet financiare, si dhe ndikimet e mundshme financiare, ekonomike dhe mjedisore.

Ndër llojet e ndryshme të organizimit të shoqërive tregtare, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar përbën organizimin më të hasur në tregun shqiptar. Ekzistojnë shumë elementë ligjorë por edhe materialë që e bëjnë kaq të aplikueshme, por theksi bie tek “përgjegjësia e kufizuar”.

## II. Funksionimi i shoqërive me përgjegjësi të kufizuar në legjislacionin shqiptar

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një shoqëri tregtare, e themeluar nga persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.<sup>1</sup>

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raportit. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 100 lekë.

Keto shoqëri sipas ligjit mund të fitojnë edhe personalitet juridik. Veshja me këtë lloj personaliteti i jep asaj mundësinë të ketë të drejta dhe detyrime kundrejt të tretëve dhe kundrejt anëtarëve të saj. Në veçanti, statusi i shoqërisë tregtare si person juridik lejon që shoqëria të zotërojë pronë dhe të regjistrohet në regjistrin e pronave.

Ligji për shoqëritë tregtare nuk e përcakton si kontratë ashtu siç trajtohej shoqëria në bazë të Kodit të Zogut dhe në bazë të ligjit të vjetër “Për Shoqëritë Tregtare”. Logjika e ligjit të ri, në lidhje me mospërdorimin e termit klasik të kontratës ka të bëjë me faktin se themelimi i saj mund të jetë i kuptueshëm edhe në rast se krijohen me vetëm një ortak aksionar.

Në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, numri i ortakëve nuk është i kufizuar, ligji nuk përcakton një tavan. Marrëveshja e ortakëve është akti me anë të së cilit ata bien dakort për arritjen e objektivave ekonomike, duke dhënë kontribute në shoqëri.

Akti i themelimit nëse mund ta quajmë të tillë, është një veprim juridik dhe sipas përkufizimeve të nenit 79 të Kodit Civil është shfaqje e vullnetit të ortakëve për të krijuar ndryshuar ose shuar marrëdhënie juridike civile. Kjo shprehje e vullnetit mund të përfshijë dy ose më shumë persona, në këtë rast është veprim juridik i dyanshëm dhe në anën tjetër kemi shoqërinë me një ortak që mund të konceptohet si një veprim juridik i njëanshëm.<sup>2</sup>

SHPK-të janë të lira të ushtrojnë çdo veprimtari që e parashikon ligji, duke bërë përjashtim për kufizimet e ndryshme, ku për disa aktivitete të caktuara në ligj, shoqëria duhet të posedojë licencë nga organet e përcaktuara shtetërore.

Lindja e shoqërisë si person më vete vjen në një moment të dytë, pasi të shikohet nga organet përkatëse, në rastin tonë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR), ekzistenca e kërkesave ligjore dhe kushteve të caktuara nga ligji për lindjen e një

<sup>1</sup> Neni 68/1 i Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

<sup>2</sup> Neni 659 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

shoqërie. Pra, midis hartimit të aktit juridik (me shkrim ose jo) dhe krijimit të shoqërisë ka një hapësirë kohore, gjatë të cilës shoqëria nuk ka lindur ende por është krijuar mundësia për lindjen, themelimin e saj. Që të kemi një subjekt të ri në qarkullimin civil, pra lindjen e një personi të ri, kemi një fazë të dytë, që është regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Regjistrimi përbën një kusht provueshmërie për kontratën (condicio juris) për ekzistencën e shoqërisë. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar hyn në ato subjekte që, si në bazë të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtarë ashtu dhe në bazë të ligjit për QKR-në detyrohen të regjistrohen në regjistrin tregtarë që të fitojnë personalitet juridik. Që nga ky moment ne kemi të bëjmë me një organizëm që ka burimin e tij, origjinën e tij nga marrëveshja e ortakëve por nga ana tjetër ka dhe një jetë relativisht të ndarë nga kjo marrëveshje.

Kapitali i regjistruar konsiderohet si garanci minimale e kreditorëve për kreditë që ata i kanë dhënë shoqërisë. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Ky kapital ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, duke i pjesëtuar me kontributin që ka dhënë në kapital. Në bazë të këndvështrimit të përgjithshëm kontributet janë detyrimet që burojnë nga kontrata e shoqërisë për ortakët. Kontributet janë të lidhura ngushtësisht me zhvillimin e aktivitetit ekonomik të përbashkët. Edhe në qoftë se shoqëria është me një ortak të vetëm, derdhja e kontributeve është e patjetërsueshme për funksionimin e shoqërisë, për të arritur objektivat e saj dhe për të plotësuar kushtet që mund të ekzistojë si person juridik.<sup>3</sup>

Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar funksionojnë mbi bazën e organeve të tyre. Fillimisht është asambleja e përgjithshme e ortakëve, e cila përbëhet nga ortakët e shoqërisë. Ky organ është vendimmarrës, ku ortakët vendosin për çështjet më të rëndësishme të aktivitetit të shoqërisë, miratojnë ose reformojnë administrimin e saj dhe vendosin për strategjitë e drejtimit të shoqërisë. Organ tjetër është administratori që mund të përbëhet nga ortakët ose jo. Administratori ka për detyrë drejtimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë, përfaqësojnë shoqërinë në raport me palët e treta. Ky organ është i varur nga Asambleja, sepse emërimi dhe shkarkimi i tij bëhet nga Asambleja. Pavarësisht kësaj, administratori nuk është totalisht nën këtë varësi, pasi një pjesë e kompetencave të tyre janë të përcaktuara në statut dhe në ligj, në këtë mënyrë administratori është i detyruar të respektojë dispozitat përkatëse dhe kundër vullnetit të asamblës së ortakëve. Në këtë aspekt, ky organ i varur, përbën një frenim të pozitës së fortë që ligji i ka dhënë asamblës. Kompetencat e këtyre organeve varen nga natyra e vetë shoqërisë sesi është krijuar si dhe nga personaliteti i subjekteve.

Në ligj janë parashikuar të gjitha te drejtat dhe detyrimet e shoqërive në mënyrë të hollësishme, duke krijuar një tablo të plotë të rregullimit ligjor të këtyre strukturave ekonomike.

<sup>3</sup> Bolaffi, R. "La Societa Semplice", Giuffrè editore 1975, fq. 173.

### III. Përparësitë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, në raport me shoqëritë që parashikon ligji

Shumë biznese tentojnë të inkorporohen në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar për të shfrytëzuar përparësitë që ofrojnë këto organizime ekonomike. Struktura e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është më e lirë. Për shkak të fleksibilitetit dhe sigurisë, kjo shoqëri është forma më e shpeshtë e organizimit të bizneseve të vogla. Në rast të kapitave të vogla fillestare ky lloj organizimi paraqet disa avantazhe për hapjen e një biznesi të ri.

Bashkëpronarët që kanë zgjedhur këtë formë të shoqërisë kanë si problematikë humbjen e kursimeve jetësore në qoftë se deshton biznesi i tyre. Bashkëpronarët janë përgjegjës vetëm për shumën që e kanë investuar në shoqëri, ndërsa pasuria e tyre personale nuk mund të rrezikohet. Partneriteti tek SHPK-të ju ofron pjesëmarrësve fleksibilitet në pronësi të biznesit. Partnerët kanë autoritetin për të vendosur sesi ata do të kontribuojnë në mënyrë individuale në operacionet e biznesit. Ata që kanë një interes financiar në kompani mund të zgjedhin të mos kenë ndonjë autoritet mbi vendimet e biznesit, por ende të ruajnë të drejtat e pronësisë në bazë të interesit të përqindjes në kompani. Pronarët janë përgjegjës vetëm për shumën e investimeve të tyre me partneritetin, sepse në partneritet të gjithë anëtarët janë përgjegjës për borxhet e kompanisë. Fleksibiliteti i ndarjes së fitimit gjithashtu është një përparësi për bizneset e vogla që kanë zgjedhur formën e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar. Kur kapitali ndahet në kuota apo pjesë është një lehtësim për llogaritjen e pjesëmarrjes së bashkëpronarëve apo ortakëve në kapitalin e shoqërisë.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar lirohet nga tatimi i dyfishtë. Fitimet e shoqërisë ju ndahen bashkëpjesëmarrësve të shoqërisë, të cilët e paraqesin pjesën e tyre të fitimit, pastaj ai tatohet si fitim personal. Vetë shoqëria nuk paguan tatim para se të ndahet fitimi midis bashkëpronarëve.

Një veçanti nga llojet e tjera të organizimeve monetare ka të bëjë me detyrimin për auditimin e pavarur të llogarive të shoqërisë. Te shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, eksperti kontabël i regjistruar nuk është kusht, si në rastin e shoqërisë aksionere. Ky auditim është kusht i detyrueshëm vetëm nëse SHPK-ja zbaton standartet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe zbaton për raportimin financiar standartet kombëtare të kontabilitetit, por në mbyllje të periudhës kontabël tejkalon dy prej tre treguesve që kanë të bëjnë me totalin e aktiveve të bilancit, shumën e të ardhurave, mesataren e punonjësve.<sup>4</sup>

<sup>4</sup> Neni 41, Ligji nr. 10091, datë 5.3.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar".

Thjeshtësia e themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe udhëheqja e saj është një përparësi në krahasim me organizimet e tjera. Edhe pse themelimi i shoqërisë mund të jetë i kushtueshëm, kërkon lidhjen e një kontratë ku definojnë politikën dhe procedurat e saj, plotësimin e statutit të shoqërisë ose aktit të themelimit. Procedurat e themelimit janë më të thjeshta se ato që aplikohen në shoqëritë aksionare. Keto shoqëri mund të regjistrohen vetëm duke aplikuar për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme, dokumentet e identifikimit të ortakëve duke nënshkruar një deklaratë të posaçme, sipas të cilës anëtarët njohin dhe pranojnë zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi për organizimin dhe funksionimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.<sup>5</sup>

Ndryshe nga regjimi i shoqërive aksionare, ligji nuk kërkon krijimin e një rezerve ligjore të detyrueshme. Krijimi i rezervave mund bëhet në mënyrë fakultative nëpërmjet vendimeve të asamblesë.<sup>6</sup>

#### IV. Përfundime

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një trajtë e posaçme e shoqërisë tregtare në të cilën dy ose më tepër persona bashkojnë vullnetin dhe mjetet me qëllim të realizimit të aktivitetit ekonomik tregtar. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar llogariten si forma më e re dhe atraktive e organizimit të biznesit të vogël. Edhe pse është më e re, numri i këtyre shoqërive është më i madh dhe akoma shkon në rritje në krahasim me shoqëritë e tjera.

Elementët personale që vijnë në shprehje te kjo shoqëri janë vetitë personale të ortakëve, ndërsa elementi i shoqërive kapitale konsiderohet përgjegjësia e kufizuar e ortakëve. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dallohen nga shoqëritë kolektive dhe shoqëritë komandite, pasi ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë. Vetëm shoqëria, me të gjithë pasurinë e saj, përgjigjet për detyrimet e saj. Termi “përgjegjësi e kufizuar” duhet kuptuar në lidhje me ortakët por jo me subjektin që krijohet, pra me SHPK-të, pasi përgjegjësia e shoqërisë nuk është e kufizuar, shoqëria si person juridik me vete përgjigjet për detyrimet e saj me gjithë pasurinë që ka. Nga ana tjetër ortakët nuk kanë përgjegjësi personale megjithatë ata marrin përsipër risk ekonomik duke kryer investimet në shoqëri. “Përgjegjësia e Kufizuar” ka të bëjë me kufizimin e këtij rreziku.<sup>7</sup>

Në shoqëritë tregtare në përgjithësi, dhe në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar në veçanti, qëllimi i të gjithë ortakëve është fitimi. Ky fitim realizohet nëpërmjet ushtrimit të një aktiviteti ekonomik (tregtar) të përbashkët ku të gjithë

bashkëpunojnë, pra kemi qëllim të njëjtë, të përbashkët. Kontributet e secilit ortak në shoqëri nuk kanë si qëllim përmbushjen e interesave të ortakëve të tjerë, por ato përdoren për zhvillimin e një aktiviteti tregtar të përbashkët. Në fakt kontributet e ortakëve për themelimin e një shoqërie janë thjesht mjete ose instrumente për të marrë fitimin që do ndahet midis ortakëve. Ato mund të jenë të ndryshme në natyrë dhe në vlerë. Kontributet e secilit ortak nuk qëndrojnë në një marrëdhënie të kushtëzuar, d.m.th. që nëse nuk i shlyen njëri nuk i shlyen dhe tjetri, por qëndrojnë në një situatë paralelizmi për të prokuruar një fitim dhe thelbi i kontratës është përqendruar në zhvillimin e aktivitetit ekonomik të përbashkët që përbën pjesën me të rëndësishme të saj. Nga ky qëndrim i doktrinës vjen dhe pasoja që mos shlyerja e kontributit nga njëri nga ortakët, për shkak vullnetit të tij ose për shkaqe të tjera, nuk shkakton mos përmbushje të thelbit të kontratës së shoqërisë, e cila mund të vazhdojë të funksionojë normalisht. Pra, mund të themi se kemi një pavarësi relative të kontratës nga palët kontraktuese.

Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar janë subjekte me natyrë hibride përse i përket krahasimit me llojet e tjera të organizimeve tregtare. Duke u nisur nga kjo natyrë organizimi, legjislatori ka marrë thjeshtësinë e gjithë llojeve të tjera duke implementuar në këtë lloj shoqërie duke sjellë lehtësira si për organizimin, ashtu edhe për funksionimin e saj.

#### Bibliografia

- Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.  
Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë.  
Bolaffi, R. “La Societa Semplice”, Giuffrè editore 1975.  
Ligji nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”.  
Ligji nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.  
Malltezi, A. “E drejta shqiptare e shoqërive tregtare”, “Mediaprint”, Tiranë 2011.  
Thomas Bacher, Edmund Philipp Schuster, Martin Winner, “Ligji i Ri Shqiptar për të Drejtën e Shoqërive Tregtare” (interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën evropiane).

<sup>5</sup> Neni 28, Ligji nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

<sup>6</sup> Malltezi, A. “E drejta shqiptare e shoqërive tregtare”, “Mediaprint”, Tiranë 2011, fq. 50.

<sup>7</sup> Thomas Bacher, Edmund Philipp Schuster, Martin Winner, Ligji i Ri Shqiptar për të Drejtën e Shoqërive Tregtare. (interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën evropiane), fq. 45.

# *Padia si akt procedural i mbrojtjes së të drejtës subjektive*

*Dokt. Valbona Shukarasi*

## **Abstrakt**

*Iniciativa për të investuar gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor i takon palës (ose përjashtimisht edhe prokurorit) pasi gjykata nuk mund të vibet vetë në lëvizje apo të procedojë për shqyrtimin e një mosmarrëveshje nëse këtë nuk e kërkon pala e interesuar. Pra, padia është e drejta e personit që ngre pretendimin, për t'u dëgjuar mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo. Ky është kuptimi i padisë sipas nenit 31 të Kodit të Procedurës Civile. Nga ky parashikim dalin në pah edhe funksionet kryesore të saj.*

*Pra, padia është mjete procedural i rëndësishëm nëpërmjet së cilës realizohet e drejta e individit për të vënë në lëvizje gjykatën për zgjidhjen e një mosmarrëveshje juridike dhe për të kërkuar nga gjykata rivendosjen në vend të një të drejte apo interesi të ligjshëm. Në këtë punim do të trajtohet kuptimi i padisë sipas legjislacionit shqiptar si dhe duke e analizuar në këndvështrimin e praktikës së Gjykatës së Lartë dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese.*

***Fjalët kyçe:** padia, palët në procesin civil, interesi i ligjshëm, legjitimiteti aktiv dhe pasiv.*

## **1. Hyrje**

Titulli II i pjesës së përgjithshme të Kodit të Procedurës Civile trajton konceptin e “padisë”. Padia është mjete procedural i rëndësishëm nëpërmjet së cilës realizohet e drejta e individit për të vënë në lëvizje gjykatën për zgjidhjen e një mosmarrëveshje

juridike dhe për të kërkuar nga gjykata rivendosjen në vend të një të drejte apo interesi të ligjshëm. Ky është kuptimi i padisë sipas nenit 31 të Kodit të Procedurës Civile. Nga ky parashikim dalin në pah edhe funksionet kryesore të saj. Me anë të padisë pala realizon kërkimin e vet të së drejtës materiael kundrejt palës kundërshtare ose sqaron pozitat e veta juridike. Padia në kuptimin procedural, është e drejta për t'iu drejtuar gjykatës për mbrojtjen e një të drejte civile subjektive ose për njohjen e ekzistencës apo mos ekzistencës së një marrëdhënie juridike të caktuar.

Duke iu referuar dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 42 i saj parashikon të drejtën e cilitdo për t'iu drejtuar gjykatës. Gjithashtu në neni 44 të Kushtetutës parashikohet: *“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore. Pra kjo dispozitë kushtetuese legjitimon personat të ngrajnë padi në gjykatë edhe ndaj organeve shtetërore”*.

Sipas nenit 31 të Kodit të Procedurës Civile: *“Padia është e drejta e personit që bën pretendimin, për t'u degjuar mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo”*. Kjo dispozita përcakton rrugën procedurale që duhet të ndjekë personi që pretendon cënimin e një të drejte subjektive. Gjithashtu ky është rregulli kryesor që fikson marrëdhënien mes personave dhe pushtetit gjyqësor: gjykata nuk proçedon dhe nuk merr vendime me iniciativën e saj, por vetëm mbi bazën e kërkesës së palës së interesuar ose në raste të rralla të parashikuara nga ligji edhe me kërkesën e prokurorit.

## 2. Analizë e vendime gjyqësore

**Në vendimin e saj Nr.8 datë 13.03.2008 Gjykata Kushtetuese është shprehur:** *“... Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese i qëndron praktikës së saj, për çështjen e legjitimitetit të palëve në një proces civil, në këndvështrimin e standartit të aksesit në gjykatë, si element të procesit të rregullt ligjor. Neni 42/2 i Kushtetutës, përfshirë në kreun e të drejtave dhe lirive themelore, garanton të drejtën e kujtdo që për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetuese, ose ligjore si dhe në rastin e akuzave të ngritura, kundrejt tij t'iu drejtohet një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj për një gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Pikërisht në lidhje me nenin 31 dhe nenin 32 të Kodit të Procedurës Civile padia mund të ngrihet:*

- a. për të kërkuar rivendosjen e një të drejte apo interesi të ligjshëm që është shkelur;*
- b. për vërtetimin e qënies ose mosqënies së një marrëdhënie juridike ose një të drejte;*
- c. për njohjen e vërtetësisë apo pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin”*. Zbërthejnë dhe zhvillojnë më tej atë që Kushtetuta garanton<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë 20.03.2006.

*Po i njëjtë është edhe qëndrimi i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut e cila shprehet se neni 6/1 I KEDNJ-së mishëron të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, në të cilën përfshihet e drejta për të filluar një proçedurë përpara një gjykatë për një çështje civile<sup>2</sup>.*

*Gjykata Kushtetuese në çështjen e legjitimitetit të palëve në një proces civil, si element të procesit të rregullt ligjor analizon të “dy anët e medaljes”: Moslegjitimimi i një subjekti, që dubet të legjitimohet në bazë të ligjit, përbën shkak për cënimin e të drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor, por vetëm fakti i legjitimitetit të një subjekti për të ngritur padi, që nuk dubet të legjitimohet sipas ligjit, nuk cënon në çdo rrethanë të drejtën e palës tjetër për proces të rregullt ligjor. Në këtë rast gjykata vlerëson nëse janë respektuar të drejtat e palës kundërshtare për një proces gjyqësor kontradiktor”*.

Pra, me anë të padisë, paditësi synon të rivendoset një e drejtë e tij e shkelur dhe i padituri detyrohet të ekzekutojë domethenë të përmëshë detyrimin e tij kundrejt paditësit. Në raste të tjera paditësi, me anën e gjykimit, synon të përcaktohet ose të njihet vetëm ekzistenca e një marrëdhënie juridike të caktuar midis tij dhe të paditurit ose ekzistenca e një të drejte. Personi legjitimohet të ngrajë padi edhe për njohjen e vërtetësisë ose të pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike të caktuara për paditësin. Qëllimin e paditësit në ngritjen e padisë e përcakton shprehimisht neni 32 i Kodit të Procedurës Civile.

Në lidhje me zbatimin e kësaj dispozite **Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në Vendimin nr.210 datë 06.05.2010 ka arsyetuar se:** *“Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, të Ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” i ndryshuar, në të cilat është parashikuar:*

*Neni 32 i K.Pr.Civile: “Padia mund të ngrihet: a. për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose inteersi të ligjshëm që është shkelur; b. për vërtetimin e qënies ose mosqënies së një marrëdhënie juridike ose një të drejte; c. për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin”*. Në vështrim të nenit 32 të K.Pr.Civile padia ngrihet për arsyet e përmendura në nenin 32 të K.Pr.Civile, në këtë kuadër, parë në lidhje me kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të të drejtave dhe detyrimeve që kanë ortakët nga zotërimi i pjesëve respektive të këtyre kuotave, pala paditëse nuk ka dhe nuk mund të ketë ndonjë të drejtë apo interes të ligjshëm të shkelur. Nga argumentat e paraqitura në proces, padia e paraqitur nga ana e palës paditëse, me objekt pavlefshmëri kontrate, në raport me kërkesat ligjore është e pa motivuar. Palës Paditëse i mungon legjitimiteti për të ngritur një padi të tillë, pasi nuk i është cënuar interesi i drejtëpërdrejtë e ligjor nga transferimi i kuotave ndërmjet ortakëve të shoqërisë, anës së paditur...”

Nga vendimi i mësipërm dalin në pah dy elementë të rëndësishëm që kanë të bëjnë me legjitimitimin e palëve në një proces civil. Nga ana e palëve për procesin gjyqësor civil kërkohet që ato të gëzojnë legjitimitetin aktiv dhe pasiv apo e thënë

<sup>2</sup> Çështja Goedler kundër Mbretërisë së Bashkuar datë 21.02.1975; dhe Devlin kundër Mbretërisë së Bashkuar: datë 20.10.2001 të GJEDNJ-së.

ndryshe, palët për të parashtruar kërkimet dhe prapësimet e tyre para gjykatës, është e domosdoshme që të gëzojnë interes të ligjshëm

Gjykata për të hetuar nëse personat fizikë apo personat juridikë të cilët i janë drejtuar asaj më kërkesë padi gëzojnë legjitimitetin aktiv, verifikon nëse palët kanë ose jo interes të ligjshëm në parashtrimin e kërtimeve apo pretendimeve të tyre para gjykatës.

Në lidhje me legjitimitetin e palëve për t'iu drejtuar gjykatës për të parashtruar kërkimet e tyre **Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në Vendimin nr.168, datë 13.04.2010 ka arsyetuar se:** "...Përfundimi i arritur nga Gjykata e Apelit se paditësi nuk ka interes ligjor (pra nuk legjitimohet në ngritjen e kësaj padie, dhe si rrjedhim kjo e fundit nuk mund të jetë e vlefshme nga pikpamja formale procedurale), për të bërë kërkimet e paraqitura në këtë gjykim është i gabuar, dhe këto konkuzione janë pasojë e një hetimi jo të plotë dhe të gjithanshëm gjyqësor.

*Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në lidhje me aspektin formal e procedural të vlefshmërisë së padisë vlerëson të theksojë se padia që të jetë e vlefshme duhet të plotësojë dy kushte themelore: a. interesi i ligjshëm për të ngritur padi dhe b. legjitimiteti për të vepruar. Në rast se ekzistojnë këto dy kushte mund të konsiderohet që padia ekziston në kuptimin që për Gjykatën del domosdoshmëria për të marrë vendim mbi themelin e saj, pra për të pranuar ose rrëzuar atë. Interesi për të ngritur padi parashikohet nga Neni 32 i K.Pr.Civile. Interesi për të ngritur padi është një element i së drejtës së padisë dhe konsiston në interesin për të marrë nga gjykata vendimin e kërkuar. Interesi për të ngritur padi është një interes procedural, i cili lind nga domosdoshmëria për të arritur nga procesi mbrojtjen e një interesi material, dhe për këtë arsye pala i drejtohet gjykatës duke kërkuar njohjen e çënimit të një interesi dhe rivendosjen e të drejtës së shkelur.*

*Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë arrin në konkluzionin se në çështjen objekt gjykimi, referuar nenit 32 të K.Pr.Civile, paditësi ka një interes të ligjshëm për të ngritur padinë objekt shqyrtimi gjyqësor, pasi pala e paditur me aktet administrative dhe veprimet juridike të kryera ka cënuar të drejtat reale të paditësit mbi sheshin e ndërtimit dhënë atij me vendim të Këshillit të Rrethit Delvine nr.26, datë 25.08.1998..."*

Në lidhje me rëndësinë që mbart interesi i ligjshëm i palëve në momentin e ngritjes së padisë **Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin nr 180, datë 07.05.2009 ka arsyetuar:** "Ky Kolegj çmon se është e domosdoshme të evidentojë disa probleme në lidhje me aspektin formal procedural të vlefshmërisë së padisë. Padia që të jetë e vlefshme duhet të plotësojë dy kushte themelore: a. interesin e ligjshëm për të ngritur padi dhe b. legjitimitetin për të vepruar. Në rast se ekzistojnë këto dy kushte mund të konsiderohet që padia ekziston në kuptimin që për gjykatën del domosdoshmëria për të marrë vendim mbi themelin e saj, pra për të pranuar apo rrëzuar atë. Në çështjen objekt gjykimi paditësi ka një interes të ligjshëm për të ngritur padi, pasi ai pretendon se është pronar i një pasurie të paluajtshme dhe si i tillë ai legjitimohet, kërkesa këto të nenit 32 të K.Pr.Civile.

*E drejta e padisë përfshin në mënyrë të domosdoshme dy aspekte: legjitimitetin aktiv dhe legjitimitetin pasiv. Legjitimiteti pasiv i takon palës kundërshtarë ose të kundërinteresuarit, domethënë atij kundrejt të cilit vendimi gjyqësor që kërkohet të merret duhet të prodhojë efekte, Pra, dhe pala e paditur duhet të ketë interes të ligjshëm në këtë proces. Ndërgjyqësia legjitime është kusht për të shqyrtuar themelsinë e padisë..."* Duke iu referuar dy vendimeve të mësipërm të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë arrijmë në konkluzionin se interesi për të ngritur padi dhe legjitimiteti për të vepruar janë kushte themelore të vlefshmërisë së padisë dhe për këtë arsye ekzistenca e tyre verifikohet nga gjykata edhe kryesisht gjatë gjykimit në çdo shkallë të procesit. Vetëm në qoftë se ekzistojnë këto dy kushte mund të konsiderohet se padia ekziston në aspektin formal procedural në kuptimin që për gjykatën del domosdoshmëria për të marrë vendim mbi themelin e saj, pra për të pranuar ose rrëzuar atë. Ndërgjyqësia legjitime është kusht për të shqyrtuar themelsinë e padisë.

## Bibliografia

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë  
Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut  
Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë  
Alban Brati (2008). "Procedura Civile", Botimi i parë; Tiranë  
Ledi Bianku, (2007), "Jurispruena e Gjykatës së Strasburgut"; Edlora, Tiranë.  
Flutura Tafaj & Vitore Tushaj, (2008), "Kushtet e Ngritjes së Padisë", Tiranë.  
Vendim i Gjykatës së Lartë, Nr 180, datë 07.05.2009;  
Vendim i Gjykatës së Lartë Nr.168, datë 13.04.2010;  
Vendim i Gjykatës së Lartë Nr.210 datë 06.05.2010;  
Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr.8 datë 13.03.2008.

# *Bashkimi familjar si një e drejtë themelore në ditët e sotme*

*Dr. Greta Bardeli*

*Prof. Asoc. Dr. Erjona Canaj*

## **Abstrakt**

*Familja është njësisia bazë e shoqërisë dhe e drejta e bashkimit familjar është një nga të drejtat më të rëndësishme në kuadër të lëvizjes së lirë. Në fakt, kjo e drejtë merr një rëndësi të veçantë në kauder të emigracionit, sidomos për shoqërinë shqiptare në këto dy dekadat e fundit. Mbrojtja e kësaj të drejte është domosdoshmëri për ruajtjen e unitetit familjar. E drejta për bashkim familjar është një e drejtë themelore e sanksionuar në shumë akte ligjore ndërkombëtare, rajonale dhe europiane. Kjo është një e drejtë shumë e rëndësishme në kuadër të lëvizjes së lirë dhe të emigracionit në përgjithësi, si dhe në mënyrë të veçantë në kuadër të ruajtjes së unitetit familjar.*

*Nëpërmjet institutit të bashkimit familjar një personi i njihet e drejta për t'u bashkuar me anëtarët e familjes së tij në një Shtet të ndryshëm nga ai i vendlindjes. Në përgjithësi, bashkimi familjar, nëse nuk ka ndonjë regjim tjetër specifik, i nënshtrohet rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Me natyrë të veçantë prezantohet rendi juridik i Bashkimit Europian, ku bashkimi familjar merr ngjyra të ndryshme në varësi të statusit të personit që kërkon bashkim familjar. Bashkimi familjar në BE njihet si titullar aktiv si shtetasin komunitar ashtu edhe atë jo komunitar. Në BE e drejta për bashkim familjar si e drejtë themelore parashikohet në direktivën 2003/86/KE, mbi bashkimin familjar për shtetasit jo komunitarë që gjenden në territorin e BE-së për arsye punësimi dhe në direktivën 2004/38/KE mbi lëvizjen e lirë për shtetasit komunitarë.*

*Bashkimi familjar është një e drejtë që garantohet edhe në vendin tonë: është instituti me anë të të cilit shtetasit e huaj që jetojnë dhe punojnë në vendin tonë bashkohen me familjarët e tyre, që vijnë nga vende të tjera dhe ky bashkim realizohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

*Në këtë studim do të fokusohemi në mënyrë të veçantë në disiplinën juridike të bashkimit familjar të shtetasve të huaj që kërkojnë bashkim familjar në territorin e*



*Republikes së Shqipërisë siç janë refugjatët, të punësuarit dhe të vetëpunësuarit. Në këtë drejtim legjislativi ynë mbi bashkimin familjar prezantohet në përputhje me standartet europiane.*

**Fjalët kyçe:** bashkim familjar, familje, të huaj, familjarë, e drejtë themelore, legjislativi shqiptar.

## 1. Hyrje

E drejta e bashkimit familjar aktualisht gëzon mbrojtje ligjore jo vetëm në nivel kombëtar dhe rajonal, evropian, por edhe ndërkombëtar. Garantimi i kësaj të drejte krijon mundësinë e bashkimit të personave me anëtarët e familjeve të tyre të cilët ndodhen në një shtet të ndryshëm nga ai i vendlindjes. E drejta për bashkim familjar është një e drejtë themelore shumë e rëndësishme në kuadër të lëvizjes së lirë dhe të emigracionit në përgjithësi<sup>1</sup>. Njëpërmjet institutit të bashkimit familjar një personi i njihet e drejta për t'u bashkuar me anëtarët e familjes së tij në një Shtet të ndryshëm nga ai i vendlindjes. Në përgjithësi, bashkimi familjar, nëse nuk ka ndonjë regjim tjetër specifik i nënshtrohet rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Me natyrë të veçantë prezantohet rendi juridik i Bashkimit Europian, ku bashkimi familjar merr ngjyra të ndryshme në varësi të statusit të personit që kërkon bashkim familjar. Bashkimi familjar në BE njihet si titullar aktiv (personin që transferohet në një shtet tjetër anëtar -shteti pritës- dhe që kërkon bashkimin me familjen e tij që ndodhen në shtetin prej të cilit vjen – shteti i vendlindjes) si shtetasin komunitar ashtu edhe atë jo komunitar. Në këtë studim do të fokusohemi në mënyrë të veçantë në disiplinën e bashkimit familjar si për shtetasit komunitar ashtu edhe ata jo komunitar dhe në përcaktimin e kategorive të familjarëve që e përfitojnë këtë të drejtë, si dhe rregullimin juridik të bashkimit familjar në Shqipëri.

Të drejtën e bashkimit familjar e gjejmë të trajtuar fillimisht në dispozitat e Traktatit Themelues të Komunitetit Europian dhe në legjislativin sekondar të institucioneve komunitare. Në Europë, bashkimi familjar merr rëndësi si pasojë e krijimit të hapësirës së përbashkët, që përcakton jo vetëm flukset e punonjësve emigrantë, por përcakton në mënyrë shumë rigorozë dhe selektive mundësinë e hyrjes dhe qëndrimit, me preferencë për qëndrimet e përkohshme. Karakteristikat

<sup>1</sup> Deklarata universale e të drejtave të njeriut (neni 12 dhe 16), Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike (17 dhe 23) dhe Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (neni 2) Konventa ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës (nenet 9 dhe 10), Konventa europiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (neni 8) Karta sociale europiane (nenet 16 dhe 19) Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre (neni 44), Konventa europiane për statusin ligjor të punëtorëve migrantë (neni 12), Karta e të drejtave themelore të Bashkimit Europian (neni 7) etj.

e flukseve migratore kanë qenë gjithmonë të ndryshme në kohë dhe për rrjedhojë kanë marrë rëndësi të ndryshme në varësi të kontekstit historik. Lëvizja e personave para viteve '90 ishte kryesisht brenda vendit dhe pas këtyre viteve filluan të shfaqeshin format e para të emigracionit ekonomik drejt vendeve të tjera. Fluksi më i madh i emigracionit ekonomik ishte pas Luftës së Dytë Botërore dhe kishte si qëllim rindërtimin ekonomik të shkatërruar nga Lufta. Pikërisht ishte kjo lëvizje migratore e cila krijoi konceptin e *guest worker*.

Një pjesë e konsiderueshme e personave emigronin vetëm dhe bashkimi i familjes, me familjarin e mbetur në vendin e origjinës, realizohej njëpërmjet nismave spontane të disa qytetarëve që i përkushtoheshin bashkimit të familjeve të ndara, edhe pse në mungesë të normativave në këtë fushë. Me evoluimin e ekonomisë dhe të shoqërisë civile evoluoi mbrojtja dhe rregullimi ligjor i të drejtës së bashkimit familjar, duke arritur një standardizim më të lartë

E drejta për bashkim familjar për shtetasit komunitarë merr rëndësi për të drejtën komunitare vetëm atëherë kur personat që shoqërojnë familjarin e tyre transferohen dhe qëndrojnë në një Shtet tjetër Anëtar për një periudhë më të gjatë se tre muaj: pra, bashkimi familjar për një familje të përbërë vetëm nga shtetas komunitarë mund të realizohet *de facto* për një periudhë kohe deri tre muaj, pasi për këta individë aplikohet regjimi i përgjithshëm i lëvizjes së lirë afatshkurtër. Në lidhje me lëvizjen e lirë dhe me bashkimin familjar, është shumë e rëndësishme direktiva e Këshillit dhe e Parlamentit Europian e dt. 29 prill 2004 nr. 2004/38/KE<sup>2</sup> e cila përfshin gjithë disiplinën e qarkullimit të lirë të shtetasve komunitarë në territorin e secilit prej Shteteve Anëtare të BE-së. Direktiva 2004/38 përmbledh në një instrument të vetëm ligjor përmbajtjen e rregullave për hyrjen dhe qëndrimin e personave të vetë-punësuar, personave të punësuar, studentëve, si dhe personave që nuk janë ekonomikisht aktivë dhe familjarët e tyre, duke e zgjeruar këtë të drejtë

<sup>2</sup> Direktiva në fjalë amendoi rregulloren n.1612 e 15 tetor 1968 e cila shënoi liberalizimin e plotë në qarkullimin e punëtorëve me kontratë dhe shfuqizoi direktivën n. 360 e 15 tetor 1968; rregulloren n. 1048/71 e 14 qershorit 1971 mbi sigurimet e cila synonte një harmonizim të të gjitha legjislativëve të Shteteve Anëtare; direktivën 98/49/CE e 29 qershorit 1998, me anë të së cilës disiplina komunitare u aplikua edhe për regjimet e pensione; direktivën 73/148/KEE që kishte të bënte me heqjen e pengesave në transferimin dhe të drejtën e leje-qëndrimit e shtetasve të një Shteti Anëtar të BE-së në fushën e vetë-punësimit dhe të shërbimeve; rregulloren n.1251/70 dhe direktivën 75/34 të cilat parashikonin kushtet që duhen plotësuar nga punëtorët me pagesë dhe familjarët e tyre për të drejtën e qëndrimit të përhershëm kur nuk punojnë më për arsye të ndryshme si moshë, arsye shëndetësore etj.; direktivën 75/34/KEE e 17 dhjetorit 1974, e cila parashikonte që t'u aplikohen edhe punëtorëve që vetë-punësohen, pasi kanë përfunduar punën për arsye të moshës ose invaliditetit (dhe familjarëve të tyre) të drejtën për leje qëndrimi ashtu sikurse parashikohet për punëtorët në përgjithësi si dhe direktivat 90/364, 90/365, 93/96, të vitit 1990 lidhur me lëvizjen e lirë të personave jo aktivë ekonomikisht, të studentëve dhe të pensionistëve. C.SANNA, *La direttiva 2004/38/CE relativa al diritto dei cittadini dell'Unione e dei loro familiari di circolare e soggiornare liberamente nel territorio degli Stati membri*, në *Rivista di diritto internazionale privato e processuale*, 42/2006, fq. 1167; M.MISSORICI-C.ROMANO, *Libertà di circolazione e soggiorno: i cittadini degli Stati terzi tra cittadinanza europea e politica delle migrazioni*, në *Rivista internazionale dei diritti dell'uomo*, n. 11/98, fq. 44.

themelore dhe zbatueshmërinë e këtij ligjislacioni tek të gjithë qytetarët e BE-së që ushtrojnë të drejtën e qarkullimit të lirë dhe rezidencës.

Kjo Direktivë nuk zbatohet për të gjithë qytetarët e Shteteve Anëtare të BE-së, por vetëm për ata subjekte që ushtrojnë efektivisht të drejtën e lëvizjes së lirë: ajo shtrihet te qytetarët e BE-së të cilët transferohen në një shtet tjetër për disa arsye, d.m.th. për arsye të ndryshme nga ato vetëm “të punësimit”. Rregullat e reja janë hartuar gjithashtu për të inkurajuar qytetarët e BE-së në ushtrimin e të drejtës së tyre për të lëvizur dhe qëndruar lirisht në territorin e Shteteve Anëtare, për të hequr formalitetet administrative të ndërlikuara përkundrejt atyre me të thjeshtave, si dhe për të siguruar një përcaktim më të mirë të statusit të anëtarëve të familjes në gëzimin e këtyre të drejtave. Në këtë kuadër vlen të theksohet se e drejta për bashkim familjar për shtetasit komunitarë merr rëndësi për të drejtën komunitare vetëm atëherë kur personat që shoqërojnë familjarin e tyre qëndrojnë në një Shtet tjetër Anëtar për një periudhë më të gjatë se tre muaj. Bashkimi familjar në qëndrimet afatgjata (më shumë se tre muaj) rregullohet nga dispozitat e direktivës 2004/38. Në këto norma rezulton se familja, e përbërë nga individë-shtetas komunitarë prezantohet më e plotë dhe më e mbrojtur pikërisht për faktin se e drejta për bashkim familjar ushtrohet në plotësim të një të drejte tjetër themelore që është ajo e lëvizjes së lirë, një liri themelore kjo e garantuar dhe e respektuar maksimalisht në Bashkimin Europian.

Bashkimi familjar i shtetasve jo komunitarë i është nënshtruar gjithmonë legjislacionit të brendshëm i përfunduar nga e drejta komunitare pasi në legjislacionin europian mungonin akte ligjore që rregullonin institutin e bashkimit familjar. Vetëm në vitin 2003 në Bashkimin Europian arrihet rregullimi ligjor komunitar i bashkimit familjar i shtetasve jo komunitarë që gjenden në territorin e BE-së. Bashkimi familjar ku titullar aktiv është shtetasi jo komunitar që jeton dhe punon në një Shtet Anëtar të BE-së, aktualisht rregullohet nga legjislacioni i brendshëm i shteteve anëtare në përputhje me direktivën e Bashkimit Europian 2003/86/KE<sup>3</sup>. Direktiva 2003/86 u drejtohet shtetasve jo komunitarë që gjenden në territorin e një Shteti Anëtar për motive punësimi dhe për refugjatët. Direktiva është instrumenti i parë ligjor i BE-së në lidhje me emigrimin e ligjshëm, dhe si pasojë për disa vende anëtare ishte hera e parë që u pajisën me një set rregullash mbi të drejtën për bashkim familjar në legjislacionin e tyre kombëtar. Implementimi i direktivës në praktikë ka hasur në probleme në vende të caktuara, si p.sh. në lehtësimin e regjimit të vizave, dhënien automatike të lejeve të qëndrimit, marrjen parasysht të interesit më të mirë të fëmijës etj. Nëpërmjet kësaj direktive përcaktohen rregullat kryesore për ushtrimin e të drejtës për bashkim familjar si dhe përcaktohen për herë të parë në nivel europian cilët janë personat që e përbëjnë një familje.

<sup>3</sup> COLACINO N., *Il diritto al ricongiungimento familiare e la disciplina introdotta dalla Direttiva 2003/86/CE* në Saulle M.R., *L'Europa tra costituzione, asilo e immigrazione*, Napoli, 2004.

## 2. Statusi i familjarit në të drejtën komunitare në kuadër të bashkimit familjar

Familja, në kuadër të bashkimit familjar prezantohet si një strukturë me gjeometri variabel: dmth ka një bërthamë të fortë dhe solide siç është familja nukleare (prindër/fëmijë të mitur), por ka edhe një pjesë heterogjene, e cila sheh si familjarë edhe pjesëtarë të tjerë (fëmijë në moshë madhore, partnere, gjyshër, vëllezër, motra etj.) të cilët përcaktohen vetëm në bazë të legjislacionit të brendshëm të Shtetit pritës.

Bashkimi familjar realizohet për shtetasit komunitarë si për qëndrime afatshkurtra ashtu edhe për qëndrime afatgjata (periudha tre muaj, tre muaj deri në pesë vjet dhe mbi pesë vjet). Shtetasit jo komunitarë e ushtrojnë këtë të drejtë vetëm për qëndrimet afatgjata, pra, vetëm për ata persona të cilët janë në posedim të një leje qëndrimi me kohëzgjatje minimumi një vjeçare dhe me perspektivën e një leje qëndrimi të vazhdueshme. Kjo, në fakt, edhe pse është kufizuese në thelb, mund të themi që është një zgjidhje e arsyeshme pasi emigracioni kërkon stabilitet dhe integrim familjar në qëndrime afatgjata.

Familja tradicionale sheh bashkëshortin/en si një komponent themelor të saj. Të dy kategoritë e familjeve e shohin në të njëjtën mënyrë. Ajo që i dallon është vetëm një specifikë që lidhet me moshën. Bashkëshorti shtetas komunitar nuk ka një kufi për moshën në ushtrimin e të drejtës së bashkimit familjar, pra nuk është vënë për të kufiri në moshën 21 vjeç për ushtrimin e kësaj të drejte, siç është vënë për shtetasin jo komunitar. Në të vërtetë, martesat e shtetasve komunitarë në moshë më të vogël se 21 vjeç janë shumë të pakta, për të mos thënë të rralla. Dispozitat e Direktivës 2003/86 e vendosin këtë kufi për shtetasit jo komunitarë për të luftuar praktikën e martesave mes të miturve pa pëlqimin e tyre të lirë. Ky kufi moshe tenton që të parandalojë martesat të detyruara dhe të sigurojë integrim më të mirë. Në qoftë se duket qëllim legjitim dhe i drejtë kriteri i parë, nuk duket i tillë ose i realizueshëm i dyti.

Direktiva 2003/86 pranon një nocion të familjes që është më e ngushtë (kufizuar) se ajo e specifikuar në Direktivën 2004/38. Duke iu referuar nocionit të përgjithshëm të familjes, sot të pranishme në Evropë janë prezent modele të ndryshme familjare. Modeli që konsiderohet të jetë modeli i “familjes europiane”, pra familja e vogël, sot është duke kaluar nëpër ndryshime të thella. Për rregullimin e të drejtave (p.sh. në kuadrin e bashkimit familjar) të të huajve që vijnë nga shoqëri ku sistemet e familjes janë shoqërisht dhe juridikisht të ndryshme nga ajo që dominon në kodet ‘evropiane’, është e nevojshme që këta emigrantë të “përshtaten” me modelin e “familjes europiane” marrë në kuptimin e saj me të ngushtë, pra një

familje e vogël, e përbërë nga bashkëshorti/ja dhe fëmijët e mitur. Qëllimi në këto raste është që të kristalizohet koncepti i familjeve të emigrantëve në funksion të asaj që konsiderohet “familja tradicionale europiane”.

Për shtetasit komunitarë, brenda konceptit të familjes, për të cilat shteti është i detyruar të autorizojë hyrjen, përfshihet edhe partneri, i cili ka mbrojtje më të garantuar nëse e ka “legalizuar” marrëdhënien e tij me shtetasin komunitar. Në këtë drejtim familja komunitare ka një element të ri në përbërjen “tradicionale”, që legjislatori komunitar është i vendosur me të gjitha mjetet e nevojshme ta mbrojë. Kuptohet që partneri i cili nuk e ka “legalizuar” marrëdhënien, pra nuk e ka regjistruar në zyrat e gjendjes civile ose ai që është i tillë në vende ku kjo nuk parashikohet, gëzon një mbrojtje më të dobët e cila përkthehet në “mundësinë e hyrjes dhe qëndrimit” në territorin e shtetit pritës dhe jo në “hyrje dhe qëndrim të pakushtëzuar”. Në këtë drejtim kjo kategori partnerësh nuk gëzon të drejtën e menjëhershme për të shoqëruar apo për t’u bashkuar me punëtorin migrant. Të drejtat e tyre të hyrjes dhe qëndrimit varen nga diskrecioni i Shteteve Anëtare. Në thelb, Direktiva 2004/38 duket se ka kontribuar në rritjen e mbrojtjes së partnerëve të regjistruar më tepër se ata që thjesht bashkëjetojnë. Direktiva 2003/86 nuk e konsideron partnerin anëtar të sigurt të një familje sipas kushteve të njëjta të direktivës 2004/38. Megjithatë, duket interesante në këtë drejtim, hapja për një partner bashkëjetues, edhe pse ky ekuacion është pranuar vetëm nëse është e parashikuar nga legjislacioni kombëtar.

Në kategorinë e anëtarëve të familjes së pranuar në bazë të bashkimit familjar sipas direktivës 2004/38 përfshihen paraardhësit dhe pasardhësit ndërsa Direktiva 2003/86 i referohet shprehimisht prindërve të titullarit -gjyshërit e shkallës së parë dhe fëmijët. Paraardhësit e titullarit ose të bashkëshortit të shtetasit jo komunitar janë identifikuar vetëm babai dhe nëna e titullarit aktiv. Për këtë kategori, si në njërin rast ashtu edhe në rastin tjetër duhet të ekzistojë kushti i varësisë ekonomike që i sheh të lidhur ekonomikisht këta persona me titullarin aktiv të bashkimit familjar. Fëmijët deri në moshën 21 vjeç, konsiderohen anëtarë të familjes së shtetasve komunitarë, në dallim nga fëmijët e shtetasit që vjen nga vendet e treta, të cilët konsiderohen për qëllime të bashkimit familjar, anëtarë të familjes vetëm nëse janë nën 18 vjeç. Fëmijët mbi 18 vjeç të shtetasve jo komunitarë mund të kenë të drejtë për bashkim familjar, sipas vullnetit të shtetit në fjalë. Kjo rrjedh nga fakti se Direktiva 2003/86 këtë kategori e ka lënë në diskrecionin e Shteteve Anëtare. Direktiva 2003/86 gjithsesi parashikon për fëmijët e rritur të pamartuar (pra, fëmijët në moshë më të madhe se 18 vjeç) një *opsion* për pranimin e tyre nëse për arsye objektive mund të jenë të paaftë për të plotësuar nevojat e tyre personale për shkak të gjendjes shëndetësore.

Direktiva 2004/38, në kategorinë e familjarëve të tjerë që mund të shoqërojnë ose të bashkohen me shtetasin komunitar, ka përfshirë edhe çdo familjar tjetër dhe

kushti i vetëm që duhet të ekzistojë është që të jetë në ngarkim ose të jetonte me të në vendin e origjinës ose kur shkaqe të rënda shëndetësore kërkojnë shtetasin e BE-së që ta ndihmojë atë personalisht. Është e vërtetë se të afërmit e tjerë nuk kanë të drejtën automatike të hyrjes dhe të qëndrimit, së bashku me shtetasin komunitar anëtarë të familjes së tyre, megjithatë, kanë të drejtë që t’u lehtësohet hyrja dhe qëndrimi në Shtetin Anëtar pritës, nëse ata janë të varur ekonomikisht ose kur shkaqe të rënda shëndetësore kërkojnë që personi të ndihmohet nga shtetasi komunitar.

Të drejtat e anëtarëve të familjes së pranuar për bashkim familjar janë e drejta e qëndrimit, e drejta për arsim, e drejta për punë (me kontratë ose vetë-punësim), si dhe të drejtat që kanë të bëjnë me formimin profesional dhe trajnimet e ndryshme. Këto të drejta, në përgjithësi, janë parashikuar në të dy aktet ligjore që analizuam.

### 3. Legjislacioni shqiptar lidhur me bashkimin familjar në përputhje me standartet e BE-së

Bashkimi familjar është instituti me anë të të cilit shtetasit e huaj që jetojnë dhe punojnë në vendin tonë bashkohen me familjarët e tyre, që vijnë nga vende të tjera dhe ky bashkim realizohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shtetasit e huaj titullarë aktivë të bashkimit familjar janë refugjatët, të punësuarit dhe të vetëpunësuarit.

Burimet kryesore të së drejtës për bashkim familjar dhe unitet familjar të të huajve të vendin tonë janë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 9959 datë 18.7.2008 “Për të huajt”, Ligji nr. 8432 datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligji nr. 9098 datë 03.7.2003 “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfutuar azil në Republikën e Shqipërisë”. Legjislacioni ynë prezantohet në përputhje me standartet europiane.

Familja si njësi natyrore duhet t’i garantohet kujtdo dhe në fakt, kushdo ka të drejtën të ketë një familje, sanksionuar në nenin 53 të Kushtetutës. Kjo e drejtë prashikohet edhe për të huajt që gjenden në Shqipëri. Kushtetuta e ka përcaktuar qartë në nenin 16 se “Të gjitha të drejtat dhe liritë themelore si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë njëjloj edhe për të huajt dhe personat pa shtetësi që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç rasteve kur Kushtetuta e lidh ushtrimin e tyre në mënyrë të posaçme me shtetësinë”<sup>4</sup>. Kuadri ligjor që respekton të drejtën për bashkim familjar, në përputhje me parimet kushtetuese dhe direktivën 2003/86/KE përmbahet në Ligjin e ri për të huajt nr. 9959 i miratuar në vitin 2008. E drejta për bashkim

<sup>4</sup> OMARI-A.ANASTASI, *E drejta kushtetuese*, Tiranë, 2008; L.IKONOMI, *E drejta e migracionit*, Tiranë, 2011, fq. 102.

familjar rregullohet shprehimisht në nenin 32 të këtij ligji<sup>5</sup>. Kjo e drejtë i njihet çdo të huaji që ka hyrë dhe qëndron në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me kuadrin ligjor dhe është i pajisur me leje qëndrimi me kohëzgjatje jo më të vogël se një vit. Në bazë të nenit 3, anëtarë të familjes janë bashkëshorti/ bashkëshortja, fëmijët nën moshën 18 vjeç, fëmijët e birësuar ose në kujdestarinë e të huajit, fëmijët e bashkëshortit/bashkëshortës së tij/saj, prindërit e moshuar, në ngarkim të të huajit.

Kërkesa për bashkim i referohet familjes që buron nga martesë monogame. Përjashtohet në këtë kategori partneri. Në rast të të huajve që vijnë nga një vend ku poligamia është e ligjshme, i huaji që kërkon bashkim familjar duhet të zgjedhë vetëm një nga bashkëshortet. Zgjidhja për këta anëtarë të familjes është në përputhje të plotë me legjislacionin komunitar, madje shkon edhe më tej, duke lejuar edhe prindërit nëse janë në ngarkim.

Ligji nr. 8432 datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 6 përcakton se “Të drejtën e azilit, me të njëjtin status, e përfitojnë edhe bashkëshorti, fëmijët e moshës nën 18 vjeç dhe çdo i afërm në ngarkim ligjor i refugjatit, të cilit i është dhënë azil, me kusht që ata të jetojnë së bashku”. Ligji në fjalë parashikon gjithashtu që fëmijët mbi moshën 18 vjeç nuk mund të përfitojnë azil, në bazë të bashkimit familjar, vetëm në rast kur ai/ajo është në ngarkim ligjor të prindërve të tij refugjatë të cilëve u është dhënë azil në vendin tonë. Në këto raste personi në fjalë duhet të paraqesë personalisht një kërkesë individuale.

Në përputhje me detyrimet ndërkombëtare dhe europiane dhe me qëllim integrimin sa më të plotë të tyre, është miratuar Ligji nr. 9098 datë 03.7.2003 “Per integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë”. Bashkimi familjar rregullohet në Kreun VI, në nenet 26-34. Në lidhje me përbërjen e familjes, neni 26 specifikon që: “Personi, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me bashkëshortin ose bashkëshorten, fëmijët e pamartuar nën 18 vjeç ose ndonjë person tjetër në ngarkim të tij”.

<sup>5</sup> Sipas këtij neni: “1. I huaji, i pajisur me leje qëndrimi, i cili qëndron dhe punon në Republikën e Shqipërisë, mund të bëjë kërkesë pranë Policisë Kufitare dhe Migracionit, vendore, për të sjellë familjen, për efekt të ribashkimit familjar, nëse plotëson kushtet e mëposhtme: a) ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji; b) qëndron prej jo më pak se 1 vit në Republikën e Shqipërisë; c) siguron jetesën, në mënyrë të rregullt, në Republikën e Shqipërisë nga të ardhurat apo pronat e bashkëshortit, që qëndron në Republikën e Shqipërisë ose, në rastin e të miturve, nga të ardhurat apo pronat e prindërve; ç) derdh kontribute në sigurimet shëndetësore, për të mbuluar shërbimet e kujdesit shëndetësor; d) garanton mjedise dhe kushte të përshtatshme qëndrimi për familjen; dh) paraqet dokumentacionin, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave. 2. Leja e qëndrimit për ribashkim familjar jepet për një periudhë kohe jo më shumë se leja e qëndrimit të personit, i cili bën kërkesën për ribashkim familjar. 3. Në rast se i refuzohet dhënia e lejes për ribashkim familjar, i huaji ka të drejtë të ankohet pranë ministrit brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim”.

Për të huajt shtetas komunitare që vijnë në Shqipëri Ligji përcakton si anëtarë të familjes:

- (a) bashkëshortin ose bashkëshorten;
- (b) partnerin me të cilin shtetasi komunitar bashkëjeton (*more uxorio*) nëse ata janë të regjistruar, në zyrat e gjendjes civile në bazë të legjislacionit të një Shteti Anëtar, nëse legjislacioni i Shtetit Anëtar pritisë i trajton bashkëjetësat e regjistruara si të njëjta (ekuivalente) me martesën dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislacionin e shtetit pritisë;
- (c) pasardhësit e drejtpërdrejtë të cilët janë nën moshën 21 vjeç ose janë në ngarkim dhe ata të bashkëshortit ose partnerit, siç përcaktohet në pikën (b);
- (d) paraardhësit e drejtpërdrejtë që janë në ngarkim ose të bashkëshortit ose të partnerit siç janë të përcaktuar në pikën (b);

Pra, ashtu si legjislacioni evropian në ushtrimin e të drejtës për bashkim familjar legjislacioni shqiptar përcakton si anëtarë të familjes një kategori *solide* siç janë bashkëshorti, *partneri*, fëmijët e mitur, fëmijët në moshë madhore që janë në ngarkim dhe prindërit: për këto kategori familjarësh nuk ka hapësirë vlerësimi. Hyrja dhe qëndrimi në territorin e këtyre anëtarëve të familjes nuk lihet në diskrecion të Shtetit pritisë (Shqipëria). Ekziston edhe një kategori tjetër familjarësh për të cilët lejohet hyrja dhe qëndrimi për arsye të bashkimit familjar, atëherë kur Shteti Anëtar pritisë e parashikon në legjislacion: bëhet fjalë për a) çdo familjar tjetër, të çfarëdo kombësie në qoftë se është në ngarkim ose bashkëjeton me shtetasin komunitar në shtetin prej të cilit vjen dhe b) partneri me të cilin shtetasi komunitar ka një marrëdhënie të qëndrueshme dhe të vërtetueshme. Për këtë kategori rol thelbësor dhe deciziv ka shteti pritisë i cili rregullon hyrjen dhe qëndrimin e këtyre familjarëve, nëpërmjet legjislacionit të brendshëm. Këtu duhet të theksohet se shtetet e rregullojnë sipas politikave të tyre të brendshme që në disa raste janë favorizuese, ndërsa në disa raste të tjera janë kufizuese. Familjarët që mund të shoqërojnë të huajt shtetas jo komunitare përcaktohen në Ligj. Ata janë:

- a) bashkëshorti/ja e titullarit;
- b) fëmijët e mitur të titullarit dhe të bashkëshortit, duke përfshirë edhe fëmijët e birësuar në përputhje me një vendim të Shtetit Anëtar në fjalë, ose me një vendim automatikisht të detyrueshëm për shkak të detyrimeve ndërkombëtare ose që njihen në përputhje me detyrimet ndërkombëtare;
- c) fëmijët e mitur duke përfshirë të birësuarit, ku titullari aktiv ka kujdestarinë e tyre. Shtetet Anëtare mund të autorizojnë bashkimin familjar të fëmijëve me prindër të divorcuar me kusht që pala tjetër për ndarjen e kujdestarisë ka dhënë pëlqimin e vet;

- d) fëmijët e mitur duke përfshirë të birësuarit, të bashkëshortit kur ka kujdestarinë e tyre. Shtetet Anëtare mund të autorizojnë bashkimin familjar të fëmijëve me prindër të divorcuar me kusht që pala tjetër për ndarjen e kujdestarisë ka dhënë pëlqimin e vet.

Kjo është korniza familjare e një familje të përbërë nga shtetasit jo komunitarë në kuadër të bashkimit familjar, pra familja e vogël. Shteti nuk mund të refuzojnë hyrjen dhe qëndrimin e familjes së përbërë në këtë mënyrë përveç rasteve kur anëtari i familjes përbën një kërcënim real dhe serioz për rendin publik, sigurinë kombëtare ose shëndetin publik. Shteti me ligj, ose akte ligjore të tjera të brendshme mund të autorizojnë hyrjen e të afërmeve të tjerë që janë:

- a) paraardhësit e drejtpërdrejtë të titullarit ose të bashkëshortit/es kur ata janë ekonomikisht të varur prej tyre dhe nuk gëzojnë mbështetjen e duhur familjare në vendin e origjinës;
- b) fëmijët e rritur të pamartuar të titullarit ose të bashkëshortit/es, kur ata nuk janë objektivisht në gjendje për të siguruar nevojat vetjake për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore.

Në rast të një martese poligame, ku titullari e ka një bashkëshorte që jeton në territorin e një Shteti tjetër, Shteti ynë pritisë nuk duhet të autorizojë bashkimin familjar të bashkëshortës së dytë. Pavarësisht nga sa fëmijë ka titullari në fjalë, ne e *kufizojmë* bashkimin familjar të fëmijëve të mitur të tij dhe të një bashkëshorte tjetër. Nuk ka rëndësi cilat nga bashkëshortet kërkon dhe përfiton bashkimin familjar.

Kjo dispozitë specifike është futur me një qëllim: duhet të ndalohen të gjitha rastet e familjeve poligame, edhe *de facto*, që realizohen në territorin e Shqipërisë, pasi këto martesat nuk janë të ligjshme në shume vende.

Në pothuajse të gjitha elementet e ligjit për të huajt kemi përputhje me legjislacionin europian perkates, edhe pse nuk specifikohet kategoria e fëmijëve të rritur që janë në ngarkim të prindërve refugjatë. I vetmi ndryshim dhe mospërputhje haset në përcaktimin e saktë të kategorive si për shembull nuk thuhet qartë fëmijët e bashkëshortit, prindërit në ngarkim, fëmijët e rritur etj. pasi ligji në fjalë e vë theksin më tepër në përcaktimin e procedurave të aplikimit, kërkesave dhe mënyrën e ushtrimit të kesaj të drejtë themelore.

## 5. Konkluzione dhe rekomandime

Regjimi juridik i bashkimit familjar i shtetasve komunitarë dhe jo komunitarë ndryshon. Kuptohet që bëhet fjalë për regjime të ndryshme juridike, të cilat

rregullohen nga akte të ndryshme ligjore. Në kuadër të bashkimit familjar familja komunitare është më e plotë dhe më e mbrojtur dhe përfshin jo vetëm bashkëshortin por edhe partnerin e regjistruar. Dhënia e një përkufizimi kategorik për familjen në tërësi në kuadër të bashkimit familjar është disi e vështirë. Këtë nocion, më shumë se legjislacioni komunitar, e kushtëzon legjislacioni i brendshëm dhe jurisprudenca komunitare ose ajo e brendshme. Para së gjithash është e vështirë të flasim për një anëtarësi të qëndrueshme të familjes. Në këtë drejtim edhe përcaktimi i situatave të veçanta apo i statusit të personave që përcaktojnë përbërjen e familjes, ndryshojnë në varësi të titullarit aktiv (shtetas komunitar ose jo komunitar). Nuk ka dyshim që disiplinat në fjalë janë subjekt i përmirësimeve dhe, në këtë drejtim me qëllim përparimin dhe harmonizimin e politikës së bashkimit familjar.

Duhet thënë se regjimi juridik i bashkimit familjar i shtetasve komunitarë dhe jo komunitarë ndryshon. Kuptohet që bëhet fjalë për regjime të ndryshme juridike, të cilat rregullohen nga akte të ndryshme ligjore. Në kuadër të bashkimit familjar familja komunitare është më e plotë dhe më e mbrojtur dhe përfshin jo vetëm bashkëshortin por edhe partnerin e regjistruar. Rregullimi ligjor i lejimit të hyrjes dhe qëndrimit të partnerëve *de facto* i lihet në dorë Shteteve Anëtare. Ky është një diskrecion i shtetit pritisë dhe jo atij dërgues. Që këtu lindin problemet e unifikimit të legjislacioneve, edhe pse në realitet unifikim nuk ka. Zgjidhja më e përshtatshme në këtë drejtim është ulja e shkallës së mbrojtjes në përputhje me rregullat e shtetit pritisë. Rregullat komunitare në lidhje me bashkimin familjar të shtetasve jo komunitarë janë në hapat e para, rregulla këto që janë subjekt i përmirësimeve ligjore dhe jurisprudenciale. Bashkimi familjar është një e drejtë që garantohet edhe në vendin tonë: është instituti me anë të të cilit shtetasit e huaj që jetojnë dhe punojnë në vendin tonë bashkohen me familjarët e tyre, që vijnë nga vende të tjera dhe ky bashkim realizohet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në pothuajse të gjitha elementet e ligjit për të huajt kemi përputhje me legjislacionin europian perkates, edhe pse nuk specifikohet kategoria e fëmijëve të rritur që janë në ngarkim të prindërve refugjatë. I vetmi ndryshim dhe mospërputhje haset në përcaktimin e saktë të kategorive si për shembull nuk thuhet qartë fëmijët e bashkëshortit, prindërit në ngarkim, fëmijët e rritur etj. pasi ligji në fjalë e vë theksin më tepër në përcaktimin e procedurave të aplikimit, kërkesave dhe mënyrën e ushtrimit të kesaj të drejtë themelore. Ajo që vlen të cilësohet si një arritje tjetër e vërtetë është fakti që të drejtat themelore që gëzojnë anëtarët e familjes së bashkuar, shtetas jo komunitarë, janë plotësisht të njëjta dhe të barabarta me ato të anëtarëve të shtetasve komunitarë. Përmendim në këtë drejtim të drejtën për punësim, të drejtën për qëndrim, të drejtën për formim dhe trajnim profesional etj. Legjislacioni ynë është me i plote dhe me favorizues se dhe legjislacionet e vendeve anetare të BE-së. I njejtë regjim shihet edhe në lidhje me shtetasit amerikane, pavarësisht se kjo kategori nuk është në fokus të këtij studimi. Rregullimi ligjor i lejimit të hyrjes

dhe qëndrimin të partnerëve *de facto* i lihet në dorë Shteteve Anëtare. Ky është një diskrecion i shtetit pritës dhe jo atij dërgues. Pikërisht këtu lindin problemet e unifikimit të legjisllacioneve, edhe pse në realitet unifikim nuk ka. Japim ketu disa rekomandime:

Rregullat komunitare në lidhje me bashkimin familjar të shtetasve jo komunitarë edhe në vendin tone janë subjekt i përmirësimeve ligjore dhe jurisprudenciale në varesi të ndryshimeve sociale, politike dhe ekonomike.

Zgjidhja më e përshtatshme në këtë drejtim do të ishte ulja (ose rritja) e shkallës së mbrojtjes në përputhje me rregullat e shtetit pritës. Vendi yne lejon bashkimin familjar të shtetasve të huaj edhe me partneret, pra është në tejkallim edhe të realitetit të vendeve të BE-se. Për këtë arsye, rekomandimi me këtë pjesë lidhet me pjesën procedurale dhe jo legjisllative.

Mbrojtja e të drejtave lidhur me lëvizjen e lirë dhe respektimin e jetës familjare dhe bashkimin familjar duhet të orientojnë politikën komunitare jo vetëm drejt objektivit për të harmonizuar ndërkombëtarisht zgjidhjet, por, në veçanti, për të shmangur situata juridike të tilla jo favorizuese, të njohura në disa shtete komunitare.

Në lidhje me shtetasit ekstra-komunitarë duhet të merren masat e duhura që t'u sigurojnë atyre të drejta (thuajse) të barabarta me ato të shtetasve të BE –së.

Legjisllacioni shqiptar lidhur me bashkimin familjar edhe pse rezultoi të jetë në përputhje me legjisllacionin evropian përkatës, nuk e perfshin kategorinë e fëmijëve të rritur që janë në ngarkim të prindërve refugjatë.

Në legjisllacionin shqiptar për të huajt duhet t'i meshojmë thjeshtesimit të procedurave lidhur me dokumentacionin si ato të gjendjes civile, të cilat kanë rezultuar problematike lidhur me kategorinë e refugjateve në vecanti.

Duhet të krijohet një përcaktimin i saktë i kategorive: si për shembull nuk thuhet qartë fëmijët e bashkëshortit, prindërit në ngarkim, fëmijët e rritur etj. pasi ligji aktual e vë theksin më tepër në përcaktimin e procedurave të aplikimit, kërkesave dhe mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejtë themelore.

Në lidhje me autoritetet dhe strukturat shtetësore që merren me të huajt dhe refugjatët, duhet të reformohet sistemi dhe të shkohet drejt një institucion i sa më unik për trajtimin e çështjeve të tyre, perfshire ketu edhe bashkimin familjar. Kjo do të lehtësonte trainimin dhe specializimin e personelit dhe zgjidhjen e çështjeve për të huajt brenda të njëjtës institucioni e do të shmange vonesat në lidhje me zgjidhjet përkatëse. Një model i tillë gjendet në disa nga vendet më të përparuar të BE si psh Holanda. Po kështu kjo do të shmange edhe moskuptimet mbi ndërhyrjen e kategorisë së refugjateve në fushat që lidhen me të drejta të cilat refugjatët duhet t'i gëzojnë

Në lidhje me bashkimin familjar, Ministria e Jashtme dhe ajo e Brendshme duhet të nxjerrin akte të qarta nënligjore, të ndryshueshme vetëm nga reformat tërësore

institucionale të cilat i japin zgjidhje çështjes së dokumenteve të paraqitshme, duke pasur parasysh gjendjen e veçantë të refugjateve, ambasadat ku familjarët mund të drejtohen dhe çështjen e numrit të kufizuar të përfaqësive diplomatike e konsullore të RSH nëpër botë, me gjithë pengesat që kjo sjell për paraqitjen personalisht të personave atje.

Në lidhje me dokumentet e gjendjes civile, organet përkatëse të gjendjes civile duhet të sigurojnë menjëherë zbatimin e ligjit dhe lëshimin e këtyre dokumenteve për refugjatët, duke qenë se thjesht rregjistrimi në gjendjen civile, pas asnjë impakti tek personat që janë në nevojë për këto dokumenta, mbetet pa kuptim dhe nuk mund të quhet arritje.

## Bibliografia

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë  
Direktiva 2004/38/KE  
Direktiva 2003/86/KE  
Ligji nr. 9959 datë 18.7.2008 “Për të huajt”  
Ligji nr. 8432 datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”  
Ligji nr. 9098 datë 03.7.2003 “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë”  
COMPASSO A., *Extracomunitari in Europa. Immigrazione, razzismo xenofobia*, Roma, 1995  
CONDINANZI M., LANG A., NASCIMBENE B., *Cittadinanza dell'Unione e libera circolazione delle persone*, ed. 2°, Milano, 2006  
FERRARI BRAVO L.-E.MOAVERO MILANESI, *Lezioni di diritto comunitario*, Editoriale scientifica, 2000  
GIUBBONI S.-G.ORLANDINI, *La libera circolazione dei lavoratori nell'Unione europea*, Torino, 2007  
GUILD E., *The legal elements of European Identity – EU citizenship and Migration Law*, Kluwer Law International, 2004  
IKONOMI L., *E drejta e migracionit*, Tiranë, 2011  
LASOK K.P.E., *Law & Institutions of the European Union*, 7° ed., Butterworths, 2002  
MANDRO A., MECAJ V., ZAKA T., FULLANI A., *E drejta familjare*, Tiranë 2006  
OMARI L.-A.ANASTASI, *E drejta kushtetuese*, Tiranë, 2008  
VILLANI U., *Istituzioni di diritto dell'Unione europea*, Bari, 2008  
SIRIANNI G., *Il diritto degli stranieri all'unità familiare*, Perugia, 2004  
ADINOLFI A., *La libertà di circolazione delle persone*, në G.Strozzi, (a cura di) *Diritto dell'Unione europea*, Torino, 2005, fq. 69-78  
ADINOLFI A., *L'art. 39*, në *Il Codice della famiglia*, M.Sesta, 2007 fq. 370-378  
BEYERS L., *“Italians” in Belgium: a unique process of changing positions and identities*, në *Studi Emigrazione*, 2005, fq. 762-788  
BISCARO A., *Italia: ancora Paese d'emigrazione*, në *Undicesimo Rapporto sulle migrazioni 2005*, Milano, 2006 fq. 76  
BOSCHIERO N., *Les unions homosexuelles à l'épreuve du droit international privé italien*, në *Rivista di diritto internazionale*, n. 1/2007, fq. 50-59

CALAMO SPECCHIA M., *Il Conseil Constitutionnel e la protezione dell'immigrato: la difficile cittadinanza dei diritti costituzionali "deboli" tra accoglienza e integrazione* në *Diritto Pubblico Comparato ed europeo*, 11/2006, fq. 1580-1587

CAMPIGLIO C., *Il diritto di famiglia islamico nella prassi italiana*, në *Rivista di diritto internazionale privato e processuale*, 2008, fq. 43-49

CALVO CARAVACA A.- CARRASCOSA GONZÀLES J., *I matrimoni tra persone dello stesso sesso*, në *La famiglia senza frontiere*. Atti del Convegno tenuto presso la Facoltà di Giurisprudenza dell'Università degli studi di Milano il 25.05.2007, a cura di S.Bariatti – A.Galizia Danovi, fq. 81-87

CARACCILO DI TORELLA E.- MASSELOT A., *Under construction: EU family law*, në *European Journal Law*, 2005, fq. 38-42

CARRILLO M., *La legge spagnola sul matrimonio tra omosessuali ed i principi costituzionali*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 264-268

COLACINO N., *Il diritto al ricongiungimento familiare e la disciplina introdotta dalla Direttiva 2003/86/CE* në *L'Europa tra costituzione asilo e immigrazione* (a cura) di Saulle M.R., Napoli, 2004

CALAMO SPECCHIA M., *Il Conseil Constitutionnel e la protezione dell'immigrato: la difficile cittadinanza dei diritti costituzionali "deboli" tra accoglienza e integrazione* në *Diritto Pubblico Comparato ed europeo*, 11/2006, fq. 1580-1587

CAMPIGLIO C., *Il diritto di famiglia islamico nella prassi italiana*, në *Rivista di diritto internazionale privato e processuale*, 2008, fq. 43-49

DE SCHUTTER O., *Homophobia and Discrimination on Grounds of Sexual Orientation*, (a cura di) European Union Agency for Fundamental Rights, 2008, fq. 67-79

DI PASCALE A.- PASTORE M., *Il recepimento delle direttive sul ricongiungimento familiare e sui soggiornanti di lungo periodo*, në *Diritto Immigrazione e cittadinanza*, 1/2007, fq. 16-23

FIBBI R., *Italiani in Svizzera: da Tschingg a persone frequentabili*, në *Studi emigrazione*, 2005, fq. 733-745

GÒMEZ E.E., *La legge spagnola sul matrimonio tra omosessuali e la Costituzione spagnola*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 267-275

GROENENDIJK K., *Legal concepts of integration in EU migration law*, në *European Journal of Migration and Law*, 2/2004, fq. 119-124

HAILBRONNER K., *Free movement of EU nationals and Union citizenship*, në CHOLEWINSKI R., R.PERRUCHOUD-E. MACDONALD, *International migration law*, The Hague, 2007, fq. 320-332

LAUROBA E., *La legge spagnola sul matrimonio tra omosessuali ed i principi del diritto civile spagnolo*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 272-281

MISSORICI M.-C.ROMANO, *Libertà di circolazione e soggiorno: i cittadini degli Stati terzi tra cittadinanza europea e politica delle migrazioni*, në *Rivista internazionale dei diritti dell'uomo*, n. 11/98, fq. 44-48

PALLARO P., *Coppie di fatto e ricongiungimento familiare nell'ordinamento comunitario: un nuovo indirizzo della Corte di giustizia?*, në *Diritto comunitario e degli scambi internazionali*, 2001 fq. 261-265

PIGNATELLI N., *Nozione di matrimonio e disciplina delle coppie omosessuali in Europa*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 260-268

ROSSI L.S., *I beneficiari della libera circolazione delle persone*, në *Foro italiano*, 1994, fq. 98-105

ROMBOLI R., *La legge spagnola sul matrimonio tra persone dello stesso sesso e la tutela delle coppie omosessuali in Italia. Note introduttive*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 256-261

RUBINACCI L., *La circolazione dei lavoratori nella Comunità economica europea*, në *La libera circolazione dei lavoratori*, Rassegna del lavoro, a cura del Ministero del lavoro e della previdenza sociale, Roma, 1962, fq. 11-23

SANNA C., *La direttiva 2004/38/CE relativa al diritto dei cittadini dell'Unione e dei loro familiari di circolare e soggiornare liberamente nel territorio degli Stati membri*, në *Rivista di diritto internazionale privato e processuale*, 42/2006, fq. 1167-1178

TRIFONE L., *L'ammissibilità di limiti parziali alla libera circolazione delle persone: la sentenza Oteiza Olazabal*, në *Il Diritto comunitario e degli scambi internazionali*, 42/2003, fq. 758-766

TOMASI L., *La nozione di famiglia negli atti dell'Unione europea e della Comunità europea*, në S.BARIATTI (ed.), *La famiglia nel diritto internazionale privato comunitario*, Milano, 2007 fq. 51-55.

#### Vendime të Gjykatës Europiane të Drejtësisë

Vendimi dt. 8 korrik 1992, çështja C-243/91, *Tanghavi*, në *Përmbledhjen Vjetore 1992*, fq. I-4401

Vendimi dt. 18 tetor 1990, çështjet e bashkuara C-297/88 dhe C-197/89, *Dzodzi* në *Përmbledhjen Vjetore 1990*, fq. I-3763

Vendimi dt.13 shkurt 1985, çështja 267/83, *Diatta c. Land di Berlino*, në *Përmbledhjen Vjetore 1985*, fq. 567.

Vendimi dt. 18 qershor 1987, *Lebon*, çështja 316/85, në *Përmbledhjen Vjetore 1987*, fq. 2811; vendimi dt. 17 qershor 1975, çështja 7/75, *Coniugi F k. Shtetit belg*, në *Përmbledhjen Vjetore 1975*, fq. 679.

# *Ndërmjetësimi i veprave penale të miturve në Shqipëri. Një disiplinë që duhet të zhvillohet*

*Msc. Eglantina Golemi*

## **Abstrakt**

*Kur një shoqëri pushon së konsideruari mbrojtjen e fëmijëve atëherë fillon shpërbërja progresive e themeleve të saj. Ndërmjetësimi i veprave penale të të miturve synon zbehjen e monopolit të funksionit disiplinor nga ana e sistemeve të drejtësisë penale si një mënyrë e qeverisjes së dhunës, e cila nuk prodhon më rehabilitimin social të dëshiruar. Shumë legjislacione të vendeve të zhvilluara evropiane disponojnë një sistem ndërmjetësimi penal të konsoliduar dhe të besueshëm në trajtimin e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve penale të të miturve. Ndërmjetësimi në fushën penale është një mënyrë e re e administrimit të situatave problematike i cili përcakton synimin e drejtësisë restauruese si një formë e drejtësisë e cila merret me konfliktet që cenojnë jetët e njerëzve. Në vendin tonë ndërmjetësimin në fushën penale është i sanksionuar në nenin 2 të Ligjit nr. 10835 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve".*

*Ndërmjetësimi i veprave penale të të miturve në Shqipëri është një disiplinë e pazhvilluar. Në kushtet kur mbrojtja e interesit më të lartë të të miturve është një nga sfidat më të rëndësishme me të cilat përballlet shoqëria sepse përfshirja e të miturve në strukturat kriminale ka një trend në rritje, mendoj se ndërmjetësimi i veprave penale të të miturve duhet të sanksionohet dhe të gjej zbatim në legjislacionin tonë të brendshëm, si një formë e dobishme për rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturve në shoqëri.*

**Fjalët kyçe:** *Ndërmjetësimi, ndërmjetësimi penal, drejtësi restauruese, i mitur, viktima*



## 1. Koncepti i ndërmjetësimit penal. Një vështrim historik i ndërmjetësimit të të miturve në veprat penale

Ndërmjetësimi penal është një domosdoshmëri aktuale i cili synon zbehjen e monopolit të funksionit disiplinor nga ana e sistemeve të drejtësisë penale si një mënyrë e qeverisjes së dhunës e cila nuk prodhon më rregullin e rehabilitimit social të dëshiruar. Shumë legjislacione të vendeve të zhvilluara kanë krijuar tashme një sistem ndërmjetësimi penal të konsoliduar dhe të besueshëm në trajtimin e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve penale.<sup>1</sup>

Ndërmjetësimi si koncept në kuptimin e gjerë konsiderohet si një teknikë e re e administrimit të konflikteve e cila realizohet me ndërhyrjen e një personi “të tretë neutral” (ndërmjetësuesi), i cili me anë të shkëmbimeve midis palëve, i ndihmon ato të gjejnë një zgjidhje ndaj problemit që i ndan. Termi ndërmjetësim në fushën penale përgjithësisht kuptohet si një mënyrë e re e administrimit të situatave problematike, i cili përcakton synimin e drejtësisë restauruese.<sup>2</sup> Palët në konflikt penal janë autori dhe viktimi e veprës penale dhe motivi i konfliktit kërkohet pikërisht tek vetë vepra penale. Roli i ndërmjetësimit në këtë rast është promovimi dhe zbutja e konfliktit midis fajtorit dhe palës së dëmtuar nga vepra penale, nëpërmjet ri-paqësimit të dy subjekteve dhe riparimit simbolik më tepër se material të dëmit të shkaktuar<sup>3</sup>. Gian Vittorio Pisapia e ka përkufizuar ndërmjetësimin penal si “rruga e mesme” që karakterizohet si “vendi i rindërtimit të lidhjes”, nëpërmjet gjetjes së një hapësire sociale brenda të cilës mund të zhvillohen takimet rindërtuese midis fajtorit dhe viktimës, duke parashikuar në këtë sens një aktivitet që ka si qëllim zgjidhjen e konflikteve<sup>4</sup>

Ndërmjetësimi e veprave penale nga të miturit është një fushë ende në zhvillim e cila lindi si një domosdoshmëri shoqërore për trajtimin e mosmarrëveshjeve të kryera nga të miturit larg dyerve të gjykatave dhe prokurorisë. Kjo formë ndërmjetësimi u krijua nga mesi i viteve shtatëdhjetë bazuar në eksperiencat e disa prej vendeve europiane rreth efekteve negative të mundshme që krijon përballja e të miturit me sistemin penal. Gjermania ishte një ndër shtetet e parë të BE-së e cila projektoj në vitin në vitin 1985 projekt pilotet e parë në ndërmjetësimin e

veprave penale të të miturve, të cilat rezultuan të suksesshme duke ndihmuar dhe në hartimin e një legjislacioni të mirëfillte në këtë fushë. Synimi i kësaj iniciative ishte mbrojtje dhe reduktimi në minimum i ndikimit të sistemit gjyqësor ndaj të miturit, në veçanti të ndërhyrjeve me natyrë detyrues edhe shtrënguese dhe rritja e procesit edukues.<sup>5</sup>

Shqipëria ka një kulturë të pazhvilluar në lidhje me ndërmjetësimin e veprave penale nga të miturit kjo si rrjedhojë e problematikave që ka pasur dhe ende vazhdon të letë legjislacioni i ndërmjetësimit në këtë fushë por edhe si pasojë e mungesës së informimit dhe të besimit që kanë personat ndaj institutit të ndërmjetësimit.<sup>6</sup> Konflikte penale kanë një shkallë ndjeshmërie më të lartë në krahasim me ato civile dhe familjare. Kryefjala e këtyre konflikteve është kryesisht jeta, dinjiteti dhe rehabilitimi i individit të përfshirë në mosmarrëveshjet penale. Aktualisht në vendin tonë nuk ekziston një Zyrë Qendrore për Drejtësinë e të Miturve e cila do të luante një rol kryesor në administrimin e këtij procesit të ndërmjetësimit të veprave penale nga të miturit së bashku me organet institucionale ekzistuese.

## 2. Ndërmjetësimi në Shqipëri. Rëndësia dhe risit që ka sjell ligji i ri

Ndërmjetësimi, si një mënyrë alternative e zgjidhjes së konflikteve, ka qenë përherë pjesë e shoqërisë shqiptare. Populli shqiptar në kushtet e mungesës së shtetit të pavarur e të pushtimeve të huaja është vetëqeverisur nëpërmjet normave të drejtës zakonore si e vetmja mënyrë ky mund të gjendej drejtësi.<sup>7</sup> Ndërmjetësimi në Shqipëri e ka zanafillën te e drejta zakonore shqiptare e cila përbëhet prej kanuneve, nga ku më i rëndësishme, Kanuni i Lekë Dukagjinit, i cili ka trajtuar “ndërmjetësimin për pajtim” si alternativë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe konflikteve.<sup>8</sup>

Instituti i ndërmjetësimit për pajtim ka jo vetëm karakter historik, por edhe juridik. Ky pajtim është realizuar ose drejtpërdrejtë nga palët në konflikt ose me anë të ndërmjetësimit për pajtim. Instituti i ndërmjetësimit për pajtim ka luajtur rol përparimtar, sepse ka vepruar për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve, kundër grindjeve, përçarjeve e hasmërive dhe ka luajtur rol emancipues e civilizues në shoqërinë shqiptare. Instituti i ndërmjetësimit me pajtim i sanksionuar në të drejtën zakonore ka vepruar deri në vitet 90.

<sup>1</sup> Prof. Dr. Ismet ELEZI, në manualin “Ndërmjetësimi për pajtim në konfliktet penale”, Tiranë, 2004, fq.145

<sup>2</sup> Ref. A. Ceretti: “Una risposta al minore autore di reato: la mediazione penale”, në *Justitia*, 1997 vol. 4., fq. 376-398. Relacion i mbajtur nga Prof. A. Ceretti në Konventën nr. 46° kombëtare të studimit të Bashkimit të Juristëve Katolikë Italianë, i mbajtur në Romë në datat 6-7-8 dhjetor 1996 mbi temën: “La tutela del minore”.

<sup>3</sup> Prof. Dr. Ismet ELEZI, në manualin “Ndërmjetësimi për pajtim në konfliktet penale”, Tiranë, 2004, fq.155

<sup>4</sup> G.V. Pisapia në “Rassegna italiana di criminologia”, nr° 4, 1993.

<sup>5</sup> Dekreti i Presidentit të Republikës Italiane – D.P.R. n. 448 datë 22 shtator 1988 (Miratim i dispozitave mbi procesin penal në ngarkim të të pandehurit të mitur)

<sup>6</sup> Alketa Elezi “Ndërmjetësimi në mosmarrëveshjet penale në kontekstin e drejtësisë rehabilituese” Jeta juridike Nr.1, Mars 2010.

<sup>7</sup> Prof. Dr. Ismet ELEZI, në manualin “Ndërmjetësimi për pajtim në konfliktet penale”, Tiranë, 2004, fq.145

<sup>8</sup> Dr. Erjona Canaj” Ndërmjetësimi tregtar si një mundësi bashkëkohore e zgjidhjes së konfliktit” Fq.2

Iniciativa e parë ligjore, e ndikuar edhe nga klima e politikave ndërkombëtare, që shërbeu edhe si guri i themelit të në fushën e ndërmjetësimit u ndërmor nga një grup ekspertësh në vitin 1999, ku ligjvënësi ynë miratoi ligjin nr. 8465, datë 11/03/1999 “Për zgjidhjen e konflikteve dhe pajtimin e mosmarrëveshjeve”. Kjo iniciativë nuk rezultoi e suksesshme për faktin sepse nuk e konsideronte ndërmjetësimin si alternativ të zgjidhjes së konflikteve. Në këto kushte dhe përball domosdoshmërisë së hartimit të një legjislacioni të përparuar dhe bashkëkohor, legjislatori vendas vendosi hartimin dhe miratimin e ligjit Nr. 9090 datë 26.06.2003 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”. Ky ligj shfuqizoi ligjin nr. 8465, datë 11/03/1999 “Për zgjidhjen e konflikteve dhe pajtimin e mosmarrëveshjeve” dhe sanksionoi ndërmjetësimin si alternativë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve fushën e së drejtës civile, tregtare, familjare dhe penale.<sup>9</sup> Në këtë ligj përcaktohet se ndërmjetësi që duhet që të ushtroj veprimtarinë e tij duhet të jetë një subjekt i licensur dhe i regjistruar në Gjykatë si persona fizikë apo juridikë.<sup>10</sup>

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit me atë të Bashkimit European pas nënshkrimit të MSA-së, dhe në mungesë të përdorimit efektiv të ligjit të mëparshëm të ndërmjetësimit, u miratua në datë 24.2.2011, Ligji nr. 10835 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” i cili shfuqizoi ligjin e mëparshëm. Hartimi dhe miratimi i këtij ligji erdhi edhe si pasojë e ndërgjegjësimit të shoqërisë civile për të përdorur subjektet ndërmjetësuese si mjete për zgjidhjen e konflikteve.<sup>11</sup> Ky ligj është hartuar në përputhje me direktivën 2001/52/EC të BE-së dhe e konsideron ndërmjetësimin si një veprimtari jashtëgjyqësore, në të cilën palët kërkojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje me anë të një personi të tretë asnjans (ndërmjetësit), për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që nuk bie në kundërshtim me ligjin.<sup>12</sup> Në lidhje me ndërmjetësimin penal edhe ky ligj nuk solli ndonjë risi për mënyrën e trajtimit dhe nuk zgjeroi gamën e çështjeve penale të cilat mund të trajtohen me ndërmjetësim. Kështu në paragrafin 3 të nenin 2 të ligjit nr. 10835 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” përcaktohet se “Ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet për mosmarrëveshjet që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, ose me ankim të të dëmtuarit, sipas neneve 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në çdo rast kur ligji i veçantë e lejon atë”

Synimi i ligjit të ri ka qenë ulja e ngarkesës së punës së gjykatave civile dhe penale në lidhje me disa çështje të cilat mund të zgjidhen edhe nëpërmjet ndërmjetësimit. Ndërmjetësimi

<sup>9</sup> Neni 2 i ligjit nr. 9090 datë 26.06.2003 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” Ndërmjetësimi, sipas këtij ligji, zbatohet për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve në fushën e së drejtës civile, tregtare, familjare dhe penale, që shqyrtohen nga gjykata, sipas neneve 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale

<sup>10</sup> Neni 4, paragrafi 4 sanksionon se: “Ndërmjetësuesit, që e ushtrojnë këtë veprimtari si profesion, kanë të drejtë të kërkojnë dhe të shpërblehen për punën, si dhe për shpenzimet e kryera në procedurën e ndërmjetësimit, sipas marrëveshjes për ndërmjetësim të nënshkruar nga palët”.

<sup>11</sup> Ligji nr. 10835 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”

<sup>12</sup> Neni 1 i , Ligjit nr. 10835 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”

u ofron subjekteve që to të ishin pjesë e proceseve gjyqësore një zgjidhje të shpejt në kohë transparente , kjo për faktin që ndërmjetësi nuk i detyron palët të pranojnë vendimin e tij, por i ndihmon atë nëpërmjet dialogut të gjejnë zgjidhjen me të mirë dhe eficiente për ta. Por nga analizimi i legjislacionit përkatës është evidentuar se ligji për ndërmjetësimin dhe zbatimin e tij nuk kanë qenë shumë të suksesshëm për shkak të mungesës së harmonizimit me pjesën tjetër të legjislacionit. Në këto kushte në janar të vitin 2016 në vazhdim të nismës së përafrimit të legjislacionit tonë atë të BE-së dhe reformës në Drejtësi, u ndërmarr një reformë për përgatitjen e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” me mbledhjet e përbashkëta të grupit të ekspertëve të nivelit të lartë të mbështetur edhe nga EURALIUS.

Ekspertët evidentuan se ndërmjetësimi është aplikuar në mënyrë të kufizuar dhe roli i sistemit gjyqësor në rritjen e përdorimit të shërbimeve të ndërmjetësimit ka qenë i ulët në krahasim me objektivat e ligjit të mëparshëm. Në këto kushte u evidentua nevoja e rritjes së përdorimit të shërbimit të ndërmjetësimit duke e harmonizuar atë me kodet e procedurave dhe fuqizimi i profesionit të ndërmjetësit duke rritur kapacitetet e dhomës, përmirësimi i bashkëpunimit me institucionet e tjera etj. Ky institucion ka nevojë për një mbështetje për të arritur besueshmërinë e duhur të qytetarët, e cila do të realizohej vetëm nëpërmjet një implementimit si të detyrueshëm të këtij procesi në disa procedura legjislative.

Ndryshimet e reja në ligjin “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” fokusohen kryesisht në forcimin e statusit të ndërmjetësve duke konsoliduar standardet etike dhe krijimin e një Kodi Etik Evropian. Risi e projektligjit është pavarësia e Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve, si një organizëm që ka raporte të tilla me DHKN sa të mos e dëmtojnë pavarësinë e tij në procesin e dhënies së licencave të ndërmjetësve. Inkurajimi i gjykatave që të përfshijnë sa më shumë ndërmjetës në zgjidhjen e çështjeve do tu vinte në ndihmë duke reduktuar ndjeshëm volumin e punës kryesisht në çështje familjare apo ato tregtare. Rritja e besueshmërisë do të arrihej nëpërmjet përfshirjes së kriterit të eksperiencës së punës në sektorin në të cilin ndërmjetësi do të operonte. Kështu plotësimi i kriterëve të përzgjedhjes së ndërmjetësve duke shtuar eksperiencën 3 vjeçare në punë, ekuivalentimin me trajnimin fillestar të studimeve pasuniversitare në programin Master për alternativat e zgjidhjes së konflikteve dhe menaxhimin e tyre, si dhe eksperiencat mbi 10 vjeçare në fushën akademike, e përmirësojnë cilësinë dhe profesionalizimin e ndërmjetësve. Një risi e ligjit është specializimi i ndërmjetësve në fushat tregtare dhe në atë të drejtësisë për të miturit. Kështu projekt ligjit ka parashikuar kushtin e eksperiencës dhe trajnimin specifik për çështjet e fushave të ndryshme që u drejtohen të miturve. Vendosja e këtij kushti është parë si esencial pasi trajtimi me prioritet dhe duke respektuar të drejtat e tyre dhe procesit të integritetit më të shpejt të tyre në shoqëri.

### 3. Ndërmjetësimi i veprave penale nga të miturit. Eksperienca e disa prej vendeve evropiane

Në vitet e fundit është konstatuar një përhapje e gjerë në Evropë të programeve ndërmjetësuese midis viktimës dhe autorit të krimit, për një kategori të larmishme veprash penale duke përfshirë dhe ndërmjetësimin në veprat penale të të miturve, si një model sukseesi për ri-integrimin e tyre në shoqëri. Eksperienca e disa prej vendeve më të zhvilluara të Bashkimit Evropian flet qartë për suksesin e kësaj disiplinë dhe rëndësinë e implementimit të saj në sistemim e brendshëm ligjor.

**Gjermani** në vitin 1985 hodhi themelet e para në lidhje me ndërmjetësimin penal për të miturit, duke u shndërruar kështu në vendin e parë ku nisën të aplikohen projektet e para eksperimentale të ndërmjetësimit penal për të miturit. Këto projekte gjetën zbatim kryesisht falë bashkëpunimit nga ana e Gjykatave për të miturit dhe në seleksionimin e rasteve për trajtim ndihmonin asistentët socialë dhe forcat e policisë. Realizimi me sukses i projekteve pilote në Gjermani bëri që në vitet 90, me hyrjen në fuqi të legjislacionit të ri të të drejtës për të miturit ndërmjetësimi të formatizohej juridikisht si masë edukuese duke parashikuar që i mituri “të sforcohet të arrijë një marrëveshje me viktimën”<sup>13</sup>. Në këtë mënyrë ligjvënësi ka dashur ti japë rëndësi fenomenit “riparues” të veprës penale të kryer nga të miturit.

Një veçori i të drejtës penale për të miturit në Gjermani është mundësia për t’i urdhëruar fajtorit ndërmjetësimin në rastet kur ekziston një disponibilitet në këtë sens nga ana e autorit të veprës penale.<sup>14</sup> Projektet e ndërmjetësimit, nëse nuk zhvillohen brenda sistemit të Drejtësisë vihen në jetë gjithmonë në bashkëpunim me Prokurorinë për të Miturit, ose me Gjykatën për të Miturit. Aktualisht sistemi ligjor Gjerman në fushën e ndërmjetësimit mund të konsiderohet si një model sukseesi i cili e konsideron ndërmjetësimin me një masë ri-edukuese.<sup>15</sup> kështu prokurori i të miturve mund të heqë dorë nga ndjekja penale ndaj të miturit autor i veprës penale, nëse janë marrë ndërkohë masat edukuese.

Ndërmjetësimi i veprave penale të të miturve në sistemin gjerman kushtëzohet nga plotësimi i disa kushteve ndër të cilat janë :vullneti i lirë i fajtorit dhe i viktimës dhe arritja e një konsensusi nga subjektet pa ushtruar asnjë lloj presioni, klauzola e “irrelevancës”. Funksionimi me sukses i ndërmjetësimit të veprave penale të të miturve në Gjermani ka mundësuar që legjislacionit të hedh një hap përpara duke aplikuar ndërmjetësimin edhe në raste të personave recidivist. Kjo procedurë ka

<sup>13</sup> D. DOLLING TaterOpfer-Ausgleich in Deutschland, (Forum Verlag Godesberg, Bonn 1998).

<sup>14</sup> F. Dünkler: “La mediazione in Germania”, në La mediazione nel sistema penale minorile, shih fq. 120-121

<sup>15</sup> 45 II JGG (Jugendgerichtsgesetz: e drejtë – ose ligj – për të miturit).

rezultuar të jetë e suksesshme duke arritur një përqindje 20-50% të pjesëmarrjes së të miturve recidivë që marrin pjesë në procedurat e ndërmjetësimit.<sup>16</sup>

**Italia** ndryshe nga sa ka ndodhur në vende të tjera evropiane ndërmjetësimi jashtëgjyqësor është bërë objekt studimi dhe aplikimi konkret pas vitit 1995. Kështu në nenin 29 të Dekretit Legjislativ nr. 274 i vitit 2000 “*Disposizioni sulla competenza penale del giudice di pace*” përcaktohet se : “Gjyqtari, kur vepra penale ndiqet me ankimin e palës së dëmtuar, promovon pajtimin midis palëve. Në këtë rast, nëse e konsideron të nevojshme për të favorizuar ndërmjetësimin, gjyqtari shtyn seancën për një periudhë jo më të madhe se dy muaj, dhe kur nevojitet mund të kërkojë ndihmën e strukturave publike apo private të pranishme në territor, të cilat kryejnë procedura ndërmjetësimi”

Në legjislacionin Italian vështirësia që ka hasur procedura e ndërmjetësimit për të miturit është ekzistenca e parimit të “detyrueshmërisë së ndjekjes penale”, parim i përcaktuar edhe në Kushtetutën Italiane.<sup>17</sup> Për rrjedhojë, procedura e ndërmjetësimit penal gjeti aplikim vetëm në raste të parashikuara në disa nene të sanksionuara të Dekretit të Presidentit të Republikës – italiane, me nr. 448/1988.<sup>18</sup> ndërmjetësimi është një proces i cili bazuar në nenin 555 K.Pr.P e shndërron të detyrueshme tentativën e ndërmjetësimit nga Gjyqtari, i cili në rolin e ndërmjetësuesit, pozicionohet në rolin e personit të tretë, i tillë që mund të garantojë, potencialisht, neutralitetin karshi palëve në konflikt. Një ndër problematikët kryesore që ka Italia në lidhje me ndërmjetësimin e veprave penale të të miturve është legjislacioni i copëzuar. Prania e një baze ligjore të mangët dhe jo-eksplicite, ka penguar për të garantuar një zhvillim të përshtatshëm dhe homogjen në gjithë Italinë për rrjedhojë është e nevojshme përmirësimi i legjislacionit në këtë drejtim.

**Austria** : Projektet e para të ndërmjetësimit të veprave penale të të miturve në Austri datojnë nga mesi i viteve 30 duke ardhur më një tendencë zhvillimi pozitiv në rritje. Që nga viti 1985 në Austri aplikohet ndërmjetësimi jashtëgjyqësor (ATA)<sup>19</sup> i cili fillimisht u projektua si një eksperimenti i cili rezultojë i suksesshëm dhe hodhi themelet për një sistem të mirëfillte të ndërmjetësimit në këtë vend.

Ndërmjetësimi jashtëgjyqësor (ATA) i ka hapur rrugën një bashkëpunimi midis asistentëve socialë dhe drejtësisë për të miturit. Ndërmjetësimi jashtëgjyqësor penal ishte masa e parë e adoptuar në Austri në fushën penale, e përqendruar rreth interesave të viktimës e iniciuar nga Gjykatësi ose nga Prokurori, me përjashtim të veprës penale të vrasjes, ku ligji i të miturve parashikon shprehimisht që nuk mund të jetë Prokurori ai që merr iniciativën.

<sup>16</sup> F. Dünkler: “La mediazione in Germania”, në La mediazione nel sistema penale minorile, shih fq. 127-128.

<sup>17</sup> Shih nenin 2 të Kushtetutës Italiane

<sup>18</sup> Shih nenet 9, 27, 28 të Dekretit të Presidentit të Republikës – italiane, me nr. 448/1988.

<sup>19</sup> Außergerichtlicher Tatausgleich.

Në qendër të sistemit të ndërmjetësimit të veprave penale nga të miturit në Austri është gatishmëria e të miturit nën hetim që të përgjigjet për veprën penale të kryer dhe të tentojë të rregullojë pasojat duke shpërblyer dëmin e shkaktuar. Në rastet e veprave penale të cilat janë në proces gjyqësor është Gjyqtari ai që inicion procedurën e ndërmjetësimit (ATA) me kusht që shkalla e fajësisë të mos jetë e lartë dhe që ndëshkimi të mos jetë i nevojshëm për të ndaluar që i pandehuri të kryejë veprime të tjera që parashikohen si vepër penale<sup>20</sup>. Asistentët socialë, psikologët dhe juristët me kualifikim specifik mund të kryejnë rolin e ndërmjetësuesit.

Procedura e ndërmjetësimit të veprave penale nga të miturit në Austri kalon nëpërmjet organit të akuzës i cili pasi merr në shqyrtim kallëzimin që i ka ardhur vlerëson nëse rasti mund të zgjidhet duke aktivizuar procedurën e ndërmjetësimit. Kur ndërmjetësimi jep rezultat pozitiv Prokurori, mbi bazën e raportit të Shërbimeve Sociale, mund të heqë dorë nga ndjekja penale ndaj të miturit. Në rastet e veprave penale, kallëzimi i të cilave i drejtohet drejtpërdrejt Gjykatës, procedura mund të fillojë me iniciativë të Gjyqtarit. Gjatë procedurës së ndërmjetësimit realizohen takime me autorin me të miturin për të parë shkallën e arsyetimit dhe reflektimit nda ngjarjes. Këto takime nëse rezultojnë të suksesshme vazhdojnë me takimin ndërmjet të akuzuarit (të miturit) dhe të dëmtuarit, duke i ndihmuar që të arrijnë në një marrëveshje. Ndërmjetësuesi ka një rol vendimtarë në hartimin e marrëveshjes konform legjislacionit duke kuruar anën juridike të marrëveshjes. Një ndër aspektet më të rëndësishme të marrëveshjes është forma dhe mënyra e kompensimit e cila duhet të monitorohet nga struktura ndërmjetësuese, e cila ka përgjegjësinë të kontrollojë nëse është respektuar marrëveshja.<sup>21</sup> Karakteristik e modelit austriak është që kur një rast disponon të gjitha karakteristikat për tu zgjidhur me anë të ndërmjetësimit jashtëgjyqësor dhe Prokurori apo Gjykatësi refuzojnë të marrin në konsideratë këtë mundësi, palët kanë të drejtë të paraqesin apel kundër këtij vendimi. Kjo dispozitë, që i jep palëve një mjet të aftë ti njohë atyre “të drejtën” për ndërmjetësim, nuk e gjejmë në asnjë vend tjetër të Evropës.

#### 4. Mungesa e ndërmjetësimit penal të miturve në Shqipëri dhe drejtësia restauruese brenda sistemit penal

Forma e parë e ndërmjetësimit në Shqipëri ka qenë “ndërmjetësimin për pajtim” i cili përdorej si alternativë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe konflikteve<sup>22</sup> duke luajtur rol të rëndësishëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të ndryshme dhe

<sup>20</sup> Veç kërkesave të parashikuara në § 7 të JGG austriak.

<sup>21</sup> Bernhard Trummer dhe G. Kaufmann, në *La mediazione nel sistema penale minorile*, L. Picotti, shih fq. 149-159.

<sup>22</sup> Kanuni i Lek Dukagjinit, paragrafi 668 përcakton se “ndërmjetës thirret aj, i cili hin për me da fjalët e kqij, a me shmang rragen, prej të cilave mund të shkaktohet vrasa a ndo i rrënim tjetër.” Paragrafi 682 përcakton se “Ndërmjetësia mbaron gjithëherë a me të rame të diellit a me të marrun të diellit (me të lem a me perëndim të diellit)”

duke synuar të zbeh përçarjet dhe hasmëritë e krijuara nga konfliktet njerëzore. Në Kanunin e Lek Dukagjinit nuk trajtohet ndërmjetësimi në zgjidhjen e konflikteve të të miturve, kjo për arsye se përgjegjësinë për veprimet e realizuara nga të miturit, sipas kanunit, e ka kryefamiljari ose personat e tjerë përgjegjës të fisit të të miturit.<sup>23</sup>

Ndërmjetësimi penal është një disiplinë e zhvilluar në 20 vitet e fundit në vendin tonë dhe ka si synim të realizoj negociata në fushën penale duke ofruar alternativa në zgjidhjen e konflikteve por fusha e zbatimit të ndërmjetësimit penal, jo vetëm në vendin tonë por edhe më gjerë, është e limituar në një numër të kufizuar dispozitash, referuar kryesisht kundërvajtjeve penale.<sup>24</sup> Ligji aktual për ndërmjetësimin në paragrafin 4 të nenin 2, pika a) përcakton se “*gjykata ose organi përkatës shtetëror, brenda kompetencave të parashikuara në ligj, detyrimisht ftojnë palët për zgjidhjen me ndërmjetësim, në çështjet civile dhe familjare, kur ndërthuren interesat e të miturve*” duke devijuar trajektoren e ndërmjetësimit të të miturve vetëm në çështjet civile dhe familjare.

Ndërmjetësimi i veprave penale të të miturve është një disiplinë ligjore e pazhvilluar në Shqipëri. Në kushtet kur mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës, integrimi social i tyre, rehabilitimi i fëmijëve në konflikt me ligjin është kthyer në një sfidë për shoqërinë njerëzore, ndërmjetësimi i veprave penale ndaj të miturve duhet të integrohet si pjesë primare e legjislacionit për të miturit.

Legjislacioni i vendit tonë është ende në procesin e harmonizimit më atë të BE-së, nga ku interesi më i lartë i fëmijës dhe riintegrimi i shëndetshëm i tyre në shoqëri është kryefjala e çdo akti ligjor. Në përputhje me procesin e harmonizimit duhet të integrohen në legjislacionin e brendshëm Direktivat për drejtësinë për të miturit, Vjenë 1997, ku përpos promovimit të drejtësisë restauruese sanksionohet edhe ndërmjetësimi i veprave penale të të miturve.

Ndërmjetësimi shërben si një absorbues i një sërë problemesh shoqërore, duke i zgjidhur konfliktet penale dhe ato civile në një kohë tepër të shkurtër dhe në një mënyrë shumë efikase, gjë që ndikon në rehabilitimin e shpejtë autorit të veprës penale (të miturit) dhe në rikuperimin e shpejtë të viktimës nga këndvështrimi psikologjik. Aktualisht fokusi i të gjitha akteve ndërkombëtarë, në të cilat vendi ynë ka aderuar, është një proces sa më i shkurtër në kohë me një zgjidhje të shpejtë që nuk do të ndikonte negativisht në psikologjinë e të miturit dhe mendoj që procesi i ndërmjetësimit i përmbush këto objektiva.

Procesi i ndërmjetësimit duhet të ofrohet falas për të miturit duke respektuar dhe të gjitha të drejtat e tjera të të miturit që i janë akorduar nga legjislacioni

<sup>23</sup> Shih paragrafët 776 dhe 774 të Kanunit të Lekë Dukagjinit

<sup>24</sup> Në paragrafin 3 të të nenin 2 të ligjit nr. 10835 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” përcaktohet se ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet vetëm në nenet 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale. Karakteristik e ndërmjetësimit penal është që vihet në jetë vetëm nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, ose me ankim të të dëmtuarit.

në fuqi.<sup>25</sup> Në legjislacionin tonë duhet të parashikohet ndërmjetësimi i veprave penale nga të miturit edhe në kuadër të promovimit të drejtësisë restauruese e cila ka në fokusin e vetë cilësinë e jetës së individit. Implementimi i kësaj discipline do të kërkonte marrjen e disa masave nga ana e shtetit shqiptarë si përfshirja e kësaj procedure si pjesë e legjislacionit të ndërmjetësimit, realizimi i ndryshimeve të legjislacioneve përkatëse të sistemit gjyqësorë dhe të prokurorisë në lidhje me implementimin dhe zbatimin e këtij procesi.

Për të evituar dështimin e këtij procesi duhet të vendoset kriteri i eksperiencës për ndërmjetësit që do të trajtojnë çështjet e të miturve si kusht për realizimin e procedurës së ndërmjetësimit. Kështu ndërmjetësit që do të trajtojnë çështjet e të miturve duhet të jetë ose ekspert në çështjet e të miturve ose avokat me një eksperience pune 10 vjeçare. Implementimi i këtij kriteri mendoj që do të rriste ndjeshëm besueshmërinë e institucionit të ndërmjetësimit në shoqëri duke krijuar edhe një iniciativë individuale në shkallë më të lartë të pjesëmarrjes së të miturve në procedurën e ndërmjetësimit. Duhet të përcaktohen një kategori veprash penale të realizuara nga të miturit, të cilat duhet të jenë pjesë e ndërmjetësimit të detyrueshëm,<sup>26</sup> me qëllim mos abuzimin nga ana e institucioneve kompetente të delegimit e zgjidhjes së çështjes pranë ndërmjetësve.

Në nenin 3 paragrafi 4 dhe 5 të ligjit nr. 10835 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” përcaktohet se “*Ndërmjetësi nuk ka përgjegjësi nëse ndërmjet palëve për zgjidhjen e konfliktit me ndërmjetësim nuk arrihet marrëveshje, ose nëse marrëveshja është arritur, por nuk zbatohet nga palët. 5. Në rastin kur palët arrijnë një marrëveshje për zgjidhjen e konfliktit ndërmjet tyre, ndërmjetësi nuk ka përgjegjësi për moszbatimin e kësaj marrëveshjeje*” duke shkarkuar në këto kushte përgjegjësin e ndërmjetësit dhe ul ndjeshëm besueshmërinë e këtij institucioni si garant në arritjen dhe zbatimin e marrëveshjes.

Mendoj se në lidhje me marrëveshjet për veprat penale nga të miturit duhet t’i akordohet më shumë përgjegjësi ndërmjetësit në fushën e zbatimit të marrëveshjes. Në lidhje me detyrimet tatimore të përcaktohet që shlyerja e tyre duhet të realizohet në një llogari të vënë në dispozicione nga ndërmjetësi duke respektuar afatet e marrëveshjes, dhe vetëm nëse kjo nuk realizohet atëherë pala e dëmtuar gëzon të drejtën të drejtohet gjykatës për përmbushjen e marrëveshjes.

Përgjegjësia e ndërmjetësit në zbatimin e marrëveshjes mendoj që është një ndër kushtet kryesore pse ndërmjetësimi është më pak i favorizuar në krahasime me procesin gjyqësor, sepse mungesa e garancisë i orienton palët të mendojnë që në mungesë të moszbatimit të marrëveshjes do të drejtohen gjykatës, dhe ta konsiderojnë ndërmjetësimin si një zgjatje në kohe të panevojshme.

<sup>25</sup> Shih nenet 35.42, 75, 81, 103, 339, 360.361 etje, të Kodit të Procedurës Penale.

<sup>26</sup> Neni 2 paragrafi 6 i ligjit nr. 10835 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” Mosmarrëveshjet për të cilat është e detyrueshme zgjidhja në rrugë gjyqësore nuk mund të zgjidhen me ndërmjetësim.

## Përfundime dhe konkluzione

Pasojat e veprimeve kriminale lënë gjurmë të thella te të miturit ndaj konsiderohet e rëndësishme që të punohet mbi sjelljen e tyre devijante, për t’i korrigjuar dhe riedukuar. Për realizimin e këtij synimi ndërmjetësimi do të luante një rol determinant në rigjenerimin dhe për rehabilitimin e të miturit. Shpesh herë dhënia e dënimit penal me burgim, për të miturin krijon gjendje depresive të cilat pashmangshmërisht krijojnë një hendek të pakapërcyeshme midis të miturit dhe komunitetit shoqëror të cilit i përket. Praktikrat e vendeve të zhvilluara kanë treguar se ndërmjetësimi i veprave penale të të miturve është një proces i suksesshëm dhe i nevojshëm në kushtet kur e gjithë vëmendja e shoqërisë është e fokusuar në distancimin e të miturve nga kriminaliteti dhe rehabilitimin tyre përsëri në komunitet.

Suksesi i kësaj discipline vjen edhe si rezultat se figura e ndërmjetësit juridikisht është jashtë fokusit të aplikimit të masave ndëshkuese, dhe krijon një qetësi dhe përgjegjshmëri më të lartë se ajo e krijuar nda ushtrimi presionit të ligjit në gjykatë. Po kështu procesi i ndërmjetësimit ka avantazh që është më i shpejt dhemb i thjesht duke u realizuar jashtë ambienteve të institucioneve përgjegjëse të drejtësisë. Shpesh herë kontakti i të miturve me institucionet e drejtësisë krijon një gjendje psikologjike të rënduar te i mituri dhe për këtë arsye ndërmjetësimi do ti vinte në ndihmë në zgjidhjen e konflikteve penale. Përpos kësaj dhe besueshmëria në vendet e zhvilluar është më e lartë për shkak të kompetencave të gjera që kanë ndërmjetësit dhe të kriterëve të përzgjedhjes së tyre.

Në vendin tonë duhen bërë hapa të rëndësishëm në implementimin e ndërmjetësimit të veprave penale nga të miturit duke hartuar një kuadër ligjor të plotë dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke i kushtuar një rëndësi të lartë kriterit të eksperiencës në këtë fushë. Krijimi i një Zyrë Qendrore për Drejtësinë e të Miturve do të luante një rol kryesor në administrimin e procesit të ndërmjetësimit të veprave penale nga të miturit së bashku me organet institucionale ekzistuese.

## Bibliografia

Kanuni i Lek Dukagjinit

Kodi I Procedurës Penale.

Ligji nr. 9090 datë 26.06.2003 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”

Ligji nr. 10835 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”

Ligji nr. 8465, datë 11/03/1999 “Për zgjidhjen e konflikteve dhe pajtimin e mosmarrëveshjeve”

VKM Nr:414 , datë 8.6.2011, “Vendim për krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësimit”

Dekretit nr. 448/1988 i Presidentit të Republikës italiane

Dr. Erjona Canaj” Ndërmjetësimi tregtar si një mundësi bashkëkohore e zgjidhjes së konfliktit”  
Prof. Dr. Ismet ELEZI, në manualin “Ndërmjetësimi për pajtim në konfliktet penale”, Tiranë, 2004

Alketa Elezi “Ndërmjetësimi në mosmarrëveshjet penale në kontekstin e drejtësisë rehabilituese” Jeta juridike Nr.1, Mars 2010.

D. DOLLING TäterOpfer-Ausgleich in Deutschland, Forum Verlag Godesberg, Bonn 1998.  
45 II JGG ,Jugendgerichtsgesetz

F. Dünkel: “La mediazione in Germania”, në La mediazione nel sistema penale minorile,

Bernhard Trummer dhe G. Kaufmann, në “La mediazione nel sistema penale minorile, L. Picotti”  
Ref. A. Ceretti: “Una risposta al minore autore di reato: la mediazione penale”, në Justitia, 1997

vol. 4

G.V. Pisapia në “Rassegna italiana di criminologia”, nr° 4, 1993.

## *Kontrata e porosisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë*

*Sbkëndi Çili*

### **Abstrakt**

*Kontrata e porosisë parashikohet në nenin 913 të Kodit Civil. Sipas këtij neni: “Porosia është një kontratë me të cilën njëra palë detyrohet të kryejë një ose më shumë veprime juridike për llogari të palës tjetër». Pra, i porosituri vepron për llogari të porositësit por në emrin e tij. Theksojmë se, ai nuk është i detyruar të tregoj se për llogari të cilit person po kryen veprimin juridik dhe se të tretët nuk kanë asnjë lidhje me porositësin. Ata nuk mund të kundërshtojnë kryerjen e veprimit vetëm për këtë fakt, edhe pse mund të kenë djeni për porosinë. Por ai mund të veproj jo vetëm në llogari por dhe në emër të porositësit. Pra, në këtë moment, i referohemi nenit 914 i Kodit Civil i cili parashikon se: Në qoftë se të porositurit i është dhënë kompetenca për të vepruar në emër të porositësit, zbatohen dispozitat mbi përfaqësimin, nënkupton se, pavarësisht mënyrës se si vepron i porosituri, veprimi për llogari nënkupton që pasojat e veprimit juridik të kryer janë të destinuara për porositësin. Veprimi për llogari nënkupton dhe interesin e porositësit. Në këtë punim, kam theksuar se, porosia përfshin jo vetëm veprimet juridike të treguara në kontratë, por dhe veprimet e domosdoshme për kryerjen e tyre, duke iu referuar nenit 917/ 1 i Kodit Civil. Veprimet që nuk janë të domosdoshme apo nuk kanë lidhje me ekzekutimin e saj mund të ndikojnë negativisht duke zgjeruar objektin e kontratës. Këto veprime të domosdoshme mund të mos jenë parashikuar shprehimisht në kontratë. Kontrata e porosisë është e vlefshme dhe për këto veprime që nuk janë të shprehura në përmbajtjen e saj, por që janë të domosdoshme për përmbushjen e porosisë. I porosituri ka barrën e provës, të provoj domosdoshmërinë e veprimeve ndihmëse (në mënyrë që të ketë të drejtën e shpërblimit dhe rimbursimit të shpezimeve).*

**Fjalët kyçe:** *kontratë, porosi e përgjithshme; e posacme, porositësi, i porosituri.*

## Vështrim historik i kontratës së porosisë

Kontrata e porosisë nga pikëpamja historike është mjaft e hershme. Ajo ka qënë parashikuar si një kontratë mjaft e rëndësishme që *në të drejtën romake*. (Mandro, 2007, fq.386). E drejta romake jepte këtë përkufizim për kontratën e porosisë: *“marrëveshje midis dy palëve (subjekteve) nga të cilat njëra palë (porositësi) i jep palës tjetër (të porositurit) detyrën për të kryer për llogari të tij ose të një personi të tretë një veprimtari të caktuar”*. (Dhima, 2007, fq. 665).

Sipas autores Arta Mandro, ajo njihet si kontratë konsensuale, e dyanshme imperfekte, sepse detyrimet ekzistonin vetëm për të porositurin. Megjithatë i porosituri mund të merrte shpërblim për veprimtarinë që realizonte në formë mirënjohjeje, dhe jo si kundërdetyrim i porositësit. (Mandro, 2007, fq.386)

Objekti i kontratës ishte kryerja e çdo lloj veprimtarie nga i porosituri dhe jo vetëm kryerja e veprimeve juridike. Kontrata klasifikohej në “mandatum generale” dhe “Mandatum unis rei”. *Mandatum generale* konsistonte në detyrimin e të porositurit për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme në funksion të administrimit të pasurisë së porositësit. *Mandatum unis rei* parashikonte detyrimin e të porositurit të kryente një punë të përcaktuar. (Mandro, 2007, fq. 387)

## Klasifikimi i kontratës së porosisë

Për qëllime teorike dhe praktike kontratën e porosisë mund t'a klasifikojmë në disa lloje. Veçanërisht neni 917 i Kodit Civil vendos dallimin ndërmjet *porosisë së përgjithshme* dhe *porosisë së veçantë*. Dallim, i cili i referohet *shtrirjes së objektit të kontratës*. Sipas natyrës së këtyre veprimeve realizohet klasifikimi në porosi të përgjithshme dhe porosi të veçantë. Neni 917 i Kodit Civil parashikon se : *“Porosia përfshin jo vetëm veprimet për të cilat është dhënë, por edhe ato akte që janë të domosdoshme për kryerjen e tyre. Porosia e përgjithshme nuk përfshin aktet që tejkalojnë administrimin e zakonshëm të punës, po qe se nuk cilësohen shprehimisht”*.

*Porosia e përgjithshme* shtrihet vetëm për veprimet e administrimit të zakonshëm. Ligji vet nuk shprehet se çfarë përfshin porosia e përgjithshme. Mjaftohet vetëm me përjashtimin nga përmbajtja e saj të akteve që tejkalojnë administrimin e zakonshëm të punës.

*Porosia e posaçme (e veçantë)* ka të bëjë me kryerjen e veprimeve juridike të veçanta që janë të përcaktuara qartë. Ajo jepet për kryerjen e veprimeve juridike që tejkalojnë kufijtë e administrimit të zakonshëm. Për këto veprime neni 917 i Kodit Civil parashikon se duhet të cilësohen shprehimisht (të tregohen në mënyrë qartë).

Nga interpretimi i dispozitave të tjera mund të bëhet një klasifikim tjetër. Klasifikim i cili bazohet në faktin që në secilën prej palëve mund të ndodhen disa persona. Sipas këtij klasifikimi kemi:

Sipas nenit 932 të Kodit Civil, *porosi kolektive* kemi nëse jepet nga shumë porositës në një akt të vetëm dhe për një çështje me interes të përbashkët. Interesi është i lidhur me kryerjen e një veprimi juridik të vetëm.

Ndërsa sipas nenin 934 të Kodit Civil, *porosi e përbashkët* i jepet disa personave të cilët duhet të veprojnë bashkarisht. Në këtë rast marrëdhënia juridike shuhet nëse shkak i shuarjes ka të bëjë me vetëm njërin prej tyre.

*Porosi e veçantë* i jepet disa të porositurve të cilët duhet të veprojnë në mënyrë të veçantë nga njëri tjetri. Marrëdhënia juridike nuk shuhet nëse shkak i shuarjes vërtetohet vetëm për njërin prej tyre.

Porosia mund të jetë e thjeshtë apo profesionale.

*Porosi e thjeshtë* është e tillë që mund të realizohet nga çdo subjekt pa qënë e nevojshme pasja e njohurive profesionale të përcaktuara.

*Porosia* mund të jetë *profesionale* kur i porosituri gëzon njohuri profesionale në një fushë të caktuar dhe disponon mjetet e nevojshme teknike profesionale për kryerjen e saj.

Dispozitat që parashikojnë kontratën e porosisë kanë *karakter të përgjithshëm*. Ato janë të zbatueshme dhe për kontrata të tjera (porosi të veçanta) për aspekte të cilat, ato nuk i rregullojnë në mënyrë të plotë. Këto dispozita do të zbatohen për kontratën e komisionit e spedicionit të cilat i referohen shprehimisht këtyre dispozitave, konkretisht neni 944 të Kodit Civil. Janë të zbatueshme për kaq sa i përshtatet natyrës së tyre, si lloje të veçanta porosie.

## Veçoritë e kontratës së porosisë

Së pari, kontrata e porosisë është *kontratë konsensuale*. Sipas nenit 676 të Kodit Civil, ajo quhet e lidhur kur palët kanë shfaqur në mënyrë të ndërsjelltë vullnetin e tyre, duke u marr vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj. Kushtet thelbësore të kontratës janë ato të parashikuara në nenin 663 të Kodit Civil, i cili parashikon se : *“Konditat e nevojshme për qënien e kontratës janë : pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkak i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji”*. Porosia do të quhet e lidhur kur palës që bën propozimin për lidhjen e porosisë, i mbërrin pranimi i palës tjetër. (Semimi T.,1998, fq.68)

Ajo është *kontratë joformale*. Lligji nuk kërkon detyrimin e respektimit të një formetë caktuar. Në parim pranohet liria e formave. Forma *nuk* kërkohet *ad substantiam*. Kontrata mund të lidhet me shkrim (akt noterial ose shkresë e thjeshtë), me gojë dhe me veprime konkludente.

Sipas nenit 921/ 2 të Kodit Civil, ajo *kanatyre personale (intuitu personae)*, e lidhur me cilësitë personale të të porositurit. Porosia bazohet në besimin që ka personi që jep porosinë mbi personin e të porositurit. Këtej rrjedh se :

- a. I porosituri nuk mund të zëvendësohet nga të tjerët në ekzekutimin e porosisë përveç rasteve të parashikuara nga neni 921/2 i Kodit Civil.
- b. Porosia shuhet si pasojë e vdekjes së porositësit apo të porositurit përveç përjashtime të parashikuara në nenin 927 dhe 928/2 të Kodit Civil.
- c. Porositësi ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata kur nuk ekziston më ky besim te i porosituri. (Galvano, 1999, fq.672).

Kontrata e porosisë është *kontratë dypalëshe*. Pavarësisht nëse në të marrin pjesë shumë subjekte. Ato grupohen në jo më shumë se dy palë. Kontrata e porosisë është *kontratë e dyanshme*. Theksojmë se, sipas nenin 662 të Kodit Civil, kontrata është me detyrime të dyanshme, kur palët detyrohen reciprokisht ndaj njëra tjetrës.

Veçori tjetër e saj është karakterime *shpërblim*. Shpërblimi *prezumohet*. I porosituri detyrohet të kryej veprimin/veprimet juridike kundrejt shpërblimit. Kjo veçori është e lidhur me karakterin e dyanshëm të kontratës. Referuar nenit 920 dhe 925 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, rezulton se, kryerja e veprimit juridik bëhet kundrejt shpërblimit.

Porosia mund të jetë *me afat të caktuarose me afat të pacaktuar*. Porosia mund të jepet *dheme kusht*. Kushti mund të ketë natyrë të ndryshme. Në vendimin nr. 1886 datë 04.04.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është shprehur ndër të tjera, se: *“...marrëveshja do të prodhonte pasoja juridike vetëm po të fitohet çështja në gjykim ku paditësi/i kundërpaditur (i porosituri) ishte përfaqësues i të paditurit/kundrapaditës (porositësit). Kushti lidhet me faktin e fitimit ose jo të çështjes në gjykim. Vetëm në këtë rast do të mund të realizoheshin veprimet e tjera si vënia në ekzekutim e vendimit, dorëzimi i banesës, shitja dhe dhënia e shpërblimit...”*. Pra kushti mund të jetë i lidhur me rezultatin e favorshëm të veprimit juridik apo si në rastin konkret me fitimin e gjykimit.

## Marrëdhënia juridike e porosisë

Marrëdhëniet shoqërore që krijohen midis subjekteve të së drejtës dhe që rregullohen nga normat juridike konsiderohen marrëdhënie juridike. Marrëdhënia juridike lind ndër të tjera dhe nga kontratat. Kontrata e porosisë si çdo kontratë tjetër krijon marrëdhënie juridike midis palëve. Është pikërisht, neni 659 i K.Civil parashikon se : *“Kontrata është veprim juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë,*

*ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”*. Prej saj lindin dy lloj marrëdhëniesh juridike. (Kondili, 2007, fq.88)

- a. marrëdhënia juridike e brendshme midis porositësit dhe të porositurit.
- b. marrëdhënia juridike e jashtme, që lind nga kryerja e veprimit juridik, midis të porositurit dhe personave të tretë, palë të veprimit juridik.

Kontrata e porosisë rregullon vetëm marrëdhëniet që krijohen midis porositësit dhe të porositurit. Këto marrëdhënie nuk ndikojnë në marrëdhënien e krijuar nga veprimi juridik i kryer, midis të porositurit dhe personit të tretë (në parim).

Marrëdhënia juridike që krijohet nga kontrata e porosisë, si çdo marrëdhënie juridike tjetër ka këto element:

1. Subjektet midis të cilave krijohet marrëdhënia juridike.
2. Objekti i marrëdhënies juridike.
3. Përmbajtja e marrëdhënies juridike.

Marrëdhënia juridike e porosisë mund të jetë me element të huaj. “Elementi i huaj në kuptimin e të drejtës ndërkombëtare private është një rrethanë juridike, një moment i marrëdhënies juridike civile, i cili bëhet premisë për lidhjen e kësaj marrëdhënieje me një rend juridik të dhënë”. (Alia, 2006, fq.58). Elementi i huaj në marrëdhënien juridike mund të ndodhet në subjekt, objekt, ose në përmbajtje.

## Cilët janë subjektet e marrëdhënies juridike të porosisë?

Në funksion të realizimit të qëllimit të kontratës së porosisë marrin pjesë tre palë. Palët janë porositësi, i porosituri dhe personi i tretë me të cilin i porosituri kryen veprimin juridik. Sipas nenit 915/ 2 i Kodit Civil, të tretët nuk kanë asnjë lidhje me porositësin. Ndërsa sipas nenin 932 dhe 934 të Kodit Civil, janë gjithmonë dy palë ku secila palë mund të ketë në brendësi disa subjekte.

Subjektet e marrëdhënies juridike janë personat që marrin pjesë në marrëdhënie si mbajtës të të drejtave subjektive dhe detyrimeve juridike përkatëse. Subjekte të marrëdhënies juridike të porosisë janë personat fizik dhe personat juridik. Ata për të qënë subjekte të marrëdhënies juridike duhet të karakterizohen nga pasja e zotësisë për të vepruar. (neni 6- 11 të Kodit Civil). Subjektit që i përket e drejta quhet kreditor ndërsa subjektit që i përket detyrimi quhet debitor. Subjektet mund të marrin emra specifik në varësi të marrëdhënies juridike konkrete. Në marrëdhënien juridike të porosisë subjektet quhen porositës dhe i porositur.



*Porositësi* është subjekti për llogari të të cilit i porosituri është i detyruar të përmbush veprimet juridike të treguara në kontratë. Kur porositës është një *person juridik*, të porositurit mund t'i ngarkohen vetëm ato veprime juridike që janë në zotësinë e tij juridike për të vepruar. (neni 29-31 Kodit Civil). Kur porositësi është *person fizik* ky duhet të ketë zotësi të plotë për të vepruar. Në qoftë se nuk ka zotësi të plotë për të vepruar vepron instituti i përfaqësimit dhe jo kontrata e porosisë. Kur nuk ka zotësi për të vepruar nuk mundet të lidh kontrata.

*I porosituri* është subjekti i cili detyrohet të përmbush një ose më shumë veprime juridike për llogari të një subjekti tjetër (porositësit). I porosituri është njëkohësisht subjekt i një marrëdhënieje juridike tjetër që krijohet me personin e tretë (marrëdhënie shitjeje, qiraje etj). Ai duhet të ketë zotësi të plotë për të vepruar, që të kryej veprimin juridik të ngarkuar nga porositësi

## Objekti i marrëdhënies juridike

Objekti i marrëdhënies juridike janë *veprimet dhe shërbimet për lidhjen e veprimeve juridike*. Ajo përfshin dhe veprime ndihmëse që janë në funksion të kryerjes së veprimit juridik. (neni 917 K.Civil). Këto veprime ndihmëse mund të kategorizohen si veprime që përbëjnë objektin dytësor të kontratës. Nuk mund të jetë objekt kryesor i porosisë kryerja e veprimeve fizike materiale. Kjo sepse në një rast të tillë do ishim para kontratës së sipërmarrjes apo kontratës së punës.

Sipas nenit 913 të Kodit Civil : *“Porosia është një kontratë me të cilën njëra palë detyrohet të kryejë një ose më shumë veprime juridike për llogari të palës tjetër”*. Në nenin 916 parashikohet se : *“I porosituri është i detyruar të kryej punët ose veprimet juridike që i janë ngarkuarsipas udhëzimeve të porositësit”*.

Objekt i kontratës së porosisë duhet të plotësoj kërkesat e parashikuara nga ligji. Pra, neni 678 i K.Civil parashikon se: *“Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet”*. Ai duhet të jetë:

1. I ligjshëm. Porosia jepet për kryerjen e veprimeve juridike të ligjshme. Nuk mund të jepet porosi për të kryer veprime të paligjshme apo të kundërligjshme.
2. I mundshëm. Pamundësia e kryerjes së veprimit juridik i referohet kriterit fizik (pamundësia fizike për të kryer veprimin) apo juridik (kur veprimi juridik ka të bëjë me një objekt që është i përjashtuar nga qarkullimi civil). Gjithashtu nuk mund të jepet porosia për të kryer veprime që i ndalohen vet porositësit (Huet, 1996, 1112), si psh parashikimet e nenit 709 të Kodit Civil
3. I përcaktuar apo i përcaktueshëm. Përcaktueshmëria ka të bëjë me rastin kur të porositurit i jepet porosia për të kryer veprime të administrimit të zakonshëm. Këto veprime dhe pse nuk janë përcaktuar me saktësi janë të përcatueshme.

Objekt i kontratës mund të jetë një nga veprimet tregtare që parashikohen në ligjin nr. 7632, datë 4.11.1992. “Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregtar“. Kontrata e porosisë në fushën tregtare do të trajtohet sipas dispozitave të Kodit Civil. Porosia do të përdoret si mjet për realizimin e veprimeve tregtare por do të rregullohet sipas dispozitave të Kodit Civil. Theksjomë se, neni 3 i ligjit nr. 7632, datë 4.11.1992. “Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregtar“ parashikon se: “Konsiderohen veprime tregtare veçanërisht:

1. Blerja me qëllim rishitjeje, shitja që rrjedh nga një blerje e mëparshme e bërë me qëllim rishitjeje, si dhe përgjithësisht cdo veprim shkëmbimi i lidhur me një veprim tjetër shkëmbimi.
2. Çdo akt i sipërmarrjeve industriale, të ndërtimit, të shfrytëzimit të minerave, të transportit, të sigurimeve, të magazinimit, të shfaqjeve publike, të reklamës, të botimit e të shtypshkrimit joartizanal.
3. Çdo operacion bankar dhe këmbimi. Të gjitha operacionet ndërmjetëse tregtare, si dhe operacionet e ndërmjetësisë ose të spedicionit dhe ato të përfaqësuesve tregtarë.

## Përmbajtja e marrëdhënies juridike në lidhje me kontratën e porosisë

Theksojmë se, përmbajtja e marrëdhënies juridike përbëhet nga tërësia e të drejtave dhe detyrimeve juridike përkatëse të subjekteve që marrin pjesë në marrëdhënien juridike konkrete. Trajtimi do të fokusohet në analizën e detyrimeve të palëve për aq sa detyrimet e njëres palë korrespondojnë me të drejtat e palës tjetër. Kontrata e porosisë si gjithë kontratat e tjera është burim i lindjes së detyrimeve. (neni 420 Kodi Civil). Të drejtat dhe detyrimet e porositësit dhe të të porositurit janë të lidhura ngushtësisht.

### a) Detyrimet e të porositurit

Pjesën kryesore të përmbajtjes së porosisë e përbëjnë detyrimet e të porositurit. Çdo detyrimi të të porositurit i korrespondojnë drejta e porositësit. Klasifikimin i mëposhtëm bazohet në interpretimin e dispozitave përkatëse sipas vijueshmërisë së parashikimit tyre nga Kodi Civil. Përveç këtyre detyrimeve do të analizoj dhe një të drejtë të veçantë që i njihet të porositurit, e drejta e tij mbi kreditë në para.

### b) Detyrimi i përmbushjes së porosisë

I porosituri është i detyruar të kryej veprimin juridik, objekt porosie. Në të kundërt mbi të do të bien pasojat që ligji parashikon për mospërmbushjen e detyrimeve

kontraktuale. Në vendimin nr. 1705 datë 23.10.2003, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, gjykata pasi saktësoi që kontrata e lidhur midis palëve nuk është sipërmarrje por kontratë porosie, shprehet se : *“...pranohet nga i padituri dhe provohet, që shumat përkatëse përbëjnë detyrime kontraktore të tij që ai duhet të detyrohet t'i shlyejë. Në një vështrim të përgjithshëm, mosshlyerja e detyrimeve i jep të drejtë (legjitimon) paditësin që të kërkojë zgjidhjen e kontratave, kthimin e shumave të dhëna dhe shpërblimin e dëmit...”*. (Neni 698 i Kodit Civil)

I porosituri mund të kryej veprimin juridik në emër të tij apo në emër të porositësit. Pra kemi dy mënyra të veprimit të të porositurit :

1. *Sipas nenit 913 të Kodit Civil, përcaktohet se, veprimi juridik mund të kryhet në llogari të porositësit por në emër të të porositurit.*Neni 915 i Kodit Civil parashikon se : *“I porosituri që vepron në emrin e vet fiton të drejta dhe merr përsipër detyrime që rrjedhin nga veprimet e kryera me të tretët, edhe po qe se këta kanë patur dijeni për porosinë. Të tretët nuk kanë asnjë lidhje me porositësin”*. Pasojat e veprimtarisë së të porositurit vijnë për të. Por ai është i detyruar që efektet e përmbushjes t'ia transferoj porositësit.
2. *Ndërsa sipas nenit 914 të Kodit Civil, përcaktohet se, veprimi juridik mund të kryhet në emër dhe për llogari të porositësit.* Në qoftë se të porositurit i është njohur e drejta për të vepruar në emër të porositësit, zbatohen dispozitat e përfaqësimit. Kontrata e porosisë në një rast të tillë shoqërohet me lëshimin e një prokure.

### c) Detyrimi për të vepruar sipas udhëzimeve të porositësit

Neni 916 i Kodit Civil, *përcakton se, i porosituri është i detyruar të kryejë punët ose veprimet juridike që i janë ngarkuar sipas udhëzimeve të porositësit. Ai mund të largohet nga këto udhëzime vetëm kur kjo është e domosdoshme për të mbrojtur interesat e porositësit dhe nuk ka mundësi që të merret vesh më parë me të.*

Në parim i porosituri gjatë kryerjes së vepimit juridik që i është ngarkuar nuk duhet të largohet nga udhëzimet e marra. Nëse largohet nga udhëzimet duhet të merret vesh me porositësin. Detyrimi i veprimit sipas udhëzimeve të porositësit nuk përjashton mundësinë e largimit kur është e domosdoshme. Ligji parashikon dy kushte, që duhet të ekzistojnë bashkarisht, për të lejuar të porositurin të largohet nga udhëzimet e marra. Këto kushte janë:

1. *Domosdoshmëria e largimit nga udhëzimet në interes të porositësit.*Kërkohej domosdoshmëria e largimit, nuk mjafton qëllimi në interes të porositësit. Kur është e domosdoshme dhe në interes të porositësit largimi nuk prezantohet vetëm si *mundësi por dhe si detyrim* i të porositurit.

2. *Mospasjen e mundësisë për t'u marrë vesh paraprakisht me porositësin.*Kjo pamundësi për t'u marrë vesh me porositësin nënkupton pamundësinë e komunikimit me të në mënyrë që ai të jap udhëzimet e nevojshme apo të ndryshoj udhëzimet e mëparshme.. Në këtë përfundim mund të arrijmë nëse do të aplikojmë me analogji nenin 940 të Kodit Civil, i cili parashikon se, parashikon se : *“Komisioneri ka të drejtë të largohet nga udhëzimet që i ka dhënë porositësi vetëm kur, për shkak të ndryshimit të rrethanave, një largim i tillë bëhet i nevojshëm për interesat e porositësit, dhe komisioneri nuk mund të merret vesh më parë me porositësin ose, kur, megjithëse e ka pyetur , nuk ka marrë përgjigje në kohën e duhur”*.

Gjthashtu kur e ka pyetur por nuk ka marrë përgjigje fare mendoj se do të konsiderohet si pranim i heshtur i largimit.

### ç) Detyrimi i njoftimit për ekzekutimin e porosisë

Ky detyrim është parashikuar nga neni 924 i Kodit Civil, sipas të cilit : *“I porosituri është i detyruar t'i jap porositësit, kur ky i kërkon, të gjitha informatat që kanë lidhje me kryerjen e porosisë, së bashku me dokumentet justifikuese, t'i japë atij llogari posa të ketë kryer porosinë, si dhe t'i kthejë atij çdo gjë që ka marrë për shkak të kryerjes së porosisë..”*

Detyrimi kryesor që ka i porosituri është kryerja e veprimit juridik për të cilin është dhënë porosia. Prej këtij detyrimi rrjedhin një sërë detyrimesh të tjera. Ndër këto detyrime është dhe detyrimi i njoftimit. Detyrimi për të njoftuar porositësin për fillimin dhe ekzekutimin e porosisë. Njoftimi për ekzekutimin e porosisë përfshin tregimin e veprimit juridik të kryer. Veç të tjerave është i detyruar të paraqes dhe dokumentet justifikues.Njoftimi jepet pas kërkesës së porositësit. Konkretisht, neni 924 i K.Civil parashikon se: *“I porosituri është i detyruar t'i jap porositësit, kur ky i kërkon, të gjitha informatat që kanë lidhje me kryerjen e porosisë, së bashku me dokumentet justifikuese..”*

### d) Detyrimi i dhënies llogari

*I porosituri është i detyruar t'i jap porositësit, kur ky i kërkon, të gjitha informatat që kanë lidhje me kryerjen e porosisë, së bashku me dokumentet justifikuese, t'i japë atij llogari posa të ketë kryer porosinë, si dhe t'i kthejë atij çdo gjë që ka marrë për shkak të kryerjes së porosisë.*(Neni 924 i Kodit Civil)

Parashikimi i këtij detyrimi buron nga fakti që i porosituri veprimin me personin e tretë e kryen për llogari të porositësit. Ky detyrim ka rëndësi të veçantë. I jep mundësi porositësit të kontrolloj nëse veprimtaria e kryer nga i porosituri

realizohet sipas kritereve të administrimit të mirë dhe përkujdesjes, (Simone, 2007, fq 1001), të parashikuar nga neni 921 i Kodit Civil. Nëpërmjet një veprimi të tillë porositësi njihet me veprimtarinë e kryer nga i porosituri.

Detyrimi i dhënies llogari ka *funksion kontrolli* nga porositësi për veprimtarinë e realizuar nga i porosituri.

#### dh) Detyrimi i kthimit

*I porosituri është i detyruar t'i jap porositësit, kur ky i kërkon, të gjitha informatat që kanë lidhje me kryerjen e porosisë, së bashku me dokumentet justifikuese, t'i japë atij llogari posa të ketë kryer porosinë, si dhe t'i kthejë atij çdo gjë që ka marrë për shkak të kryerjes së porosisë.* (Neni 924 i Kodit Civil).

Ai është i detyruar t'i dorëzoj porositësit, çdo gjë që ka marrë për shkak të kryerjes së porosisë. Në një rast të tillë rëndësi ka përcaktimi i gjithçkaje që është marrë për shkak të porosisë dhe asaj që është marrë me titull tjetër. Pra, përjashtohen ato pasuri që janë fituar nga i porosituri të lidhura me personin e tij.

Detyrimi i kthimit ka si objekt :

1. Kthimin e çdo gjëje që ka marrë nga personat e tretë.
2. Kthimin e çdo gjëje që është marrë nga porositësi, për të bërë të mundur ekzekutimin e porosisë dhe që nuk janë përdorur.

Sendet që porositësi i ka dhënë (furnizuar) të porositurit dhe sendet që i porosituri ka fituar në ekzekutim të porosisë duhet t'i kthehen porositësit. Kjo dispozitë duhet interpretuar e lidhur ngushtë e nenin 918 të Kodit Civil. Kur i porosituri refuzon t'i kthej sendet që ka fituar në ekzekutim të porosisë, porositësi mund të ngrej padinë e rivendikimit për të kërkuar kthimin. Kjo padi mund të ngrihet pasi sendet e fituara në këtë rast janë në pronësi të porositësit.

Objekt kthimi mund të jenë sende apo shuma në të holla. Kur detyrimi i kthimit ka të bëjë me shuma në të holla i porosituri duhet t'i kthej ato. Kur nuk dorëzon këto shuma aplikohen dispozitat për detyrimet monetare. (Nenet 445-454 të K.Civil). Mosdorëzimi i këtyre shumave nënkupton mospëmbushjen e detyrimeve kontraktuale prej të cilës lindin pasoja të ndryshme. Për këtë Gjykata e Lartë ka arsyetuar se : *"...pranohet nga i padituri dhe provohet, që shumat përkatëse përbëjnë detyrime kontraktore të tij që ai duhet të detyrohet t'i shlyejë. Në një vështrim të përgjithshëm, mosshlyerja e detyrimeve i jep të drejtë (legjitimon) paditësin që të kërkojë zgjidhjen e kontratës, kthimin e shumave të dhëna dhe shpërblimin e dëmit"*. (Vendimi nr. 1705 datë 23.10.2003, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, referuar nenit 698 të Kodit Civil).

#### e) Detyrimi për të kryer porosinë personalisht

Neni 921/2 i K.Civil përcakton se, *i porosituri detyrohet që të zbatojë porosinë personalisht, përveç rastit kur është i autorizuar t'ia kaloj një të treti, kur është i detyruar nga rrethanat, ose në mbrojtje të interesave të porositësit.*

Karakteristikë esenciale e kontratës së porosisë është elementi personal. Pra, pavarësisht elementit personal, i porosituri mund të ngarkoj një zëvendës për kryerjen e veprimit juridik, kur :

1. Autorizohet për një zëvendësim të tillë (mundësia e parashikimit me kontratë të zëvendësimit).
2. Detyrohet nga rrethanat (sipas natyrës së veprimit juridik).
3. Për mbrojtjen e interesave të porositësit.

Mendoj se kushtet e parashikuara në nenin 921/2 të Kodit Civil nuk duhet të interpretohen në mënyrë të ngushtë. Mundet që zëvendësimi të konsiderohet i ligjshëm kur edhe pse nuk ka qënë i autorizuar, nuk rezulton të jetë i ndaluar

#### f) Detyrimi për të kryer porosinë me përkujdesje

Neni 921/1 i Kodit Civil parashikon se: *"I porosituri detyrohet të zbatojë porosinë me besnikëri dhe përkujdesje. Ai duhet t'i bëjë të ditur porositësit rrethanat e krijuara që mund të sjellin revokimin e saj"*. (Neni 921/ 1 i Kodit Civil). Kjo dispozitë është shprehje e parimit të përgjithshëm për përmbushjen e detyrimeve të parashikuar nga neni 422 dhe 455 të Kodit Civil. Shprehimisht, neni 422 parashikon se : *"Kreditori dhe debitori duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit me korrektesë, me paanësi dhe sipas kërkesave të arsyes"*. Ndërsa neni 455 i K.Civil *"debitori dhe kreditori duhet të tregojnë kujdesin e duhur e të jenë të përpiktë në përmbushjen e detyrimit sipas përmbajtjes së tij."*

Mendoj se rëndësi ka përcaktimi i masës së kujdesit që duhet të tregoj i porosituri në ekzekutimin e porosisë. Neni 921/1 i Kodit Civil jep vetëm një përcaktim të përgjithshëm për detyrimin e të porositurit për të vepruar me përkujdesje. Një përcaktim interesant bënte Kodi Civil i vitit 1929. Sipas këtij kodi, *i porosituri asht i detyruar me ekzekutiv porosinë me shkathtësinë e një ati familjeje të mirë.*

#### j) Detyrimi i ruajtjes së sendeve dhe të drejtave të porositësit

Po ashtu, neni 922 i Kodit Civil, parashikon se, *i porosituri duhet të marrë masa për ruajtjen e sendeve që janë dërguar për llogari të porositësit dhe të mbrojtje të drejtat e këtij*

të fundit kundrejt transportuesit, po qe se sendet paraqesin shenja dëmtimi ose kur kanë mbërritur me vonesë. (Neni 922 i Kodit Civil).

Ruajtja e sendeve shihet në dy aspekte :

1. Ruajtja e sendeve të marra nga porositësi për zbatimin e porosisë. psh sendet që ai i furnizon të porositurit sipas nenit 923 të Kodit Civil.
2. Ruajtja e sendeve të dërguara te i porosituri për llogari të porositësi nga një person i tretë. Nga interpretimi i dispozitës (shprehjes mbroj të drejtat kundrejt transportuesit) nënkupton se këto sende kanë si paraprijëse një kontratë transporti. Mbrojtja e të drejtave të porositësit kundrejt transportuesit bëhet nga i porosituri.

## Konkluzione

1. Porosia jepet për kryerjen e veprimeve juridike dhe për veprime, punë të tjera. Në këtë kategori do të përfshihen dhe veprimet e tjera të ligjshme. Ajo përfshin dhe veprime që mund të mos jenë parashikuar shprehimisht në kontratë, por që janë të domosdoshme për ekzekutimin e saj. Ekzekutimi nuk nënkupton vetëm kryerjen e veprimit juridik por vazhdon deri në kalimin e plotë të efekteve të porositësi.
2. Mund të pranohet si e vlefshme kontrata e porosisë për të kryer veprime juridike pas vdekjes së porositësit. Bazuar dhe në faktin që vdekja e porositësit nuk është gjithmonë shkak për shuarjen e porosisë sipas nenit 927/2 dhe 928/2 të Kodit Civil.
3. Kontrata e porosisë rregullon vetëm marrëdhëniet e brendshme që krijohen midis porositësit dhe të porositurit. Në parim këto marrëdhënie nuk ndikojnë në marrëdhënien e krijuar, nga veprimi juridik i kryer, midis të porositurit dhe personit të tretë.
4. Karakteri personal i porosisë nuk përjashton mundësinë e zëvendësimit të të porositurit. Kushtet e parashikuara në nenin 921/2 të Kodit Civil (që parashikojnë mundësinë e zëvendësimit) nuk duhet të interpretohen në mënyrë të ngushtë. Mundet që zëvendësimi të konsiderohet i ligjshëm kur edhe pse nuk ka qënë i autorizuar, nuk rezulton të jetë i ndaluar. Në rast zëvendësimi nuk do të ekzistojë përgjegjësi solidarë e të porositurit me zëvendësin, sepse i porosituri del si subjekt nga marrëdhënia dhe hyn zëvendësi.
5. Në parim, për kontratën e porosisë ligji nuk kërkon detyrimin e respektimit të një forme të caktuar për efekt vlefshmërie. Por nëse solemniteti kërkohet për të ruajtur konsensusin, porosia duhet të ketë të njëjtën formë si veprimi juridik. Kontrata e porosisë për të kryer veprime juridike formale (sipas nenit

83 të Kodit Civil) duhet të bëhet me akt noterial për efekt vlefshmërie. Mundet që kontrata e porosisë për analogji me prokurën të bëhet me akt noterial. Por në këtë rast forma nuk është e detyrueshme për efekt vlefshmërie. Kontrata e porosisë duhet të bëhet me shkrim për efekt provueshmërie.

6. Kontrata e porosisë prezumohet me shpërblim. Si shpërblim mund të shërbejë një shumë të hollash (pavarësisht nga lloji i monedhës që përcaktohet nga palët), një send, një e drejtë dhe çdo gjë tjetër (psh. artikull në gazetë që të krijojë një sadsifaksion moral) që mund të krijojë avantazh për të porositurin, dhe që jepet përkundrejt veprimit juridik që ka kryer si kundërdetyrim i porositësit. Porosia nuk mund të jetë e pavlefshme për mospërcaktimin e çmimit. Çmimi në mungesë të përcaktimit nga palët është i përcaktueshëm, sipas kriterëve të parashikuara nga ligji, të cilat duhet të zbatohen sipas parimit hierarkik. Përcaktimi i shpërblimit sipas këtyre kriterëve bëhet nga gjykata, e cila duhet të caktojë ekspert për të bërë të mundur përcaktimin. Rekomandoj që gjykatat për përcaktimin e shpërblimit sipas këtyre kriterëve të caktojnë ekspert në çdo rast.
7. Kur flasim për pa/vlefshmërinë e kontratës së porosisë nëkuptojmë se për të do të zbatohen rastet e pavlefshmërive të veprimeve juridike. Pasojat e pavlefshmërisë do të ndryshojnë në varësi me llojin apo shkakun e pavlefshmërisë. Rast specifik i pavlefshmërisë së veprimeve juridike objekt porosie, është nëse jepet porosi e përgjithshme dhe i porosituri kryen dhe veprime të administrimit të jashtëzakonshëm. Këto veprime janë të pavlefshme.
8. Kontrata e porosisë duhet të dallohet nga kontratat e ngjashme. Objekti e dallon atë nga kontratat e tjera si kontrata e sipërmarrjes, komisionit dhe spedicionit. Mundësia e të porositurit për të vepruar dhe si përfaqësues i porositësit e dallon nga kontrata e komisionit, sipërmarrjes dhe ndërmjetësimit. Veçnisht duhet të dallojmë porosinë nga sipërmarrja. Ekzistenca e riskut, i cili rëndon mbi sipërmarrësin është element dallues specifik.

## Bibliografia

### Legjislacioni

*Kodi Civil i datës 01.04.1929.*

Ligji nr. 7632, datë 4.11.1992. "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregtar".

### Literatura

Arta Mandro (Balili), "E drejta romake", shtëpia botuese "Emal", Tiranë 2007.

Ken Dhima, "E drejta romake", shtëpia botuese "Medaur", Tiranë 2007.

Valentina Kondili, "E drejta civile I" (pjesa e përgjithshme), shtëpia botuese "Maluka", Tiranë 2007.

Mariana Semini (Tutulani), "E drejta e detyrimeve dhe e kontratave" (pjesa e posaçme), shtëpia botuese "Skanderbeg books", Tiranë 2006.

- Juliana Latifi (Fuga), *“E drejta civile”(pjesa e përgjithshme)*, shtëpia botuese “Ilar”, Tiranë 2001.
- Mariana Semini (Tutulani), *“E drejta e detyrimeve dhe e kontratave”(pjesa e përgjithshme)*, shtëpia botuese “Afërdita”, viti 1998.
- Ken Dhima, “E drejta romake”, shtëpia botuese “Medaur”, Tiranë 2007, fq. 665.
- Prof. Asoc. Dr. Arta Mandro (Balili), “E drejta romake”, shtëpia botuese “Emal”, Tiranë 2007, fq. 386.
- Prof. Asoc. Dr. Arta Mandro (Balili), “E drejta romake”, shtëpia botuese “Emal”, Tiranë 2007, fq. 386.
- Prof. Asoc. Dr. Arta Mandro (Balili), “E drejta romake”, shtëpia botuese “Emal”, Tiranë 2007, fq. 387.
- Valentina Kondili, “E drejta civile I”(pjesa e përgjithshme), shtëpia botuese “Maluka”, Tiranë 2007, fq. 88
- Ardian Kalia, “E drejta ndërkombëtare private”, shtëpia botuese “Sejko”, Elbasan 2006, fq. 58
- J, Ghestin, J, Huet, “Traitè de droit civil- les principaux contrats speciaux, , II edition, Paris 1996, fq. 1112.
- Francesco Galgano, *“E drejta private”*, shtëpia botuese “Luarasi”, Tiranë 1999.

#### Praktikë Gjyqësore

- Vendimi nr. 1705 datë 23.10.2003, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Vendimin nr. 1886 datë 04.04.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
- <http://it.ëikipedia.org/ëiki/Mandato> (mars 2008)

## *Rregullimi i marrëdhënieve të punës në Shqipëri sipas ligjit “Për Nëpunësin Civil”, krahasimi me disa nga vendet e botës*

*Irisi Menga*

#### Abstrakt

*Nëpërmjet këtij punimi kam synuar që të sjell një trajtim sa më të veçant në lidhje me marrëdhëniet e punës në sektorin publik në Shqipëri, Europë dhe ShBA. Përmes këtij punimi synoj që të prek disa nga aspektet më të veçanta e me problematike të së drejtës së punës, pasi zbatimi në praktik i marrëdhënieve të punës në sektorin publik ka sjell mjaft problematika për zbatuesit e saj. Kam menduar të trajtoj këtë temë për vetë faktin se gjatë viteve të fundit është vërejtur një interes në rritje për rregullimin e marrëdhënieve të punës në sektorin publik, kjo për vetë veçantinë dhe objektin interesant që përçjell ky sektor krahasuar me sektorët e tjerë. Jam munduar që të sjell një analize teorike të legjislacionit, për marrëdhëniet e punës në sektorin publik duke evidentuar kështu avantazhet dhe disavantazhet që sjell në praktik zbatimi i ligjit “Për Nëpunësin Civil” në Shqipëri, kjo për të kuptuar me mirë se ku ka nevoj legjislacioni jonë të plotësohet, ndryshohet për të realizuar një rregullim sa më të mirë për këto marrëdhënie. Në këtë punim kam trajtuar në një vështrim krahasues në marrëdhëniet e punës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Angli, Francë dhe Gjermani duke evidentuar karakteristikat kryesore të legjislacionit të çdo shteti për rregullimin e këtyre marrëdhënieve të punës. Kuadri ligjor për marrëdhëniet e punës në shërbimet publike të vendeve europiane është përqendruar në rolin që luajnë punëdhënësit, qeveria dhe sindikatat. Duke marrë parasysh rëndësinë që paraqet ky sektor ai ka qenë objekt i reformimeve të shumta gjatë dy-tre dekadave të fundit, këto reforma janë një përgjigje e drejtëpërdrejtë e situatave të reja që dalin nga zbatimi në praktik dhe nga nevojat e një shoqërie e cila zhvillohet me rritme të shpejta dhe duhet ti paraprihet çdo situatë konfuzë në të ardhmen. Duke pasur parasysh*

*faktin se sot kemi një ekonomi globale e cila zhvillohet me rritme të shpejta, duhet që dhe legjislacionet e vendeve përkatëse t'iu përshtaten këtyre ndryshimeve duke e bërë zbatimin në praktik të marrëdhënieve të punës në sektorin publik sa me eficient. Kjo do të çonte në modernizimin e marrëdhënieve të punës në sektorin publik, të këtyre vendeve.*

**Fjale kyçe:** *Nëpunës civil, administratë publike, marrëdhënie pune, shërbim publik.*

## Evolimimi historik i ligjit

Shqipëria ka një traditë të drejtimit pastërtisht politik të shtetit, edhe pse jemi një shtet i vogël, me një administratë të vogël publike dhe një numër të kufizuar të punonjësve publikë. Sektori publik është duke kaluar nëpër reforma shumë dinamike në rrugën drejt integritimit evropian. Duke pasur parasysh kushtet e tilla korniza ligjore në fushën e marrëdhënieve të punësimit në shërbimin civil duhet të synojë: forcimin e unitetit të shërbimit civil dhe të jetë mjaft fleksibel për të lejuar qeverinë të përshtaste sistemin me ndryshimet e shpejta që po kalon vendi dhe zhvillimin në fushën e kapaciteteve njërëzore.

Përpyekja e parë për krijimin e një shërbimi civil profesionist e të materializuar në ligjin Nr. 8095, datë 21.03.1996 (ligji “Për Shërbimin Civil në Republikën e Shqipërisë”) nuk mundi të bashkëjetonte me këtë traditë shumëvjeçare.

Ligji i vitit 1996 nuk bënte dallime ndërmjet marrëdhënies juridike të nëpunësve dhe marrëdhënieve të tjera të punës pasi ato rregulloheshin sipas Kodit të Punës. Rregullave të këtij Kodi i nënshtroheshin si nëpunësit ashtu dhe punëtorët e thjeshtë.

Pas krizës së thellë që përfshiu administratën publike në tërësi në vijim të shndërrimeve politike të viteve 90, reforma e fundit duket se e ka stabilizuar, të paktën në nivel konceptual, administratën publike në rolin e saj rregullator. Natyrisht mbetet shumë për të bërë që administrata publike të përsosur rolin e saj në jetën shoqërore dhe ekonomike të vendit.

Pra me shërbim civil kuptojmë veprimtarinë e punonjësve të administratës publike, që kanë cilësinë e nënpunësit civil, për të realizuar funksionet e saj të bazuar në Kushtetutë e në ligje.

amount, whereas the defendant has a low probability to incur a considerable loss.<sup>43</sup> Under such circumstances, the fourfold pattern predicts that the claimant will exhibit risk-seeking behaviour while the defendant will tend to be risk-averse.<sup>44</sup> Experiments conducted by legal scholars and data taken from outside the litigation context confirm the correctness of the fourfold pattern as applied to the frivolous claim.<sup>45</sup>

The risk preferences normally exhibited by litigants in ordinary litigation are reversed in the frivolous suit. Legal scholars have provided different accounts why claimants make risk-seeking decisions in the frivolous suit.<sup>46</sup> Here we are interested in the psychological factors as they are described in the prospect theory. The principle of diminishing sensitivity indicates that the changes close to the endpoints are more significant than the changes at the middle of the range.<sup>47</sup> Guthrie, while he accepts this principle, is nonetheless not convinced why it entails overweighting rather than less underweighting in the low endpoint.<sup>48</sup> In our opinion, the possibility effect, i.e. 'access' to the hope to obtain a good outcome, makes highly unlikely outcomes loom larger than their probability would justify.

Again, these discoveries have an important influence upon litigation and settlement. Risk-seeking claimants will favour trial, while risk-averse defendants will prefer settlement. In these circumstances, settlements when they occur will tend to benefit to claimants whose greater tolerance to risk provides them with a "psychological lever"<sup>49</sup> towards defendants. In a sense, the surplus amount that claimants are able to obtain from defendants compared to the expected value of the trial can be construed as purchasing of insurance by the defendant to avoid the risk of a very bad event.<sup>50</sup>

For the attorney, the implications are mixed. On the one hand, his task is to assess the merits of the case and, especially, if he is paid upon a contingency fee, the attorney will dismiss frivolous cases.<sup>51</sup> On the other hand, he may make the "rational" choice of pursuing some frivolous suits not only because there exists a possible positive outcome, however improbable, but also because he may exploit the risk-averse attitude of the defendant in order to obtain favourable settlement.<sup>52</sup>

<sup>43</sup> Ibid.

<sup>44</sup> Ibid, 187.

<sup>45</sup> Ibid, 188-191.

<sup>46</sup> Ibid, 196.

<sup>47</sup> Kahneman and Tversky, 'Advances in Prospect Theory' (nxx) 303

<sup>48</sup> Guthrie, 'Framing Frivolous Litigation' (nxx) 198.

<sup>49</sup> Guthrie, 'Framing Frivolous Litigation' (nxx) 191.

<sup>50</sup> Kahneman, *Thinking, Fast and Slow* (nxx) 320.

<sup>51</sup> Guthrie, 'Framing Frivolous Litigation' (nxx) 208.

<sup>52</sup> Ibid.

#### IV. Limitations of the fourfold pattern to describe litigants' behaviour

Despite the descriptive power of the fourfold pattern, scholars have questioned the ability of the prospect theory to accurately predict litigant's behaviour.<sup>53</sup> One concern is the validity of the prospect theory in real litigation situations as opposed to experiments.<sup>54</sup> Another limitation put forward is that the fourfold pattern does not take sufficiently into consideration individual differences between litigants and the distinction between individual and group decision-makers.<sup>55</sup>

The fourfold pattern applied to litigation has been further criticized because it assumes that litigants adopt the status quo as the reference point.<sup>56</sup> However, it can't be excluded that they might evaluate options compared to other reference points, such as the aspired outcome. It has been shown that claimants, in ordinary litigation, may exhibit risk-seeking attitudes when they are so induced by prior expectations.<sup>57</sup>

Above all, the prospect theory's main shortcoming is that, in contradiction to its prediction that disputes tend to be litigated in lieu of being settled, available data show the contrary.<sup>58</sup> Ironically, in spite of the prospect theory being more descriptively accurate than the economic theory, it is the latter who better predicts the high rate of settlements.<sup>59</sup>

The culprit acknowledged by scholars is that prospect theory, not unlike the economic theory, fails to take into account the emotional component of individuals.<sup>60</sup> Guthrie, for example, identifies regret aversion as a potent emotion that can be employed to observe and analyse litigant's behaviour.<sup>61</sup> To Kahneman's credit, he admits that the inability of the prospect to deal with regret is one of its "blind spots"<sup>62</sup>.

The regret aversion theory of litigation suggests that litigants will prefer to settle rather than litigate in order to avoid post-decision regret.<sup>63</sup> For an attorney, the implication is that he has to take into account the type of litigant (institutional or individual), his personality (high or low self-esteem) and the type of case

<sup>53</sup> Guthrie, 'Prospect Theory' (nxx) 1118, 1156.

<sup>54</sup> Ibid, 1156-1159.

<sup>55</sup> Ibid, 1160-1162.

<sup>56</sup> Guthrie, 'Prospect Theory' (nxx) 1159-1160 *ibid*

<sup>57</sup> Rachlinski, 'Gains' (nxx) 145

<sup>58</sup> Chris Guthrie, 'Better Settle than Sorry: The Regret Aversion Theory of Litigation Behavior' (1999) University of Illinois Law Review 43, 89.

<sup>59</sup> Ibid.

<sup>60</sup> Ibid, 59-62.

<sup>61</sup> Ibid, 64.

<sup>62</sup> Kahneman, *Thinking, Fast and Slow* (nxx) 286.

<sup>63</sup> Guthrie, 'Better Settle than Sorry' (nxx) 64

(monetary or emotionally charged) when assessing the different options offered by trial and settlement.<sup>64</sup>

## Conclusion

The rational choice theory, employed in the economics and law literature for the last fifty years, despite its huge achievements, lacked an empiric confirmation. The prospect theory filled this gap by showing that individuals exhibit predictable deviations from the rational theory's expectations in situations of risk and uncertainty. The fourfold pattern of risk attitudes, the prospect theory's main implication, was employed and confirmed by legal scholars as highly relevant to litigation situations. In the ordinary litigation, the framing of the litigation as a gain for the claimant makes him favourable to settlement even for less than the expected value of the trial. Conversely, the risk-seeking attitude of the defendant constitutes an obstacle to settlement deals that might be favourable to him. This configuration is reversed in the frivolous suit, where a risk-seeking claimant frequently leads to settlement imposed by psychologically blackmailing a risk-averse defendant.

Nevertheless, not unlike the economic theory, the fourfold pattern is a "blunt tool"<sup>65</sup> of behaviour analysis. It fails to take into account the emotional aspects of litigants. Regret aversion, for instance, is a powerful feeling which induces a preference for settlement to litigation.

As a conclusion, prospect theory is an additional formidable instrument in the hands of attorneys to deliver better advice to their clients and to understand better the counterparty in litigation and settlement situations.

## Bibliography

- Bazerman M H. & Moore D A., *Judgement in Managerial Decision Making* (Wiley 2013 8<sup>th</sup> ed.)
- Guthrie C & Korobkin R, 'Psychological Barriers to Litigation Settlement: An Experimental Approach' (1994) 93 *Michigan Law Review* 107
- Guthrie C, 'Better Settle than Sorry: The Regret Aversion Theory of Litigation Behavior' (1999) *University of Illinois Law Review* 43
- Guthrie C, 'Framing Frivolous Litigation: A Psychological Theory' (2000) 67 *University of Chicago Law Review* 163
- Guthrie C, 'Prospect Theory, Risk Preference, and the Law' (2003) 97 *Northwestern University Law Review* 1115

<sup>64</sup> Ibid, 81-84.

<sup>65</sup> Guthrie, 'Prospect Theory' (nxx) 1163

- Kahneman D, *Thinking, Fast and Slow* (Penguin Books 2012)
- Kahneman D & Tversky A, 'Prospect Theory: An Analysis of Decision Under Risk' (1979) 47 *Econometrica* 263
- Kahneman D & Tversky A, 'The Framing of Decisions and the Psychology of Choice' (1981) 211 *Science* 453
- Kahneman D & Tversky A, 'Choices, Values, and Frames' (1984) 39 *American Psychologist* 341
- Kahneman D & Tversky A, 'Advances in Prospect Theory: Cumulative Representation of Uncertainty' (1992) 5 *Journal of Risk and Uncertainty* 297
- Korobkin R B. & Ulen T S., *Law and Behavioral Science: Removing the Rationality Assumption from Law and Economics* (2000) 88 *California Law Review* 1051
- Moore D A., Tetlock P E, Tanlu L and Bazerman M H., 'Conflicts of Interest and the Case of Auditor Independence: Moral Seduction and Strategic Issue Cycling' (2006) 31(1) *The Academy of Management Review* 10, 16-17
- Rachlinski J J., 'Gains, Loses and the Psychology of Litigation' (1996) 70 *Southern California Law Review* 113.

# *Parashikimi i veprave penale jashtë Kodit Penal dhe ndikimi i tyre në stabilitetin e sistemit juridik penal*

*Msc. Arjan Kastrati*

## **Abstrakt**

*Parimi i ligjshmërisë, si një nga parimet themelore ka shoqëruar formalisht të drejtën penale, i cili që në Romën e lashtë shprehej në formulën e njohur “nullum crimen, nulla poena sine lege-s’ka krim,s’ka dënim pa ligj”. Dispozitat, që parashikojnë një veprim të caktuar si vepër penale jashtë dispozitave të Kodit Penal, si pjesë përbërëse e një ligji të miratuar me shumicë të thjeshtë të gjithë deputetëve, bie ndesh me një nga parimet kryesore të Kushtetutës – ky parim është parimi i ligjshmërisë. Dispozita, që e klasifikon një veprim të caktuar si vepër penale jashtë dispozitave të Kodit Penal, dhe si pjesë e një ligji, kërkon në mënyrë taksative që ky ligj të jetë miratuar me 3/5 e votave të deputetëve të Kuvendit. Nëse dispozitat penale bëhen pjesë e ligjeve të miratuara me shumicë të thjeshtë kjo dëmton sistemin penal dhe stabilitetin juridik. Argumentimi i kësaj hipoteze lidhet me dy vendime të Gjykatës Kushtetuese, të cilat janë marrë në shqyrtim gjatë këtij punimi. Shpërndarja e normave juridiko-penale në ligje të ndryshme si dhe ndryshimet e shpeshta në legjislacionin penal, nuk i shërbejnë stabilitetit juridik të vendit, i cili është kusht thelbësor për funksionimin e shtetit të së drejtës.*

***Fjalë kyçe:** Legjislacion penal, vepra penale, të drejtat dhe liri themelore, stabilitet juridik*

Parimi kryesor që parashikohet në kodin penal bashkangjitur me parimet e tjera, është edhe parimi i ligjshmërisë që nënkupton parashikimin me ligj të veprave penale dhe mosdënimin për një veper penale e cila nuk është parashikuar shprehimisht si krim ose kundërvajtje penale. Dispozita, që parashikon një veprim

të caktuar si veper penale jashtë dispozitave të Kodit Penal , si pjesë përbërëse e një ligji të miratuar me shumicë të thjeshtë të gjithë deputetëve, bie ndesh me një nga parimet kryesore të Kushtetutes, parimin e ligjshmërisë. Bie ndesh, sepse prek drejtpërdrejtë shtetasit në të drejtat dhe liritë e tyre, duke mos respektuar shumicën e cilësuar për ligje të tilla të parashikuar nga neni 81 pika 2 të Kushtetutes.

Një rast faktik është ligji nr.9662, date 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” që parashikon si vepër penale në nenin 90 “Ushtrimi pa licensë i këmbimit valuator”.

Detyrimi kushtetues për ligjvënësin i shprehur dhe në vendimin nr.1 dt.12.01.2012,i Gjykatës Kushtetuese që dispozitat penale t’i parashikojë në Kodin Penal ose edhe në ligje të tjera,me kusht që të miratohen me shumicë të cilësuar prej 3/5 të anëtarëve të deputetëve. Kërkuesit në vendimin e sipërcituar, pretendojnë që përfshirja në ligj e një dispozite penale, jo vetëm që bie ndesh me parimin e ligjshmërisë të sanksionuar në nenin 29 të Kushtetutës,por vjen në kundërshtim edhe me nenin 81 pika 2 shkronja d, të Kushtetutës, sipas së ciles kodet miratohen me 3/5 e antarëve të kuvendit.

Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave ka kërkuar rrëzimin e kërkesës duke paraqitur argumentet e mëposhtme: Kodi Penal, në nenin 1/a, parashikon se legjislacioni penal përbëhet nga ky Kod dhe ligje të tjera që parashikojnë veprat penale. Në interpretim të këtij neni ligjvënësi ka çmuar se jo detyrimisht çdo vepër penale duhet të parashikohet si e tillë në Kodin Penal, duke lënë hapësirë që disa lloj veprash të parashikohen edhe në ligje të tjera.<sup>1</sup>

Qëndrimi i kërkuarve me të drejtë arsyetohet duke u shprehur se: është në kompetencën e ligjvënësit që nëpermjet akteve ligjore të rregullojë me hollësi të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë.Qëllimi i kushtetutbërësit duke iu referuar nenit 29 të Kushtetutës nuk është parashikimi i veprave penale vetëm në Kodin Penal ose në ligje të barasvlefshme me të për nga procedura por edhe në ligje të vecanta të miratuara me shumicë të cilësuar.<sup>2</sup>

I parë historikisht, parimi i ligjshmërisë ka shoqëruar formalisht të drejtën penale, i cili që në Romën e lashtë shprehej në formulën e njohur “nullum crimen, nulla poena sine lege - s’ka krim, s’ka dënim pa ligj”. Ligjshmëria përbën në vetvete një garanci për veprimtarinë normale të shtetit demokratik dhe të organizatave dhe të organizmave të tjera kombëtare e ndërkombëtare. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, (miratuar më 10 dhjetor 1948), konventat, marrëveshjet dhe çdo akt që përmban norma juridiko-penale apo që trajtojnë probleme të kriminalitetit, përshkohen nga parimi i ligjshmërisë, nga rregulla dhe angazhime për miratimin dhe zbatimin e ligjeve që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

<sup>1</sup> Sipas, Parime Kushtetuese dhe të drejta themelore në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, fq.201.

<sup>2</sup> Sipas, Vendimi nr.1 datë 12.1.2011 i Gjykatës Kushtetuese.

Neni 12 i Deklaratës Universale i të Drejtave të Njeriut parashikon se, askush nuk mund të dënohet për veprime ose mosveprime, që në kohën e kryerjes nuk përbëjnë veper penale sipas të drejtës së brendshme ose asaj ndërkombëtare.<sup>3</sup>

Sipas nenit 29/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se: “Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale,e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas të drejtës ndërkombëtare”.

Dispozita që e klasifikon një veprim të caktuar si vepër penale jashtë dispozitave të Kodit Penal, dhe si pjesë e një ligji, kërkon në mënyrë taksative që ligji të jetë miratuar me 3/5 e deputetëve të Kuvendit, pasi në të kundërt, do kishim shkelje të parimit të kushtetutshmërisë, pasi preken të drejtat dhe liritë e shtetasve duke mos respektuar shumicën e cilësuar të parashikuar nga neni 81 pika 2 të Kushtetutës.

Sipas nenit 81 pika 2 e Kushtetutës, miratohen me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit:

- a) Ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve, të parashikuara nga kushtetuta,
- b) Ligji për shtetësinë,
- c) Ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore,
- d) Ligji për referendumet,
- e) Kodet,
- f) Ligji për gjendjen e jashtëzakonshme ,
- g) Ligji për statusin e funksionarëve publikë,
- h) Ligji për amnistinë,
- i) Ligji për ndarjen administrative-territoriale të vendit.

Rasti konkret i veprës penale të cituar më sipër bën pjesë në nenin 81 pika 2 e Kushtetutës, shkronja d.

Pra veprat penale qoftë si figura të veprave penale të parashikuara në pjesën e përgjithshme qoftë si dhe për veprat e parashikuara në pjesën e posaçme, janë të përfshira brenda Kodit Penal.

Rasti që po analizohet, bën pjesë në kategorinë e veprave penale që nuk janë të parashikuara në Kodin Penal, por si vepër penale e parashikuar në një ligj të veçantë, pra një rast përjashtimor.

Ligji nr.9662 dt.18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, është një ligj i miratuar me shumicë të thjeshtë, pra kemi të bëjmë me një veper penale të parashikuar në ligj të miratuar me një shumicë të thjeshtë, të anëtarëve të Kuvendit, ndërkohë që të gjitha figurat e tjera të veprave penale të parashikuara në ligje të

<sup>3</sup> E Drejta penale (pjesa e përgjithshme),Dr.Shefqet Muci,fq.33

posaçme siç është Kodi Penal, janë të miratuara me një shumicë të cilësuar, prej 3\5, e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë. Shpërndarja e normave juridiko-penale në ligje të ndryshme si dhe ndryshimet e shpeshta në legjislacionin penal nuk i shërbejnë stabilitetit juridik të vendit. Gjykata Kushtetuese e ka konsideruar si një problem serioz shpërndarjen e veprave penale jashtë Kodit Penal, pasi shtetasit mund ta kenë të vështirë njohjen me to.

Problematikë tjetër e evidentuar është fakti se një shpërndarje e tillë ka sjellë në praktikë inflacion të këtyre normave, për shkak të pasaktësive në formulim, zëvendësimit të rregullimeve të sjelljes, që mund të përbënin kundërvajtje administrative me rregullimet juridiko-penale, duke krijuar njëkohësisht vështirësi serioze në njohjen, kuptimin dhe zbatimin e tyre.

Prandaj gjykata ka arritur në përfundimin se në raste të veçanta, kur është e pashmangshme, ligjvënësi mund të parashikojë vepra penale jashtë Kodit Penal, por në çdo rast, ligje të tilla duhet të miratohen me shumicë të cilësuar, pasi parashikimi i veprave penale është kufizimi maksimal që i bëhet lirisë së shtetasve dhe si i tillë duhet të ketë një miratim sa më të gjerë në parlament.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Gjykata Kushtetuese edhe në një vendim të mëvonshëm kur ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetuten, nenin 15\A të ligjit nr.9794, datë 23.07.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, pasi u gjend në kundërshtim me kriterin formal të miratimit të ligjeve, bazuar në nenin 81\2, shkronja d, të Kushtetutës, që kërkon shumicë të cilësuar për miratimin e veprave penale.

Sipas nenit të sipërcituar: “Kryerja e punimeve të ndërtimeve pa leje, ndërtimi me pasojë krijimin e sipërfaqeve ndërtimore përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet. Kryerja e punimeve me pasojë shtesa në sipërfaqe ndërtimore tej lejes së ndërtimit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet”.<sup>4</sup>

Të dyja rastet e sipërcituara janë figura të veprave penale të posaçme por të parashikuara në ligje të veçanta, ndërkohë që Kodi Penal i përmban tek sistemi i pjesës së posaçme të resurcit e normave juridike që parashikon figurat e veprave penale (krimeve dhe kundërvajtjeve penale).<sup>5</sup> Këto janë të vendosura sipas krerëve dhe seksioneve të cilat cënojnë marrëdhëniet shoqërore të mbrojtura posaçërisht nga dispozitat e ligjit penal.

Pjesa e posaçme e së drejtës penale të Republikës së Shqipërisë, si një degë e veçantë e saj, është tërësia e normave juridike të vendosura nga shteti demokratik, të cilat parashikojnë figurat konkrete të veprave penale (krime dhe kundërvajtje penale) që përmban ligji penal si dhe llojin dhe masën e dënimit për çdo vepër penale.

Vepra penale e parashikuar në nenin 90 “Ushtrimi pa licensë i këmbimit valuator”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, mund të bënte pjesë shumë mirë tek kreu III i Kodit Penal, ku përfshihen veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, dhe mund të përfshihej në një seksion të posaçëm brenda këtij kreu të Kodit Penal.

Siç e përmenda dhe më sipër, norma të tilla juridike sidomos me karakter penal duhet të jenë të përfshira në ligje të veçanta të miratuara me shumicë të cilësuar dhe jo nga ligje të miratuara me shumicë të thjeshtë. Mendoj se një praktikë e tillë abuzimi e pushtetit ekzekutiv cënon rëndë një nga normat e Kushtetutës.

Sipas mendimit tim, shpërndarja e normave juridiko-penale në ligje të ndryshme si dhe ndryshimet e shpeshta në legjislacionin penal ndërmjet këtyre rasteve nuk i shërbejnë stabilitetit juridik të vendit, i cili është kusht thelbësor për funksionimin e shtetit të së drejtës.

Problemi më serioz konsiston dhe me shpërndarjen e normave jashtë Kodit Penal ku shtetasit mund ta kenë të vështirë njohjen me to. Një shpërndarje e tillë sjell në praktikë një inflacion të këtyre normave duke përmendur këtu, pasaktësitë në formulimin, zëvendësimin juridik të sjelljeve të cilat duke u parë në filtrin e teknikës legjislative krijojnë njëkohësisht vështirësi serioze në njohjen, kuptimin dhe zbatimin e tyre.

## Bibliografia

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.  
Xhezair Zaganjori, Arta Vorpsi, Denar Biba, “Parime kushtetuese dhe të drejta themelore në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese”, Konrad Adenauer Stiftung, Tiranë, 2012.  
Vendimi nr.1 datë 12.1.2011 i Gjykatës Kushtetuese.  
Shefqet Muçi, “E drejta Penale”, Botimet Dudaj, Tiranë 2007.  
Ismet Elezi, “E drejta penale e Republikës së Shqipërisë”, Albin, Tiranë 1999.

<sup>4</sup> Sipas, Parime Kushtetuese dhe të drejta themelore në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, fq.202.

<sup>5</sup> Sipas, Ismet Elezi, E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, fq 7.

# *Pse i binden njerëzit ligjit?* \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ *Msc. Brikena Mile* \_\_\_\_\_

## **Abstrakt**

*Ligji fillon e merr formën e tij të përkryer në momentin që bëhet i zbatueshem. Askujt nuk mund t'i shërbej thjesht morali pozitiv për te qenë i sigurt në shoqëri. Që funksioni i tij rregullator e harmonik për jetesën e gjithë secilit të marr formë reale ai duhet doemos të zbatohet. Objekti i këtij artikulli do jetë pikërisht bindja ndaj së drejtës dhe arsytet pse ne shtyhem drejt saj. Qëllimi është të arrijmë të kuptojmë pse disa ligje gjejnë lehtë zbatim masivisht, ndërsa të tjerat shkelen, duke sfiduar në këtë mënyrë të gjitha ato pikëpamje abstrakte që apriori vendosin në të njëjtën peshore ligjet dhe njerëzit.*

**Fjalët kyçe:** E drejta, ligji (i padrejtë), morali, mosbindja civile

## **Vështrim i përgjithshëm**

Filozofia e së drejtës na ofron pikëpamje natyrore, pozitiviste, utilitariste, kantiane etj. që tentojnë të japin argumenta gati absolute se përse njerëzit i binden së drejtës.<sup>1</sup> Mjaft prej këtyre doktrinave e paraqesin të drejtën në kushte laboratorike duke marrë si faktor vetëm ligjin nga njëra anë dhe individët në anën tjetër, të modeluar në të atillë formë që merret si raport konstant dhe universal për të gjitha shoqëritë. Të gjitha qasjet filozofike megjithëse me pretendime të kundërta për prevalimin e ligjit apo moralit, na fokusojnë në një rreth vicioz ku është e pamundur të dalësh. Ose fajin për mosbindjen e ka ekskluzivisht e drejta, ose ekskluzivisht njerëzit. Por e drejta nuk mund të shpjegohet në kushte sociale të idealizuara apo të imagjinuara në mënyrë abstrakte. E ndërsa sociologjia e së drejtës arrin të na thotë se raporti i bindjes ose mosbindjes së njerëzve ndaj së drejtës është variabël dhe i varur nga faktorë të ndryshëm, si kohore ashtu dhe kulturore<sup>2</sup>.

<sup>1</sup> Shih për më tepër Luljeta Ikonimi, *Filozofia e së drejtës*, (Tirane, 2010)

<sup>2</sup> David Nelken, 'Blinding Insights? The Limits of a Reflexive Sociology of Law', (Journal of Law and Society, 1998)

Vetë metoda empirike dhe historike që zgjedh sociologjia e së drejtës tregon qartazi natyrën jokonstante njerëzore dhe sjelljen jo gjithmonë ideale të individit të kushtëzuar nga rrethana konkrete.<sup>3</sup> E drejta singulare që kishin parasysh filozofet e së drejtës kur i referoheshin asaj e humbet kuptimin në studimin që bën sociologjia e së drejtës, pasi do ishte e pamundur që njerëzit të zbatonin të gjitha normat njëherësh apo t'i shkelnin ato njëherësh. Do ishte dogmë të besohej kjo gjë.

Bindja ndaj së drejtës rezulton kur funksionon si duhet komunikimi ndërmjet së drejtës dhe shoqërisë, ndërkohë që mosbindja rezulton kur ky raport komunikimi është i mangët, është rrjedhojë e keqkuptimeve, imponimeve apo presioneve si nga ana e së drejtës, ashtu dhe nga ana e shoqërisë.

## Raste studimore

### Rasti i 'Sokratit'

*Faktet:* Sokrati pret të ekzekutohet dhe një nxënës i tij, Kritoni, i propozon të arratiset. Sokrati refuzon arratisjen, me argumentin se edhe pse është dënuar padrejtësisht, kjo padrejtësi nuk mund të ndreqet duke kryer një tjetër.<sup>4</sup>

*Analiza:* Zakonisht, interpretimi që i behët këtij rasti nga filozofia e së drejtës e lidh qendrimin e Sokratit me bindjen ndaj ligjit sipas qendrimin të teorisë se të drejtës natyrore. Pra Sokrati i bindet një ligji të padrejtë, sepse ky është një ligj njerëzor, ndërkohë që ai sheh përtej këtij ligji: sheh te drejten natyrore, vete 'Drejtësinë'. Kështu, është e drejta natyrore që ka krijuar këtë ligj njerëzor, edhe pse të padrejtë. Në fakt, është e drejta natyrore që ka mundësuar shoqërinë në të cilën Sokrati jeton dhe i ka dhënë fuqi edhe këtij ligji të padrejtë që e ndëshkoi atë. Megjithatë, duhet të kemi parasysh se argumenti i Sokratit është vetëm i tij dhe nuk përfaqëson domosdo mendimin e shumicës së njerëzve që jetonin në atë kohë. Përveç kësaj, edhe pse Sokrati e konsideron të padrejtë atë ligj, kjo s'do të thotë se në fakt është kështu. Pasi një ligj i padrejtë për Sokratin, mund të konsiderohet i drejtë nga të tjerët, ose edhe nga vetë Sokrati po të jetonte në rrethana të tjera kohë më vonë. Dhe, në rrethana të tilla të ndryshuara, nuk mund ta dimë nëse Sokrati do vazhdonte t'i bindej këtij ligji.

### Rasti 'Martin Lutter King'

*Faktet:* Lutter King vuan dënimin në burg për shkak të demonstratave dhe aksioneve te paligjshme që ka kryer. Lutter Kingu e mbron veten për shkeljen që i ka bërë ligjit me argumentin se është përgjegjësi morale për të mos i bindur ligjeve të padrejta.

<sup>3</sup> Roger Cotterrell, 'Why Must Legal Ideas Be Interpreted Sociologically?', (1998, Journal of Law and Society, 25(2), 171-192.)

<sup>4</sup> Jack Balkin, 'Interdisciplinarity as Colonization', (1996, Washington and Lee Law Review, 53, 949-970.)

*Analiza:* Duket sikur kemi një rast të kundërt me atë të Sokratit. Ndërsa Sokrati i bindet një ligji të padrejtë, Lutter Kingu zgjedh të mos i bindet, madje duke theksuar se mosbindja është detyrim moral. Megjithatë, duhet të mbajmë parasysh se Sokrati jetonte në epokën e së drejtës natyrore, ndërkohë që Lutter Kingu jetonte në epokën e së drejtës pozitive. Kjo do të thotë se në kohën e Sokratit një ligj i padrejtë mund të justifikohet me faktin se buronte sidoqoftë nga themelet e drejtësisë, të cilat mundësonin vetë shoqërinë. Pra Sokrati ishte i mendimit se shoqërinë e ka krijuar e drejta dhe jo anasjelltas. Lutter Kingu, nga ana tjetër, mendonte se është shoqëria ajo që krijon të drejtën dhe për këtë arsye mund ta ndryshojë atë, ose kur nuk ka mundësi, të zgjedhë mosbindjen. Kështu, në epokën e së drejtës natyrore Sokrati na shfaqet si pozitivist, ndërsa në epokën e së drejtës pozitive Lutter Kingu na shfaqet si perfaqësues i së drejtës natyrore. Keto dy raste janë përjashtim nga rregulli, por sidoqoftë dëshmojnë se njerëzit dhe e drejta janë variable dhe nuk mund të nxjerrim konkluzione konstante për bindjen apo mosbindjen ndaj ligjit.<sup>5</sup>

## Konkluzione

Në këtë kontekst, problemi i sigurimit të bindjes ndaj së drejtës i referohet sistemit politik për ta zgjidhur, duke marrë vendime të përshtatshme, pas analizave të kujdeshme të terrenit kulturor të vendit, qëndrimin të opinionit publik në lidhje me ligje të caktuara, konsultimit me grupet e interesit, por edhe respektimit të specifikave lokale.<sup>6</sup>

Sa më sipër mendoj se është relevante për procesin më të madh ku është futur Shqipëria vitet e fundit: integrimin evropian. Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit i kërkon Shqipërisë të përafrojë legjislacionin shqiptar me atë të Bashkimit Evropian. Ky është një moment që mbart shumë probleme. Së pari, e drejta evropiane po bëhet pjesë e së drejtës shqiptare pa marrë fare në konsideratë traditën kulturore, stadin ekonomik, opinionin publik ekzistues, dhe kapacitetet administrative që disponon Shqipëria.

Për të gjitha këto arsye, ligjet e miratuara nga Parlamenti në funksion të ecurisë së procesit të integritimit evropian, kanë sjellë probleme të mëdha komunikimi ndërmjet së drejtës dhe njerëzve. Shqiptarëve u ofrohet një e drejtë që nuk merr parasysh situatën e tyre, vlerat e tyre, dhe aspiratat e tyre. Kështu, nuk ka pse të habitemi që kemi një nivel të lartë të mosbindjes ndaj ligjit sot në Shqipëri.

<sup>5</sup> Boaventura de Sousa Santos, 'Law : A Map of Misreading. Toward a Postmodern Conception of Law ', (1987, Journal of Law and Society, 14(3), 279-302.)

<sup>6</sup> Gunther Teubner, 'The Two Faces of Janus: Rethinking Legal Pluralism', (1997, in Kaarlo Tuori, Jyrki Uusitalo, and Zenon Bankoë ski (eds.), Law and Power: Critical and Socio-legal Essays, Deborah Charles Publications.)

Vendimarrja e detyrueshme për të gjithë ne i takon politikës. Ndaj dhe është pikërisht sistemi politik që duhet të fillojë të reflektojë për situatën e krijuar dhe të përdorë të gjitha mekanizmat që disponon për të normalizuar raportin ndërmjet së drejtës dhe individëve.

## Bibliografia

- Balkin, Jack M. (1996), 'Interdisciplinarity as Colonization', *Washington and Lee Law Review*, 53.
- Cotterrell, Roger (1998), 'Why Must Legal Ideas Be Interpreted Sociologically?', *Journal of Law and Society*, 25(2).
- Ikonomi, Luljeta (2010), *Filozofia e së drejtës*, Onufri, Tiranë.
- Nelken, David (1998), 'Blinding Insights? The Limits of a Reflexive Sociology of Law', *Journal of Law and Society*, 25(3).
- Santos, Boaventura de Sousa (1987), 'Law: A Map of Misreading. Toward a Postmodern Conception of Law', *Journal of Law and Society*, 14(3).
- Teubner, Gunther (1997), 'The Two Faces of Janus: Rethinking Legal Pluralism', in Kaarlo Tuori, Jyrki Uusitalo, and Zenon Bankowski (eds.), *Law and Power: Critical and Socio-legal Essays*, Deborah Charles Publications.

# *Legjitimimi i palëve në ngritjen e padisë për çështjet mjedisore. (Rasti i Parkut të Liqenit Artificial Tiranë)*

*Dokt. Artan Manushaqe*

## Abstrakt

*Rasti i ndërtimit të Parkut të Liqenit Artificial Tiranë, i miratuar me Vendimin nr. 1, datë 12.02.2016 të Këshillit Kombëtar të Territorit për miratimin e lejes së ndërtimit nga Bashkia Tiranë, bie në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën e Arhusit si dhe ligje të tjera sektoriale pasi nuk është respektuar statusi i Parkut të Liqenit Artificial si zonë e rëndësisë kombëtare (Kurora e Gjelbër). Gjithashtu nuk është bërë vlerësimi strategjik i mjedisit dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis, si dhe janë shkelur një sërë ligjesh të tjera kombëtare dhe komunitare për parandalimin e shkaktimit të dëmit mjedisor, përgjegjësinë e shkaktimit të dëmit ndaj mjedisit dhe zhvillimit të territorit si pjesë e zhvillimit të qëndrueshëm, dhe shumë parimeve të tjera të së drejtës.*

*Të gjitha këto shkelje legjitimojnë publikun e prekur dhe të interesuar për ngritjen e padisë për çështjet mjedisore, dhe kërkimet e tjera që shoqërojnë kërkesë padinë.*

**Fjalë Kyçe:** ligjshmëria, dëm mjedisor, legjitimimi, padia.

## Hyrje

Qëllimi i këtij punimi është të ofrojë njohuri në fushën e së drejtës mjedisore; të legjitimimit të personave fizik dhe juridik në lidhje me kërkimet për pavlefshmëri të akteve juridike; në rikthimin e gjendjes së mëparshme të mjedisit; si dhe shkaktimin e dëmeve mjedisore reale dhe të ardhshme ndaj personave fizik dhe juridik (publik i prekur), nisur nga rasti i Parkut të Liqenit Artificial Tiranë.



Në datën 10 shkurt 2016 midis pjesës hyrëse të Parkut nga krahu i digës dhe përgjatë gjithë kolinës (deri të kisha e Shën Prokopit) dhe në afërsi të Amifiteatrit kjo zonë u rrethua me një gardh, ku sipas Bashkisë Tiranë më vonë u deklarua që do të ketë një kënd lojrash për fëmijë, sip e rrethuar rreth 11800m<sup>2</sup>. Sipas faqes zyrtare të Agjensisë së Prokurimit Publik APP në datën 14.12.2015 njoftohej hapja e tenderit me nr 49 me objekt “Këndi i Lojrave” dhe ku autoriteti prokurues është Bashkia Tiranë. Në datë 08.02.2016 lidhet kontrata me fituesin e shpallur. Përshkrimi i objektit sipas APP: kënd lojrash për fëmijë, shina treni për fëmijë, Grand Kafe, kioska për akullore, gazeta: platformë vallëzimi; pikë informacioni në lidhje me parkun si dhe një zonë për ndihmën e shpejtë<sup>1</sup>, klub i vozitjes dhe një pishinë publike lundruese brenda në liqen, të cilat mbulohen nga një platformë dritash e quajtur “Tufa e Xixëllonjave”.

Këshilli Kombëtar i Territorit me vendimin nr 1 datë 12.02.2016 vendos për miratimin e lejes së kushtëzuar të ndërtimit për objektin “Kënd i lojrave për fëmijë, projekti pilot 4, në këtë kuadër të rehabilitimit të Parkut të Liqenit, Bashkia Tiranë”, është zhvilluesi projektit.

Pas reagimit të shoqërisë civile për mos bërjen transparente të projektit dhe konsultimin me publikun sipas Konventës së Aarhusit (2001) dhe ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe ligjeve të tjera sektoriale dhe kuadër, projekti i shfaqur në faqen zyrtare të APP fillon të zbatohet nga Bashkia Tiranë pjesërisht, duke u anuluar nga projekti i shpallur më sipër elemente të tilla si: grand kafeja, kioskat, pista e vallëzimit dhe një sërë objektesh të tjera. Vendimi i KKT përcakton se kjo zonë është zonë me rëndësi kombëtare në planifikimin e territorit, identifikuar si kurora e gjelbër Tiranë.

Kushtet e Lejes së ndërtimit sipas KKT janë:

- a. Harta e planvendsojes së strukturës bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- b. Dokument i lejes së ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  1. Plotësimit të dokumentacionit tekniko –ligjor;
  2. Marrjes së konformitetit nga Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit;
  3. Pagesës së Taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të njësisë së qeverisjes vendore.

Shoqëria civile gjatë kësaj periudhe protestoi për mos transparencë nga institucionet shtetërore për ditë dhe muaj me radhë.

<sup>1</sup> Këshilli Kombëtar i Territorit me vendimin nr 1 datë 12.02.2016 vendos për miratimin e lejes së kushtëzuar të ndërtimit për objektin “Kënd i lojrave për fëmijë, projekti pilot 4, në këtë kuadër të rehabilitimit të Parkut të Liqenit, Bashkia Tiranë”.

## Legjitimimi i paditësve për ngritjen e padisë për çështjet mjedisore (Rasti i Parkut Tiranë)

Me ligjin nr.8672, datë 26.10.2000 “Për ratifikimin e Konventës së Aarhus-it për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”, shteti shqiptar ka ratifikuar Konventën e Aarhus-it. Objektivi i Konventës së Aarhus-it në përputhje me nenin 1 të saj, është dhënia e kontributit “në mbrojtjen e të drejtës së çdo individi të brezave të sotëm e të ardhshëm, për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij” dhe garantimin nga të gjitha shtetet anëtare të konventës së të drejtës së publikut “për të pasur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t’iu drejtuar gjykatës, në lidhje me çështje të mjedisit”.

Neni 9 (3) i Konventës së Aarhus-it, përmban një dispozitë thelbësore e cila i mundëson publikut të aktivizohet personalisht për mbrojtjen e mjedisit në të cilin jeton. Përkatësisht nenin 9(3) i Konventës parashikon se “kur anëtarët e publikut plotësojnë kriteret, nëse ka të tilla në ligjin kombëtar, ata do të kenë të drejtë për t’iu drejtuar procedurave administrative ose gjyqësore për të mos pranuar veprimet apo neglizhimet nga personat privatë dhe autoritetet publike, të cilat janë në kundërshtim me klauzolat e legjislacionit të vet kombëtar, në lidhje me mjedisin”. Në përputhje me nenin 116 (1) (b) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, siç është Konventa e Aarhus-it, janë akte normative që kanë fuqi në të gjithë territorin shqiptar. Për më tepër neni 122 i Kushtetutës i vlerëson këto akte me epërsi mbi ligjet e vendit dhe iu jep forcën për të qenë direkt të aplikueshme. Interpretimi i përbashkët i dispozitave të mësipërme të Konventës së Aarhus-it të ratifikuar u jep paditësve të drejtat e mëposhtme: të drejtën për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tyre; të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës kundër veprimeve të autoriteteve publike të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit kombëtar në lidhje me mjedisin sipas nenit 9 (3) të konventës.

E drejta për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien, sanksionuar nga neni 1 i Konventës së Aarhus-it, njihet në Shqipëri edhe nga një numër i madh parimesh dhe procedurash të tjera ligjore. Përkatësisht në nenin 1 të Ligjit Nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”<sup>2</sup>, përcaktohet se qëllim i ligjit është mbrojtja e një niveli të lartë të mjedisit, ruajtja dhe përmirësimi i tij, parandalimi dhe pakësimi i rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe

<sup>2</sup> Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit

sigurimi i kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Në të njëjtën mënyrë të gjitha parimet e ligjit nr. 10431 të tilla si parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, parimi i parandalimit, parimi i përgjegjësisë, parimi ndotësi paguan, parimi i informimit të publikut dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen mjedisore etj, synojnë zbatimin e të drejtës për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm (nenet 6-14). Të gjitha këto parime janë të përkthyer në një sërë procedurash të domosdoshme që duhen zbatuar nga autoritetet publike dhe private, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre dhe janë baza kryesore për legjitimimin e palëve në proces për ngritjen e padisë për dëmin mjedisor, si nga subjektet private dhe ato publike. Në rastin konkret, këto parime gjejnë pasqyrim më tej në parashikimet e Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”<sup>3</sup>, Ligjit nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor” dhe Ligjit nr.10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

E drejta për t’iu drejtuar gjykatës kundër veprimeve të autoriteteve publike të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit kombëtar në lidhje me mjedisin, garantohet nga neni 48 (b) i Ligjit nr.10 431, i cili parashikon se publiku ka të drejtën të ngrëjë padi në gjykatë kundër autoritetit publik që ka sjellë dëme në mjedis ose rrezikon ta dëmtojë atë. Kriteret ligjore të legjitimitit përpara gjykatave të anëtarëve të publikut, ashtu siç kërkohet nga neni 9 (3) i Konventës së Aarhus-it, janë shprehimisht të përcaktuar në legjislacionin shqiptar mjedisor dhe përkatësisht në Ligjin Nr.10431 dhe Ligjin 10440 të sipërpërmendur. Sipas nenit 5 (12) të Ligjit 10431, “publiku është një ose më shumë persona fizikë apo juridikë në përputhje me legjislacionin dhe praktikën kombëtare...”. Ky përkufizim i përgjithshëm, plotësohet nga përkufizimi më specifik i dhënë nga neni 6 (5) i Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, i cili flet për publikun e ndikuar dhe e përkufizon këtë të fundit si “publiku i prekur ose që mund të preket, apo publiku që është i interesuar për vendimmarrjen mjedisore...”. Në këto kushte, paditësit në cilësinë e banorëve të qytetit të Tiranës, pa dyshim bëjnë pjesë në bashkësinë e publikut të ndikuar nga vendimmarrja e Bashkisë së Tiranës për kryerjen e punimeve të ndërtimit të parkut të lojërave brenda një zone me ndjeshmëri të lartë mjedisore. Për më tepër, duke marrë parasysh se zona ku po ndërtohet parku i lojërave është shpallur zonë me rëndësi kombëtare nga Vendimi i KKT nr. 4, dt.29.12.2014<sup>4</sup>, legjitimimi zgjerohet përtej qytetarëve të Tiranës, duke përfshirë të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë.

Siç provohet në mënyrë të detajuar në këtë kërkesë padi, punimet e ndërtimit kanë nisur dhe po vazhdojnë të kryhen pa asnjë studim paraprak të ndikimeve të punimeve në mjedis dhe pa u pajisur me leje mjedisore. Jemi përpara kushteve kur aktualisht janë shkaktuar dëme në mjedis dhe rreziku i shkaktimit të dëmeve

akoma më të mëdha rritet dita ditës. Për të gjitha këto arsye, paditësit në përputhje me parashikimet e nenit 15 (a) të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i drejtohen Gjykatës me anë të kësaj padie, kundër veprimit të paligjshëm të Bashkisë Tiranë në shkelje të së drejtës së tyre për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqënien e tyre sipas nenit 1 të Ligjit nr. 8672 dhe për mbrojtjen e mjedisit nga dëmet apo rreziku i dëmtimit sipas nenit 48 të Ligjit 10431.

## Konkluzion

Mendoj se ndërtimi te Parku i Liqenit Artificial Tiranë është i kundraligjshëm, pasi publiku nuk është informur dhe nuk ka qenë pjesëmarrës në këtë proces, si dhe duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë: jemi në shkelje të parimit të shtetit të së drejtës të përmendur në vetë preambulën e Kushtetutës sipas të cilës, populli shqiptar ka vendosmërinë e ndërtimit të shtetit të së drejtës. Ky synim kushtetues, përcaktohet shprehimisht në nenin 4 (1) të Kushtetutës sipas të cilit “*E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit*”. Zbatimi i një projekti të paligjshëm, si ndërtimi i parkut të lojërave nga zhvilluesi Bashkia e Tiranës, shkel haptazi parimin e shtetit të së drejtës në çastin kur Bashkia e Tiranës në mënyrë arbitrare ka shmangur procedurat ligjore për kryerjen e punimeve, si dhe vendosi nisjen dhe vazhdimin punimeve pa asnjë bazë ligjore dhe të kundraligjshme.

Në të njëjtën mënyrë, veprimtaria e paligjshme e Bashkisë së Tiranës shkel gjithashtu nenin 9 (1) të Kodit të Procedurave Administrative i cili përcakton se organet e Administratës Publike e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë. Po ashtu mendoj se shkelet neni 23 mbi të drejtën e informimit, neni 56 e drejta e informimit për çështjet e mjedisit, neni 42 i Kushtetutës që lidhet me të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe disa parime të tjera.

Bazuar në shkresën e AKM-së nr.570/1 Prot., datë 23.03.2016<sup>5</sup>, kjo e fundit ka pohuar shprehimisht se nuk ka pasur asnjë aplikim pranë këtij institucioni për Leje Mjedisore në lidhje me projektin e parkut të lojërave. Pra ndërtimi i trenit të lojërave, aktivitet që sigurisht shkakton zhurmë në mjedis, nuk është paraprirë nga aplikimi për Leje Mjedisore të tipit C sipas detyrimeve të legjislacionit në fuqi. Për këtë arsye punimet e ndërtimit të parkut të lojërave janë në kushtet e veprimit të paligjshëm administrativ sipas nenit 17 (d) të Ligjit 49/2012.

Duke u bazuar në analizën e disa prej shkeljeve të mësipërme si dhe dëmin e shkaktuar në këtë zonë nga prerja e pemëve, gërmimet, prishja e strukturës së tokës, hedhja e

<sup>3</sup> Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”

<sup>4</sup> Vendim i KKT nr 4, dt.29.12.2014

<sup>5</sup> Shkresë e AKM-së nr.570/1 Prot., datë 23.03.2016

zhavorrit, hekurit, dhe e rreth 900 metro kub beton etj. në një hapësirë publike të gjelbër që quhet Parku i Madh i Tiranës, mendojmë së ndërtimi të Parku i Liqenit Artificial është në kundërshtim me shumë ligje vendase, komunitare dhe ndërkombëtare. Për pasojë leja e KKT nr1, datë 12.02.2016 është e pavlefshme sipas Kodit të Procedurës Administrative<sup>6</sup>, është nxjerë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji, pasi është një veprim juridik apsolutisht i pavlefshëm dhe bie në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit. Për këto fakte, mendoj se publiku legjitimohet t'i drejtohet gjykatës si për ngritjen e padisë në themel ashtu edhe për kërkim të Sigurimit të Padisë si dhe dëmeve të shkaktuara në mjedis nga kjo veprimtari.

Po ashtu në rastin e Parkut të Liqenit Artificial Tiranë, është shkelur edhe Konventa e Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit, ratifikuar me ligjin nr 8672/20001 si dhe një sërë ligjesh dhe aktesh të tjera<sup>7</sup>.

Kësisoj publiku i ndikuar personat fizik dhe juridik legjitimohen për ngritjen e padisë për pavlefshmërinë e aktit juridik, rikthimin në gjendjen e mëparshme dhe kërkimin e dëmshpërblimit për shkak të dëmit mjedisor të shkaktuar nga i padituri.

## Bibliografia

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë  
Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut  
Konventa e Aarhusit  
Kodi i Procedurave Administrative  
Kodi Civil  
Kodi i Procedurës Civile  
Ligji nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.  
Ligji nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”  
Ligji nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”  
Ligji nr.10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”  
Vendimi i KKT-së, nr.4, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e çështjes dhe zonës me rëndësi kombëtare në planifikimin e territorit, identifikuar si kurora e gjelbër e Tiranës”  
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 956, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e kurorës së gjelbër të Tiranës dhe masat për mbrojtjen e saj”  
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”

<sup>6</sup> Kodi i Procedurave Administrative, neni 116 pika c.

<sup>7</sup> Mendoj që ligje të tjera të shkelura janë edhe: ligji nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”; ligji nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; ligji nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”; ligji nr.10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis; Vendimi i KKT-së, nr.4, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e çështjes dhe zonës me rëndësi kombëtare në planifikimin e territorit, identifikuar si kurora e gjelbër e Tiranës”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 956, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e kurorës së gjelbër të Tiranës dhe masat për mbrojtjen e saj”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

## *Vështrim i shkurtër krahasimor ndërmjet legjislacionit të BE-së dhe legjislacionit të SHBA-së në fushën e së drejtës së autorit*

*Dnt. Enejda Shyti*

### Abstrakt

*Zhvillimi i njerëzimit ka ardhur si rezultat i aftësive të krijimtarisë njerëzore, të cilat sjellin progresin ekonomik, social dhe atë kulturor. Në këtë kuadër, duke marrë parasysh rëndësinë që ka krijimtaria njerëzore, është e nevojshme që asaj t'i sigurohet mbrojtje në nivelet e duhura. Kjo mbrojtje duhet të akordohet nga legjislacioni përkatës për mbrojtjen e së drejtës së autorit. E drejta e autorit ka gjetur mbrojtje ligjore nga shumica e legjislacioneve në botë. Megjithatë, mbrojtja që i bëhet kësaj të drejte nuk është e njëjtë kudo. Kështu, mënyra e realizimit të mbrojtjes ligjore, që i sigurohet të drejtës së autorit në SHBA ndryshon nga ajo në Bashkimin Europian, sepse edhe vetë legjislacionet respektive janë zhvilluar mbi baza dhe koncepte të ndryshme ligjore. Legjislacioni i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në fushën e së drejtës së autorit mbështetet në Common Law dhe në konceptin e “Fair Use”, ndërsa sistemi evropian i së drejtës së autorit e ka origjinën e tij nga e drejta romake dhe nga e ashtuquajtura “paternity right”. Qëllimi i punimit është të evidentojë elementet kryesore të legjislacionit mbrojtës së të drejtës së autorit në BE dhe SHBA, në mënyrë që më pas të fokusohet në një vështrim krahasimor ndërmjet tyre, duke prezantuar qartë ngjashmëritë, ndryshimet dhe përparësitë e secilit prej tyre. Gjithshka këtu, do të konkretizohet duke iu referuar çështjeve të ndryshme gjyqësore.*

**Fjalë kyç** – *Bashkimi Europian, SHBA, e drejta e autorit, legjislacion, Fair Use.*

## Hyrje - Qëllimi i krijimit të legjislacionit të BE-së për të drejtën e autorit

Fillesa e Bashkimit European e ka origjinën e saj në krijimin e një tregu të përbashkët, ndaj në kuptimin e saj të përgjithshëm, e drejta e autorit në legjislacionin e BE-së, është konsideruar pjesë e rëndësishme e legjislacionit european për të kryer rregullimin ligjor të shumë çështjeve, që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në mirëfunksionimin e tregut unik european.

Zhdukja e kufinjve të brendshëm në Bashkimin European nuk do të kuptojë uljen e nivelit të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve, krijuesve dhe bizneseve. Liria e qarkullimit të personave, shërbimeve, kapitaleve dhe mallrave janë përforcuar nga politika që synojnë luftën ndaj aktiviteteve ilegale, duke i dhënë përparësi tregëtisë mbi baza të mirëfillta ligjore, si dhe mbrojtjen e interesave të individëve dhe bizneseve të tyre. Për të krijuar një treg unik në Evropë, duhen eliminuar ose në pamundësi duhen reduktuar maksimalisht kufizimet mbi lirinë e lëvizjes dhe praktikave antikonkurrenciale, duke krijuar një ambient të favorshëm për risitë në teknologji dhe investimet në fushat kryesore të ekonomisë. Në këtë kontekst, mbrojtja e pronësisë<sup>1</sup> intelektuale dhe veçanërisht mbrojtja e së drejtës së autorit është një element esencial për suksesin e Tregut Unik European. Të gjitha masat e marra në nivel komunitar mbi pronësisë intelektuale, janë të nevojshme për funksionimin e tregut unik dhe janë projektuar për të krijuar një mjedis ligjor, të harmonizuar për përfitimin e gjithsecilit që vepron në industri dhe tregti.

Pronësia intelektuale mbulon një hapësirë të të drejtave të ndryshme, të cilat janë duke u harmonizuar gradualisht me qëllimin final për të siguruar një nivel të lartë mbrojtjeje, e cila garanton lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve. Brenda Bashkimit European, e drejta e autorit (copyright) rregullohet nga çdo shtet me të drejtën e brendshme të tij, ndaj edhe Shtetet Anëtare të BE-së deri vonë kanë ruajtur autonominë e tyre në këtë fushë. Në këtë kuadër, theksojmë faktin se ligjet mbi të drejtën e autorit ndryshojnë në Vendet Anëtare të BE-së, sidomos ndërmjet vendeve në të cilat zbatohet sistemi *Common Law* (Qipro, Irlanda, Malta dhe Britania e Madhe) dhe vendeve të sistemit *Civil Law*. Për këto arsye, ishte mëse i nevojshëm harmonizimi i kuadrit ligjor brenda Bashkimit European.

Megjithatë, meqenëse shumica e shteteve të BE-së janë palë në marrëveshjet<sup>2</sup>, traktatet dhe konventat ndërkombëtare që mbrojnë të drejtën e autorit në nivel global, zbatimi i detyrimeve të këtyre konventave ka qënë i detyrueshëm për këto shtete, si dhe ka kryer deri diku një unifikim të përgjithshëm global, për sa i përket

parimeve kryesore të së drejtës së autorit dhe mjeteve për mbrojtjen e saj.

Ky konsiderohet një hap i madh përpara, por në të njëjtën kohë duhet njohur fakti që shumica e konventave shumëpalëshe dhe veçanërisht ato të rishikuara në fund të viteve '60 dhe fillim të viteve '70, nuk japin një përgjigje të plotë për të gjitha pyetjet, te cilat mund të ngrihen rreth çështjeve komplekse që i përkasin të drejtës së autorit<sup>3</sup>, e në mënyrë të veçante atyre pyetjeve që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zhvillimet teknologjike e industriale të kohëve të fundit. Natyrisht, që tregu unik shpesh kërkon një harmonizim më të strukturuar të legjislacionit kombëtar, sesa kërkojnë konventat ndërkombëtare. Kështu që, megjithëse veprimi shumëpalësh është i nevojshëm, nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e tregut të përbashkët european.

Komuniteti European ndërmori hapat e para reale në fushën e pronësisë intelektuale në gjysmën e dytë të viteve '70, por vetëm me krijimin e tregut unik u siguria shtytja vendimtare për harmonizimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Qëllimi ishte të sigurohej që mallrat dhe shërbimet e mbrojtura nga këto të drejta, mund të lëviznin lirish. Një mbajtës i të drejtës së autorit duhej të ishte në gjendje të trajtonte komunitetin<sup>4</sup> si një treg unik vendas, që do të thoshte që mbrojtja e mundshme duhej të ishte e njëjtë në të gjitha Vendet Anëtare. Ndryshimet<sup>5</sup> që do të pengonin arritjen e këtij qëllimi, duhet të eliminohehin me anë të masave të miratuara në nivel komunitar. Megjithatë fillimisht, veprimi i Komunitetit mori formën e vendosjes në një linjë të legjislacionit të pronësisë intelektuale (dhe të drejtës së autorit si pjesë e saj) të Vendeve Anëtare me qëllim për të eliminuar ndryshimet e trajtimit, të cilat ndërhynin në lëvizjen e lirë të shërbimeve dhe mallrave. Përpjekjet u përqëndruan në fushat ku ndryshimet ishin më shumë të theksuara, ose atje ku kishte pengesa të pajustificuara për lëvizjen e lirë.

Për këtë arsye, rreth viteve '80, duke pasur parasysh mënyrat e ndryshme ligjore të rregullimit dhe trajtimit të së drejtës së autorit, shkallën e ndryshme të zbatimit të ligjeve kombëtare në Vendet Anëtare, si dhe zhvillimin e vullshëm teknologjik të saj kohe, u pa e arsyeshme të krijoheshin disa rregulla të përbashkëta në fushën e së drejtës së autorit për të gjithë Shtetet Anëtare të BE-së. Pikërisht, legjislacioni i së drejtës së autorit në BE është lartësuar në përpjekje për të harmonizuar nocionet dhe interpretimet e ndryshme, që kjo e drejtë merrte në Vendet Anëtare të Bashkimit European. Parimet bazë, ku mbështeten të gjitha aktet e BE-së në lidhje me të drejtën e autorit, konsistojnë në idenë se mbrojtja e pronësisë intelektuale konsiderohet domosdoshmëri për suksesin e tregut<sup>6</sup> të brendshëm, nxit risinë dhe krijimtarinë, si dhe ndikon në rritjen e punësimit dhe sidomos konkurrencës.

<sup>3</sup> I. Londo (2007) "E Drejta e Autorit", Instituti Shqiptar i Medias;

<sup>4</sup> Scott B., Copyright in a frictionless world, *First Monday*, volume 6, number 9, (September 2001) f.21-24;

<sup>5</sup> *European Law Journal*, Vol. 13, No. 5, September 2007, pp. 680-694., Journal compilation © 2007 Blackwell Publishing Ltd, f.13-14;

<sup>6</sup> Geller P.E., *International Copyright Law and Practise*, (2000), f. 98-102;

<sup>1</sup> Holleman J. R. (2002), *Comments on standards setting and intellectual property*, f. 23.

<sup>2</sup> Traktati "Për të drejtën e autorit" (WCT) (1996) dhe Traktati "Për artistët ekzekutues dhe interpretues, prodhimet e fonogrameve" (ËPPT) (1996), Marrëveshja e TRIPS-it (1994) etj.

## 1. Legjislacioni i së Drejtës së Autorit në Bashkimin Europian

### 1.1. Legjislacioni i BE-së për të drejtën e autorit

Këshilli i Ministrave dhe Parlamenti Europian kanë miratuar 7 (shtatë) Direktiva<sup>7</sup>, të cilat janë të fokusuara në çështjen e mbrojtjes dhe garantimit të së drejtës së autorit në BE. Shtetet Anëtare janë të detyruara t'i zbatojnë dhe t'i inkorporojnë këto Direktiva në legjislacionin e tyre të brendshëm.

Përpjekjet për të harmonizuar të drejtën e autorit në Europë (dhe më tej) fillojnë pikërisht me Konventën e Bernës “Për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike” (1886). Të gjitha Vendet Anëtare të Bashkimit Europian e kanë nënshkruar dhe ratifikuar Konventën e Bernës (1886) dhe përshtatja e legjislacioneve kombëtare me dispozitat e kësaj Konvente ka qenë e detyrueshme për të gjitha vendet europiane, të cilat dëshirojnë të pranohen në Bashkimin Europian. Referuar edhe dispozitave të Konventës së Bernës (1886), mbrojtja e së drejtës së autorit në BE është automatike, e menjëherëshme dhe nuk është e nevojshme të kryhet një regjistrim formal i veprës. Në të njëjtën kohë, dispozitat e kësaj Konvente janë fleksibël dhe i lejojnë Vendet Anëtare të Bashkimit Europian, që t'u ofrojnë veprave letrare dhe artistike, afate më të gjata mbrojtjeje, sesa ato të përcaktuara në këtë Konventë.

Megjithatë, hapi i parë, i madh, për harmonizimin e ligjeve kombëtare të së drejtës së autorit, u ndërmor nga Komuniteti Ekonomik Europian, me idenë e zbatimit të standarteve të përbashkëta për mbrojtjen e programeve kompjuterike, pikërisht me miratimin e Direktivës<sup>8</sup> “Për mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike” (91/250/EEC), në vitin 1991. Sigurisht që një Direktivë e tillë u konsiderua mëse e nevojshme, duke patur parasysh zhvillimin ekonomik dhe teknologjik që kishte përfshirë të gjitha Shtetet Anëtare, si dhe duke ndjerë domosdoshmërinë e unifikimit të dispozitave mbrojtëse të programeve kompjuterike në Bashkimin Europian.

<sup>7</sup> Council Directive 91/250/EEC of 14 May 1991 “On the legal protection of computer programs”; Council Directive 92/100/EEC of 19 November 1992 “On rental right and lending right and on certain rights related to copyright in the field of intellectual property”; Council Directive 93/98/EEC of 29 October 1993 “On harmonizing the term of protection of copyright and certain related rights”; Directive 96/9/EC of the European Parliament and of the Council of 11 March 1996 “On the legal protection of databases”; Directive 2001/29/EC of the European Parliament and of the Council of 22 May 2001 “On the harmonisation of certain aspects of copyright and related rights in the information society”; Directive 2001/84/EC of the European Parliament and of the Council of 27 September 2001 “On the resale right for the benefit of the author of an original work of art”; Directive 2004/48/EC of the European Parliament and of the Council of 29 April 2004 “On measures and procedures to ensure the enforcement of intellectual property rights”;

<sup>8</sup> Council Directive 91/250/EEC of 14 May 1991 “On the legal protection of computer programs”;

Vetëm 2 vjet më vonë, Direktiva e sipërpërmendur u ndoq nga Direktiva<sup>9</sup> (93/98/EEC), miratuar nga Këshilli i Ministrave, nëpërmjet së cilës u mundësua harmonizimi i afateve të mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe disa të drejtave (fquinje) të lidhura me të. Në këtë mënyrë, u vendos një afat i përbashkët i mbrojtjes së të drejtës së autorit deri në 70 vjet *post mortem auctoris* (pas vdekjes së autorit).

Më pas, filluan të miratohen Direktiva të tjera, të cilat parashikonin mbrojtje të veçantë për vepra të tjera si fonogramet, database-t<sup>10</sup>, fotografitë etj., por jo të gjitha u miratuan pa diskutime dhe debate të gjata ndërmjet përfaqësuesve të Shteteve Anëtarë. Implementimi i Direktivave të Këshillit të Ministrave të BE-së mbi të drejtën e autorit ka qënë tepër i diskutuar, fakt që mund të vihet re në 6 (gjashtë) çështje gjyqësore të dërguara për gjykim pranë Gjykatës Europiane të Drejtësisë, për moszbatim të Direktivës (2001/29/EC) mbi të drejtën e autorit në BE.

Direktiva<sup>11</sup> 2001/29/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të Ministrave, datë 22 maj 2001, e njohur shkurtimisht me emrin Direktiva e Bashkimit Europian për të Drejtën e Autorit, synon të harmonizojë disa aspekte të së drejtës së autorit<sup>12</sup> dhe të drejtave të lidhura me to (të drejtat fqinje) në shoqërinë e informacionit. Kjo Direktivë u hartua dhe miratua si rezultat i ndikimit që patën dy traktatet e Ëipo-s në vitin 1996, përkatësisht Traktati “Për të drejtën e autorit” (1996) dhe Traktati “Për artistët ekzekutues dhe interpretues, prodhimet e fonogrameve”. Direktiva në fjalë ka hyrë në fuqi në qershor 2001 dhe duhej të kthehej në ligj të brendshëm të shteteve anëtarë brenda datës 22 dhjetor 2002. Shtetet anëtare mund ta bënin këtë duke u bërë ndryshime ligjeve të tyre ekzistuese për të drejtën e autorit dhe duke i përshtatur ato me Direktivën e sipërpërmendur. Deri në vitin 2005, kjo Direktivë u kthye në ligj të brendshëm për Austrinë, Greqinë, Italinë dhe Danimarkën, ndërkohë që shtetet e tjera e kanë shtyrë zbatimin e saj nën presionin e lobeve të brendshme.

Në vitet në vijim u miratuan Direktiva e tjera, që plotësuan kuadrin ligjor të legjislacionit të Bashkimit Europian për mbrojtjen e së drejtës së autorit. Këto Direktiva ndikuan pozitivisht, në forcimin dhe unifikimin e metëjshëm të legjislacionit të Bashkimit Europian, në fushën e të drejtës së autorit.

### 1.2. Disa karakteristika të së drejtës së autorit në Bashkimin Europian

Mbrojtja e të drejtës së autorit në Bashkimin Europian konsiderohet si një ndër çështjet më të rëndësishme të ditëve të sotme. Kjo mbrojtje u ofrohet të gjithë autorëve, të cilët kërkojnë të mbrojnë veprat letrare, artistike dhe muzikore, të

<sup>9</sup> Council Directive 93/98/EEC of 29 October 1993 “On harmonizing the term of protection of copyright and certain related rights”;

<sup>10</sup> Directive 96/9/EC of the European Parliament and of the Council of 11 March 1996 “On the legal protection of databases”;

<sup>11</sup> Directive 2001/29/EC of the European Parliament and of the Council of 22 May 2001 “On the harmonisation of certain aspects of copyright and related rights in the information society”;

<sup>12</sup> A. De Robbio (2006) “Copyright in Europe”, Università di Padova – Italy, f. 24.

shprehura në trajtën apo formën e librave, pikturave, skulpturave, filmave, inçizimeve apo programeve kompjuterike dhe bazave të të dhënave (databases). Përveç të drejtës së autorit, legjislacioni i BE-së i siguron një mbrojtje të veçantë edhe të drejtave fqinje me të drejtën e autorit. Këto të drejta përfshijnë të drejtat e interpretuesve, prodhuesve të fonogrameve dhe organizatave transmetuese.

E drejta e autorit nuk mbron idetë, por vetëm shprehjen e tyre në krijime të veçanta. Kjo kërkesë krijon mundësinë e pajtimit të interesave të krijuesve dhe të shoqërisë, duke mbrojtur lëvizjen e lirë të ideve. Pra, e drejta e autorit mbron formën që i është dhënë një ideje të caktuar.

Mbrojtja e së drejtës së autorit në Bashkimin Europian i ofron krijuesit të veprës, përfitime të karakterit ekonomik, në trajtën e shpërblimit financiar për veprën e krijuar, por njëkohësisht i atribuon atij edhe përfitime me karakter moral, që konsistojnë përgjithësisht në shpalljen e autorësisë së veprës, si dhe ndalimin e shtrembërimeve<sup>13</sup> ose keq informimeve, lidhur me veprën e tij. Pikërisht, mbrojtja e të drejtës së autorit bën të mundur, që krijuesi të gëzojë të drejtat ekskluzive (ekonomike) dhe të drejtat morale të veprës së tij.

Në shumicën e vendeve Anëtare të BE-së, të drejtat morale janë të përjetëshme, ndërkohë që në disa vende të tjera, ato përfundojnë në të njëjtin moment me të drejtat ekonomike. Të drejtat morale janë të patransferueshme dhe autori i veprës mbetet gjithnjë zotëruesi i tyre. Sipas legjislacionit të Bashkimit Europian, të drejtat ekonomike ose *exclusive rights*, janë të drejta, që i përkasin autorit të veprës, por që me autorizimin e tij mund t'i kalojnë edhe personave të tjerë. Pra, këto të drejta janë të transferueshme dhe të përkohëshme. Sipas legjislacionit të BE-së, të drejtat ekonomike përfshijnë: të drejtën e publikimit të veprës, të drejtën e riprodhimit, të drejtën e prezantimit në publik, të drejtën e difuzionit, të drejtën për ta komunikuar në publik, të drejtën e shpërndarjes, të drejtën e përkthimit, të drejtën e dhënies hua apo me qira të veprës.

Për sa më sipër, autori i veprës ka të drejtën ekskluzive për të riprodhuar veprën dhe për t'ia komunikuar atë publikut. E drejta e riprodhimit e lejon autorin e veprës të riprodhojë të gjithë veprën ose pjesë të veçanta të saj. Çdo riprodhim i veprës duhet të autorizohet nga autori. Përgjithësisht, të drejtat ekonomike e humbin fuqinë e tyre 70 vjet pas vdekjes së autorit.

Legjislacioni i BE-së, sikurse edhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e të drejtës së autorit, theksojnë faktin që për identifikimin e autorit të veprës të përdoret referenca “© **copyright emri i autorit**”. Një referencë e tillë nuk është e detyrueshme për t'u përdorur, por është e nevojshme për të provuar autorësinë e dikujt mbi një vepër të caktuar.

Përgjithësisht, në shtetet anëtare të BE-së nuk është e nevojshme një regjistrim i veprës, sepse këto shtete janë palë në Konventën e Bernës (1886), sipas dispozitave

<sup>13</sup> De Robbio A. (2006) “Copyright in Europe”, Università di Padova – Italy, f. 13;

të së cilës parashikohet mbrojtje e menjëhershme e veprës, që në momentin e krijimit të saj. Megjithatë, në shtetet anëtare të BE-së janë krijuar të ashtuquajturat Zyra Kombëtare të së Drejtës së Autorit (National Copyright Offices), të cilat kanë krijuar sisteme të regjistrimit, nëpërmjet së cilave, krijuesve u sigurohen përfitime dhe lehtësira të ndryshme, si psh krijuesi mund t'ia transferojë të drejtat e tij publikuesit ose prodhuesit etj.

#### 1.2.1. *Koncepti i origjinalitetit tek veprat që gjejnë mbrojtje nga e drejta e autorit*

Në shumicën e shteteve europiane, kriteri standart për mbrojtjen e së drejtës së autorit është pikërisht *origjinaliteti i veprës*. Në këtë mënyrë, një vepër konsiderohet se përfiton mbrojtje nga e drejta e autorit, për sa kohë që ajo mendohet të jetë origjinale. Terminologjia e përdorur nga vende të ndryshme europiane, për të përcaktuar se çfarë është ajo që ka rëndësi për t'i siguruar një vepër të caktuar mbrojtje nga e drejta e autorit, është pak a shumë e njëjtë në të gjithë shtetet.

Për shembull, si në Ligjin spanjoll<sup>14</sup> “Për të Drejtën e Autorit” (*Ley de Propiedad Intelectual*), ashtu edhe në Ligjin e Mbretërisë së Bashkuar “Mbi të drejtën e autorit, disenjot dhe patentat” (*UK Copyright, Designs and Patents Act*) përdoret shprehja “vepra origjinale”. Në të njëjtën mënyrë, edhe Copyright Act në SHBA i referohet “*original works of authorship*”, Ligji italian mbi të Drejtën e Autorit (*Legge sul Diritto d'Autore*) i referohet “*opere dell'ingegno di carattere creativo*” pra, veprave të mendjes, me natyrë krijuese, Ligji gjerman mbi të drejtën e autorit (*Urheberrechtsgesetz*) i referohet “*persönliche geistige Schöpfungen*” dhe në fund vëmë re Kodin francez për të Drejtën e Autorit (*Code de la Propriété Intellectuelle*), i cili nuk i referohet saktësisht kriterit të origjinalitetit duke iu atribuar mbrojtje “*të gjithë veprave intelektuale, pavarësisht nga forma dhe mënyra e shprehjes*”. Megjithatë, edhe në këtë rast, si literatura juridike, ashtu edhe praktika gjyqësore, bien dakord me faktin që kriteri i origjinalitetit është i nënkuptuar.

Në nivel ndërkombëtar, as Konventa e Bernës (1886) dhe as Marrëveshja e TRIP-s (1996) nuk përcaktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë standartin që duhet të plotësojnë krijimet dhe veprat, në mënyrë që ato të përfitojnë mbrojtje nga e drejta e autorit. Në këtë mënyrë, vendeve palë në këto marrëveshje u është lënë shumë hapësirë për të sistemuar vetë ligjërisht këtë çështje.

Edhe Bashkimi Europian nuk ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në harmonizimin e standartit të origjinalitetit që duhet të plotësojnë krijimet dhe veprat për të përfituar mbrojtje nga e drejta e autorit. Standarti i kërkuar deri tani është arritur të harmonizohet për 3 kategori veprash të mbrojtura nga e drejta e autorit, përkatësisht për bazat e të dhënave (neni 3.1, i Direktivës së BE-së “Për mbrojtjen e bazave të të dhënave”, fotografitë (neni 6 i Direktivës “Për harmonizimin

<sup>14</sup> Balañá Vicente S. (2007) “The Originality Requirement in Copyright Law - A Comparative Study Between the Spanish, French, UK, US, German, and Italian Jurisdictions”, f. 32-33;

e afateve të mbrojtjes të së drejtës së autorit dhe disa të drejta të tjera të lidhura me të” dhe programet kompjuterike (neni 1, pika 3, i Direktivës së Be-së “Për mbrojtjen e programeve kompjuterike”. Standarti i BE-së për *“origjinalitetin”* për sa i përket bazave të të dhënave, programeve kompjuterike, dhe fotografive është se për këto vepra duhet të mendohen se janë *“krijime intelektuale të vetë autorit”*.

Sikurse u përmend edhe më sipër, në asnjë rast nuk përcaktohet saktësisht dhe nuk qartësohet se kush janë elementët më të rëndësishëm që të mund të vërtetojnë origjinalitetin e një veprë. Këto vështirësi u rritën akoma edhe më tepër, kur çështje të tilla u dërguan në gjykatë për të kryer interpretimin e të qënurit “origjinale” të një veprë, ku sigurisht që gjykata të ndryshme dhanë interpretime dhe përgjigje të ndryshme.

Ndërsa, në disa vende si Spanja dhe Franca, koncepti i origjinalitetit kuptohet si *“vulë e personalitetit të autorit”*, në vende të tjera si Britania e Madhe apo SHBA, kuptimi i këtij koncepti ka kaluar nga ideja e *“seat of the brow-djersës së ballit”* në idenë e *“të pasurit një nivel mesatar krijmtarie”*. Pra, origjinaliteti mund të jetë lehtësisht i perceptueshëm nga kushdo, por mjaft i vështirë për t’u përkufizuar.

Pra, nga sa më sipër, vende të ndryshme kanë përcaktuar standarte të ndryshme të konceptit të origjinalitetit, për të bërë të mundur mbrojtjen e veprave dhe krijimeve të autorëve, ndaj si rrjedhim të qënurit *“origjinale”* për një vepër, është e ndryshme në vende të ndryshme.

Për të gjitha veprat që gjejnë mbrojtje në mënyre specifike në legjislacionin e Bashkimit Europian, testi i origjinalitetit<sup>15</sup> konsiston në atë që ato janë *“krijim intelektual i vetë autorit”*, përndryshe Direktiva përkatëse i referohet Nenit 2 të Konventës së Bernës (“çdo prodhim në literaturë, apo në fushën shkencore dhe artistike, në çfarëdo lloj forme apo mënyre të shprehuri”). Sikurse u përmend edhe më sipër, mbrojtja e së drejtës së autorit shtrihet në mënyrën e të shprehurit, por jo tek idetë, procedurat, metodat e të vepruarit ose konceptet matematikore, sikurse parashikohet edhe në Nenin 9 (2) të TRIPS dhe Nenin 2 të WCT.

### 1.2.2. Veprat e mbrojtura nga legjislacioni i së drejtës së autorit në BE

Veprat letrare dhe artistike janë të mbrojtura automatikisht, nëpërmjet dispozitave përkatëse të Konventës së Bernës (1886). Ndërkohë që, legjislacioni i BE-së i ofron mbrojtje programeve kompjuterike, në të njëjtën mënyrë sikurse Konventa e Bernës u siguron mbrojtje veprave letrare dhe artistike (neni 1, pika 1, e Direktivës 91/250/EEC), sikurse edhe neni 10 (1) i TRIPS dhe neni 4 i WCT). Fotografitë janë të mbrojtura nga e drejta e autorit, vetëm nëse ato janë krijime intelektuale të vetë autorit (neni 6, Direktiva 93/98/EC, si dhe neni 9 i WCT). Por, Shtetet Anëtare të BE-së mund të mbrojnë edhe fotografitë që nuk bëjnë pjesë në kategorinë e sipërpërmendur, nëpërmjet mbrojtjes së të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit.

<sup>15</sup> De Robbio A. (2006) “Copyright in Europe”, Università di Padova – Italy, fq. 22;

Database-t (bazat e të dhënave) janë gjithashtu të mbrojtura, sikurse veprat letrare nga Konventa e Bernës (1886), në rast se ato janë krijime intelektuale në bazë të arsyes së përzgjedhjes apo përmbajtjes së tyre (neni 3, Direktiva 96/9/EC, sikurse neni 10/2 i TRIPS dhe neni 5 i WCT). Në rast të kundërt, atyre u sigurohet mbrojtje *sui generis*. Mbrojtja *sui generis*, që legjislacioni i BE-së u atribuon bazave të të dhënave, konsiderohet si elementi më i veçantë i këtij legjislacioni krahasuar me legjislacionet e vendeve të tjera apo me legjislacionin e SHBA-së.

### 1.2.3. Vepra të pambrojtura

Disa lloje krijimesh nuk mbrohen nga e drejta e autorit, për vetë faktin se këto krijime nuk plotësojnë kriteret për të gëzuar një mbrojtje të tillë. Në këtë kontekst, theksojmë faktin se idetë, informacionet, fjalimet politike ose vendimet gjyqësore, teoritë matematikore, algoritmat apo veprat, të cilat nuk janë origjinale, nuk gëzojnë mbrojtje nga Direktivat e BE-së.

Gjithashtu edhe ato vepra, të cilave u ka përfunduar afati i mbrojtjes së tyre (përgjithësisht 70 vjet pas vdekjes së autorit) futen automatikisht në grupin e veprave të pambrojtura.

## 2. Legjislacioni i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në fushën e së drejtës së autorit

Legjislacioni i së drejtës së autorit në SHBA udhëhiqet nga i ashtuquajtura *Copyright Act* (1976). *Copyright Act* parandalon kopjimin e paautorizuar të veprës të autorëve dhe krijuesve të veprave letrare, artistike dhe programeve kompjuterike, bazave të të dhënave etj. Në këtë kontekst, duhet theksuar fakti që nëpërmjet këtij akti ndalohet kopjimi i paautorizuar i veprës, por jo kopjimi i ideve që përmban një vepër. Sikurse është vënë re edhe në legjislacionin e BE-së, edhe në atë të SHBA-së, që një vepër të mbrohet nga e drejta e autorit duhet që kjo vepër të përmbushë kriterin e origjinalitetit, pra që vepra në fjalë të mos jetë e kopjuar, por të jetë një produkt intelektual i vetë krijuesit. Pa dashur të kalojmë në përsëritje të kriterëve apo veprave të mbrojtura nga ana e legjislacionit të SHBA-së mbi të drejtën e autorit, kalojmë në studimin e atyre që janë konsideruar si elementë të veçantë të tij.

### 2.1. Koncepti i “Fair Use” dhe kriteret e tij.

*Copyright Act*<sup>16</sup> në SHBA siguron një mbrojtje të posaçme për të drejtat ekskluzive apo të drejtat ekonomike të autorit. Megjithatë, duhet theksuar fakti

<sup>16</sup> Engle E, (2007), “When is Fair Use Fair? A Comparison of EU and US Intellectual Property Law”, f.42;

që këto të drejta nuk janë të palimituara, por mbi to ekzistojnë disa kufizime. Këto kufizime njihen nën emrin e doktrinës së “fair use”<sup>17</sup>. Kjo doktrinë është zhvilluar ndër vite nëpërmjet praktikës gjyqësore të gjykatave amerikane, të cilat janë munduar të balancojnë të drejtat e autorit me interesat e shoqërisë amerikane, për sa i përket lejimit të kopjimit të veprës në disa raste të caktuara. Kjo doktrinë ka në thelb të saj idenë që jo çdo kopjim duhet ndaluar, sidomos në rastet e kritikizmit, raportimit të lajmeve, mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Megjithëse Doktrina “Fair Use” është krijuar nga praktika gjyqësore, ajo është pasqyruar në dispozitat përkatëse të *Copyright Act*<sup>18</sup>. Kështu sipas dispozitave të *Copyright Act* në disa raste lejohet kopjimi dhe shpërndarja e veprave pa lejen apo autorizimin e mbajtësit të së drejtës. Këtu nuk jepet qartësisht përkufizimi i *fair use*, por për të përcaktuar nëse një rast do të konsiderohet “fair use” duhet që të analizohen 4 faktorë të rëndësishëm:

1. qëllimi dhe karakteri i përdorimit të veprës që gëzon mbrojtje nga e drejta e autorit. Këtu, duhet patur parasysh fakti që të bëhet dallimi nëse përdorimi i saj nga një subjekt i caktuar, bëhet për qëllime tregëtare apo për qëllime edukative, pa qëllime fitimi;
2. natyra e veprës së kopjuar;
3. sasia dhe substancialiteti i ekstraktit të përdorur, në raport me veprën e kopjuar në tërësinë e saj; dhe
4. efekti ekonomik, i mbështur në vlerën e veprës së kopjuar, vlerë kjo e përcaktuar sipas tregut përkatës.

Shpeshherë është e vështirë të vendoset nëse përdorimi apo kopjimi i një vepre të caktuar përben “fair use”, sepse të katër faktorët e sipërpërmendur çojnë në rezultate konfliktuale. Gjithsesi, në çdo rast do të jenë gjykatat, ato që do të qartësojnë interpretimin e “fair use”.

Koncepti i “fair use” vihet re edhe në Britaninë e Madhe, apo në vendet e Commonëalth-it. Edhe në këto vende, kjo praktikë është vendosur nga gjykatat e më pas është inkorporuar në legjislacionet përkatëse. Por, ky koncept nuk është përkufizuar në mënyrë të qartë edhe në këto vende. Në Kanada, kopjimi për përdorim personal është parashikuar shprehimisht si i lejuar në ligjin e vitit 1999. Ndërkohë që, në Australi, përjashtimet e *fair use* që janë pjesë e *Copyright Act* 1968, përbëjnë në vetvete një grup rrethanash të caktuara, në të cilat veprat e mbrojtura nga e drejta e autorit mund të kopjohen ose ndryshohen pa pëlqimin apo autorizimin e autorit, krijuesit apo mbajtësit të të drejtave. Në ligjin aktual

<sup>17</sup> “Fair Use” përkthehet “përdorim i drejtë”.

<sup>18</sup> Article 17 U.S.C. § 107;

australian ekziston sërish dispozita, sipas së cilës materialet apo veprat e mbrojtura me të drejtën e autorit mund të riprodhohen ose ndryshohen për përdorim personal pa lejen e autorit.

Në SHBA, akti ligjor i njohur si AHRA (Audio Home Recording Act, 1992) ndalon marrjen e masave apo sanksioneve të ndryshme ndaj konsumatorëve, që bëjnë kopje të disqeve muzikore për qëllime jo tregëtare, kundrejt pagesës dhe ushtrimit të mekanizmave kontrollues detyrues të kopjeve.

Akte të tjera ligjore që kanë amenduar Copyright Act të SHBA-së, kanë vendosur se bërja e një kopjeje të plotë të një vepre, ose të një pjese të veprës, për qëllime tregëtare, nuk do të konsiderohet si *fair use*.

## 2.2. Licencat e detyrueshme

Përgjithësisht, të drejtat ekonomike të pranuar nga Copyright Act mund të ushtrohen nga mbajtësi i së drejtës së autorit në mënyrën që ai e konsideron të përshtatshme. Nëse autori i një dorëshkrimi nuk dëshiron që vepra e tij të publikohet apo shpërndahet, atëherë ai në cilësinë e mbajtësit të së drejtave ekonomike mbi veprën përkatëse, mund të ndalojë publikimin dhe shpërndarjen e këtij dorëshkrimi. Në mënyrë të ngjashme, këto të drejta mund të kontrollohen sipas mënyrës që mbajtësi i të drejtës dëshiron, nëpërmjet licencave. Megjithatë, ka disa përjashtime nga ky rregull, të cilat janë pasqyruar në *Copyright Act* dhe shprehen nëpërmjet **licencave të detyrueshme**. Licencat e detyrueshme janë të kufizuara dhe zbatohen vetëm në 5 rrethana të caktuara:

- Për prodhimin e inçizimeve të reja muzikore, që mbështeten në inçizime muzikore ekzistuese, me natyrë jo dramatike;
- Për shfaqjen e një inçizimi muzikor, me natyrë jo dramatike, në një gramafon me monedhë (juke-box);
- Për rintransmetimin simultan nga operatorë të sinjalit televiziv kabllor;
- Për shfaqjen, paraqitjen dhe inçizimin e veprave të caktuara nga entitete transmetuese publike;
- Për ushtrimin e së drejtës së përkohshme për të ritransmetuar sinjalet televizive në rrugë satelitore për tek antenat satelitore private.

*Copyright Act* trajton edhe çështje të tjera që trajtohen edhe në Direktivat e BE-së, të cilat janë pothuajse të ngjashme. Kjo ndodh për shkak të përmasave globale që kanë marrë Konventat dhe Traktatet në fushën e të drejtave të autorit, të cilat janë munduar të unifikojnë parimet dhe konceptet kryesore të së drejtës së autorit në botë.



### 3. Konkluzione mbi dallimet dhe përparësitë e legjislacioneve të BE-së dhe SHBA-së në fushën e së drejtës së autorit

#### 3.1. Vështrim i përgjithshëm

E drejta e autorit ka gjetur mbrojtje nga shumica e legjislacioneve në botë. Megjithatë, mbrojtja që i bëhet kësaj të drejte nuk është kudo e njëjtë. Kështu, mënyra e realizimit të mbrojtjes ligjore që i sigurohet së drejtës së autorit në SHBA ndryshon nga ajo europiane, sepse edhe vetë legjislacionet respektive janë zhvilluar mbi baza dhe koncepte të ndryshme ligjore.

Legjislacioni i Shteteve të Bashkuara të Amerikës<sup>19</sup> në fushën e së drejtës së autorit mbështetet në Common Law dhe në konceptin e të ashtuquajturit “Fair Use”, ndërsa sistemi evropian i së drejtës së autorit e ka origjinën e tij nga e drejta romake dhe nga e ashtuquajtura “paternity right”.

Pjesa më e madhe e vendeve europiane, markat dhe patentat i identifikojnë me termin “Pronësi Industriale”, ndërkohë që në SHBA, për të dyja kategoritë (e drejta e autorit dhe pronësia industriale) përdoret termi “Pronësi Intelektuale”.

Termi “copyright” që përdoret në SHBA reflekton pikërisht orientimin e SHBA-së në trajtimin dhe mbrojtjen e kësaj të drejte. E drejta amerikane thekson rolin ekonomik të së drejtës së autorit. Pra, synimi kryesor në këtë rast është mbrojtja e të drejtave ekonomike (ecscluzive rights).

Tradicionalisht, në SHBA “copyright”-i është parë si një e drejtë që synon të nxisë zhvillimin e artit, ndërsa mbrojtja e autorit e veprës është parë vetëm si rruga apo mjeti për ta arritur këtë synim, por nuk është vetë synimi. Kjo duke qartë në Nenin 1, Par. 8 të Kushtetutës Amerikane<sup>20</sup> ku parashikohet: “Kongresi gëzon të drejtën të nxisë zhvillimin .... e arteve të dobishme, duke u siguruar për afate kohore të kufizuara autorëve... të drejta ekskluzive në lidhje me shkrimet.... e tyre”.

Në Evropë ndodh e kundërta. Legjislacioni evropian në këtë fushë, kur mbron veprën, synon të mbrojë autorin si individ. Në të drejtën kontinentale, e drejta e autorit buron nga të drejtat e personalitetit të krijuesit. Të drejtat e autorit bazohen kryesisht në nocionet e së drejtës natyrore: “Të drejtat e autorit nuk krijohen nga ligji, por kanë ekzistuar gjithmonë në ndërgjegjien e njeriut”. Në filozofinë e pastër të “droit d’auteur”, e drejta e autorit është thelbësisht një e drejtë natyrore e pakufizuar, që reflekton lidhjen e ngushtë ndërmjet autorit dhe krijimit të tij, personal. Ky perceptim është reflektuar edhe në emrin “e drejtë e autorit”. Mbrojtja synon të respektojë veprimtarinë krijuese dhe shtrihet, përtej përfitimeve ekonomike edhe tek të drejtat morale.

<sup>19</sup> Ravicher M., (2007), “Originality Requirements under U.S. and E.U. Copyright Law”, f.17-18;

<sup>20</sup> USA Constitution Act, Section 8.

#### 3.2. Roli i të drejtave morale në legjislacionin e USA dhe vendeve të BE-së

Në Europë sistemi “droit d’auteur” është i orientuar për mbrojtjen e autorit, ndërkohë që në sistemin “copyright” të SHBA-së, sikurse u përmend edhe më sipër, të drejtat morale nuk gjejnë mbrojtje dhe me “copyright” do të kuptohet e drejta e përdoruesit për të bërë një kopje të veprës. Pra, dallimi kryesor ndërmjet dy sistemeve është pikërisht trajtimi i të drejtave morale apo “les droits morale”.

Për të argumentuar sa më sipër, diskutojmë çështjen gjyqësore të Campbell v. Acuff Rose<sup>21</sup>, të gjykuar në një gjykatë të SHBA. Në këtë çështje, grupi muzikor rap “Tëo Live Creë” përdori këngën e famshme të Roy Robinson “Pretty Woman” si model të njëres prej këngëve rap në një album të tij, pa lejen paraprake të Orbinsonit. Gjykata e Lartë amerikane u shpreh në favor të “Tëo Live Creë”, sepse sipas gjykimit të saj përdorimi i veprës përfshihej në kategorinë e “fair use”, për shkak se grupi rrepist e kishte përdorur këngën për të parodizuar veprën origjinale. Theksojmë faktin se paroditë dhe satirat janë të mirënjohura në praktikën gjyqësore amerikane si raste të mirëfillta të “fair use”.

Në rast se çështja e sipërpërmendur do të ishte gjykuar në Evropë, Acuff-Rose nuk do ta kishte fituar çështjen. Një gjykatë europiane në vendimin e saj do të kishte arsyetuar që një rast i tillë ishte një shkelje e hapur e të drejtave morale të autorit të këngës, duke i ndryshuar dhe parodizuar lirikën e këngës.

#### 3.3. Ndryshime dhe përparësi të dy legjislacioneve në fushën e së drejtës së autorit

Dallimi midis copyright-it në vendet e Common Law dhe të drejtës së autorit në vendet e Civil Law reflektohet në dispozita të ndryshme të ligjeve respektive të vendeve që u përkasin këtyre sistemeve: psh. Tradita anglo-amerikane i jep mbrojtje edhe regjistrimeve të tingujve (fonogrameve) dhe programeve radio-televizive, ndërsa tradita kontinentale europiane përdor një grup më vete për këto vepra, që quhet “neighboring rights” ose të drejtat fqinje.

Kur vepra krijohet gjatë një marrëdhënieje pune, e drejta anglo-amerikane njeh pronar të parë të copyright-it, punëdhënësin e autorit, ndërsa e drejta kontinentale europiane konsideron pronar vetë autorin. Sikurse përmendëm edhe më sipër, në të drejtën anglo-amerikane, të drejtave morale nuk u sigurohet mbrojtje në nivelin e të drejtave ekonomike, ndërkohë që në të drejtën kontinentale europiane, që përfshin legjislacionet e Vendeve Anëtare të BE-së, por edhe legjislacionet e vendeve të tjera europiane, të drejtat morale kanë një rëndësi të veçantë dhe mbrohen posaçërisht.

<sup>21</sup> Simpson B., (2004) Copying case highlights of EU over US law, pages 34-35;

Në disa raste, e drejta e autorit e inkorporuar në Direktivat e BE-së u garanton një mbrojtje më efikase veprave të caktuara. Për të qënë më konkretë, i referohemi mbrojtjes ligjore që SHBA dhe BE i japin bazave të të dhënave.

Megjithëse, bazat e të dhënave mbrohen si të tilla nga ligji i copyright-it në SHBA, të dhënave të veçanta të tyre (brenda/në përmbajtjen e bazës së të dhënave) nuk u garantohet automatikisht mbrojtje ligjore. Sipas *Copyright Act* mbrojtja i sigurohet vetëm bazës së të dhënave në tërësi, por kjo mbrojtje nuk shtrihet edhe tek të dhëna të veçanta në brendësi të kësaj bazë të të dhënave.[17 U.S.C.§103(b)] Pra, një bazë të dhënash mbrohet vetëm në tërësinë e saj. Kështu, për të qartësuar sa më sipër, japim një shembull. Në një database të citimeve që kanë bërë presidentët e SHBA-së ndër vite, nuk do të konsiderohet shkelje nxjerrja apo kopjimi nga kjo bazë të dhënash, të një citimi apo thënieje të Xhorxh Uashingtonit, por do të konsiderohej shkelje vetëm kopjimi i të gjithë database-it, për sa kohë që database-i i plotëson kërkesat e origjinalitetit dhe krijmtarisë sipas vendimit të gjykatës amerikane në çështjen *Feist*.

Në çështjen **Feist<sup>22</sup> Publication, Inc. V. Rural Telephone Service Company, Inc.**, Gjykata e Lartë e SHBA-së vendosi që një vepër e përpiluar në formën e një baze të dhënash (database) duhet të përmbaje një nivel minimal krijmtarie në mënyrë që të mund të gëzojë mbrojtje ligjore nga *Copyright Act*.

*Rural Telephone Service Company, Inc.* ishte një shoqëri telefonike, lokale në Kansas (SHBA) që botonte numratorë telefonikë, me të dhënat e përfitura nga pajtimtarët e saj. *Feist Publications, Inc.* ishte një botues numratorësh telefonikë që mbulonte një territor në një shkallë të madhe gjeografike. Për të botuar numratorin e tij telefonik, *Feist Publications, Inc.* kishte nevojë për të dhënat që *Rural Telephone Service Company, Inc.* kishte elektronikisht në database-in e tij. Fillimisht *Feist Publications, Inc.* u mundua të liçensonte informacionin drejtpërdrejt nga numratorët telefonikë të *Rural Telephone Service Company, Inc.*, por kur ky i fundit refuzoi, *Feist Publications, Inc.* kopjoi elektronikisht listat e pajtimtarëve nga direktoria elektronike e *Rural Telephone Service Company, Inc.* Megjithëse, *Feist Publications* e ndryshoi shumë renditjen e pajtimtareve dhe të dhënave të tyre nga listat e kopjuara nga *Rural Telephone Service Company*, sërisht shumë të dhëna të tjera ishin identike me listat e numratorëve të këtij të fundit.

Për këtë arsye, *Rural Telephone Service Company* e paditi *Feist Publications* për shkelje të së drejtës së autorit, duke kopjuar database-in e tij, mbi bazën e të cilit kjo shoqëri botonte numratorët telefonikë për pajtimtarët e saj.

Dy gjykata lokale i dhanë të drejte *Rural Telephone Service Company*, duke e konsideruar shkelje të së drejtës së autorit veprimin e *Feist Publications*. Megjithatë, Gjykata e Lartë vendosi që në këtë rast nuk kishin të bënin me shkelje të së drejtës së autorit. Sipas Gjykatës së Lartë, ekstraktet e të dhënave apo përzjerjet

e të dhënave të database-ve janë të pambrojtur nga e drejta e autorit. Mbrojtja do të ekzistonte vetëm në rast se të dhënat do të ishin të kopjuara, renditur dhe klasifikuar në mënyrë identike si vepra origjinale dhe pikërisht në këtë rast do të konsiderohej se *Feist Publications* do të kishte shkelur të drejtën e autorit kundrejt *Rural Telephone Service Company*.

Mbrojtja e kufizuar e bazave të të dhënave në SHBA, ka bërë të nevojshme që autorët e tyre t'i mbrojnë këto të fundit nëpërmjet kontratave. Vetëm nëpërmjet një kontrate apo liçence përdorimi për database-in, autorët e tyre mund të parandalojnë nxjerrjen ose kopjimin e ekstrakteve nga database-i original. Për shembull, një kontrate mund të ndalojë një përdorues të kopjojë ekstrakte të saj, apo t'i përfshijë këto ekstrakte në një database të ri, duke e bërë këtë database të disponueshëm vetëm për persona të autorizuar.

Ndërkohë, mbrojtja ligjore që iu rezervohet bazave të të dhënave në Europë, është më e madhe. Në bazë të Direktivës “Mbi mbrojtjen e databaseve”, 11 mars 1996, një database mund të mbrohet në dy mënyra.

*Së pari*, Direktiva parashikon se database-t do të mbrohen nga ligji për të drejtën e autorit vetëm kur seleksionimi ose sistemimi i të dhënave në të përbën një krijim intelektual të vetë autorit. Ky parashikim ligjor është pak a shumë i njëjtë me atë të SHBA-së.

*Së dyti*, Direktiva i siguron mbrojtje *sui generis* bazave të të dhënave, duke ndaluar kopjimin apo nxjerrjen e ekstrakteve nga to. Efektivisht, kjo Direktivë u jep database-ve në Europë mbrojtjen që rrjedh nga parimi “djersa e ballit”, parim i cili u përjashtua nga çështja *Feist* në SHBA. E drejta e mbrojtjes *sui generis* zgjat për 15 vjet nga data e krijimit të database-it.

Në disfavor të interesave amerikane, në Europë<sup>23</sup>, e drejta *sui generis* aplikohet vetëm për database-t e krijuara nga kompanitë/shoqëritë në vendet e BE-së. Për këtë arsye, kompanitë europiane përfitojnë me tepër mbrojtje, në lidhje me bazat e tyre të të dhënave, se kompanitë amerikane.

Tradita ligjore amerikano-veriore ka pasur ndikimet e saj edhe në Europë. Kështu, legjislacioni mbi të drejtën e autorit në Britaninë e Madhe, edhe pse paksa i ndryshëm nga ai i SHBA, është jo pak i ndikuar nga ai, sepse të dy legjislacionet mbështeten fuqimisht në Common Law. Megjithatë, duhet theksuar fakti që Direktivat e BE-së në fushën e të drejtave të autorit kanë pasur një ndikim shumë të fuqishëm në Angli, për vetë faktin se këto Direktiva kanë qënë të detyrueshme për zbatim në të gjitha vendet e BE-së, ku bën pjesë edhe Britania e Madhe.

Megjithatë, si rrjedhim i Marrëveshjeve dhe Traktateve Ndërkombetare mbi mbrojtjen e së drejtës së autorit, ligjet europiane dhe amerikano-veriore në këtë fushë janë përafër, duke bërë të mundur zbutjen e ndryshimeve dhe diferencave në trajtimin e këtyre çështjeve.

<sup>22</sup> Simpson B., (2004), Coping case highlights of EU over US law, fq. 98-104;

<sup>23</sup> Hugenholtz, P.B., (2000) Copyright & freedom of expression in Europe, fq. 85-89;

## Bibliografia

1. Council Directive 91/250/EEC of 14 May 1991 “On the legal protection of computer programs”;
2. Council Directive 92/100/EEC of 19 November 1992 “On rental right and lending right and on certain rights related to copyright in the field of intellectual property”;
3. Council Directive 93/98/EEC of 29 October 1993 “On harmonizing the term of protection of copyright and certain related rights”;
4. Directive 96/9/EC of the European Parliament and of the Council of 11 March 1996 “On the legal protection of databases”;
5. Directive 2001/29/EC of the European Parliament and of the Council of 22 May 2001 “On the harmonisation of certain aspects of copyright and related rights in the information society”;
6. Directive 2001/84/EC of the European Parliament and of the Council of 27 September 2001 “On the resale right for the benefit of the author of an original work of art”;
7. Directive 2004/48/EC of the European Parliament and of the Council of 29 April 2004 “On measures and procedures to ensure the enforcement of intellectual property rights”;
8. Koçi E., (2005), “Pronësia Intelektuale”, Shtëpia Botuese “Erik”;
9. S.Balaña Vicente (2007) “The Originality Requirement in Copyright Law - A Comparative Study Between the Spanish, French, UK, US, German, and Italian Jurisdictions”;
10. Loëenstein J. (2002), “The author’s due: Printing and the prehistory of copyright”, University of Chicago Press.
11. Hugenholtz, P.B, (2000) Copyright & freedom of expression in Europe.
12. May C. (2002), “The Venetian moment: New technologies, legal innovation and the institutional origins of intellectual property”;
13. Patterson L.R., (1999) “Copyright in historical perspective”, Vanderbilt University Press;
14. Birrel A., 1899, (1971 Reprint), Seven Lectures on the law and history on copyright books, Rothman Reprints Inc.;
15. Holleman J. R. (2002), Comments on standards setting and intellectual property;
16. De Robbio A. (2006) “Copyright in Europe”, Università di Padova – Italy;
17. Homiller D. P. (2006) “The Digital Millennium Copyright Act and the European Union Copyright Directive: Next Steps”;
18. Engle E., (2007), “When is Fair Use Fair? A Comparison of EU and US Intellectual Property Law”;
19. Ravicher M., (2007), “Originality Requirements under U.S. and E.U. Copyright Law”;
20. Simpson B., (2004) Copying case highlights of EU over US law,
21. Londo I. (2007) “E Drejta e Autorit”, Instituti Shqiptar i Medias;
22. European Commission, (2005), Study on a community initiative on the cross-border collective management of copyright;
23. Report on responses to the European Commission Green Paper on Counterfeiting and Piracy, June 1999;
24. European Law Journal, Vol. 13, No. 5, September 2007, pp. 680–694., Journal compilation © 2007 Blackwell Publishing Ltd,
25. Summary of Berne Convention for the Protection of Literary and Artistic Works (1886);
26. Summary of WIPO Copyright Treaty (WCT) (1996);
27. Summary of WIPO Performances and Phonograms Treaty (WPPT) (1996);

## RECENSË

*Recensë mbi librin “Pesë leksione  
mbi konstitucionalizmin” të autorit  
Spartak Ngjela*

---

*Dokt. Marsidi Gupi*

---

Demokracia kushtetuese është një lloj sistemi politik, i cili garanton ekuilibrin shoqëror nëpërmjet kushtetutës. Pra, kjo lloj demokracie krijon edhe konstitucionalizmin sepse po të ishte vetëm demokraci, sistemi patjetër që do të nënkuptonte një pushtet politik të dalë nga zjedhje të lira, por që i takon vetëm shumicës. Me një kushtetutë të shkruar, sistemi politik që doli nga konventa e Filadelfias dhe që ishte akti juridik që solli modernitetin, nënkupton dicka më tepër, garantimi i të drejtave të individit dhe vetë pakicës. Autori me këtë moment e nis sqarimin e konceptit të konstitucionalizmit për të treguar se është i vërtetë postulati: “Drejtësia më e madhe në raport me numrin, prodhon padrejtësinë më të madhe, pasi ndërkohë që pjesës më të madhe i garantohen dhe sigurohen të drejtat, pjesës më të vogël ose minorancës i shkelen tërësisht”.

